

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

51  
70

JGURI  
MIÇINOTI

GJILPËRA

roman

811a.51  
NI 30

# GURI MIÇINOTI

# GJILPËRA

roman



6448

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KAPITULLI I PARË

### 1.

Dhosì Qafëzezin, magazinierin e pjesëve të këmbimit, e njihnin që të gjithë punëtorët e punëtoret e kombinatit. Shkas për këtë ishte bërë rregulli e pastërtia që ai kishte vendosur në magazinën e tij.

Dhosì trupgjatë, me kocka të dala nga supet, me hap disi të nxituar ndaloi përpara portës së drejtorisë si një ushtar i disiplinuar në qëndrim gatitu. Trokiti lehtë. Priti përgjigjen që duhej t'i vinte nga brenda, po nuk dëgjoi asgjë.

Dhosì Qafëzezi dukej mjaft i shqetësuar. Ai pshëritiu e u mat të largohej nga korridori, por në çast u hap një derë tjetër dhe një zë i njohur femre e ndali në vend:

— Urdhéroni, xha Dhosi, drejtori më telefonoi dhe më porositi t'ju prisja unë në vend të tij.

— Mirë, shoqja kryeinshiniere, ja, erdha!, — iu përgjigj Dhosi e fityra i mori një dritë gëzimi e respekti. Poshtë ballit të kërcyer shkëlqenin sytë e zinj. Ata ngjasonin si prush zjarri e cullufja që i varej poshtë i jepte plakut një hije si ajo e Çarli Çaplinit.

## 2.

Në zyrë, ngaqë drita hynte nga dritaret e mëdha, magazinierit i dukej kryeinshinierja më e plotë dhe më e gjatë se ç'ishte. Pastaj ai vështroi tavolinën e gjatë mbuluar me kadife të kaltër, sipër së cilës mbështeti pëllëmbët e tij të mëdha.

— Shoqja Margarita, më falmi, por jemi shumë keq me gjilpërat, — tha ai dhe ndjeu sikur mallëngjimi i tij u ngjit dhe në ftohtësinë e vajzës që u pre në fytyrë.

— Gjilpërat!, — u habit ajo.

— Po!

— Mos vallë u mbaruan dhe seritë e fundit? — Në zërin e kryeinshinieres ndihej një qortim i heshtur.

— Jo, nuk i kam prekur ato, shoqja kryeinshiniere, por ta dini se nuk janë shumë.

— Sa?! — ngriti vetullat kryeinshinierja.

— Pesë mijë!

— Mos harro se kemi rezervën, xha Dhosi!

— Oh, megjithatë, shoqja kryeinshiniere, këtë javë ato të shkreta po thyhen sikur tëjenë kleçka për qërimin e dhëmbëve. Apo jo?, — i kërkoi ai miratim për krahasimin.

Margarita ia qepi sytë thellë fytyrës disi të fishkur të Dhosit, i cili uli vështrimin. Siç dukej ai ishte mësuar të fshihte diçka nga rezervat, por vajza ishte e stërvitur mirë dhe ai nuk e duroi dot atë vështrim dhe i buzëqeshi.

— Mos më fshih gjë, xha Dhosi??

— Jo. Të betohem që jo. Nuk kam asgjë në raftet.

Margarita e drejtoi vështrimin nga dritaret që zotëronin sheshin e kombinatit dhe u kthyte me vrull nga magazinieri që, me njëfarë nervozizmi, po trokiste gishtëri-njtë e trashë në tavolinën e mbuluar me kadife.

— Edhe këtë gjendje të vështirë doemos do ta kalojmë, xha Dhosi.

Magazinieri, që posa i kishte mbushur të pesëdhjetat, lëvizti supet dhe miratoi me kokë. Por, duke e vështruar atë vajzë të fortë e të bukur, atij iu kujtua dita e parë e ar-

dhjes së saj në punë. Ishte një vajzë e druojtur, e turpshme, që skuqej e skuqej si të kishte bojën në faqet buçkë. Po sa vjet kishin rrjedhur qysh atëherë? Dhosi u përpinq t'i numëronte, por atij iu duk sikur llërët e bardha të vajzës i kishin kapur nofullat e zeza të një kafshe të llahtarshme, që quhej bllokadë, e cila po përpinq t'i bluante me egërsi gjithë eshrat.

Ai fërkoi sytë si të zgjohej nga një èndërr e llahtarshme e ndeshi në buzëqeshjen e çiltër të vajzës.

## KAPITULLI I DYTË

### 1.

Dhosì Qafëzezi renditej në mes njerëzve të ditur në kombinat.

Njohuritë e tij ai i pat mbledhur si bleta polenin në gjithë bisedat që dëgjonte nga punonjës të ndryshëm dhe nga librat teknikë që lexonte. Ai nuk do të habitej, sikur dikush t'i fliste për shpikjen e trenave që shkojnë mbi jastëkët e ajrit, për radio me tranzistor të vogël sa një kuti shkrepësesh e për shumë shpikje të tjera teknike. Por Dhosi Qafëzezi u habit që gjilpërën e trikove, me një gjuhëz të vogël sa një këmbëz karkaleci, e prodhonin vetëm ca shtete, dhe çfarë shtetesh se, me një industri e teknikë të përparuar! Ai mori lapsin dhe filloi të llogariste se sa valutë prishtë shteti për gjithë gjilpërat që kombinati harxhonte për një vit dhe, kur pa rreshtin e gjatë të shifrave, tha: «Shumë para!».

Valutën ai e njinte mirë. Kjo e vuri atë në mendime dhe në heshtje u betua se nuk do të tregohej aq dorëlëshuar për nxjerrjen e gjilpërave nga magazina. . .

Atij për një çast iu duk sikur po e shihte valutën që ishtë hequr nga thesari dhe derdhej e derdhej për të nga-

pur makinat e thurjes në inderlogë<sup>1</sup> me gjilpëra që nuk kishin të sosur!

Dhosì Qafëzezit iu kujtuan artikujt e shtypit që flisnin për kolektiva të tërë punëtorësh që kursenin e vetëm kursenin. «Përse të mos kursente dhe reparti i makinerive? Përse të harxhoheshin kaq shumë gjilpëra? Mos vallë kaq ishtejeta e tyre e gjatë e pastaj ato kthehen në kufoma!».

Dhosì iu ngroh zemra që e rendiste veten në mes njerezve që kursenin e për më shumë që këta njerëz të mirë ishin punëtorë të thjeshtë.

«Ca shtete! Vetëm ca, por ato që nxirrnin gjoksin ishin tri!...» — pëshpëriti ai. Iu kujtua diçka nga e kaluara. Triniteti i shenjtë, i lidhur dhe ai me ato shtete që prodhojnë gjilpërën. Baballarët e saj duhej të ishin si formula ungjillore «I atit, i birit, i shenxit», dhe gjilpërën ata e përdornin si formulën ungjillore për të nënshtuar të tjerët, sidomos ata që u zgjatnin duart.

Dhosì Qafëzezi filloj të vriste mendjen se cila nga venglat që përdorej në jetë kishte të bënte me shfirën tri shtete.

I doli perustia. Dhe ajo kishte tri këmbë si një venduzë me tri këmbëza. Tri, tri, tri... një numër fatal, i keq.

Dhosit iu kujtua vogëlia e largët e nëpër mjegull të harresës ngjallej zëri i gjyshes së tij, Dhoksisë, që i tregonte për kreshnikë që ndalonin mes tri rrugësh e mendoheshin se nga duhej të shkonin përfatin e tyre. Nga e para që humbiste kali, apo nga e dyta nga humbiste kali dhe kalorësi, apo nga e treta, nga nuk dihej nëse kthehej i gjallë ose jo!

Iu kujtua kisha. Dhe ajo tri kambanore kishte. Në kishë shërbënин tre priftërinj, kungonin në tri kupa, jepnin nga tri lugë verë, nga tri nafora, nga tri, nga tri...

Dhosì shkoi për të mbledhur zemrën në bankun tek bëheshin kafetë. Atje ndeshi me kurrizin e inxhnier Stefanit. Njeri i çuditshëm ishte ai inxhinier Stefani. Ai u kthente shpinën njerëzve, ves i keq i pahonepsur, një e

metë e madhe për të, por ai as skuqej dhe as nxihej, se pse ishte i zeshkët e me pikla lie në fytyrë. Vinte nga një familje e mesme. Ai pat mbaruar studimet jashtë shtetit dhe mburrej përparrë të tjerëve që kishte parë tokë e male pa mbarim që i takonin një së gjashtës së botës. Ishte i habitshëm ky njeri, por Dhosi dinte të zbuste edhe vetë tigrin e jo më inxhinier Stefan Grabovën. Ai priti sa tjetri të mbaronte së rufituri kafenë dhe pastaj i foli:

— Inxhinier Stefani, dua t'ju pyes për diçka, por ju duhet të më tregoni të vërtetën.

— E dashke shumë të vërtetën, o Dhosi, — i qeshi ai me ata sytë e tij si të ngjyer në këna.

— E vërteta të çlodh, o inxhinier, se nuk e verifikon më për ta dalluar nga e gënjeshtërtë.

Dhosi Qafëzezi i vështroi dhëmbët e tij të verdhë, të rrallë si hunj gardhi. Sa të pështirë i dukeshin ata dhëmbë të mëdhenj dhe ato buzë të holla që vërtitnin cigaren e duhanit.

— Pa fol, Dhosi, hë, çfarë halli të mundon?

— Sa shtete e prodhojnë gjilpërën, inxhinier?

Shpejtësia dhe padurimi me të cilën Dhosi e bëri pyetjen, e egërsoi fytyrën e inxhinierit, i cili e mbuloi me një vështrim përcmues.

— Ç'të ka hipur në kokë gjilpëra e shtetet që e prodhojnë, apo mos vallë dhe ti vazhdon studimet për inxhinieri?

Ai si një arap i një mijë e një netëve kishte dalë nga shishja magjistare për t'u tallur me Dhosin.

— Kot, dua ta di!

— Dy-tri shtete (e gënjeu Stefani).

— Unë dija më shumë, inxhinier! — e ndezi ai.

— Hip këtu e të shohësh Stambollin, të tjerat s'ke ç'i vë në hesap, — ia priti ai dhe u largua nga bufeja si një trung qymyri.

Dhosi mbeti i shtangur. I erdhi inat që nuk gjeti dot ndonjë fjalë që t'ia lëshonte në kurriz. Ndjeu një si marrje mendsh... Dy-tri shtete... Dy-tri!...

## 2.

Jashtë binte shi i rrëmbyeshëm. Pelljet e rrugës ishin bërë pishina. Zhurma e ujit që përpinqej e shtyhej për të kaluar nëpër vrimat e shkarkimit të cingëristë nervat. Sipër tyre si barka të vogla e të habitshme lundronin gjethet e thata ngjyrë bakri.

Margarita ecte mes shiut dhe nuk e nxitonte hapin. Uji shkiste në çadrën e vogël ngjyrë vjollce dhe çorapet e holla pikëlohesin nga balta që ngrinte hapi i ngadalshëm i saj.

Kush do ta vështronte këtë vajzë të veshur thjesht e bukur që nuk e prishte terezinë nga shiu? Mundet që në thellësi të shpirtit të saj diçka digej e ajo kërkonte shiun për ta shuar atë mllef të prushtë.

Vajza vështroi njëherë me nge të gjitha automjetet e vendosura përballë hotelit të ri. I numëroi sa copë ishin ato, pastaj markat e targat e qyteteve dhe iu kujtua kongresi i gruas, kongresi në të cilin ajo përpara disa vjetësh pat marrë pjesë. Autokolona e autobusëve me delegatet, përshëndetjet e njerëzve që pritnin delegatet, këngët partizane që nuk kishin të mbaruar, pastaj zbritja në bulevardin e madh që të conte në sallën e kongresit të flakëruar me ngjyra të kuqe flamurësh.

Margaritës i kujtohet se kur në sallë u dha shoku Enver, ajo ndjeu që në faqet e saj të njoma po shkisnin pika loti. Po ata ishin lot gjëzimi e lumturie!

Margaritës iu lagën faqet nga shiu dhe e mërzitur nga mungesa e gjilpérave, mezi u kujtua se takimi i lënë me Arbenin duhej të bëhej pikërisht në atë orë.

Hyri në hollin e ngrohtë të lokalit luksoz. Hapi portën dhe, posa hyri në lokal, ndali vështrimin te tavolina ku ishte ulur Arbeni dhe u nis me hap të sigurt.

## 3.

Arbeni u ngrit në këmbë. Ajo i zgjati dorën dhe buzëqeshi lehtë.

— Jeni e përpiktë si akrepat e sahatit, — tha Arbeni buzëgaz duke tërhequr karigen.

— Sa pak femra që ka këtu, Arben!

— Ashtu éshtë!, — tha ai dhe i erdhi inat që nuk kish-te ndonjë çift tjetër në gjithë atë sallë. Kështu ata do ta ndienin veten më lirshëm.

— Ju sikur më kërkonit pér të biseduar diçka të rën-dësishme, Arben.

— Ju nuk keni porositur akoma gjë pér të pirë...

— Një ponç portokalli do të më pëlqente, jashtë éshtë ftohtë e ka lagështi.

Ajo ndoqi kurrizin e kamerieres që nxitoi hapat dhe pér një çast ndeshi vështrimin e ftohtë të syve tinzarë të Stefan Grabovës. Po ai! Mos vallë i kishte vajtur prapa pa u vënë re? Ndoshta, por vështrimi i tij me atë dinakëri Margaritës i kujtohej se e pati ndeshur në Moskë në sheshin «Pushkin» atë ditë të nxeh të korriku. Vajza u zymtua në fytyrë.

— Çfarë patët kështu, Margarita? — pyeti Arbeni.

— Asgjë. Më tregoni përsë më deshët?

— Ndoshta ju kam shqetësuar kot së koti, por ka kohë që po më mundon një mendim, Margarita.

Arbeni heshti dhe vështroi lëngun e përskuqur të ponçit që nuk lëvizte në gotën e kristaltë.

— Më tregoni çfarë ju mundon.

— Gëzuar! — Ai e çukiti gotën duke ia prerë fjalën më dysh.

— Flisni, pra!

— Ç'të flas, ndoshta éshtë iluzion! — Ai fare pa shkak po fshihej përpara vajzës.

— Nuk ju kam njojur si njeri që prisni lutje pér të shfaqur mendimet, Arben!

— Fjalën e kam pér gjilpërën.

— Pér gjilpërën?!

— Pikërisht..., — u përgjigj Arbeni dhe e mbuloi me vështrimin e tij.

«Mos vallë magazinier Dhosit i ka shkarë gjuha!», — mendoi Margarita dhe tundi kokën.

Arbeni e pa vajzën të zverdhej dhe u tremb. Përse ky ndryshim?

— Çfarë patët kështu?

— Asgjë. Më vjen nga tymi i duhanit. Por ju më flisni më shkoqur për gjilpërën.

— Mendoj se ajo mund të prodhohet në vend, me forcat tona, Margarita!

Ajo i nguli sytë Arbenit.

Arben Korça ishte një djalosh me trup mesatar, më flokë kaçurrel si një drizë e mbushur me rrodhe. Fytyra e tij kishte një ngjyrë të kuqërrëmë nga gjaku që i shkonte në damarët e trashë të qafës të tkurrur si një trup hardhie. Ekte çapraz e kjo binte më shumë në sy, ngaqë këpucët i hante nga anët e thembrave më shumë e dallohej që larg se ai lëkundej si një marinar në kuvertën e anijes.

Ballin e gjerë e kishte të kërcyer përpara. Gjerësia e ballit tregonte se ai kishte një këmbëngulje mushke.

— Në vend! — u habit ajo.

— Po, — tha ai i vendosur.

— Mos bëni shaka, Arben?

— E kam seriozisht, Margarita.

— Ndoshta ju mendoni që të vijnë makineritë e prodhimit të gjilpërës nga jashtë shtetit e ato të prodhohen këtu, apo jo?

— Mendoj që makineritë e prodhimit të gjilpërës të prodhohen këtu me forcat tona.

— Dëshirë e bukur, Arben, po midis dëshirës e mundësive tona për ta bërë realitet, më duket se kemi një mal të tërë, — tha ajo.

— Kurse unë mendoj se ne jemi në gjendje të shehshojmë male dhe të ngremë male të reja me forcat tona edhe në fushën e teknikës, Margarita!

— Ëndrra të guximshme sheh ti, Arben!

— Veç jam i bindur se me forcat tona të bashkuara mund ti bëjmë realitet, Margarita!

### 3.

Godina e oficinës, e veshur me xham që nga çatia deri në mesin e saj, shtrihej poshtë lulishtes së kombinatit. Rrëketë e ujit që nuk futeshin në ulluk kishin përskuqur fajen e murit si me ndryshk, sa ajo ngjasonte me lëkurën e ndonjë indianë të Amerikës së Veriut. Ky përfytyrim bëhej më bindës kur vështroje dhe shiritat e ndryshëm të hequr me granil me ngjyrat e ylberit që i vareshin ndërtesës si kordele zbukurimi. Përpara oficinës ngriheshin dy pirgje mbeturinash spirale e bluashka të metaleve të punuara që nuk kujtohej njeri për t'i hequr. Atje të vriste hundët era e athët e acidit klorhidrik.

Pozicioni ku ishte ndërtuar oficina, e largonte atë nga drejtoria. Kjo distancë kishte të mirat dhe të këqijat e saj. E mira ishte se drejtoria, duke e pasur larg oficinën, ishte e qetë dhe nuk shqetësohej nga gërvishtja e metaleve që punoheshin në tornot që t'i cingëris nervat. E keqja ishte se kontrolli ndaj oficinës nga drejtoria nuk bëhej shpeshherë siç ndodhët me repartet e tjera që ata i kishin pothuajse te dera.

Në vitin 1960, atëherë kur ndodhnin të gjitha ato tronditje në botë, në kombinat që ndezur debati për të ruajtur si sytë e ballit pasurinë e makinerinë që u ishte besuar punëtorëve. Atëherë ndodhi një avari, një difekt i rëndë në repartin e çorapeve. Fytyrat e mekanikëve dhe të mjeshtërve të repartit morën ngjyrën e dheut. Atë ditë u ndodh në kombinat dhe inxhinieri Endrih Shtojf. Ai me ata sy të qelqtë si pa jetë e kundroi njëherë kokën e thyer tek vendosej çorapja për t'u thurur.

— Kaput, — tha ai dhe sytë iu ndezën si të kishte lla mbushka njëzetekatërvoltëshe në bebëzat e tyre.

— Inxhinier, ne kemi shumë nevojë për çorapet, si do të bëjmë për riparimin e difektit?, — i tha përkthyesja, një grua e thyer në moshë e që e zotëronte gjermanishten.

— Duhet dërguar në Gjermani, vetëm atje mund ta riparojnë difektin. Këtu nuk ka mundësi! — tha Shtojfi

dhe ktheu kurrizin pa i lëvizur fare gjaku në fytyrën e tij të përhimë.

— Moj motrani, as skuqet, as zverdhet ky njeri, vallë ka gjak ky djall? — tha Vojsava, një punëtore topolake, që ngjasonte me një kuzhinierë.

— Po të kishte gjak, ai do bëhej copë për ta riparuar difikatin, — ia priti tjetra.

— Pika!

— Kallja datën, lëre të shikojë punën e tij.

— Pse, o motrani, të presim vetëm nga ky njeri si mermer? Shkojmë njëherë nga djemtë tanë në oficinë, — tha brigadierja, një vajzë e hollë.

Në repartin e çorapeve u derdhën njëri pas tjetrit inxhinierët dhe mekanikët e kombinatit.

— Vështirë, shumë vështirë!, — u shpreh i pari inxhinier Stefani duke mohuar me kokë dhe ndezi cigaren.

— Bëhet, këtë na thuaj ti, inxhinier Stefani, — iu drejtua vajza që ato ditë dukej shumë më e zhđervjellët.

— Ku ta dish!, — ngriti supet Stefani.

— Po çfarë di ti, je dhe inxhinier?!, — ia priti gruaja topolake që po e vështron tejetrin me përcëmim.

Stefan Grabova diçka shau me mend, por urtë e butë, pa e prishur gjakun ia priti:

— Ju keni të drejtë, moj motra, por është vështirë.

— Edhe ti si gjermani!

— Unë kam mendimin tim, ju duhet të më kuptoni!, — tha ai dhe iku duke buzëqeshur pa u shqetësuar për romuzet e punëtorëve.

Inxhinier Qendro Berati, pasi e vështroi një copë herë detalin e prishur, iku si të ishte memec pa shprehur asnjë mendim.

Të fundit erdhën inxhinier Sotir Filloja dhe Andrea Bunça, të cilëve, pasi e vështruan mirë e mirë detalin dhe shkëmbyen mendime midis tyre, sikur u qeshi buza.

— Bëhet, pse të mos bëhet, vetëm duhet një teknik i zoti, mjeshtër në zanat, se fjalën më shumë e ka lima, sesa librat!, — u përgjigjën ata.

— Po ju, inxhinierët, nuk mund ta zini limën me duar, apo ju prishen duart?, — i thumboi Vojsava.

— Po, helbete, detyrat janë të ndara; — u gjegjën ata.

Dikush nga drejtoria, pa u thelluar, hapi fjalën se atij që do ta bënte detalin, do t'i ngrihej kategoria personale pa u paraqitur në komisionin e kualifikimit.

Në repartin e çorapeve u derdhën njëri pas tjetrit teknikët, me shpresë se mos detali ishte i thjeshtë dhe kështu fluturonte kategoria. Por ata ikën siç erdhën me nxit.

Të dukej sikur gjithçka ra në heshtje dhe se koka e makinës ishte një kokë misterioze që nuk bëhej dot.

Arben Korça u dha i fundit dhe, pà u rënë fare të tjerëve në sy, e mori kokën dhe u mbyll në oficinë një natë të tërë pa gjumë. Të nesërmen në mëngjes inxhinier Endrih Shtojfi shtangu sikur ta kishin goditur në çakën e kokës me çekiç.

— Ja!

— C'thotë!, — e pyetën gratë përkëthyesen.

— Habitet!, — u tha ajo.

— S'paska plasur! Pandehte se do të mbeteshim në duart e tij?!

— Pika!

— Kallja datën.

— Lëre të vështrojë punën e tij.

Inxhinier Shtojfi ishte skuqur si një piperkë dhe vështronte detalet e reja duke çapëlyer sytë. I vinte të pëlciste nga marazi.

Toni i tij ngjasonte me vërvshëllimën e nepërkës, por asnjë njeri nuk ia varte torbën këtij njeriu-qelq!

## KAPITULLI I TRETEË

### 1.

Asnjë njeri nuk e mori vesh se atë mekanizëm të vështirë e pati bërë Arben Korça.

Në moshën 22 vjeç, kur Arbeni hyri në radhët e Partisë, deklaroi përpara të gjithë shokëve të punës se atë datë ai do ta quante ditëlindjen e tij, sepse për të fillontejeta e vërtetë, një jetë e madhe e mbushur me ideale të mëdha.

Tani Arbeni nuk priste ta thërriste puna. Ai e kërkonte vetë atë. U futej me guxim detaleve që nuk i njihet, mësonte të fshehtat e tyre, kërkonte ndihmën e mjeshtërve më të vjetër e më të zotë dhe mësonte prej tyre. E dita-ditës ai e ndiente se po bëhej më i ditur, më i aftë, më i fortë. Si komunist, atij i lindi një energji e re, një vrull i ri, një pasion për të mësuar sa më shumë.

Zgjuarsinë, energjitë dhe vullnetin e djaloshit për t'u futur në të fshehtat e teknikës, i pari e pat zbuluar mjeshtri i urtë, Miha Voskopoja.

Vështrimi i punës së tjetrit është gjykimi më i drejtë për të caktuar pozitën që mban ai njeri në jetë. Këtë sekret e dinte mirë Miha Voskopoja, prandaj ai me durim punonte dhe kaliste te të rinxjtë dashurinë për njëri-tjetrin, për punën, vullnetin e këmbënguljen për t'u ftur me guxim në të fshehtat e teknikës, të zanatit.

Miha Voskopoja dinte të ndante mirë grurin nga egjra, prandaj nga karakteri i Arbenit shkulte me kujdes barërat e këqija.

Një punë e tillë është e gjatë dhe e lodhshme. Por Miha Voskopoja e kryente me një ndërgjegje të lartë e kujdes të rrallë ashtu siç ushqen zgalemi me zemrën e tij pjellën e vet.

Arben Korçës i kujtohej dita e punës, ngarkesat e shumta që kishte oficina për pjesë këmbimi, orët e zgjatura që ai punonte së bashku me Miha Voskopojën dhe interesimin e mjeshtrit, i cili shpeshherë i shfaqejet në gjumë.

— Nuk di si të them!, — përgjigjej ai.

— Të vërtetën të thuash, Arben, — e këshillonte ai. Arbeni buzëqeshte lehtas e miratonte me kokë.

## 2.

Arben Korça shkrihej në ëndërrime. I shfaqeshin imazhe nga më të ndryshmet. Fantazia e tij ku s'e conte atë. E ndiente të vështirë t'i shfaqte me gojë ato që i pillte mendja.

«Kush ma lidh gjuhën mua? Kush?», — pyeste veten dhe vriste mendjen si e si të ndërtonte ato që fantazonte, po nuk i shfaqte me gojë.

Arben Korça e ndiente se nuk i njihte të fshehtat e teknikës. Prandaj nuk ngopej së vështruarit të gjitha ato tipe makinash që shtoheshin dita-ditës dhe zemra i ngrohej kur mendonte se të gjitha ato makina do të punonin për të krijuar të mira për popullin. Po kur të prisheshin kush vallë do t'i rregullonte?

Ekte dhe mendonte. Por boria e makinave që mbartnin llaç ia shkatërronte imazhet e ingranazheve të pjella nga imaginata dhe nga kabinet e automjeteve ai merrte si shpërblim të sharat e shoferëve: «Ej, i humbur! Ti paske lindur për t'u bërë petë lakrori!».

Arben Korça mendjen e kishte te makinat, tek ato

krijesa të metalta, që viheshin në lëvizje nga energjia elektrike dhe komandoheshin nga ai e shokët e tij. U afrohej me hapa të ngadalshëm makinave si të ndodhej në një fjetore ku flinin njerëz, dhe vështronte ngjyrat e bardha të hequra me pistoletë nga uzinat e ndërtimit të tyre. Sa të bukura! Ato i dukeshin djaloshit si ushtarë në pozicion luftimi, që prisin urdhrin e komandantit: Zjarr! Një gatishmëri e tillë ia ngazëllente shpirtin djaloshit që i dridhej nishani në faqe.

I fërkonte me duart e tij të rreshkura si të përkëdhelte fëmijët e kopshtit dhe, mbasi harxhonte një kohë të mirë të pushimit, kthehej mendueshëm në oficinë dhe thoshte me vete: «Ja, të tilla makina të ndërtojmë dhe ne! Të bukura e të forta, siç jemi ne shqiptarët». E përse të mos i futej njéherë e të provonte të ndërtonte, qoftë një detal të vetëm të tyre, ndoshta ia dilte manë punës!

E provoi e mbeti me gisht në gojë. I vinte plasja për dështimin.

Përse të ndodhët kështu vallë me të? Mos ndoshta ai ngjasonte me ata muzikantë që i bien klarinetës pa nota dhe ngrenë supet me frikë përpëra partiturës? Ndoshta. Në qenien e tij po zhvillohej një luftë e rreptë, e gjatë dhe ai po tretej në atë dyluftim të brendshëm.

Po vinte pranvera. Nga juglindja vinte flladi i ngrohtë i erërave që buisnin fletët e plepit e Arbeni dëgjonite me veshët ngritur pizgë buisjen e zhurmës së shpërthimit të gonxheve të trëndafilit.

Kështu po ndodhët dhe në qenien e tij. Akujt e padiges po shkriheshin nga këto erëra të ngrohta të shkençës dhe cikna e gjatë që ia kishte ngrirë gjakun e trupit po shkrihej e në aortë po formoheshin pellgjet e ngrohta të gjakut ku do të futej shkenca e njohjes së makinave. Ai e ndiente se avash-avash po futej në sekretet e të fshehat e teknikës.

Kështu i pat ndodhur Arbenit përpëra disa vjetësh. Ai po rrinte e ëndërronte përpëra oficinës, duke u ngrohur nga rrezet e arta të diellit, kur u dha si pa u ndier një vajzë e veshur me një palë rroba të thjeshta, por jo të zakonshme për sytë e djaloshit. Ishte Margarita.



Arbeni, i përhumbur në mendimet e tij, nuk dalloj siluetën e hijes që kaloi pranë. Ai u përmend atëherë kur i foli vetë ajo:

— Më falni, mund të më çoni tek ajo e sëmura juaj? — Ajo e kishte fjalën për një torno të prishur.

— Cila e sëmurë?, — tha ai dhe vështrimet e tyre u kryqëzuan, siç kryqëzohen shpatat në dyluftim. Arbeni e mori për doktoreshë. «Një doktoreshë që shkon të bëjë vizita në një oficinë. Sa qesharake bëhet me pyetje të tila!», — mendoi Arbeni.

— E kam fjalën për gjermanen!, — tha ajo.

Arben Korça e përmblodhi veten dhe e kuptoi se ajo do të ishte inxhinierja që duhej të vështronë tornon gjermane të prishur. Por, sa e mori ai veten, ia mbërriti Anastas Kitara, të cilin Arbeni nuk e honepte dot.

— Ardhja e inxhinierës sigurisht që e tronditi «shtyllën e oficinës», — thumboi Arbeni me nofkën që i shkon te për shtat Anastas Kitarës.

Anastasi i binte mirë dhe me pasion kitarës. Ndodh që disa njerëz të përfshirë nga një pasion i tepruar për instrumentet që u bien, marrin si mbiemër vetë emrin e instrumentit. Kështu pat ndodhur dhe me Anastas Kitarën.

— Urdhëroni, zonjushë, mos kërkoni njeri? Jam gati që t'ju shoqëroj, unë jam Anastas Kitara. Ju pëlqen muzika? Cila prej tyre, e rënda apo e lehta? — reklamoi veten Anastasi.

— Më falni, por dua të di se ku është tornoja! — Vaja nuk i pëlqente njerëzit fjalëshumë.

— A! Ti je inxhinierja, ja ku është! — Ai u tërhoq si një njeri indiferent, që posa ia kanë sharë gjënë, bën sikur të adhuron.

— Ku është brigadier?

Arben Korça, sikur të ishte shurdhuar, nuk po hapte gojë.

— Për brigadierin mendojnë që të gjithë, për ne punëtorët nuk çan kokën njeri!, — ironizoi Anastasi dhe i tregoi Arbenin, i cili u skuq në fytyrë.

— Ju jeni brigadier?, — pyeti vajza dhe buzëqeshi lehtë.

— Unë jam, pse?

— Po ju vizatoj skicat e tornos, ato duhen të punohen, ju sigurisht e njihni vizatimin teknik.

Në ato çaste, edhe po ta kishin vrarë, Arbeni do ta ndiente veten më të qetë. Ai nuk dinte skicat, siç nuk di një njeri që i bie gajdes notën e muzikës. Sa turp!

— Nuk e njoh.

— Si është e mundur! Vizatimi teknik është abejeja e gjuhës teknike, si punoni brigadier ju?

— Ashtu me hamendje!, — gjegji ai i turpëruar.

— Si quheni ju?, — pyeti ajo me keqardhje.

— Unë... Arben. Arben, — por në mendje shkonte një emër ofendues.

— Këtu, motër, ke të bësh me «analfabetë», — ia priti Anastas Kitara.

Veshët e Arbenit u skuqjnë dhe filluan të oshëtinin.

— Për këtë çështje kam për të biseduar përsëri me ju, — tha Margarita dhe u largua.

Qetësinë e akullt e prishi një tingull. Gjithë mallëngjim qau teli i kitarës së Anastasit.

— Pusho ti!, — klithi Arbeni.

— Pa dashje, më shkau dora.

Po të mos kishte vajtur Miha Voskopoja, çështja nuk do të mbetej aq e thjeshtë sa ç'u duk në fillim.

— Çfarë po ndodh këtu?, — pyeti ai duke vështruar nga xhamat e syzeve. Ishte e vështirë ta gënjeje atë njeri.

— Asgjë!... Erdhi inxhinierja... Ajo kërkon vizatim teknik... ti e kuption vetë, mjeshtër.

— Ah! Të duhet shkolla, Arben, të duhet shkolla. Pa të ta dish se do të jesh gojëkyçur përjetë.

— Ja edhe sikur të shkoj, vallë a do të mësoj dot atje?

— Si jo. Ti je komunist e nuk do të thyhesh, Arben!

### 3.

Shkolla e mesme mekanike e mbrëmjes është një ndërtesë dykatëshe. Përkarshi ndodhet parku i qytetit.

Arben Korça vendosi që të mos i ndahej për katër vjet rrështh asaj shkolle. Atij i vinte keq të shkëputej nga kinemaja që e frekuentonte vazhdimisht.

I veshur me pallton e trashë, që e pat lënë i ati, ai kalonte në heshtje rrugicave duke mos tërhequr asnje vëmendje.

Shkonte i pari në klasë. Qëndronte si një qingj i urtë dhe përpinqej të thoshte shpjegimet e mësuesve. Ikte i fundit duke mbyllur të gjitha dritaret që të mos i thyente xhamat era që frynte. Kjo detyrë e marrë vetviteti përsipër e pat bërë atë në mes klasës një njeri me teka të tillë që nuk janë larg një snobi.

Një ditë Pirroja së bashku me Yllin, që nuk ishte aspak yll, vendosën që së bashku me klasën ta bënин atë ditë «festë», mbasi në kinema shfaqej filmi «Helena e Trojës».

Arben Korça nuk dinte asgjë për planin e endur.

— Ku po shkoni kështu?, — u habit ai.

— Si?

— Nuk e ditke zotrote se ku do të shkojmë sot?

— Mos u tall, Ylli!

— Do të vish tc Helena e Trojës? — Pirroja i shkurtër e rrumbullak si një top kérceu në temë si një karkalec.

— Të lëmë shkollën për një film!

— Punë e madhe për katër orë mësim!

— Na u mërzit mësimi...

— Do t'jua shtroj në kolektiv, morët vesh?, — ua përplasi ai dhe zuri derën e klasës.

— Shpresa, vështroje këtë «bandill» që e ka marrë si tepër me revan çështjen e mësimit.

— Arben, mos u bëj kokëmushkë për dy orë vizatim-teknik, se të tjerat as që na hyjnë në punë.

— Pse kështu e kuptioni ju shkollën, ë?

— Falemnderit, na shtove dijet, i dashur, — tha Ylli.

- Ti tallesh, se kaq mendon pér rëndësinë e mësimit.
- Mos harro, Arben, se Helena e Trojës ka vënë shtetet në luftë e jo ne të dy. — Ai e dintë se, po të mbërthej me të, do të merrte bishtin në shalë.
- Nuk trembem, Ylli.
- Çfarë njeriu, éshtë gati të rrahë shokët, — tha Piroja. Arbeni e vështroi vëngër.
- Çuna, grindja éshtë e kotë, filmi filloj. Vajti ora, — i qetësoi Shpresa.

— Xhelat filmash, — shfryu Ylli. Arbeni nuk foli. Pritën gjatë. Në klasë ra një qetësi e thellë. Mësuesi nuk po dukej e ndihej qartë frymëmarrja e rëndë e nxënësve të nevrikosur.

Mësuesi ishte i sëmurë dhe thumbat ndaj Arbenit kalaun çdo kufi, po ai e pa të udhës të heshtte.

#### 4.

Ata u takuan rastësisht. Margarita po kthehej nga një tetova e saj, ai nga shkolla. Ai uli kokën me turp kur ndeshi vështrimin e saj.

— Qenkeni ju, Arben?! — Në zërin e vajzës ndihej një simpati pér të.

— Po kthehem nga shkolla.

Në rrugë ishte errët. Llambat e rrugës ende nuk ishin ndezur.

Vargmali që shtrihej përkarshi qytetit thyente erën e freskët që vinte e rraskapitur nga larg.

— Nga shkolla, ë?, — ia dha një pickim tjetër në atë vend që ai e ndiente më shumë dhimbjen.

— Mungonte një mësues.

— Ju e keni rrugën drejt? Shkojmë së bashku?

— Shkojmë.

— A ju pëlqen vjeshta?, — theu heshtjen ajo.

— Nuk më pëlqen.

— Pse?

— Është një kohë që kërcasin petkat e tërhani e unë nuk i ha që të dyja.

— Mos harroni se në vjeshtë ka shumë dasma!, — ia priti ajo me atë guxim që ka një vajzë me shkollë dhe ia shkrepit gazit.

— Gëzimin dasmat e marrin jo nga vjeshta, por nga rakia e vera që bëhen në vjeshtë.

— Ç'do të thotë kjo? — Ajo u bë shumë kurioze.

— Hiç! Unë fola kot së kati sa për t'u ndodhur në bisedë me ju.

— Keni diçka të veçantë në fjalët tuaja, Arben, prandaj dhe unë qesha, sigurisht që kam qeshur nga gëzimi, shpresoj se nuk jeni ofenduar.

— Pse?

— Sepse shpeshherë nga biseda të tillë lindin keqkuptime.

— Nuk jam nga ata tipa unë që keqkuptohen.

Përpara një pasticerie që llamburiste nga drita ata ndeshën me vështrimin e inxhinier Stefan Grabovës. Ai vështrim ngjyrë ulliri ishte si një qullje kërmilli në qafë.

— Natën e mirë!, — tha ai duke turbulluar çiftin që nuk e priste një përshtendetje të tij.

Arbeni s'po fliste. Kontrolloi xhepat që ta ftonte vajzen në pasticeri, por u bind se nuk ishte në gjendje të tre-gahej dorëlëshuar përpara saj.

— Po ndahemi. Natën e mirë, — tha ajo. Arbeni mbeti si i shtangur nga largimi i saj, vështroi hijen e trupit që i shkau si ngjalë përtej qoshes dhe qortoi veten: «Kungull».

## 5.

Qershori i erdhi Arben Korçës me gjithë ato shqetësime që kanë zakonisht provimet. Posa e zinte gjumi, ai humbiste në ëndërrime dhe i dukej vetja në mes luadhevë të mbushura me lloj-lloj lulesh po vraponte i zënë përdore me Margaritën, që gajasej së qeshuri nga të folurit e ashpër të tij. Por zgjohet dhe i shfaqej mjeshtri Miha Voskopoja që ato ditë të mbushura me vapë dhe mësimet e trondiste më shumë atë duke e qortuar me dashuri: «Pse,

Arben, po i lë pas dore provimet? Do të na turpërosh, do të na turpërosh!».

Arbeni, i zverdhur, si një fëmijë që është kapur nga roja e bahçes me mollë, justifikohej përpara Miha Voskopojës: «Po ja ku e kam librin, mjeshtër, unë po mësoj, vështro!».

Ai e dinte mirë që dijet nuk i duheshin për stoli, matura nuk do t'i vlenë Arben Korçës për t'u krekosur mes shokëve si Anastas Kitara. Prandaj i përzuri nga vetja ato mendime që e tulatin dhe u hyri mësimeve me zell.

Ai ngríhej shpejt e me librat mbledhur shuk vendsur nën sjetull, me mëngjesin në qese celofani nisej te kodrat. «Nuk është shaka të japësh provimet e maturës të një shkolle të mesme teknike, mbushur deri në grykë me lloj-lloj formulash e vizatimesh teknike», — mendonte ai.

Ai e dinte që, për t'i dalë në krye kësaj detyre, duhej të organizonte të gjitha dijet e marra për katër vjet rresht e për këtë punë të vështirë e të lodhshme duhej durim e guxim. Po ai i kishte të dyja.

Në qoftë se komisioni i provimeve në vend të teorisë së makinave metalshpuese do t'i kërkonte atij që të bënëtë në torno një kokë të makinave të çorapeve, që ishte një punë e vështirë (sigurisht që dikush tjetër nuk do të bënëtë naze në këtë fat që po i shfaqej si i rënë nga qielli), ai nuk do të kënaqej nga një gjë e tillë, mbasi nuk kishte lejuar që në qenien e tij të formoheshin ato pellgje të mosdijes, që të turpërojnë në jetë kur ndeshesh me ato sekrete teknike, të cilave ti u ke bërë bisht. Komunisti i vërtetë nuk e lejon veten kurrë të turpërohet, prandaj i përvetësonë që të gjitha mësimet e shkollës, pa vënë në llogari nëse do ta pyeste apo jo komisioni i provimeve.

Dhe ja, më në fund...

— Të lumtë, Arben, hapin e parë e hodhe të sigurt!, — e përgëzoi Miha dhe e puthi në ballë.

— Po kjo është vetëm një fillim i mirë, — ia ktheu Arbeni i bérë flakë i kuq në fytyrë.

## KAPITULLI I KATËRT

### 1.

Nuk kishin kaluar veç disa muaj pas marrjes së maturës kur Arbenit Partia i vuri mbi supe një detyrë të re. Ngjarjet rrodhën aq shpejt, saqë Arbenit me shokë do t'u vinte turp t'i zinte me gojë, e jo më të mburreshin, siç bënин disa që, për prodhimin e një vegle të rëndomtë, krekoseshin përpala të tjera.

Organizatat e Partisë të kombinatit kritikuani me forcë shfaqje të tillë mendjemadhësie, egoizmi dhe autolëv-dash. Me mbledhjet e organizatave u morën seriozisht shokët e komitetit të partisë të kombinatit dhe nxorën detyra për punën me njerëzit. Çështja ishte delikate e shumë serioze. Për to duhej të bisedoje me urtësi e durim për të shkulur me kohë barërat e këqija, që kalliri i grurit të rritej i shëndetshëm e plot kokrra.

Disa muaj të shkuar përgjegjësi i oficinës, Koço Opin-gari së bashku me inxhinier Qendron dhe Stefan Grabovën kishin bërë përpjekje për të prodhuar në vend lame-lën.<sup>1)</sup> Por puna e tyre shkonte zvarrë. Ata hiqeshin sikur po shembeshin e rraskapiteshin në punën e re që ishte e vështirë, kur, si për habi të tyre, plasi në të gjithë ofici-

1) pjesë këmbimi në makinat e trikotazheve.

nën lajmi se lamelën e kishte prodhuar një oficinë e një shkolle të mesme në Tiranë.

Fakti që lamela u prodhua në vend, qoftë dhe në Tiranë, i gjëzoi që të gjithë punëtorët e oficinës, mbasi kjo vegël e imët u duhej shumë.

Një gjë e tillë nuk i pëlqeu Koço Opingarit. Megjithëse komunist, ai filloi t'i binte gjoksit, të lëvdohej, të bëhej i padurueshëm.

Drejtori i kombinatit, duke thithur erën e luleve që mbulonin zyrën e tij, e priti përgjegjësin e oficinës ftohtë. Ai u habit kur tjetri e tërhoqi derën e zyrës me vrull.

- Tërhiqeni me kujdes derën, shoku Koço!
- Kërkoj drejtësi, shoku drejtor.
- E për këtë përplasni derën?!
- Më kanë fyter, shoku drejtor!
- Kush ju ka fyter?

Kopi Nanushi po plakej në kombinat. Koço Opingari e dinte dhe e njihte shumë mirë karakterin e drejtorit, mbasi ata kishin aq vjet që ishin shokë së bashku. Po, kur Kopi Nanushi lëshoi atë klithmë me zërin e tij të hollë, ai u tremb.

Kopi Nanushi ndryshonte nga njerëzit e tjerë. Kur ishte i qetë, fliste me një zë të trashë si bas, po, kur zemërohej e zemërimi i tij ishte i fortë, zëri i hollohej, si zë fëmije. Atëherë te gjeje vrimë të futeshe nga zemërimi i tij.

— Na penguan për prodhimin e lamelës! — Koçoja nuk nuk dinte se çfarë po fliste. — Ata të Tiranës na morën shpikjen nga dora.

- Kush ju pengoi? Unë!
- Nuk e kam fjalën për ju.

— Kërkuat torno, torno ju dhamë. Kërkuat e kërkuat, e ne jua dhamë që të gjitha. E trulloset edhe kolektivin me autolëvdata. Mirëpo ja që doli një grup nxënësish dhe jua tregoi sa ju vlen lëkura.

— A!... Ju kërkoni që të gjithë barrën e dështimit ta mbaj unë, jo, shoku Kopi, nuk jam dakord.

— Ama lamelën nuk e prodhuat. Edhe për këtë nuk jeni dakord? — Kjo për Koço Opingarin ishte një ironi aq e rëndë, saqë i theri në zemër.

- Po të jetë puna kështu, unë ja ku po të lë çelësin e oficinës dhe gjej një tjetër më të zotin për atë punë.
- Lëre!
- E lë pos!
- Por mos harro se je komunist?
- Prandaj dhe më tallni ju! — Koço Opingari i vuri gjoksin e tij të gjerë sulmit të drejtorit.
- Ju tallët vetveten!
- Me mua ishin dhe inxhinierët, por atyre nuk po u flisni kështu, sepse janë njerëz me shkollë dhe dinë ta vërtitin punën.
- Ti u bëre shkaktari, ti ishe kryesori, ti u zotove para organizatës-bazë të partisë. Dhe ne i besuam fjalës sate. Tani na thua po dorëzoj çelësat. Kjo është kapitullim para vështirësive, dezertim nga fronti i luftës. Prandaj do ta diskutojmë qëndrimin tënd.
- Pse kështu i flitet shokut! — Koço Opingari e kuptoi se midis tyre po hapej një hendek i gjerë.
- Nuk të lejoj të shfrytëzosh shoqërinë për të mbuluar dështimet në punë!
- Koço Opingarit iu ngritën nervat. U largua duke tërhequr derën me forcë.

## 2.

Zgjedhjet e reja në oragnizatat e partisë u zhvilluan mes një entuziazmi të madh. Në këtë fushatë estrada e kombinatit fitoi çmimin e konkurrimit midis estradave të qendrave të punës. Kombinati kishte realizuar planin në të gjitha zërat. Vetëm se sherri i Koço Opingarit disi ia prishi humorin Kopi Nanushit.

Marrëdhëniet e tij me Koço Opingarin drejtorit po i dukeshin si ajo pranverë që po vinte mes shirave pa mbarim e keqësimit të motit që ftohej e ftohej në vend që të ngrohej.

Por cikna e rënë papandehur u shkri. Vetëkënaqësia

që mbulonte të metat e njerëzve u fshi e në qielin e pastër doli dielli.

U bë mbledhja e parë e komitetit të ri të kombinatit e sekretar u zgjodh Miha Voskopoja. Ai u betua përpara shokëve se do të shkrinte gjithë jetën e tij për çështjen e idealet e Partisë.

Organizata e partisë e oficinës e kritikoi rëndë sjelljen e Koço Opingarit dhe për thyerje të disiplinës proletaore e tërheqjen përpara vështirësive mori masa.

Ai u paraqit përpara komitetit të partisë të kombinatit i bindur se shokët e tij të dikurshëm nuk do ta kishin harruar se kush ishte Koço Opingari.

— Ju jeni larguar nga fronti i punës në mënyrë demonstrative. Kjo nuk i lejohet askujt, jo më një komunisti.

— Kopi Nanushi më ka fyter rëndë.

— Në vend që të thelloheshe e të bëje autokritikë përzvarritjen e prodhimit të lamelës, ti i flake çelësat drejtorit me arrogancë. Prandaj thellohu në gabimet e tua.

— Nuk kam ç'të thellohem.

— Si e quan ti flakjen e çelësave drejtorit?

— I kërkoi vetë dhe ia dhashë!, — dredhoi bisedën.

— Pse ç'jam unë, pronar? — tha Kopi pa marrë leje.

— Qetësohu shoku Kopi!

— Le të flasë të vërtetën, atëherë qetësohem.

— Koçojë nuk ka përfillur kritikat e shokëve! — Miha e qëlloi në vendin e duhur.

Koço Opingarit iu këput koka në gjoks.

— Fol, përsë nuk flet?

— Ndoshëta është ashtu siç thotë Miha.

Koço Opingarit i kujtohet e kaluara, koha kur ai shërbente në batalionet e mbrojtjes së popullit. Komandanti i batalionit, një burrë i thinjur, por i ri nga mosha, për një aksion të vështirë zgjodhi vetëm komunistët.

Kritikat e shokëve godisnin si kopanë mbi shpatullat e tij e prej andej ngrihej pluhuri i të metave të tij. Ai e pat lejuar vetë të grumbullohej gjithë ai pluhur, se nuk kishte përfillur kritikat e shokëve. Por edhe organizata

-bazë nuk qe ndalur seriozisht si këtë radhë. Prandaj ai nuk qe thelluar në gjykimin e vetvetes. Tani të metat qe-në trashur dhe nuk mund të kaloheshin lehtë. Po sikur ta përjashtonin nga Partia? Ky mendim i flakëriu në kokë dhe iu drodh zemra. Jo! Një gjë të tillë nuk duhej ta bënin. Fundja ai ishte njeriu i tyre. Ai nuk mundej të jetonte dot jashtë radhëve të Partisë, më mirë ta vrisnin, ta vrisin...

— Shokë... Kam gabuar... Jam juaji. Më jepni dhe një herë dorën, kam për t'ia shlyer gabimet Partisë me punë.

Goja i ngriu. Ajo shpohej nga miliona gjilpëra që e bënë të fortë si një lepitkë hekuri.

I trulloosur nga ai mendim i lebetitur, ai nuk e ndjeu dorën e shokëve që nuk e lanë të rrokullisej më tej drejt greminës për ku ishte nisur.

E kishin kthyer kandidat partie...

### 3.

Arben Korçën e thirrën qysh në mëngjes në drejtori. Ai u nis duke fshirë duart nga vajrat dhe s'po e kuptonte përsë e kërkonin me aq ngut.

— Uluni, shoku Arben, jeni emëruar përgjegjës i oficinës, — i tha drejtori me zërin e tij të trashë e të ngrohtë. — Kështu do të bëni pjesë dhe në këshillin teknik të ndërmarrjes.

Arben Korça kopsiti mëngën e kominosheve, vështroi fytyrat e anëtarëve të këshillit teknik e, disi i hutuar, s'po dinte ku të ulej. Si në mjegull pa një vend bosh dhe u habit që ai vend ishte karshi Margaritës, që e mbuloi me vështrimin e saj joshës. Ajo përpiquej të fshihte atë lumturi që ia bënin qepallat të dridheshin. Se çfarë u fol atje dhe se çfarë u miratua, ai nuk e kuptoi.

Të gjithë u ngriten. U ngrit dhe ai si për inerci.

— Ju, shoku Arben, ndalon pak, — tha Kopi.

Siq dukej, as drejtori, as Margarita nuk ishin të bindur që shpatullat e atij djaloshi do ta mbanin atë barrë.

Mbetën vetëm që të tre mes asaj bardhësie.

— Ju, Arben, jeni përgjegjësi më i ri në të gjithë kombinatin. Mos u tronditni, kemi pér t'ju ndihmuar. Apo jo, shoqja kryeinxhiniere?

— Sigurisht, shoku Kopi.

— Nga funksionimi i mirë i oficinës varet shumë realizimi i planit të kombinatit, — theksoi drejtori. — Prandaj kërkohet organizim i përsosur dhe disiplinë e fortë pér të çarë bllokadën.

— Kështu! Ju e dini që makina e kollarisjes, ajo gjermania, ka kaq ditë që na ka bllokuar prodhimin, se ka difekt. Atje kryeinxhinierja ka kaq net që po gdhihet si pranë një të sëmuri pér ta shpëtuar nga vdekja, ndihmojeni shoqen inxhiniere. Porositë e saj janë me pérparësi. Kaq kisha.

#### 4.

Makina gjermane e kollarisjes ngjasonte me një bunker të stërmadh me bark të çarë. Rrethanat se si ishte flakur ky «bunker» në atë sallë të gjerë të kombinatit Arbeni nuk i njihte. Si makinë e këtij lloji ajo ishte e vëtmja në kombinat, prandaj kujdesi ndaj saj kalonte çdo kufi. Tekat e saj nuk soseshin kurrën e kurrës. Ndoshta nga kjo arsy e ajo ishte pagëzuar «Prishanikja gjermane».

Arbeni mori një nga kushinetat, e vështroi dhe pastaj e vendosi në vendin e saj.

— Është suedeze!, — tha ai.

— Këtu është e gjithë bota teknike!

— Si është e mundur?!, — u habit ai.

— Ja që është e mundur. «Prishanikja» ime ka marrë ilaqe nga oficinat e botës si kokrra valumi.

— Kush është prishanikja?

— Kjo!

— A!

— Bukur e kanë pagëzuar?

— A e di, Margarita, se ti dukesh si plakat e magjisë me këtë rrangallë?

— Nuk më shkonte mendja. Por mos mendo se magjistaret janë të reja.

— Po ti je se!

— Magjistaret janë plaka!

— Po të jetë kështu, ti nuk je magjistare.

— Jo. Ti e the, mos e ha fjalën.

Ai u zu ngushtë dhe e mallkoi veten që e zemëroi atë!

Gjithçka ndoshta do të kalonte mirë dhe ata do ta gjenin fillin e bisedës së tyre për ta lidhur përsëri, por ja, u dha Stefan Grabova dhe ai ndjeu erën e hudhrës që nuk e duronte.

— Hello, Margarita!, — i foli ai si i huaj.

— Qenke ti!

— Ç'thotë «prishanikja»?

— Si gjithmonë.

— Kam frikë se mos ju prishë dhe ju, Margarita.

— Mos u shqetëso, vëllai i diamantit, — tha ajo.

«Po kjo. Përse ia zgjat kaq shumë fjalën këtij zeshkani që nuk ka asgjë të mirë? Pse s'e shporr sa më shpejt dhe në vend që ta quante vëllanë e qymyrit, e quan..., po diamantit ky i merr të keqen».

— Martoje këtë «nevrastenike», Margarita.

— Po të jesh ti dhëndri!

Arbenit i shkëlqyen sytë. Një përgjigje e saktë, e burkur. Vetëm për këtë fjalë ajo meritonte një të...

— Mirë e ke, moj magjistare, por tempulli im nuk është për qenie të tillë. Ajo e ka dhëndrin në varr. Flake atje, Margarita, të shpëtosh njëherë e mirë prej eshtrave të asaj rrangalle.

— Siç e flakët ju lamelën, — e shpoi ajo. Margarita ia bënte samarin copë atij Stefan Grabovës.

— Ta dish, unë e ndiej veten më të qetë.

— Tani çfarëdo të bëni, dështimi gjithmonë ndjell fatkeqësi.

— Të jesh e bindur që nuk kam për t'ia hequr vetes.

— Ti je me karakter!

— Por jo me revolver, e dashura ime!

«Sa i pacipë! Si kështu? Po kjo si ia pranon këto fjalë?

E dashur... Apo mos vallë diçka ka mes tyre?».

— Do të kesh lexuar gjë, pa dërdëllit kështu, — i tha ajo.

— Për kë e ke fjalën, për hekurat, apo për zemrat?

— Ti e di vetë!

— Ah ti, shkaktare e luftës së Trojës. Kam lexuar një libër që ka të bëjë me ne! — Ai i vështroi që të dy ata.

— Cilin, «Otellon»?

— Një libër gjerman.

— Përse ka të bëjë me ne?

— Sepse është i Remarkut.

— Tre shokët?, — tha ajo.

— Po, Pat, dhe ne jemi tre.

Arbeni u nxi. Ai ishte gati si një spartan të rrëmbente një ushtë e ta bënte tjetrin pelte në gjak. Si guxonate ta quante atë shokun e tij? «Maskarai!»

— Se ku i gjen këta libra.

— Shumë i bukur. Një vajzë me emrin Pat, që mbart gjysmën e bukurisë sate, Margarita.

— Kompliment!

— Mes shokëve të vjetër nuk ka komplimente.

— Mirë.

— Po shkoj, o magjistare, tani ti do të fillosh nga magjitet e tua, nuk kam durim të merrem me «prishaniken» tënde. Më fal, shoku përgjegjës i oficinës, do të kemi kohë që të njihem mirë së bashku.

Ai iku si hixe, ashtu siç pat vajtur.

Arbenit i hipit gjaku në kokë. Po ziente përbrenda, por nuk u shfaq.

## 5.

Arbeni e mbajti fryshtën e Dhosit. Por atje kishte një mori vajzash që prisnin të furnizoheshin.

— Shoku Dhosi, më keni dhënë pesë pako me penjë më pak se fletëkërkesa.

- Por ato i kam shuar dhe nga fletëkérkesa.
- Brigadierja do të më flasë.
- I thuaj se jemi në bllokadë, kursim.
- Na futni në grindje, o xha Dhosi.

Arben Korça dëgjonte debatin e tyre. Dhosi Qafëzezi e kishte kuptuar siç duhet detyrën delikate dhe me përgjegjësi. «Nga xha Dhosi kanë ç'të mësojnë magazinierët e rrëthit, bile edhe të Republikës», — mendoi Arbeni.

— Po ti?, — pyeti magazinieri Arbenin që po priste radhën.

— Gjeta belanë me akset e «prishanikes gjermane», më prishi të gjitha thikat e vidios.

— Prej saj do të të lindë sëmundja e kokës.

— Si të bëj, nuk ka gjékundi video!

— E di! Prit njëherë. — Dhosi u zhduk mes rafteve dhe erdhi i gëzuar si një njeri që ka gjetur vetë lumturinë. — E mbaja mend se diku pata fshehur disa video. E di sa vjet kanë? Mbi dhjetë!

— Po kjo kutia metalike?

— Koço Opingari e ka bërë. Si mjeshtër i ka shokët të rrallë ai.

— Ashtu është, por nuk më thua, e ke lexuar librin «Tre shokë»?

— Mos është ai me atë gërmadhën makinë, që e quanin Karli?

— Ai është, ka dhe një femër, libër me qyfyre e me të qara!

## KAPITULLI I PESTË

### 1.

Inxhinier Qendro Kolonja nuk ishte më i gjatë se një metër e shtatëdhjetë pont. I zbehtë dhe i hequr. Për një kohë kishte punuar si inxhinier mekanik në uzinat e përpunimit të naftës dhe ja së fundi po vinte në qytetin e lindjes.

Inxhinier Qendro Kolonja u takonte atyre tipave që kanë një energji të pafrenuar, por që nuk dihet se çfarë drejtimi do të marrin. Ndodh që nganjëherë lava e fuqishme shpirtërore merr rrugën e gabuar të egoizmit, menjemadhësisë e dobësive të tjera, të cilat e bëjnë të dëmshëm për shoqërinë.

Peshonte pesëdhjetë e pesë kilogram. Tullac, me buzën e poshtme të varur si vesh, ai të buzëqeshte fare pa shkak, dobësi kjo që formonte njëfarë antipatie. Hunda e kthyer si sqep mbushej me pikla të vogla lie. Sytë e vegjël shumë zevzekë të dukej se nga çasti në çast do të dilnin nga zgavrat e tyre e do të bëheshin copë e thërrime kudo që të binin.

I veshur me atë pardesy në ngjyrë të përhime, ai, pa i tërhequr askujt vëmendjen, filloj kokulur punën si përgjegjës i remontit.

Parimi i tij fshihej në formulën latine: «Gjuha e gjatë

jetëshkurtër, gjuha e shkurtër, jetëgjatë». I bindur se një ditë do të arrinte të tria dëshirat e fshehura të tij, ai nuk hapej, porëndërronte dhe luftonte sipas mënyrës së tij: «Të zinte një post të rëndësishëm (në fillim në ndërmarrje, pastaj në Komitetin Ekzekutiv të qytetit, e më vonë në kryeqytet), të martohej me një grua pjellore (të shëndetshme), të lindte një djalë. Sigurisht që nuk përjashtohej sikur barra të ishte e mbarë dhe të dilnin dy djem); të zinte një apartament me tri dhoma (në fillim në qytet, e pastaj në kryeqytet).

Të jesh inxhinier mekanik e të kesh vetëm tri dëshira, nuk është ndonjë pretendim kushedi se çfarë. Por ja që inxhinierit nuk po i shkonte puna mbarë dhe kudo që pati ndërmarrë përt'i vënë në jetë dëshirat e tij, pati dështuar. Kjo nuk do të thoshte që ai kishte hequr dorë nga èndrrat e tij, por vetëm se ishte tèrhequr përkohësisht për arsyet taktike.

Një ditë ai e bëri emrin të bujshëm në të gjithë kombinatin. Puna rrodhi kështu e u lidh me vetë Dhosin e ndershëm:

Ishte lëshuar një urdhër dorëzimi për një ruleman<sup>1)</sup> me dimension të vogël.

Inxhinieri picërrroi sytë dhe vajti me të shpejtë te xha Dhosi.

— Jujeni magazinieri?

— Po, unë jam, inxhinier!, — u habit ai.

— A e dini, shoku magazinier, se në çfarë situatash po kalon vendi? A e di ti se çfarë bëhet sot rrëth nesh?

— Nuk ju kuptoj, ku doni të dilni, inxhinier?!

— Te bllokada, që nuk e njihni! — Qendroja po zverdhej.

— Por unë për çështjen e bllokadës kam menduar! — Xha Dhosi e pa që diçka nuk shkonte mirë në atë mes, por nuk po kuptonte se cila nga ato detale nuk po shkonte mirë!

— Pse kështu lëshohen kushinetat. Jo, vëllaçko, një dorë e shpuar si jotja, e dëmton rëndë shtetin.

— Po ju e keni firmuar vetë urdhrin e dorëzimit.

1) kushinetë.

— Gabim! Shumë gabim! Tjetër herë, dhe të kem vënë firmë, pa më thënë mua, ju nuk do të jepni asnje kushinetë, pikë. Qartë?

Shefi i llogarisë, një burrë i thinjur me ballë të ngushtë, ishte njeri i urtë, që siç ishte ngjitur ngadalë e ngadalë në shkallët e përgjegjësisë së tij nga punëtor i thjeshtë, ashtu pati hyrë dhe në shpirtin e njerëzve që e nderonin dhe e respektonin.

- Shoku Nesti, ai njeri më çmendi!
- Cili, o xha Dhosi?
- Ai inxhinieri me pardesy të hirtë.
- Shoku Qendro?
- Nuk qëndroj, o jo!
- Mos u nevrikos, është emri i inxhinierit.  
Si një hije ia behu inxhinier Qendroja.
- Nderime shefit të llogarisë!, — përrshëndeti ai duke ngritur dy gishtërinj.
- Shoku Qendro, ka ca ankesa ndaj jush.
- Kush kështu?, — u habit ai.
- Xha Dhosi.
- Për njeriun që nuk i dhimbset malli i shtetit, kam për të qëndruar më i ftohtë, — filloi sulmin inxhinieri.
- Nuk ka gjë të keqe që kushinetat t'i marrin vetë mekanikët, — ndërhyri Nesti butë.
- Të gjithë njerëzit në kombinat kanë besim ndaj meje, për këtë le të flasë dhe vetë shefi, — tha xha Dhosi, por shefi nuk foli e kjo e zemëroi më shumë xha Dhosin që në heshtjen e tij u duk se zbulonte humbjen e besimit.
- Kushedi se ku i shpien mekanikët kushinetat.
- E ku tjetër, përveç se në makineritë?, — ia priti xha Dhosi.
- Mos më mësoni, jam inxhinier me një stazh të vjetër unë. Kam punuar në të gjitha distileritë e naftës, dhe e di mirë se ku mund të vihen kushinetat.

— Shoku Qendro, duhet të keni besim ndaj klasës punëtore. Ajo është e pastër.

— Kush tha se nuk është e pastër, shoku shef i llogarisë? Po dikush e fut kushinetën në xhep, e pastaj ti e di vetë se si janë këto punëra!

— Besim e kontroll, shoku Koço, e jo dyshim e kontroll!, — i mëshoi zërit Nesti. Inxhinieri nuk foli. Xha Dhosit i qeshi buza.

## 2.

Arben Korça u habit me atë lidhje që u bë në mes të asaj pesësheje të kombinatit.

Ishte viti 1964. Dikush tha se një **lidhje** e tillë ishte një shaka e bërë nga inxhinier Adrian Bunça, që nuk e kishte për gjë të formulonte një shaka të çastit. Si një skuadër basketballistësh, për kapiten të saj pesëshja kishte zgjedhur inxhinier Qendro Kolonja, një njeri hermetik që nuk zbulonte asgjë. Tre të tjerët ishin mjeshtër të zakonshëm e nuk ngrinin peshë përpara Qendros e shokut të tij.

— Jujeni mjeshtri i talentuar, më i talentuari që më kanë thënë, shoku Koço Opingari në mos gabohem?, — i tha Qendro Kolonja që e dinte se një lëvdatë qoftë dhe e padrejtë mund të zëvendësonë një lugë mjaltë.

— Hë, hë, unë jam, — iu përgjigj Koçoja. Mbas shkarkimit nga detyra si përgjegjës i oficinës, ai ishte bërë i heshtur dhe i çuditshëm, por, për të punuar, punonte si një ari. U habit që mori në shpatullat e tij gjithë ato lëvdata dhe e vështroi tjetrin sikur përpara tij të kishte dalë kulla Eifel e Parisit.

— Gëzohem, unë jam inxhinier Qendro Kolonja, — i tha ai dhe mori pëllëmbën e madhe të mjeshtrit me të dyja duart e tij si mashë.

Biseda e tyre u bë në një korridor të ngushtë që buçiste nga të gjitha anët me atë ulërimë gërvishtëse që

nxjerrin të gjithë metalet kur hahen nga majat e thikave të veshura me video.

— Ecim më tutje, kështu shpëtojmë nga zhurma.

Ata u larguan nga korridori e dolën në cepin e qoshes të katandisur për ibret nga këllirat e hekurishteve.

— A e dini se si është puna, mjeshtër? Kam vendosur që të jeni bashkautor me katër shokë të tjerë për një shpikje interesante; projektet i kam bërë vetë, është një punë që ka shumë interes.

— Po unë ç'hyj në mesin tuaj si i pesti?, — pyeti ai, i habitur që tani duhej të bëhej «shpikës».

— Si ç'hyni. Ju jeni i pesti. Na duhesh medoemos.

— Shpikja apo prodhimi është për të mirën e atdheut?

Qëndro Kolonja e kuptoi se kishte të bënte me një njeri të zotin për limën, por sylesh dhe aspak egoist. I ftohtë dhe siç dukej, i vrarë nga rrëzimi i ndodhur. Një njeri më të mirë për qëllimet e tij vështirë se mund të gjente ai.

— Sigurisht që për atdheun e ndërtojmë!, — ia priti inxhinieri duke qeshur për naivitetin e tij dhe i zgjati paketën.

— Mirë, inxhinier, për mbarë na goftë!

Ai nuk priste një mbarësi më të mirë sesa fillimi i ndërmarrjes së tij dhe që këtu gaboi.

I bindur që Koço Opingari ishte një njeri leshko, baxhan, ai iu hap atij me gjithë atë betim të fortë që i pat bërë vetes:

— Ti nuk e di, o mjeshtër, se çfarë kohe fillon për ty qysh tani që pranove të bëhesh bashkautor i shpikjes që do të bëjmë. Radioja, gazetat do të flasin për ty si një mjeshtër me përvojë. Fotografitë tona do të botohen në faqet e para të gazetave. E ke për të parë, edhe dokumentar ka për të bërë kinostudioja...

— Mirë e ke, o kapedan, por në ndodhtë si më lame-lén, që na e kaluan ata nxënësit e shkollës së mesme, ku do të futemi?

— Çfarë lamele? Kjo është shpikje e vërtetë. Punë jo për kalamaj, po për burra me mend, me përvojë.

Ai fliste me një pasion të papërbajturi. Fjalët e tij

derdheshin si ujet e një përroi të vrullshëm. Afshi i egoizmit ia dridhte buzët e nxehura prush. Bebëzat e syve të tij kishin marrë ngjyrën e ujit të ndenjur në vozat e sjarrfikëseve.

— U bëftë si të jetë më mirë, inxhinier!

Qendro Kolonja u largua i kënaqur duke vërvshëllyer. Koço Opingari hoqi përparësen dhe e la në tavolinën e madhe të mbushur me njolla vaji dhe çelësa të ndryshëm. Mendimet e zymta e kapën dhe në mendjen e tij kaloi ftyra e inxhinier Stefan Grabovës që diçka të ngjashme kishte me ftyrën thatime të këtij inxhinieri që quhej Qendro!

Kush vallë e pat shtyrë atë që të hapte plagën e tij, që mezi po i zinte kore? Sigurisht që ndonjë njeri i keq, ose ndoshta egoizmi i tij i papërmabjatur.

«Koço Opingari është komunist dhe si i tillë ai duhet të vërë në dijeni organizatën e partisë dhe shokët e drejtorisë», — mendoi ai.

E vërteta ishte se Qendro Kolonja nuk ia zuri fare në gojë Partinë, qëndrimin që mbante ajo ndaj prodhimit të platinës. Mos vallë këtu kemi të bëjmë me egoizmin dhe lavdinë personale që do të arrijë inxhinier Qendro Kolo-nja?

Koço Opingari la përparësen e tij mbi bankë dhe unë. Rrugës po kalonte Kopi Nanushi. Koçoja se pse e ndjeu veten ngushtë kur ndeshi shokun e vjetër. Por nuk e humbi toruan dhe i foli:

— Duhet të bisedoj me ju, shoku drejtor.

— Cfarë ka ndodhur?

— Inxhinier Qendroja, që ka ardhur tanë vonë, më foli për një shpikje, kërkon të bëhem bashkautor. Si më këshilloni?

— Nuk kam dijeni. Kam qenë dy muaj në spital.

— Më falni, shoku Kopi, se nuk kam ardhur për t'ju parë!

— Pavarësisht nga ajo, Koço, ne jemi komunistë, nuk i mbajmë mëri njëri-tjetrit, po ecim në unitet të çeliktë siç kemi ecur në kohën e luftës. A të kujtohet si ecnim në

kohën e luftës?, — tha Kopi dhe i hodhi në sup dorën e tij të bëshme.

— Ecnim dhe do të ecim, shoku Kopi, — miratoi Koço Opingari buzagaz dhe me pëllëmbën e bëshme fshiu ballin e mbuluar me bula djerse.

### 3.

Qendro Kolonja e ndali vrapin në sallën e madhe të mbushur me gjithë ato mbeturina të llamarinave dhe të hekurave të përmasave të ndryshme. Ai dridhej nga nervozizmi dhe nuk dinte se në çfarë pike t'i hidhte sytë e tij zevzekë.

Arben Korça u dha përpara me duar të ndotura me vajra. Kishte orë të tëra që po merrej me një torno të prishur e së fundi mezi gjeti atë dado të vogël që, e dalë nga vendi i saj, pati sjellë gjithë atë dëm në makinën e shkallmuar. Ai me një qetësi të habitshme fshinte duart përpara inxhinierit që dridhej.

— Përgëzimet e mia, o shefi i oficinës! — Sarkazmi i tij dallohej në të gjithë sallën e madhe të tornove.

— Qenkeni gjithë nge, inxhinier, prandaj bëni dhe shaka!

— Kam njëzet vjet në punë, i dashur, e kam njojur shumë tipa njerëzish. Unë kërkoj punë. Nuk ka shakara, e sidomos kur jemi në këtë situatë, të bllokuar!

— Që luftojmë kundër bllokadës, këtë e dimë që të gjithë, inxhinier.

— Varet se si luftoni! — Ai në kësó rastesh ishte i pakapshëm e shumë i zhdërvjellët.

— Çfarë kërkon prej nesh, inxhinier? — Arbenit po i ndodhët historia e Dhosi Qafëzezit.

— Punë, punë. Puna është pasqyra politike e njeriut. Gjatë saj ai njihet se cili është: dembel, shpifarak, intrigant, i keq, megalloman, shpirtzi, gjithë kompleksi i keq dhe i mirë i njeriut në punë njihen.

Arben Korça u kujtua se kishte edhe njerëz që fshin prapa predikimeve të tillë.

— Meqë kërkoni punë, inxhinier, atëherë mos na pëngoni, na lini të qetë të punojmë!

Inxhinier Qendroja shtangu nga përgjigjja e Arben Korçës dhe u zembraps. Mendoi se dy sherre përnjëherësh (me shefin e ofiqinës dhe me magazinierin e pjesëve të këmbimit) do të transformoheshin në dy gurë që do ta pengonin në rrugën e tij. Prandaj dhe ai me zhđervjellësi ndryshoi tehun e bisedës.

— Shoku përgjegjës i ofiqinës, ju ndoshta do të keni biseduar edhe në shtëpi për rëndësinë e ndërtimit të linjës së platinës, apo jo?

— Jo, — u përgjigj tjetri duke u treguar naiv, sepse Qendro Kolonja diçka po zbulonte.

— Tani e kuptoj që ende s'e keni vënë fare ujët në zjarr për modelet e platinave!

— Vështronî dhe vetë rrëth e rrotull, nuk kemi kohë të ngremë kokën nga tornot, sepse kemi shumë punë.

Qendro Kolonja vështroi njëherë me sytë e picërruar të gjithë atë fushë të madhe që ishte mbushur me pjesë e detale të plagosura e prisnin radhën për të hyrë në sallën e kirurgjisë që quhej reparti i tornove. Ishte një batërdi e vërtetë, por ai nuk e kishte mendjen te hallet e të tjerëve, që paraqiteshin mes difekteve të detaleve që prisnin radhën atje, ai mendonte vetëm për veten e tij.

— Po... Vështroj... Të gjitha këto rrangalla janë të «prishanikes». E ju me sa duket përpëra saj nuk pyesni për asgjë tjetër.

Nuk dukej aq i humbur ai njeri që të gënjeni nga pamja e jashtme. Kjo mënyrë e jashtëzakonshme për të nuhatur e mahnitit Arben Korçën. Mos vallë e hodhi fjalën për miqësinë që kishte Arbeni me Margaritën?

— Zbatoj urdhrat e drejtorisë!, — ia priti ai shkurt.

— Por cila është më e rëndësishme: shpikja e platinës, apo «prishanikja»?

— Për mendimin tim që të dyja të rëndësishme janë, por më urgjente është «prishanikja». Megjithatë, po patët vërejtje, bëjani drejtorisë, inxhinier!

## 4.

Arbenit akoma po i zienin në kokë llafet e inxhinier Qendro Kolonjës, kur në rrugë takoi Margaritën. Ajo duhej të ishte e gjëzuar, mbasi kishte shumë fjalë. E ftoi të shkonin në pasticeri. Porositën një kafe e një pastë.

— Çfarë ke kështu sot?, — pyeti ajo disi e shqetësuar.

— U grinda me inxhinier Qendro Kolonjën.

— Sa herë të kam këshilluar. Tregohu i përbajtur në marrëdhënie me njerëzit.

— Dhe kur tjetri të vjen e të hipën në zverk?

— Jo, deri këtu jo. Po, kur tregohesh i përbajtur, edhe sherri mund të evitohet.

— Ti je pëllumbesa e paqes!

— Çfarë njeri që je, gjithmonë bën humor!

— Bile dhe kur vjeshta melankolike na lë shëndenë.

— Dimri i ashpër siç duket duhet të jetë shoku yt.

— Më mirë shok dimrin se inxhinierët si Qendro Klonja.

— Por ka dhe inxhiniere!...

— Nuk i fusim të térë në një thes.

— Ë shoh se qenke inatosur.

— Nuk më pëlqen ai njeri, Margarita!

— Arben, njerëzit kanë huqet e tyre, kushedi se në ç'orë është ndodhur, po mua nuk më duket njeri i keq.

— Ashtu qoftë, Margarita, po tek ai njeri shoh njëfarë zilie, që s'duhet ta kenë njerëzit tanë.

— Sidoqoftë, njeriu nuk gjykohet nga një bisedë e çastit.

— Le t'ia lëmë kohës, atëherë do të llafosemi.

Margaritës këmbëngulja e Arbenit iu duk e pavend, e, për t'ia larguar nga koka atë zemërim që e kishte përfshirë, e ftoi të shkonin në teatër.

## KAPITULLI I GJASHTË

### 1.

Salla e re e teatrit ishte pa ngrohje. Margarita ishte përqëndruar në lojën e aktorëve. Por poterja që po bënин aktorët e asaj trupe asaj nuk i pëlqeu. Ata vërtite-shin në skenë. Bërtisnin, shaheshin, lëshonin fjalë të pa-hijshme dhe pastaj pajtoheshin.

Margarita mendonte përse bërtisnin ata. Përse nuk si-lleshin me edukatë? Vallë ky ishte humori? Kurrsesi që jo! Ata ishin larg së vërtetës, larg realitetit tonë.

— Mos ju kanë thënë se jemi të shurdhër?, — tha Margarita.

— Nuk i kuptoj disa aktorë, të cilët e kanë bërë zakon të bërtasin.

Kjo vjen ngaqë salla nuk duhet të ketë akustikë.

— Cfarë!, — u habit ai.

— Shët! . . .

Shfaqja nuk u kishte pëlqyer të gjithëve. Kjo shpre-hej në bisedat e shumta të spektatorëve që shtynin pér të dalë sa më shpejt jashtë nga ajo sallë.

Në strehën e teatrit ndaluan që të gjithë duke nde-shur në një pamje fantastike e të mrekullueshme. Dëbora me hapin e saj të pandjeshëm po binte me pllazga të më-dha si fjolla që shkëputeshin ngadalë — ngadalë.

— Sa bukur! Si flutura përtace po bien pllazgat! —  
Ajo ishte mahnitur e i lëviznin flegrat e hundës.

— Duket se ky dimër don dru. . . — tha një spektator e ngriti jakën e pardesysë. Ai dukej që mërdhinte shumë.

U dha një rrymë ajri e ftohtë.

— C'mrekulli!, — tha Margarita e magjepsur.

Dhe vërtet që gjithë qyteti i mbuluar me dëborë të kujtonte një nuse që ishte veshur me fustan të bardhë e tani priste t'i vinte takzia e dhëndri pér ta marrë!

— Ikim! — Ai e zgjoi nga èndërrimet.

— Sa bukur, më vjen keq të shkel dëborën e parë!

— Atëherë të të marr në krahë?

— Lojte nga mendja!

Ecën një copë herë gjithë kujdes e pa folur në shtresën e shtruar gjithë bardhësi.

Por më tutje u mbuluan nga breshëria e topave të dëborës që fluturuan mbi kokat e tyre si zogj të bardhë.

— Au!, — klithi ajo, sepse një top iu ngjesh në vesh.

— U rrethuam. Ta dish se ramë në çark!, — tha Arbeni.

Por ajo nga instinkti i afrohej atij dhe nuk dëgjonte asgjë.

— Futu këtu, futu, — hapi pallton Arbeni.

— Shoqeni, t'i shpartallojmë, — ndien zërat e gëzuar të vajzave, — t'i mbulojmë me dëborë!

Kaloi makina e poliambulancës dhe ata mundën të hynin në një dyqan ushqimesh. Ata pastronin njëri-tjetrin nga fjollat e dëborës. Ishin skuqur nga faqet e dihatnin duke nxjerë shtëllunga të ngrohta avulli.

— Ishin ato vajzat e filaturës. I njoh se çfarë çapkë-nesh janë, të marrin gjak në vetull!

— Ti i njohke si shumë vajzat, nuk qenke ashtu siç tregohesh?

— Shkundu. Ke dëborë në flokët e mos fol gjëra të paqena!

— E zbulove vetveten!, — tha ajo dhe i hoqi një fjollë të bardhë që atij i kishte mbetur në jakën e palltos si lu-lja e dhëndrit.

- Nuk bën,ëshië dyqan e ka njerëz!
  - Sa i keq që bëhesh nganjëherë, Arben.
  - Ata dolën jashtë. Rruga ishte bosh, njerëzit ishin të fshehur nëpër strehët.
  - Shkojmë nga kjo anë?
  - Shkojmë më mirë bulevardit. Më pëlqen të vështroj dëborën duke rënë.
  - Sikur e sheh për herë të parë.
  - A e di, Arben? Megjithëse shfaqja nuk më pëlqe, unë jam e lumtur.
  - Edhë unë.
  - Ti, Arben, mendimet i shpreh shkurt. Sa mirë!
  - Jo çdo gjë e shkurtër të kënaq. Edhe shfaqja e shkurtër ishte, po s'na pëlqe.
  - Këtu ke të drejtë.
- Dolën te qoshja e rrugës së Margaritës. Përpara tyre shtrihej rruga e bardhë e shtruar me dëborë të virgjër. Andej nuk kishte kaluar njeri dhe gungat e ngritura si gungat e një gamileje ajo e kuptoi që ishin postafët e gurtë.
- Rrimë dhe pak këtu, Arben?
  - Si të duash, por mos ftohesh?
  - Jo. Vetëm më trego diçka. Më pëlqen kur ti më tregon diçka. Zëri yt se ç'ka një tingull.
  - E kam gojën të kyçur, nuk di të flas, Margarita.
  - Po ti provoje një herë.
  - Vështroj dëborën që bie dhe më ngjason sikur bie një detal.
  - Tani, Arben, të lutem mos na fol për detale.
  - Edhe dëbora është e ftohtë si metali!
  - Përsëri me metalet!
  - Ku dhëmb dhëmbi, vete gjuha!
  - Kjo vjen ngaqë ju nuk lexoni letërsi, Arben.
  - Lexoj, por dua të di më shumë për shkencën, për teknikën.
  - Nuk je kaq profan sa hiqesh. Mbarove dhe shkollën e mesme. Përse dyshon në aftësitë e tua?
  - Në krahasim me ç'duhet të di, dijenitë e mia janë

fëmijërore. Të çash bllokadën në fushën teknike, duhen dijeni të thella shkencore e teknike e jo llafe. Ja, akoma s'po i japim rrugë «prishanikes» gjermane.

Margarita e kuptoi se në fjalët e Arbenit kishte një kritikë të ashpër edhe për vetë Margariten e inxhinierët e tjerë. Kjo e vuri në mendime, po nuk foli.

## 2.

Ekonomisti Tori Pini po përgatitej për të festuar pesë-dhjetëvjetorin e ditëlindjes së tij.

Të festosh pesëdhjetëvjetorin, sigurisht për njeriun është një festë e bukur dhe e gëzueshme. Por për një ekonomist të dalluar, të dashur e të thjeshtë siç ishte komunisti Tori Pini, ky përvjetor ishte një gëzim i madh, mbasë ai sapo kishte përfunduar studimin për të kursyer sa më shumë në repartin e prerjes.

Tori Pini ishte kryetar i bashkimeve profesionale dhe amator i dalluar në pallatin e kulturës të qytetit.

Pesëdhjetë vjet! Nuk është një jetë e shkurtër. Tori Pini po gjykonte rrugën e përshkuar. Nuk kishte pse të zemërohej. Sigurisht që rruga nuk ishte e shtruar me lule, por ama ai kishte luftuar mirë. Për këtë le të gjykonte kolektivi dhe organizata e Partisë.

Ai e ndiente veten të freskët e plot energji. Ndiente kënaqësi se kurrë nuk ua kishte kthyer kurrizin detyrave. Përkundrazi, ishte hedhur në ballin e tyre, atje ku e kërkonte nderi i tij si komunist.

Në luftë, i tha Partia. Në luftë u hodh. Tori Pini e dinëtë mirë se lufta nuk kishte mbaruar. Ajo përditë po bëhej më e ashpër për të çarë rrëthimin e bllokadën. Ai e kuptonte se duhej luftuar me vvetveten dhe njerëzit që e qarkonin për t'u pastruar nga mbeturinat e trashëguara nga e kaluara dhe ndikimet e huaja.

Jashtë vlontejeta e gjallë. Ndiheshin boritë e makinave, tringëllimat e zileve të karrove dhe zhurma e njerëzve.

Tori Pini ishte ulur në tavolinën e tij në zyrën e vëtmuar dhe po vështron te copërat e mbetura të stofit. Ato ishin me përmasa të vogla e fare të vockla, sa leckat. Ai po i vështron te dhe po e gjykonte veten e tij reptë. Mos vallë kishte lënë ndonjë punë pa kryer? Po. Kështu pat ndodhur para disa muajsh. Kur ai shpiku linjën e vatës, që bërë shumë zhurmë. Erdhën nga komiteti ekzekutiv e pastaj u duk sikur gjithçka do të shkonte mbarë. Për këtë qëllim u bënë dhe disa pjesë të makinës së vatës, por ja që filloi një zvarritje e kotë dhe ai, Tori Pini, nuk po zbulonte dot se ku ishte koka e kësaj zvarritjeje në ndërmarrjen e prodhimit të qilimave!

Si komunist ai vështron rrjedhën e jetës së tij, dhe ja që ai qe pajtar me atë gazetarin që i thuri lavde si autor i shpikjes së vatës, por që nuk e shpuri punën më tej duke luftuar ashpër burokracinë e disa shokëve. «Pse ishte tulatur e s'kishte ngritur zérin?». Tori Pinit kjo çështje i ngjasonte si një plagë e mbetur pa shëruar dhe pshëretiu thellë.

Gjithçka ishte gati. Linja e vatës ishte shpikur e bëre gati, por u desh një luftë e tërë kundër zvarritjeve për ta vënë në prodhim.

I kujtohej biseda me shefin e llogarisë, Nestin, që ishte ndër të parët që kishte aprovuar idetë e kursimeve të tij. Ishte diçka si e pabesueshme që nga një centimetër plackë që Tori Pini e mbante në bulëzat e gishtërinjve të lindnin të gjitha ato kursime. Po të rreshtoheshin shifrat si milingona, bëheshin miliona. Por Nesti si ekonomist që e dinte mirë se q'do të thotë kursim e punë, mbasi vetë pat qenë punëtor, ia vlerësoi dhe e inkurajoi Tori Pinin që hyri në luftë të rreptë me ata njerëz që nuk u jepnин rëndësi mendimeve të tij.

— E di si thua ti, shoku Tori Pini? Që njeriu të hajë bukë dhe të mos bëjë thërrime!, — i thoshte inxhinier Steli, pa e vrarë shumë mendjen për mallin e shtetit.

— Pse jo! Dhe thërrimet t'i ruajmë, inxhinier!

— Njeriu bëhet i mërzitshëm kur vete dhe e mërzit punëtorin për çikërrima të tilla.

— Kjo cikërrimë sjell miliona kursim në vit, inxhinier!

— Se mos ka ngelur shteti ynë të kursejë nga leckat! Vështro shëndetin tënd, Tori.

— Po të mendojmë të gjithë kështu, inxhinier, s'kemi për të çarë kurrë rrëthimin e bllokadën!

— Bllokada e rrëthimi nuk çahen me lecka, o Tori.

— Cahen, çahen që ç'ke me të, por thelloje mendimin! . . . — i tha Tori dhe e kuptoi së duhej shumë punë sqaruese me të gjithë njerëzit.

Kjo histori mori një kthesë të habitshme. E rrjedhja e ngjarjeve doli nga një kooperativist që ujiste bostanet. Ai vajti një ditë në drejtorinë e kombinatit me një lakër të mbështjellë dhe takoi Kopi Nanushin që ishte së bashku me Tori Pinin duke biseduar për çështjen e vendosjes së formave të mostrave sipas një metode të menduar prej Tori Pinit.

— Ju jeni drejtori?, — tha ai duke hequr me respekt shapkën e tij të mbushur me dhe.

— Unë jam, si e keni punën?, — u habit Kopi.

— Ja, vështro se si është puna! — Ai e hapi letrën që mbështillte një lakër të kuqe!

— E çfarë do kjo lakër me ne!, — u habit Kopi që nuk po hynte dot në thelbin e shqetësimit të tjetrit.

— Po e lëshoni bojën pa kursim në kanalin e shkarkimit të ujit. Nga kjo po skuqen lakrat!...

«Ja ku na qenka shkaku i shpenzimit të bojërave pa kriter, që na kushtojnë një djall e gjysmë, duke na përpire gjithë atë valutë!, — mendoi Kopi Nanushi duke vërtitur nëpër gishtërinj atë lakër. — Kjo qenka për të zënë kokën me dorë!».

Thirri në telefon inxhinier Stelin e ai erdhi qetë-qetë.

— Rri, Steli!, — i tha Kopi i përmبajtur dhe i vuri përpara lakrën e skuqur. — Ja! Vështroje punën tënde. Nuk le lakër pa ngjyrë! Turp!

— Të jenë të gjitha të kuqe, hajde de, se ua hidhni lopëve, por ca kanë ngjyrë portokalli, ca të zeza e ca të verdha, të zë lemeria, o drejtor! Për besë si shumë të

pasur qenkeni në bojëra! . . . , — u zbraz kooperativisti.

— Ku të shpie mushka me ato dorëlëshuarat e tua. Prandaj cilësia e ngjyrave nuk del mirë. Nuk kam për ta lënë me kaq këtë punë. Do të lajmëroj të vijnë specialistë nga lart dhe po nxorën ata që ju jeni shkaktari, nuk kam për të treguar asnje shenje keqardhjeje, sepse po tregoheni tepër liberal me mallin e shtetit! — Inxhinier Stelit iu kyç goja. Ai u zverdh.

Tori Pinit i kujtohet kjo skenë. Atij i kujtohet edhe debati me inxhinier Stelin, kur ai merrej me studimin e kursimit në repartin e prerjes.

Tori Pinit i kujtohet edhe biseda me inxhinier Qendro Kolonjën. Inxhinieri i shkurtër e pat parashikuar se autoriteti dhe pushteti që kishte Tori në kombinat, sigurisht që nuk duhej të nënveftësohej prej tij. Qendro Kolonja po e vriste mendjen si ta tërhiqte pas vetes Tori Pinin, i cili do t'i vlente aq shumë për qëllimet e tij egoiste.

— Eh!, — kishte pshëritirë skilja plakë që vinte nga vendet e naftës dhe pastaj vazhdoi kur e ndeshi Tori Pinin në atë gjendje që i vlente atij: — Këtu, i dashur kryetari i bashkimeve profesionale, nuk vritet kaq shumë mendja. Ore, punëtorët e naftës janë, për mendimin tim, heronj, heronj! Jemi në bllokadë. Pse kështu duhet të qëndrojmë ne përpara bllokadës, duarlidhur?

— Kush rri duarlidhur, inxhinier?!, — u habit Tori.

Qendro Kolonja e kuptoi se duhej ta kthente timonin e bisedës se gafa që bëri do ta demaskonte atë si një njeri që i ka sytë me perde e nuk vështron se çfarë bëhet rrëth tij.

— Fjalën e kam te shpikjet dhe te prodhimi i të gjitha pjesëve të këmbimit të interlogëve, të makinave të çorapeve, të makinave qepëse. . . Të shkojmë të pimë së bashku një kafe!

— Ju falemnderit. Por nuk ju kuptoj se ku e keni konkretisht fjalën, inxhinier.

— Më kanë thënë se ju keni bërë shumë racionalizime e shpikje, shoku Tori. Bile për to keni marrë aq shpërblime, saqë e keni pajisur shtëpinë me ato që nuk i ka askush në këtë qytet! . . .

— Marrëzira! — Tori Pini u prek dhe e vështroi me mospërfillje për ato që tha.

— Sigurisht që ndonjë gojë ziliqare i shpik këto fjalë, apo jo, shoku Tori?!, — kërkoi të riparonte bisedën e nisur, por ndeshi në vështrimin qortues të Torit.

— Thashethemet çojnë ujë në mullirin e djallit, o inxhinier, — tha Tori vrazhdë.

— Unë kam një parim, shoku Tori. Të hidhemi përpala për të çarë në fusha të panjohura, pa le të dalë ku të dalë.

— E kush na ka qitur dorën përpala? — Tori nuk ishte i flashkët siç dukej në paraqitjen e jashtme.

— Ndoshta ju keni të drejtë, shoku Tori, po ja që për prodhimin e platinës nuk po gjemjë përkrahjen e duhur... Prandaj kërkoj mendimin tuaj të vyer.

— Nga unë mund të mësoni se si mblidhen lekkat e bëhet stofi, — tha Tori që e kuptoi se inxhinier Qendroja po luftonte për të krijuar një kundërpeshë për në drejtori.

— Mrekulli, shoku Tori!, — tha shefi i llogarisë, Nesti, që u ndërpren bisedën. — Një mijë copë kanotiere më shumë sipas metodës suaj të prerjes. Ja, sot gëzojmë për metodën e re të prerjes, nesër për shpikjen e platinës nga inxhinier Qendroja, pasnesër për linjën e vatës e kështu me radhë, — theksoi Nesti dhe u vuri duart në supe Torit e Qendros.

Torit i ngazelleu fytyra. Qendro Kolonja heshti dhe picërroi sytë.

### 3.

Në oficinë ra një qetësi e frikshme. Ishte prerë ko-renti. Difekti ndodhej larg në termocentral. Punëtorët, të cilët nuk dinin se çfarë do të bënin sa të rregullohej difekti, dolën të shullëheshin në diell.

Koço Opingari e hapi pakon e tij të ushqimit dhe filloi të përtypej me nofullat e mëdha. Rreth tij u grumbulluan disa punëtorë? Aty vajti edhe Anastas Kitara.

— Ju bëftë mirë, mjeshtër!

— Urdhéroni, merrni nga një copë!, — foli ai duke u mbillaçitür.

— Një viç të tërë të pjekur e ha?, — tha Anastas Kitarra. — Të tjerët ia plasën gazit si në kor.

Papritur u dha inxhinier Qendro Kolonja i nxirë si të kishte dalë nga oxhaku i gjatë i kaldajës.

— Bujrëm, inxhinier!

— Lidhuni me klasën punëtore!, — ia priti tjetri. Ai u largua pa folur.

Arben Korça po vështronte mendueshëm Vasfi Dishnicën që kishte zënë vend në grupin tjetër sipër murit të mbushur me bar të gjatë. «Vallë të gjitha ato thika prej videoje të thyera! Po shkaku?» Kur Arbeni po mendonte kështu, përpara tij ia behu inxhinier Qendroja së bashku me drejtoria e kryeininxhiner.

— Ja ... Vështroini se si livadhisin punëtorët e oficinës në orar të punës! ..., — bërtiti inxhinier Qendroja dhe vështroi reagimin e Kopit e të Margaritës.

— Është prerë korenti, lajmëruam centralin, — tha Arbeni.

— Dhe ne me mendjen e këtij! — Kopi Nanushi e qortoi Qendron që u tkurr si miu i zënë në çark.

#### 4.

Margarita priti Arbenin të qoshja e rrugicës, nga dilej në bulevardin e madh.

Roja me pushkën e varur në sup po vështronte vjedhurazi supet e vajzës që shndrisnin nga drita e projektorit.

— U vonove, — i tha ajo.

— Kontrollova repartin, por dhe një minutë. — Ai ndaloj përsëri dhe u përkul.

— Çfarë ke kështu? — Në zërin e saj ndihej njëfarë nervozizmi.

- Një minutë sa të lidh këpucën.
- U vonuam.
- Nuk ma mban pak librin! I zgjati librin që e mbante në dorë.

Margarita vështroi titullin. Ishte një libër teknik që nuk i ngjalli ndonjë kureshtje.

Më tutje ua ndriçoi fytyrën një rreze drite e dalë nga shtylla e neonit.

- Diçka për motorët!
- Për cilët motorë!
- Ja! Diçka për makinat!
- Mos do të ndërtoni ndonjë tip kamioni?
- Mirë do të ishte, por . . .
- Sot e teproi inxhinier Qendroja!, — ndërroi bisedën ajo.
- Unë nuk shqetësohem prej tij.
- Ty të shqetëson vetëm inxhinier Stefan Grabova!
- Vërtet, Margarita, ku e njihni atë tip të pahonep-sur!!?

- Kemi qenë së bashku në Sojuz!
- Vërtet ka qenë jashtë ai tip?!
- Pse habitesh?

— Interesant, nganjëherë sita lëshon edhe qime të gjata, prandaj sita duhet të jetë sa më e shpeshtë.

— E ke gabim, unë nuk e njoh për njeri të keq Stefanin. Kot e keni marrë për ters. . .

- Unë s'kam gjë me të.
- Mbase nga njëfarë xhelozie. . .
- Unë xheloz? Ama më paske njohur mirë, Margarita!

— Në qoftë kështu, atëherë pse nuk e honeps dot Stefanin?

— Ai i përqmon të tjerët. Përpiqet si e si t'i vërë në lojë. Ai duhet kritikuar dhe, po s'u ndreq, duhet fshikuilluar! . . .

- Mos u shpejto në gjykimin e të tjerëve, Arben.
- Fundja shokët e tu mbeten shokët e tu, por, që të hyjë ai tip në zemrën time, është fare e pamundur. Ai diçka fsheh, nuk është i singertë.

— Mirë, e lëmë këtë bisedë, — tha Margarita.

— Mos duhet të blejmë ndonjë dhuratë për Torin?

Ka pesëdhjetëvjetorin. Pastaj ti e ke dhe tëndin.

Margarita miratoi me kokë. Arritën në pasticeri vetëm disa çaste përpëra se shitesja të mbyllte dyqanin. Margarita mezi po merrte frymë ngaqë pati vrapuar dhe Arbeni vështronë në profil hundën e saj të vogël që mezi aspironte.

## 5.

Në hyrjen e shtëpisë që llamburiste nga dritat e shumta i priti vetë Tori Pini. Atij i ngazëllente fytyra. Nuk ishte e pakët të festoje pesëdhjetëvjetorin.

— Ti më dukesh si dyzetvjeçar, Tori!, — i tha Margarita dhe e puthi në faqet duke i dhënë buqetën e luleve dhe dhuratat simbolike.

— Po ju pse nuk flisni, Arben?

— Gëzuar ditëlindjen, shoku kryetar i bashkimeve profesionale.

— Ja një urim i bashkuar me ofiqet!, — tha Tori.

— Përkunderazi, ishte një urim shumë i goditur, Arben, — tha Margarita.

Ecën më tutje të ngazëllyer. Arbeni vështronë shtëpinë e përpinqej të zbulonte se cilit stil i takonte. Me të tilla mendime ai u dha në dhomën e madhe të shtruar me një qilim të bukur gjithë ngjyra e me një tavolinë të shtruar me mezera e pije, rrëth së cilës kishin zënë vend të ftuarit.

Arben Korça ndeshi një ambient të ri. I dukej sikur ajri përzihet me frymën e njerëzve të shumtë që bisedonin të ndarë në grupe e tymosnin duhan. E përqëndroi vështrimin te shefi i llogarisë, që përpinte me sy të gjitha të mirat e tavolinës dhe si një makinë llogaritëse kalonte nëpër mend shpenzimet që i ishin dashur të bënte Tori Pinit. Ndoshta ngaqë shuma e shpenzimeve sipas llogarive të tij dilte e madhe, ai nuk bëri asgjë tjetër vetëm

që përveshi buzën e poshtme, zakon i keq i tij që Margaritës i sillte shqetësim.

Sotir Filloja po fliste me zjarr pér gjuetinë e peshkut. Ai ishte amator i peshkimit, ndonëse gjithnjë kthehej me duar bosh, me orë të tëra tregonte pér atë peshkun e madh që kishte «zënë».

Pastaj i tërroqi vëmendjen inxhinier Andrea Bunça, i cili në kësó rastesh qëndronte si i ngurosur në kostumin e tij të zi.

— Mirë se erdhët, shokë e miq! Këtë dolli ta pimë me fund pér Partinë tonë trime dhe t'i urojmë shëndet e jetë të gjatë sa malet tona shokut Enver Hoxha! — tha Tori Pini, të cilit i shndriste ftyra.

Të gjithë u ngritën në këmbë dhe çuan gotat me fund.

— Ky është shëndeti i Torit! Le të bëhet Tori njëqind vjeç dhe le të mendojë gjithnjë pér kursime, — ngriti gotën Miha Voskopoja. Të gjithë e çuan me fund.

— Unë gjithmonë kam pasur besimin që rakia e rrushit .nëntëmbëdhjetëgradëshe të bën të flasësh më burkur e më mirë. Apo mos e kam gabim? — Dhosi ishte në pikën e parë të vlimit të rakisë.

— Gjella me kripë, e kripa me karar, — tha Kopi, që po e shihte se Dhosi po shpejtonte në të pirë.

Margarita gajasej së qeshuri nga fjalët çapraze të Dhosi Qafëzezit, i cili zuri të fliste pa kursim.

— Rroftë shoku Tori Pini! Unë e kam pér nder që po dehem në shtëpinë e shokut Tori Pini, mbasi është shtëpi me tradita të lashta e ka strehuar bile dhe Themistokli Gërmenjin me gunën e tij në kohën kur i kërkxonin që të dy!

Të tjerët u gajasën me të madhe. Dhosi Qafëzezi ishte në kulmi të gjëzimit dhe nuk po u zemërohej batutave që po i hidhnin. Ai po e kuptione se e kishte lëshuar pakëz frerin e «pegasit», por kishte forca pér ta mbajtur pa shkarë në greminë.

Atëherë kur pothuajse tavolina po boshatisej, u dha Stefan Grabova. Inxhinieri i vonuar ishte veshur shik. Kostumi i bardhë me kuadrate me ngjyrën e fytyrës së tij

brune të theksuar krijonte një kontrast të thellë bardhë e zi.

Margarita i bëri shenjë që ai të ulej pranë saj. Bile ajo u shty pak më tutje duke shtyrë dhe Arbenin pér t'i liruar vend të porsaardhurit, por ai nuk u ul pranë tyre. Në sytë e tij si të vajosur të dukej se kundroje një mje-gull.

— Mirë se erdhe, o Stefan Grabova!, — i foli zoti i shtëpisë dhe ngriti gotën.

— Jetë të gjatë të zotit të shtëpisë!

— Shokët e miqtë qofshin me nder!

## KAPITULLI I SHTATE

### 1.

Sofie Korça, grua me një përvojë të pasur në jetë, që sapo kishte lënë të gjashtëdhjetat, diçka kishte nuhatur në shpirtin e djalit të saj të vetëm. E gjatë nga shtati, kurmi i saj të ngjasonte me trupin e një dardhe të plasaritur. Por ajo ishte e fortë dhe mbahej mirë. Nuk mbante syze. E shkonte me lehtësi perin edhe në gjilpërën e vogël. Dhëmbët e bardhë të qarkuar nga buzët e buta e të pastra mund t'i ngjallnin zilinë dhe një vajze. Me përjashtim të thinjave që i binin poshtë shamisë së zezë tek ajo nuk dukej asnë shenjë pleqërie.

Si nënë e një djali të vetëm, ajo mezi priste ditën e fejesës dhe mendja i fluturonte gjithmonë të nusja, që si pas dëshirës së saj duhej të ishte e bukur, e gjatë, e urtë. Pa të tria këto cilësi ajo nuk kishte se si ta kuptonte nusen e të birit. Por mendimi se nuset kërkojnë nga vjehrrat që ato të jenë të zonja të mbajnë veten e tyre, që të mos bëhe barrë për to, e kishte bërë Sofien të mbahej më mirë se ç'e kishte zakon.

Por nusja nuk binte nga qielli. Ajo duhej kërkuar.

Në mbrëmje natën vonë kur i biri kotej në gjumë, ajo fillonte nga biseda e saj që i ngjasonte tingullit të një teli të hequr:

— Arben, prit mos fli, dua të të tregoj diçka.

Atij po i mbylleshin sytë nga gjumi i rëndë si plumb dhe zëri i saj i vinte si nga jehona e shkrepave.

— Mirë, mirë. Vetëm se pak shpejt, nënë.. Më flihet! Një përgjigje e tillë e zvarritur e fare pa interes e egërsonte Sofien, e cila nuk dinte se si të vepronë në këso rastesh.

— Si shpejt!

— Mirë. Fol ngadalë!

Ajo merrte zemër nga ajo përgjigje e sa fillonte të fliste, atë e kishte zënë gjumi! Sofia, sa dëgjonte frymë-marrjen e tij të lehtë, i afrohej fytyrës së Arbenit që kish-te humbur në èndrrat e tij clodhëse. Ajo ngrihej ngadalë ia mbulonte me bataniqe gjoksin e gjerë. E vështronë. I vinte mirë që ai ishte i tillë. I bukur dhe i ashpër. «Kështu duhet të jetë burri!», — thoshte. Dhe i biri, me-gjithëse po flinte si një shqerrë, i shembellente si dy pika uji me tiparet e të shoqit.

I kujtohej se si i pat kënduar kur ishte i vogël me gjithë ato këngë të veshura me historira trimërish ku trimat e kësaj toke luftonin me bajlozat që vinin nga deti dhe gjaku derdhej lumë gjersa i hidhnin në det.

U ndie një kollë e fortë. Sofia u hodh përpjetë e kë-puti perin e lëmshit të çorapes, Arbeni hapi sytë. Shikoi orën.

— Stavri martoi të birin!, — hapi bisedën ajo.

— Të trashëgohet, nënë!

— Në kokën tënde ishallah.

— Mirë, mirë, tani të flemë.

Ti nuk e di se çfarë zoge pashtë në dasmë. Ishte e bu-kur shejtania dhe e gjatë sa ty! E di se si shkonit të dy, si pendë qe, asnjë më i shkurtër, as më i gjatë.

— Mirë, mirë, tani do të fle!

— Do të flesh?, — thoshte ajo e inatosur.

— Këto biseda hiç nuk më pëlqejnë!, — ia kthente ai.

Sofia humbiste urtësinë, gjë që dallohej në vijat që i thelloheshin në atë ballë të lartë.

— More kapedan, si flet kështu ti xhanëm! Unë i la-shë të gjashtëdhjetat e jam me sot me nesër e ti më folke

mua sikur në botë nuk ka ndryshuar asgjë e si të jesh një djalosh i vogël që po mëson hapat e parë! Ej, kokë! I thirr mendjes, se kushedi se nga të kullot. U plaka unë dhe na duhet nusja.

— Mirë, nënë, por mua po më luan tepeleku i kokës me punë, me shkollën dhe vështroje vetë, a e kemi kohën pér të marrë nuse?

— Pika mua! Më mirë të kisha lindur dhjetë çupa... Kur mbaron puna, mbaron edhejeta. Atëherë do të martohesh, ë?

— Natën e mirë, nënë.

Ai kthehej në anën tjetër dhe fillonte të flinte. Ajo ikte me pishmanllék që ishte grindur me të.

Në mëngjes ajo ngrihej shpejt dhe, si të kishte shkundur gjumin e së bashku me të dhe grindjet, fillonte e bënte mëngjesin gati.

Sofia dridhej nga mendimi që ia buçiste kokën dhe që ia trazonte shpirtin. Të ishe shtatë metra larg maternitetit e të mos kishe asnjë trashëgimtar, pér Sofien ishte një brengë e madhe! Të rriste njëherë fëmijët e Arbenit, pastaj le të mbyllte sytë. Atëherë do të pushonte e qetë.

Fjalë pas fjale Sofie Korça kishte dëgjuar pér një vajzë në një fshat të largët malor që lum ajo shtëpi që do ta fuste brenda. Falë bukurisë, vajza ishte nga soji i mirë, punëtore dhe e shkathët si flutur. Kaq donte Sofia dhe një të hipur autobusit të linjës e frymën e mbajti në fshat. E vështroi vajzën si ndonjë xhambaze dhe mbeti me gojën hapur! Nuk e kishin gënjer. Por, kur i thanë që vajzës i kishte hedhur grepin një bandill në fshat dhe fejesa ishte shpallur ato dy-tri ditë të shkuara, ajo u bë pikë e vrer. U kthyte në shtëpi e lënduar dhe me fytyrë të hequr sikur të kishte lënguar pér ditë të tëra. E kapi një dhembje koke aq, sa nuk ngrinte dot kapakët e syve. Arbeni u shqetësua aq shumë, saqë edhe atij nuk po i queshte buza. Ajo nuk i kishte thënë asgjë.

## 2.

- Nesër, nënë, shtëpia duhet të jetë më e rregullt, — i tha Arbeni një ditë kur ajo ishte ngritur nga krevati.
- Përse?, — e pyeti ajo.
  - Do të vijë për vizitë Margarita.
  - Cila Margaritë?, — pyeti ajo me kureshtje.
  - Kryeinzhinierja.
  - Korba unë, e kemi shtëpinë pa lyer!, — i tha ajo e brofi në këmbë.
  - Shtëpia nuk është keq, nënë, pastaj tjetri nuk vjen për të parë shtëpinë tonë.

Sofia i hodhi një vështrim qortues të birit dhe filloi të pastronte e të lante shtëpinë me ngut.

## 3.

Arbeni kapërceu pragun e shtëpisë me ca libra në duar. Si një grua e thjeshtë dhe e rrahir me hallet e jetës, Sofia mendonte se për shtëpinë më të vlefshme janë një krah me shkarpa, sesa ata libra që ai i mbante me aq kujdes.

- Përse i ke ato libra, o bir?
  - Janë libra teknikë. Duhen, nënë, duhen!, — u përgjigj ai, duke e lënë si të ngrirë në kanatet e portës së hapur.
  - Pse pak vuajte sa mbarove shkollën dhe tani ke vendosur që të vrasësh ende mendjen?
  - Ai ishte fillimi, nënë. Tani na presin punë të mëdha.
  - A? — foli ajo dhe e la vetëm me ata libra nëpër duar, të cilët ai po i stivonte në raft. Asaj nuk po i vinte mirë që i biri ishte dhënë aq tepër pas librave dhe s'po e vriste fare mendjen pér t'u fejuar e martuar.
- Një ditë i vajti mendja që t'i rrëmbente të gjithë ata libra që ia kishin prishur mendjen Arbenit dhe t'i flakte në pus, por u pendua, sepse e dinte se do t'ia lëndonte

zembrën të birit. U ul në minder dhe po e vështron te përkundruall dhe tundi kokën e pakënaqur duke pëshpëritur me zë të ulët: Im bir, në vend që të mendojë pér vete, e humb kohën duke lexuar nëpër libra se çfarë kanë bërë të tjerët!...».

#### 4.

Arben Korça, nga vrulli me të cilin kishte filluar punën, u habit kur i dhanë ftesën e përvjetorit të themelimit të kombinatit. Për linjën e platinës ai po punonte dhe vetë në torno deri në orët e vona të natës.

Duhej të vishej mirë pér festën. Me siguri që atje do të shkonin të gjithë kuadrot kryesorë të rrethit, bile edhe sekretari i parë, me të cilin kishte aq kohë pa u takuar.

Atë ditë Arbeni shkoi më shpejt në shtëpi se herët e tjera. U la dhe u vesh si dhëndër. Sofia e vështron me një krenari prej nëne dhe s'po ia ndante vështrimin të birit sikur të mos e kishte parë prej muajsh.

— Pse më vështron kështu, nënë?

— I bukur je! Si një hero të ka mamaja, por mendo, të keqen mamaja, të fejohesh, se o sot, o kurrë!...

— Vetëm aty të rreh çekani, nënë, — foli Arbeni me buzën në gaz.

— E ku të më rrahë, mor bir? Dua të të shoh me nuse e me kalama pér dore...

Salla e madhe e këndit të kuq ishte zbuluar me banderola. Midis njerëzve që ishin ulur në presidium, krekoj më shumë inxhinier Qendro Kolonja, kurse Koço Opingari kishte zënë vend nga fundi i sallës.

Dhosì po bisedonte me Margaritën. Ai diçka po i trengonte vajzës, e cila qeshte e nuk i zinte besë, sepse dhe Dhosì, kur bisedonte me vajzat, rrëmbehej nga fantazia dhe ato gajaseshin me të madhe.

Arbeni u afrua me hap të ngadalshëm.

— Pa kavalierin dukeni krejt e pikëlluar, — i thoshte pa tekliif xha Dhosi duke mos ditur se prapa shpine ndodhej Arbeni.

Mbledhja akoma nuk po fillonte. Dikë prisnin.

— Ja, qenka bërë dhëndër, — tha Dhosi.

— Kush?, — pyeti Margarita dhe ktheu kokën me vrull e i qeshi buza.

Arbeni i vuri dorën në sup xha Dhosit dhe i tha:

— Xha Dhosi, si shumë e hape lojën!

— Ulu, ulu, se, po të mos vije ti, rrezik se do të fillonte breshri, aq shumë ishte vrenjtur koha, — tha xha Dhosi dhe vështroi Margaritën. Të tjerët u gajasën, kurse Margarita buzëqeshi e uli kokën.

Inxhinier Qendro Kolonja i krekosur në presidium s'ia ndante sytë kinooperatorit, që ta fuste në objektiv, por ai se pse i binte anash dhe kjo po e nevrikoste së tpermëti inxhinierin, që po lëpinte buzët e thara nga inati.

I deleguari lexoi emrat e të dekoruarve. Koço Opingari nuk u besoi as veshëve kur u zu në gojë edhe emri i tij dhe nuk po lëvizte nga vendi.

Inxhinier Qendro Kolonja priste emrin e tij, por atij nuk ia zuri njeri në gojë. Atëherë fytyra e tij mori ngjyrën e shpretkës. Filloj të vriste mendjen se kush i kishte hequr laps të kuq emrit të tij. «Kush, vallë?!», — pyeste veten dhe po ecte si i mekur.

## *KAPITULLI I TETË*

### 1.

Inxhinier Qendro Kolonjën nuk po e zinte gjumi. Ai po rrihte gjoksin si shpikësi i linjës së platinës. Mosdekorimin e tij po e quante një padrejtësi të madhe. Vetëmburrjet e tij po kalonin nëpër kombinat si një re karkalecësh dhe nuk linin gjë të mirë për shpikësit e dekoruar.

Miha Voskopoja nuk mund të qëndronte pasiv. Së bashku me Kopin e thirrën ta sqaronin, po ai mori zjarr.

— Autolëvdatat dhe puna për lavdi personale janë të huaja për njeriun tonë të ri, o Qendro!, — i tha Kopi dhe e mbuloi me vështrimin e vrazhdë. Inxhinieri heshti.

### 2.

Arben Korça çështjen e platinës nuk e quante kushe di se çfarë. Prodhimi i platinës nuk kishte ndonjë vështirësi teknike. Ajo ishte një vegël e thjeshtë e pa ndërlikime.

Guximi dhe iniciativa e autorëve të platinës nuk duhej të liheshin mënjanë, por dhe vlerësimi i tepërt i tyre ishte një punë e nxituar që bëri drejtoria ndaj tyre.

Kush vallë do të ishte ai që do të merrte mbi shpatulla ndërtimin e linjës së makinave të gjilpërës? Kjo

po! Kjo ishte një punë pér të qenë, një punë e vështirë, me të panjohura e të papritura.

G j i l p è r a ! Kjo qenie e vogël, e brishtë, ky detal i vogël me forcë kolosale, që pengonte e ndërpriste prodhimin, ja se cila ishte gjilpëra.

Arbeni shkoi nëpër mend inxhinierët që kishin ngri-tur supet përpara zbulimit të misterit të gjilpërës. Gjilpëra kishte kyçur gojët më guximtare. Mos vallë do të kyç-te dhe gojën e Arben Korçës! Ku dihej!

G j i l p è r a ! Ai u përkul, e kapi me dy gishtërinj dhe e vendosi mbi pëllëmbën e tij.

Duke e vështruar me kujdes, pér një çast Arbenit iu duk se ajo po i thoshte: «Ç'më vështron me kureshtje? Vërtet të dukem e vogël, por deri më sot vetëm ca shtete të industrializuara kanë mundur të më prodhojnë. Je i zoti të më prodhosh, të më bësh bijë të Shqipërisë socialiste? Pérndryshe të mos më hiqesh si luftëtar i paepur pér të çarë bllokadat!». E shtrëngoi fort në pëllëmbën e tij plot kallo. Dora iu bë grusht. U betua: «Ne, bijtë e kësaj toke, jo vetëm ty që je sa një këmbë mize, por edhe traktorin do t'ju bëjmë bij e bija të Shqipërisë socialiste dhe do t'ju gatuajmë me brumin e nëntokës sonë!».

Arbeni vendosi të konsultohej me Margaritën, me Koço Opingarin, me shokët e tij punëtorë dhe t'ua mbush-te mendjen që t'i hynin punës pér prodhimin e gjilpërës në vend. «Vallë mos do të tallen me mua? Le të tallen? Unë do t'i bind me punë se kjo është e mundshme!», — foli ai me vete.

### 3.

Mendimet e Arbenit pér gjilpërën aq sa e ngazllyen, e vunë në mendime Margaritën. Ata, të pushtuar nga bis-sedat e mendimet, u ngritën të dilnin nga lokali «Iliria» pa paguar.

Jashtë po qimëzonte dëborë, trokitja e parë e lehtë, që lajmëronte ardhjen e dimrit. Një thëllim i acartë ua

preu fytyrën. U ndalën nën strehën e një ballkoni. Nga era i mbronte qoshja e rrugës që kthehej pak më tutje. Errësirë. Ai kënd i fshehur si gji deti ishte një vend i preferuar për bisedë.

— Si kështu, Arben? Më habite!

Ajo stinë, siç dukej, për Margaritën po vinte plot habira, ndoshta më vonë siç vjen dimri me atë petkun e tij të bardhë, mund t'i sillte dhe asaj fustanin e nuses!

— Kjo mund të bëhet, Margarita! — Ai nuk tundej nga e tija.

— A e di ti se cilat janë makinat e prodhimit të gjilpërës? A e di ti se cila është gjilpëra vetë?!

— E marr me mend! — Ai e ndjeu që nën këmbët e tij u bë një boshllék!

— Mos u nxito, Arben.

— Shqetësosesh kot së koti, Margarita, — tha si i habitur nga kthesa që po merrte biseda. — Unë i kam menjuar e peshuar që të gjitha. Do t'ia dal në krye se s'bën!

— Optimizmi yt më ngazëllen shumë por jam e bindur që kundërshtarë do të kesh shumë. Çështja qëndron se si do ta presin inxhinierët këtë mendim!

— Ata me siguri do të përkrahin mendimin tim.

— Çështja e ndërtimit të linjës së gjilpërës sot për sot është një betejë e pamundur, Arben. Megjithatë, për këmbënguljen tënde unë ruaj respektin më të thellë.

— Mua më duhet ndihma e jo respekti!

— Njerëzit, përpara se të japin fjalën për të ndihmuar, duhet të binden se çështja, për të cilën do të sakrifikojnë, e ka të sigurtë fitoren, apo jo?

— Domethënë ti nuk ke besim se ne mund ta prodhojmë në vend linjën e gjilpërës, ë?

— Për mendimin tim, sot për sot është e pamundur të ndërtojmë një linjë të tillë.

— Ti më këshillon të heq dorë nga projekti, ë?!

— Vrulli për ta marrë çdo gjë lehtë, të turpëron, Arben!

— Unë kam besim në forcat e mia dhe të shokëve, që, po t'i futem me gjithë shpirt, do t'i dalim në krye se s'bën!

— Të kuptohemi, Arben! Për të ndërtuar linjën e gjilpërës, duhet të zgjidhen gjithë ato vështirësi teknike të koklavitura e shumë të vështira pér t'u zgjidhur.

— Që do të ketë shumë vështirësi e pengesa, këtë ta pranoj me gjithë zemër. Po si thua ti, Margarita, të ngremë duart përpara bllokadës e rrëthimit armiqësor që kërkon të na mbysë në truallin tonë, apo të luftojmë me thonj e me dhëmbë duke bërë edhe të pamundurën?

— Të gjithë po mendojmë e po luftojmë se si të çajmë bllokadën e rrëthimin, Arben, e mos u nxito të nxjerrësh konkluzione të gabuara.

— Mirë, mirëpo duhet të mendojmë e të luftojmë më mirë, më shumë, më me kurajë, sidomos në frontin e teknikës.

Margarita vështron te sytë e tij gjithë zjarr, e pasion ndjeu një krenari pér gjithë atë optimizëm të shokut të saj, që të bënte pér vete. Ajo kishte shtangur. Ai kishte të drejtë. Përse nuk pat menduar si Arbeni dhe ajo, dhe in-  
xhinier Andrea Bunça, Stefan Grabova, apo dhe Sotir Filloja?!

— Kjo çështje duhet matur mirë Arben, se përndryshe bëhemë qesharakë përpara të tjerëve.

— Frika e dështimit nuk duhet të na mpijë gjykimin, të na bëjë të ngremë duart, por me guxim t'u futemi provave një herë, dy herë, tri herë, dhjetë here derisa ato të na dalin me sukses, e jo të themi se ç'do të thotë bota!

— Sa thjesht i mendon gjérat ti, Arben! Po mos harro se ata njerëz, me të cilët ti ke të bësh, nuk janë «bota», siç shprehesh ti nga nxitimi, por njerëz realë, ata që formojnë opinionin, dhe ti nuk duhet ta nënvlërësosh opinionin, mbasi ai është një forcë e madhe, që ndikon drejt-përdrejt.

— Po s'patëm besim në forcat tona, s'kemi se si të thyejmë nofullat e bllokadës!

— Edhe mbivlerësimi i forcave tona është një sëmundje e rrezikshme që të çon në mendjemadhësi. Prandaj duhen peshuar mirë forcat.

— Domethënë ti, Margarita, gjithnjë qëndron në tënden, ë?

— Tash për tash po, Arben! Megjithatë ta bisedojmë njëherë shtruar edhe me Mihën, Kopin, me inxhinierët, teknikët.

— Doemos do ta bisedojmë, po unë desha miratimin tënd, kurse ti po lëkundesh si ndonjë degë peme në furtunë.

— Natën e mirë, Arben!, — tha ajo e fyer.

— Natën e mirë, Margarita.

Ajo u largua me nxitim sikur ta ndiqte njeri. Arbeni u habit nga hapat e shpejtë të saj dhe ngriti supet.

#### 4.

Miha Voskopoja nuk e kishte për turp që ta shihte ndokush duke bërë punët e shtëpisë. Lëre më tanë që ai e kishte gruan të shtruar në spital dhe i kishin rënë mbi kokë të gjitha punët. Kur trokiti dera, ai me tenxheren në dorë e hapi atë dhe i buzëqeshi Arbenit.

— Ne burrat s'mbajmë dot rregull e pastërti në shtëpi, — tha ai dhe shpejtoi t'i mbulonte pjatat e palara me peshqirin që kishte në sup.

— Nuk ka gajle! Fundja jemi së bashku, ne nuk kemi se çfarë të fshehim nga njëri-tjetri.

— Ke të drejtë, — tha ai dhe i vuri përpara një raki rrushi.

— Gëzuar! Miha!

— Gëzuar!

— E di përsë kam ardhur?

— Sigurisht për fejesën. Keni vendosur ta hapni ë?

— Kam menduar që t'i futemi ndërtimit të linjës së gjilpërës në vend.

— Linjës së gjilpërës!, — u habit ai.

— Po, Miha.

— Pa më thuaj, i ke marrë parasysh se ç'vështirësi na dalin?

— I kam llogaritur të gjitha, Miha, dhe jam i bindur se do t'ia dalim me sukses.

- Po Margarita ç'mendim ka?
- Sot për sot ajo ka frikë se nuk ia dalim dot, bile edhe u grindëm për këtë çështje.
- Që duhet peshuar mirë kjo çështje, Margarita nuk e ka gabim. Po ti peshoje mirë dhe futju me kurajë, se nuk do të jesh vetëm, do të na kesh të gjithë, për këtë të jesh i bindur, Arben.
- Mua më duhet ndihma e të gjithëve!
- Dhe ajo nuk ka për të munguar!
- Ja, për këtë të shqetësova!
- Po të arrijmë një sukses të tillë, do të bëhem i më të fortë, do t'i japim një grusht tjetër bllokadës. Dhe do t'ia japim se s'bën — foli me bindje Miha. Arbenit po i ngazëllente ftyra e s'po përmbahej nga gëzimi. Fjalët e Mihës i dhanë krahë, po mendja po i rrihte te debati që kishte bërë me Margaritën.

#### 4.

Kopi Nanushi e ndiente shumë barrën e rëndë që i binte në supet e tij si drejtor i kombinatit. E kjo i rëndohej më shumë, mbasi ai po kalonte vitin e dytë pa zëvendësdrejtor.

Miha Voskopoja u dha në zyrë kur Kopi Nanushi po përgatiste një raport për ministrinë lidhur me kërkesat për pjesë këmbimi.

— Kam një çështje për ta biseduar me ty, shoku Kopi! Arben Korça ka vendosur të prodhojë me forcat tona linjën e prodhimit të gjilpërës!

— Ëndërr e bukur, për besë. Mua po më zien koka si poçe. Kushedi mos ka parë ndonjë ëndërr Arbeni dhe ti vjen e ma tregon mua!

— Kopi! E kam seriozisht!

— Deri këtu jam ngopur me premtimet boshe për këtë linjë të mallkuar. Kanë shkuar dhe jashtë shtetit e fundi asgjë në torbë. Te Kopi Nanushi nuk kanë për të shkuar më!

- Kopi! Ti e di gjendjen e rezervave të gjilpërës.
- Prandaj dhe s'di ç'të bëjmë! A e di ç'do të thotë të pakësosh apo të ndërpresësh prodhimin për gjilpëra?!
- Prandaj them të mos rrimë duarlidhur, po të çajmë! Arbeni ka bërë një punë shumë të mirë e ne duhet ta përkrahim.
- Për gjilpërat nuk përgjigjëm unë. Ato i ka ministria. Më ka ardhur shpirti në majë të hundës.
- Në qoftë se ministrinë e zë gjumi, ne duhet ta zgjojmë atë dhe nga ana tjetër të mendojmë më seriozisht çfarë mund të bëjmë me forcat tonë!
- Ti më thua se Arbeni ka bërë një punë të mirë. Mrekulli. Ku i ka gjilpërat e gatshme? Hë! Pse hesht? Ëndrrat më kapin edhe mua nganjëherë, bile ëndrra të tillë të guximshme, por ato mbeten ëndrra.
- Ej, Kopi, Kopi, sa nxitohesh!
- Nxitohem the? Por mua më duket se kam të drejtë.
- Ndoshta vështirësi më të mëdha do të na dalin, por ne nuk duhet të tërhiqemi.
- Mirë thua, po çfarë kërkon prej meje, Miha?
- Unë dua që drejtoria ta studiojë mirë projektidenë e Arbenit, të angazhohet seriozisht dhe të ndihmojë drejt-përdrejt për iniciativën që ka marrë, duke ia plotësuar kushtet materiale e teknike.
- Mirë. Të hënën mbledhim këshillin teknik. Ta shohim se çthonë specialistët!
- Për këtë ndoshta kërkohet një punë e madhe bindëse.
- Edhe atë do ta bëjmë, — tha Kopi, — se ka nga ata që u tremben vështirësive dhe nuk duan telashe.
- Edhe egoizëm profesional ka, — tha Miha, — po këto koncepte duhet t'i thyejmë.

## 5.

E hëna u gdhi me shi. Edhe natën kishte rënë i imët dhe i qetë, që të ndillte gjumë. Kopi kishte bërë një gjumë të lehtë.

Mbledhja e këshillit teknik po bëhej me ngut. Dhimitrulla i lajmëroi njerëzit me listë në dorë, të cilët hodhën firmën me pishmanllëk, ngase ishin të përqëndruar në punën e ditës.

Margarita, që i njinte më mirë vështirësitë e linjës së gjilpërës, ishte mjaft e shqetësuar për iniciativën e Arbenit. Vallë do t'ia dilte në krye? Apo do të dështonte dhe ec e t'i mbylli gojët e këqija! A do të kishte aftësi të bënë vetë projektet e linjës së makinave? Ajo ishte një punë e madhe dhe tepër e ndërlikuar.

Po e vriste mendjen se si mund ta ndihmonte ajo konkretisht, që ai t'ia arrinte me sukses kësaj ndërmarrjeje kaq të rëndësishme e me aq leverdi. Nuk përqëndrohej dot. Vendi vend s'po i zinte.

U ngjit lart. Në zyrën e madhe ishin mbledhur që të gjithë. Nuk prisnin njeri tjetër.

— Sot jemi mbledhur këtu për një punë me shumë rëndësi, — i mëshoi zërit Kopi Nanushi dhe vazhdoi duke përmendur shifra, fakte, vështirësi, të gjitha të vlerësuara në shuma të hollash në valutë. — Bllokada e rrëthimi i egër imperialisto-rezisionist, — tha ai, — kërkon të na zërë frymën, të mbysë Republikën Popullore të Shqipërisë! Prandaj, si një trup i vetëm duhet të ngrihem i në këmbë për t'i shpartalluar armiqjtë e brendshëm e të jashtëm! Unë në emër të drejtorisë e përgëzoj shokun Arben Korça për iniciativën që ka marrë për të ndërtuar në vend me forcat tona linjën për prodhimin e gjilpërave. Po arritëm këtë, ne do të shpartallojmö bllokadën për të gjitha llojet e gjilpërave.

Kopi fshiu ballin e djersitur.

Qetësi. Një qetësi e rëndë. Filloi të ndihej fluturimi i një mize, piskama e saj.

— Kush e do fjalën?, — e theu heshtjen Miha që kishte zënë vend në të djathtë të drejtor Kopit dhe po i vështronë të gjithë me radhë, por vështrimin më në fund e ndali në fytyrën e Margaritës, që dukej se kishte humbur humorin e zakonshëm.

— Unë!, — e mori fjalën inxhinier Adrian Bunça, i cili

e kishte zakon të fliste i pari, duke mos dhënë asnjë mendim të vetin, por duke aprovuar apriori mendimin e drejtorisë.

Margarita vështroi tavanin. Atje ndodhej një pilivesë. E gjatë me krahë transparentë si një gjilpërë e bukur fluturake? Sa i ngjante ajo pilivesë gjilpërës, për të cilën po diskutonin.

Ajo pati një dëshirë të flaktë që ta kapte atë insekt, t'i hiqte fletët e holla dhe të thoshte: «Hë, tani të kam unë në dorë!

— Në qoftë se drejtoria e quan projektin e shokut Arben të zbatueshëm, edhe unë jam dakord. Në rast të kundërt, është e pamundur!..., — u shpreh Adriani.

Margarita i hodhi një vështrim përqmues dhe mbledhi buzët.

— Ne duam mendimin tuaj si inxhinier, shoku Adrian, — iu drejtua Miha dhe nga qëndrimi që mori kuptohej se ai do ta shkundte mirë mbledhjen, e cila po binte në gjumë sikur dikush i hidhte fshehurazi opium.

— Unë apo e shpreha, shoku Miha!, — u habit ai.

— Ai ishte mendimi i drejtorisë, një mendim i përgjithshëm. Ne duam shkoqur mendimin tuaj, inxhinier!

— S'na thatë asgjë konkrete. Ne duam mendimin e secilit. Kjo çështje na takon të gjithëve, — tha Miha.

Dikush kërkoi të bënin njëzet minuta pushim.

## KAPITULLI I NËNTË

### 1.

Sa u bënë kafetë e para, në bufe u ndez biseda.

— Si shumë larg kërkoka të shkojë Arben Korça!

— Të ishte inxhinier, hajde de, por..., — u shpreh inxhinier Adriani.

— Fundja projekt i Arbenit ka diçka të mirë. Pastaj pse nxitoheni? Ju apriori u shprehët në një mendje me drejtorinë, apo jo, inxhinier?

— Sido që të jetë pyetja juaj, inxhinier Stefani, unë nuk kam ndër mend të prish shkallët e jetës sime, sepse ashtu ju pëlqen ju.

— Ti s'�e asnje mendim tëndin, veç bëre amin fjalët e drejtorit!

— Ju, Stefan Grabova, me cinizmin tuaj po e ofendoni rëndë kolegun tuaj, gjë që nuk e prisja. — Tori Pini po shkonte me kafenë në dorë.

— E ku është cinizmi, shoku kryetar i bashkimeve profesionale?

— Kujtimi i shpeshtë që i bëni gabimit të tjetrit. Duket sikur kérkonit ta vini poshtë këmbëve tjetrin dhe pastaj ta shtypni sa t'i merrni shpirtin.

— Ky, po të kishte shpirt e zemër, do të fliste çfarë mendon vetë e jo të bëjë amin!

— Të shohim se si do të flasësh ti.

— Heshtja nganjëherë është flori!

— Mund të jetë dhe mefshtësi! — Tori nuk po i ndahej Stefan Grabovës.

— Sido që të jetë, diçka personale ka.

— Bisedohet për një çështje me shumë rëndësi, që na takon të gjithëve të japim mendim dhe të angazhohemi seriozisht.

— Shkojmë, koha e pushimit po mbaron, — tha Stefan. — Ti, Tori, nganjëherë veç prish punë...

Përsëri salla ra në heshtje.

— Flisni, diskutoni, shprehni të gjithë mendimet e shqetësimet. Përse heshtni?, — tha Miha Voskopoja, që po i nxiste të merrnin fjalën.

— Kam një pyetje, — tha inxhinier Sotir Filloja. — Dua të di, projektet e linjës së gjilpërës shoku Arben i ka bërë vetë, apo...?

— Projektet nuk janë bërë ende, inxhinier Fillo.

— Ndoshta unë gaboj, por ku është parë që një punë e vështirë, siç është linja e gjilpërës, të fillojë pa projektet e mbaruara? Ky është një iluzion.

— Inxhinier Filloja ka të drejtë, — miratoi Stefan Grabova. — Kjo është njëlljo sikur pa hartë të sulmosh pér të pushtuar botën.

Margarita u trondit. Një kthesë e tillë e mbledhjes ishte një goditje e rëndë jo vetëm pér Arbenin, por edhe pér interesin e përgjithshëm. Sigurisht që mungesa e projekteve ishte një argument i fortë, por jo guri ku duhej të ngekte ideja e tij.

— Unë mendoj që projektet kanë pér t'u bërë më vonë dhe me ndihmën tuaj, inxhinier Sotiri.

— Ju e keni mirë, shoku përgjegjës i oficinës, ndoshta dhe gaboj, më falni. Por më mirë do të ishte që ne t'ju jepnim diçka siç janë idetë, dhe ju të na jepnit projektet. Ndoshta gaboj, por, të projektosh linjën e gjilpërës, është një punë e vështirë!

— Pse thua e vështirë? Është e pamundur!, — shtoi pa marrë leje Adrian Bunça.

— Kjo çështje mendoj se duhet matur mirë, shoku drejtor, — tha inxhinier Stefan Grabova. — Arbeni meriton të lavdërohet pér qëllimin e mirë; por kjo ide sot pér

sot më duket vetëm një ëndërr e bukur! Megjithatë të flasin edhe të tjerët...

— E ç'të themi, — tha inxhinier Steli, — kur s'kemi një projekt, për të cilin të diskutojmë, por vetëm një ide! Kështu rrahim kota ujë në havan. Arbeni bën mirë që të merret më shumë me organizimin e punës në oficinë e të mos na humbasë gjithë këtë kohë pune kot, se për ne minuta është flori.

Arbeni u nxi në fytyrë. Edhe Miha e Kopi e kuptuan mirëfilli se mbledhja ishte e papërgatitur, prandaj edhe doli pa gjë në torbë.

Një fyerje të tillë Arbeni nuk e kishte provuar në jetë. Por, në vend që kjo ta demoralizonte, siç priste ndonjë keqdashës, atë e mobilizoi, ia dhjetëfishoi fuqitë.

## 2.

Margaritës nuk i rrihej pa takuar Arbenin. Vallë si do ta priste ai atë dështim.

Hyri në oficinë. Ajo ziente nga puna si një koshere bletësh. Margarita përshëndeti me kokë disa vajza që e pritën buzagaz. Pastaj, si dalloi kókën si drizë të Arbenit, u nis për nga ai. Arbeni po merrej me një detal. Po masste me mikrometër dhe nuk i vuri rëndësi vajtjes së saj. Margaritës i bëri përshtypje si detal dhe nuk arriti të kuptonte se e kujt makine ishte ajo pjesë metalike që ai po e punonte me aq kujdes. U mat t'i fliste, por e përmbarjti veten, mbasi ai e pati vendosur detalin përsëri në nofullat e mandrinos së tornos dhe e hapi çelësin e ushqimit të korentit. Makina uturiu dhe thika e videos puthi detalin që po gdhendte.

— Puna mbarë, Arben!, — i foli ajo.

— Mbarë paç, Margarita! — Ai nuk e priste.

— Erdha të të takoj.

— Mirë bëre. Falemnderit për kujdesin, por më mirë do të bëje të shfaqesh qoftë edhe kundër mendimit tim.

— Ndoshta ke të drejtë, por ti e tepron, Arben, atë-

herë kur ngul këmbë në mendimin tënd. Ti, a u binde se unë kisha të drejtë kur të këshilloja që të mos nguteshe për linjën e gjilpërës?

— Unë qëndroj plotësisht në mendimin tim, Margarita!

— Domethënë nuk ke hequr dorë, ë?

— Kurrë! Ajo ishte vetëm beteja e parë. Shumë të tjera më presin.

— Si? Për cilat e ke fjalën?

— Për legjendën e gjilpërës, Margarita.

— Ti duhet të jesh më i matur, Arben!

— Këshillën tënde do ta kem parasysh, — tha ai dhe fshiu ballin me shpinën e dorës.

Margaritës kjo përgjigje i dogji. U largua pa folur. Ai vijoi punën i zhytur në mendime.

### 3.

Dy ditë mbas mbledhjes së këshillit teknik, Arbeni së bashku me Mihën dhe Kopin u kthye në bufenë e vogël për të pirë nga një kafe.

Për çudi në atë kohë në bufe nuk kishte asnjë klient, kurse bufetierja po pastronte tavolinat me leckë të lagur.

— Bukur, për besë shumë bukur na e punoi ai inxhinier Sotir Filloja. Ku i shkoi mendja te projektet?

— Pritej një pyetje e tillë, — tha Miha.

— Atëherë gabimi ynë është që nuk i dolëm përpara, por pësuam një fjasko.

— Asgjë nuk humbëm, morëm një mësim, atë që ne më parë duhet të përgatitemi.

— Unë e ndiej grushtin, ja këtu në nofull, që na e dha këshilli teknik, e ti thua, o Miha, asgjë nuk humbëm! Apo jo, o Arben? — Arbeni rrudhi supet, por nuk foli.

Në bufe u dha një djalosh sykaltër. Ai i përshëndeti me kokë, por nuk i shqetësoi.

— Mos jeni ju inxhinier Alqi Katroja, i biri i Raqit, që e kam pasur mik?, — i tha Kopi djaloshit, që u skuq nga faqet si ndonjë vajzë.

- Po, unë jam.
  - Nuk më thua se ku punon?
  - Jap mësim në teknikumin e qytetit.
  - Njihu, këta janë shokët e mi të punës. Më ka shpëtuar për një qime nga duart ky inxhinieri i ri, është djali i një shoku të luftës. Eh, ç'shokë e shoqe na mori lufta!
- Po sa pinë kafetë, Kopi e Miha u larguan, kurse Arbeni qëndroi aty me Alqin.
- Çfarë ke kështu? Më dukesh fare i shushatur!
  - Veç preokupimeve të punës asgjë.
  - Thashë mos je gjë i sëmurë, xhanëm, se telashet e punës me vullnet e këmbëngulje zgjidhen.

- Vetëm ato nuk mjaftojnë, kërkohen edhe dijeni të gjera shkencore e teknike, — theksoi Arbeni.
- Shumë e drejtë, po edhe ato me vullnet e këmbëngulje fitohen.

Arbeni miratoi me kokë dhe i tregoi fill e për pe për linjën e gjilpërës, për vështirësitë që kishte ndeshur. Alqi e dëgjoi me vëmendje dhe i premtoi se do ta ndihmonte për vizatimet teknike, mbasi në këtë fushë ai ishte i zoti dhe se do të kërkonte ta ndihmonin në shkollë edhe nxënësit e tij. Ky premtim Arbenit i dha krah, e entuziazmoi. Dolën duke biseduar për projektet e linjës.

#### 4.

Sofie Korça ia hapi të birrit portën duke lëshuar enkas poshtë hekurin e gjatë që lëshoi një tingull të çjerrë.

- Nga humbe kështu deri tani në mesnatë?
- Ja, kisha punë, — tha ai dhe eci nëpër oborrin e gjerë.

Sytë i digjinin dhe biseda e bërë gjithë afsh me Alqin po i ziente në kokë. Sa i gatshëm qe treguar ai! «Ja, ky është njeriu ynë i ri! Me njerëz të tillë çahen malet dhe bëhen hi e pluhur mendimet konservatore të disa menjemykurve që kanë mbetur rob të mosbesimit në forcat e veta!», — mendoi Arbeni me vete.

- Erdhi një çupë!, — ia prishi mendimet eëma.
- Cila ishte ajo?
- Në fillim nuk e njoha! Ishte ajo inxhinierja, që erdhi atë ditë. E bukur si një yll!
- Ta paska mbushur syrin, ë?
- Eh, mor Arben! Ti gjithnjë vëç me shakara. Po zemra e nënës do një nuse në shtëpi.
- Punët e mira bëhen ngadalë, nënë, — tha Arbeni dhe i qeshën edhe bebëzat e syve.
- Pa më thuaj, mor bir, nga humbe deri në këtë orë?
- Isha me shokët.
- Ti me shokët? Ajo priti e priti e iku. Më hyri mu në zemër, — tha Sofia dhe vuri dorën në gjoks.
- Të pëlqen për nuse?
- Gjithnjë me një palë mend ti, ë? E përse nuk më tregon për sherret që bën andezaj nga puna?
- Unë nuk zihem me njeri!, — u habit ai. — Pse të tha gjë Margarita?
- Ajo nuk më foli gjë, po llafosnin në dyqanin e ushqimeve. Arbeni kështu, Arbeni ashtu...
- Mos u shqetëso se ç'thonë të tjerët, nënë!
- Nuk është për të qeshur! Mos u zi me inxhinierët. Ata janë njerëz të ditur dhe e kanë punën qiqër me drejtore.
- Ne nuk zihemi, po bisedojmë për punët e shtetit, nënë.
- Hap sytë e mos u bëj grindavec e mendjemadh. Ata dinë më shumë se ti.
- Si flet ti, nënë. Kërkon të kesh një djalë lepe-peqe!
- Jo lepe-peqe, po as grindavec e mendjemadh!
- Unë të ngjas ty, nënë. Nuk grindem me askënd.
- Me mua, ja, po grindesh çdo natë, apo s'të është bërë mendja vëç makina!
- Kurse ty të është bërë mendja vëç nuse!
- Edhe sikur t'i kishte në krye gjithë punët e shtetit, duhej të dëgjoje tét emë! Po më thonë shoqet: «Ai djali yt, o Sofie, se si shkon rrugës me ato këmbët e mëdha e me kokën ulur poshtë si ta kenë zënë të gjitha hallet e botës».

— Më fal, nënë, por i kam dhënë fjalën Partisë që  
nuk do të kthehem prapa.

— Po të jetë puna kështu, edhe mua prapa më ke, o  
bir, Partisë i jemi borxhlinj edhe me jetën tonë, por me-  
ndo edhe për zemrën e nënës. — Arbeni i tha s'ëmës fill e  
për pe se ç'e preokuponte atë.

Ajo po rrinte si një statujë dhe po e dëgjonte.

— Vallë do t'ia dalësh në krye, mor bir?

— Me kujdesin e Partisë dhe me ndihmën e kolektivit  
do t'ia dal se s'bën!, — tha ai. Ajo tundi kokën me dy-  
shim, por nuk foli.

## *KAPITULLI I DHJETË*

### **1.**

Dhosи Qafëzezi desh po fluturonte nga gëzimi, që Arben Korça po merrte përsipër të bënte gjithë atë punë të madhe dhe të vështirë. Le të pëlciste ai inxhinier Stefani që s'e vinte fare në hesap.

— S'kepi turp ju, inxhinierët?, — i tha Dhosi inxhinier Sotir Fillos që i kishte vajtur në magazinë.

— Ç'thuas kështu, o Dhosi?

— Ja, del një teknik i mesëm dhe zotohet të bëjë gjithë atë punë të gjilpërës, kurse ju na mburreni me diplomat tuaja!

— Ju flisni përpara kohe, i dashur Dhosi!

— Pse para kohe?

— Unë s'jam inxhinier mekanik, po, kur nuk i doli më anë inxhinier Grabova, këto janë zotime në erë. Ai nuk i ka projektet dhe më duket se sheh ëndrra në diell, i dashur Dhosi.

— Kështu flisni ju, inxhinier, por Arbeni, po të mos kishte gjë në vijë, nuk do ta merrte mbi supe atë barrë. Është djalë serioz ai.

— Pse nuk e di ti, o Dhosi, që ka njerëz, të cilët, përtu bërë të dëgjuar, venë dhe djegin edhe kishat?!

— Akoma me kishat ti!

— Fjala vjen, xhanëm, po le të pyesim mjeshtrin Vasfi Dishnica.

— E pyesim!

— Si thua ti, Vasfi, a do ta bëjë dot Arbeni atë linjën e gjilpërës?

— Atë e di ai që e ka marrë përsipër, — ia preu ai me sëpatë.

— Arbeni! Ha, ha, — Drejt tyre me gotën e konjakut në dorë po vinte fare pa u ftuar Steli.

— Pse si të duket ty Arbeni? — pyeti Dhosi Qafëzezi me vetulla të vrenjtura.

— Një copë mekanik që kërkon të hedhë baltë mbi inxhinierët e kombinatit.

— Ti vështro mos i skuq lakrat, o Steli, — ia priti Dhosi që e dinte punën e shkarkimit të ujit me ngjyrë.

— Vërtet që nuk flisni aspak mirë, o Steli?, — tha Stefan Grabova që po ndiqte bisedën në tavolinën pranë.

— Harrove se ç'më the dje për Arbenin, o Stefan Grabova!, — tha Steli i inatosur. — Paske harruar, ë? «S'e bëra dot unë që pashë edhe botë me sy, e po e bën ky spurdhjak që nuk di sa këmbë ka pula». S'më the këshfu?

— Ju këshilloj që të mos pini më konjak, se kushedi se me ç'ngjynahe do të na ngarkosh e ndonjë mendjelehtë mund t'i marrë për të vërteta, — tha Stefani dhe ia plasi një të qeshure histerike duke e rrokur për qafe.

— Si, si?, — pyeti Hamit Dëllinja duke kërcitur dhëmbët.

— Ty, Hamit, të shkon për shtat mbiemri, sepse, sa herë që flet, kërcet si dëllinja kur digjet!, — u përpoq të humbiste fillin e bisedës.

— Dhe iku Stefani në Evropë e u kthyesh kokëbosh!, — ia përplasi me kërcëllima Hamiti. — Ama valixhet ishin të rënda plumb!

Ia plasi një e qeshur me lot që e bëri Stefani Gravovën të nxihej si nata.

— Megjithatë, po ia arriti Arbeni, unë do ta duartrokas...

## 2.

Stefan Građovës nuk iu durua dhe që të nesërmen vajti e i trokiti në zyrë kryeinshinierës.

— Rrini, Stefan, — i foli ajo ftohtë.

— Guximi i Arbenit është për t'u lavdëruar, por... .

— Ç'farë?

— Iniciativa e tij duket sheshit, Margarita, hedh baltë mbi ne inxhinierët! Apo jo?

— Aspak!, — e mbuloi me vështrimin e saj Margarita.

— Dhe më vjen keq që ju mbeteni gjithmonë ai që keni qenë. Njeri pa fije sedër.

— Nuk kam asnje arsyë të prish gjakun. Puna ime ka shkuar mirë.

— Po zotimi juaj për të bërë linjën e gjilpërës ku mbeti? Njerëzit kanë zënë të pyesin. .

— Kjo as që më shqetëson, po kjo vjen ngase ai Arbeni juaj i nxit këto dhe, po vazhdoi kështu, ndonjë ditë do të më detyrojë t'i jap një përgjigje që..., se nuk duroj më të merrem nëpër gojë. E nga kush? Nga një që fryhet si gjel me pretime të zbratëta!

— Gabohesh, Stefan. Ai nuk i merr të tjerët nëpër gojë. Të kam shok shkolle e më bie të të jap këshilla: Mos u merr me thashetheme, po vraje mendjen për punën, se jemi përpara detyrash të rëndësishme që kërkojnë shumë nga unë, ti e nga të gjithë.

— **Mirë thua, por si shumë mban anën e Arbenit. Vallë s'u bë shkak pretimi i tij për linjën e gjilpërës që të merrret nëpër gojë dhe të diskutohet ndërgjegjja ime?**

— Nuk po të kuptoj.

— Ti vetë më the ku mbeti zotimi im!

— E pastaj?

— Kjo do të thotë se ti braktise shoqërinë studenteske dhe po këndon duet me Arbenin. Kjo më rëndon sa një mal.

— Ato fyere t'i marrësh me vete. Është fakt se ti, në vend që të vrissje mendjen për t'u specializuar, u dhe pas rraqeve e jetës së lehtë. Zotimi për linjën e gjilpërës ku mbeti? Dhe na thua se e ke ndërgjegjen të qetë.

- Po dhuaratat që ju solla ju pëlqyen ama!
- Urdhëro ku e ke e hiqmu sysh, se s'të shoh dot!,  
— tha ajo me një zë të ashpër dhe i përplasi në gjoks stilografin që po e rrrotullonte nëpër gishtërinjtë e hollë.

### 3

Margaritës iu kujtua ajo ditë e nxehjtë moskovite, kur ajo e takoi Stefanin që mezi hidhte hapat, e njerëzit, nga-që ishin të trullo sur nga vapa nuk po e vinin re.

— Ç'ke kështu, Stefan?, — i tha ajo. — Mban erë të keqe votke!

— E jastaj?! Këtu të gjithë pinë!

— Ke filluar të imitosh jetën e tyre si majmun.

— Budallaçkë! Si ti të rri, me këtë fustan të trashë që e ke nga mama ja?!

— Kushedi sa ke pirë!

— Margaritusha. Njiçivo pollohova. Të betohem!

— Ti lëpihesh si macet, ta dish që kjo nuk të nderon as ty, as ne!

Ra zilja e telefonit. E mori receptorin. Dëgjoi zërin e drejtorit.

Kujtimet iu shpërndanë si zogj të trembur. Zëri i Kopit. U ngrit e vendosur dhe u nis për të vajtur në zyrën e tij, me bindjen sejeta nuk është aq e lehtë sa ç'mendohet nganjëherë në eufori:

## KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

### 1.

Organizata e Partisë e ofiçinës diskutoi me gjallëri dhe miratoi projektin e paraqitur nga Arben Korça për ndërtimin e makinës së gjuhëzës, si fillimin e ndërtimit të plotë të linjës së gjilpërave. Organizata pas shumë debatesh e diskutimesh të zjarrta, më në fund, përgëzoit Arbenin për iniciativën e tij dhe u zotua që atë ta quante aksion të të gjithë kolektivit të ofiçinës dhe t'i vinte gjoksin gjersa ta bënин realitet. Kjo kishte entuziazmuar pa masë vetë Arbenin dëhe Miha Voskopojën që kishte qenë i pranishëm në atë mbledhje. Ndryshe nga mbledhja e këshillit teknik, Arbeni ishte paraqitur mjaft i përgatitur. Ai nuk vinte atje vetëm me një mendim të guximshëm për të ndërtuar makinën e gjuhëzës; një nga më të vështirat për ndërtimin e linjës së gjilpërave, por ai sillte përpëra shokëve dhe projektin me një argumentim të pakundërshtueshëm, që vërtetonte katërcipërisht ndërtimin e saj. Tani duhej vetëm një gjë, që Arbenin ta mbështesnin fort shokët dhe gjithçka të ecte përpëra. Ndërsa për projektet e linjës së plotë të gjilpërës do të bisedohej më vonë, atëherë kur të ishin pjekur kushtet.

Miha Voskopoja nuk fjeti gjithë natën. Ku t'i gjente ai ata njerëz, të cilët ta ndihmonin për shumëzimin e vi-

zatimeve tekniqe të pjesëve të makinës? Tu drejtohej nxënësve të shkollës mekanike?

Miha Voskopoja u entuziazmua për së tepërm nga gatishmëria që tregoi rinia e shkollës së mesme tekniqe: Ai në takimin që pati në kuadrin e ditës së novatorit e shtroi edhe këtë problem duke kërkuar ndihmën e organizatës së rinisë.

— Ne kërkojmë që të na ndihmoni që edhe me punën tuaj të thyejmë një koncept të gabuar frenues. Kjo do t'i japë hov dhe shtytje një mendimi krijues. Ju si organizatë rinnie a mund të na kopjoni disa vizatime teknike të detaleve të ndryshme të linjës së gjilpërës? Kjo për ne është një aksion me vlerë të madhe politikë, ideologjike dhe ekonomike, — tha ai.

— Sigurisht që do t'ju ndihmojmë, shoku Miha!, — u dëgjuan shumë zëra. — Organizata jonë e rinisë do ta ketë për nder që të kontribuojë për një aksion të tillë që theyen bllokadën, — tha sekretari i komitetit të rinisë të shkollës që po i shndrisnin sytë nga një gëzim i papërmabujtur.

Ata tokën duart. Miha u largua i pushtuar nga entuziazmi i rinisë. Ngazëllimin ia turbulloi tymi dhe zjarrri që plasi papritur në qoshen e ofiqinës.

Ulërimat e zjarrfikëseve të shponin veshët. Vërsimi i njerëzve për të shuar zjarrin, lëshimi i marçikëve të gjatë; gjuhët e flakëve nuk të jepnin kohë të mendoje.

Kopi Nanushi ishte bërë meit në fytyrë. Ai e dinte fort mirë që të gjithë kopanët e përgjegjësisë do të binin mbi shpatullat e tij, prandaj po e vriste mendjen se kush e kishte bërë atë proçkë. Mos vallë kishte ndodhur nga pakujdesia, apo kishte dorë puna e armikut?! Sigurisht që dikush do të kishte gisht, sepse zjarri nuk binte vetylë! Më mirë këtë punë t'ua linte zjarrfikëseve. Ata kishin pérvojë dhe me siguri që do ta gjenin. Fundja si të ishte e thënë, ashtu le të bëhej! Përgjegjësi do të mbante Arben Korça që i ishte bërë mendja ndërtim makinash dhe dukej se kishte harruar detyrën kryesore si përgjëjës i ofiqinës.

Në gjithë atë pështjellim të furishëm Arben Korça u vërsul nëpër flakët e zjarrit. Nuk e merrte me mend se si kishte plasur ai zjarr papritur në mes të ditës.

Komandanti i zjarrfikëseve, një djalosh i ri me një hundë të djegur, e sqaori shkakun e zjarrit. «Copérat e pambukut të lyera me vajin e tornove e të flakura në qoshen e oficinës, kanë shkaktuar shpërthimin e zjarrit, mba-si në oficinë, siç duket, shkëndijat e gurzmerilit shkonin mbi copérat e pambukut, — tha ai. — Dikush këto do t'i ketë njomur me benzinë». Kopi miratoi me kokë. Të dyja makinat zjarrfikëse u larguan të qeta e pa klithma nga oborri i kombinatit, si të ishin urtësuar nga dora e madhe e Kopit.

Njerézit u shpérndanë. Dezhurnin e bombarduan me telefona nga Komiteti i Partisë, Komiteti Ekzekutiv, nga prokuroria dhe së fundi mori e shoqja e Kopit.

— Kopi, çfarë ka ngjarë andezaj nga ju, se më ngriu gjaku?

— Qetësohu, se asgjë.

— Si asgjë? Na thanë se u bë batërdia nga zjarri!

— Zjarri u shua, e dashur, pa asnjë dëm, — e qetësoi Kopi dhe mbylli receptorin. Ai u bind se lajmi i keq përhapej me shpejtësinë e dritës dhe trillohej si mos më keq!

Mbasdite u mblodh këshilli teknik për këtë çështje. Debatet qenë të ashpra:

— Mendoni, shokë, se çfarë katastrofe do të ishte bë-rë në qoftë se zjarri do të binte në të gjithë kombinatin.

— Stefani ia hodhi njëherë vështrimin fytyrës së drejtoirit, por ajo nuk shprehu nga fjalët e tij asnjë shenjë gjallërie! Megjithëse nuk e gjeti atë shkëndijë që ai shpresonte të ngjallej në bebzat e syve të Kopit, ai vazhdoi:

— Do të ishte një katastrofë e vërtetë. Unë propozoj që shkaktari t'i jepet prokurorisë për ndjekje penale!...

— Jo, shoku Stefan, nëse e dini se nga cili është shkaktuar zjarri në oficinë, na e thoni!, — i tha Miha.

— Po ta dija personin, do të ndeshesha me të për jetë ose vdekje?!

— Atëherë kë t'i japim prokurorisë për ndjekje penale?

— Po përgjegjësi i oficinës nuk mban përgjegjësi, të paktën, për pakujdesi në ruajtjen nga zjarri? Unë mendoj se mban dhe për këtë propozoj që të shkarkohet nga përgjegjësia dhe t'i jepet prokurorisë.

— Edhe pakujdesinë e mungesën e vigjilencës do ta diskutojmë, po ne duhet të zbulojmë shkakun e shkaktarin.

— Ai si përgjegjësi i oficinës mban të gjithë përgjegjësinë. Logjika këtu të shpie!...

— Ju po e sulmoni Arbenin duke përfituar nga rrethanat që u formuan ndaj tij për shkak të linjës së gjilpërës.

— Aman, o Miha, përsë e trajton problemin kështu? Një e dy gjilpëra... Unë jam drejtori, më kuption, dhe mbaj të gjithë përgjegjësinë e kombinatit!

— Ngadalë, shoku Kopi, përgjegjësinë e të gjithë kombinatit e ka Partia!

— Partia mua më kërkon llogari, po nuk shkuan punët mirë!

— Edhe ty, edhe neve, shoku Kopi!

— Ashtu është, o Miha, po mos harro se ka ndonjë që nuk na e do të mirën, andaj hedh gurin e fsheh dorën dhe pastaj tregon se ku ka rënë guri, por hajde të lutem ta gjejmë se cili është ai. Përderisa të gjendet ai njeri, ja mbi këto shpatulla bie e gjithë përgjegjësia. Kështu më duket mua, dhe sigurisht që kështu duhet të jetë, apo jo, shokë?

— Ashtu duhet të jetë, shoku drejtor, — ia priti Stefan Grabova.

— Në qoftë se zjarri nuk ka rënë nga shkëndijat e gurzmerilit, atëherë atë e kanë vënë qëllimisht për të diskredituar Arbenin! — Miha nuk hiqte dorë nga mendimi i tij.

— Dhe pse ta kenë bërë një gjë të tillë?!, — habitej Kopi.

— Po të jetë vënë qëllimisht, është një diversant politik, që, veç të tjerave, Arbenin ta detyrojë të heqë dorë nga projekti që ka për linjën e gjilpërave!

— Përsëri gjilpërat!

- Po s'qe aksident, atëherë gjilpëra e asgjë tjetër!
- Atëherë çfarë t'i raportoj byrosë së Komitetit të Partisë, apo kolegjumit të ministrisë? Hë, çfarë t'u them?! Këtë më sugjeroni!
- Mendimin tonë, mendimin komunist. — Miha kish-te ndërhyrë me vend.
- Shoku Miha ka shumë të drejtë, — tha Tori Pini.
- Shkarkimin e Arbenit mund ta kërkojnë vetëm ata që nuk ishin dakord me linjën e gjilpërës. Këto gjykime janë të gabuara dhe duhet t'i hedhim poshtë si të huaja.
- Ju, Margarita, ç'mendim keni? — Kopi e vësh-troi vajzën me shpresë se mos ajo gjente ndonjë zgjidhje.
- Mendimi i Mihës më duket i drejtë, por dua të pyes Arbenin, nëse është e lejueshme që leckat të vendosen në qoshen e gurzmerilit, apo jo.
- Jo!, — tha Arbeni.
- Po ato lecka kush i hodhi?
- Kjo nuk dihet, — tha ai.
- Shoku drejtor, për mendimin tim këtu s'kemi të bëjmë me një pakujdesi, po me diçka tjetër...
- Atëherë kush i vuri zjarrin ofiqinës simbas mendi-mit tuaj, Margarita?
- Kush dhe përsë, koha do ta tregojë, por kjo duket fare sheshit..., — pohoi Margarita.
- Inxhinier Stefani ndjeu një gërvishtje në gjoks.
- Enigma mbetet vetëm te leckat e vendosura në atë vend të rrezikshëm, — tha Miha. — Ai që i hodhi është shkaktari.
- Logjika e fakteve atje të shpie, — tha Margarita. — Inxhinier Stefani u bë qymyr në fytyrë.
- Edhe njëqind pashë nën dhë po të jetë futur, ai që na vuri zjarrin duhet zbuluar se s'bën, — pohoi Kopi dhe u ngrit në këmbë.
- Me Kopin mbeti Miha dhe Margarita.

Alqi Katros iu mpinë këmbët duke pritur Arben Korçën, i cili nuk po dukej më në vendin e takimit.

Punëtorët zakonisht e linin punën në orën tre mbas-dite. I kaluan pranë. Në fytyrat e tyre ai vërejti një shqetësim. Ata po flisnin për diçka të jashtëzakonshme që kishte ndodhur, por që Alqi nuk e mori vesh. Ai kundroi qiellin e purpurt, pastaj orën.

Arbeni së bashku me Mihën, Torin e Margaritën u dukën në fund të bulevardit «Gjergj Kastrioti». Ata po ecnin duke biseduar. Arbeni i kërkoi ndjesë për vonesën. Ata ecën një copë rrugë pa folur.

— E ç'i ke gjithë këto vizatime?, — pyeti Margarita me kureshtje.

— Nuk janë të miat, unë diçka kam ndihmuar Arbenin, shoqja kryeinixhiniere! Janë projektet e makinës së gjuhëzës.

— Të plota? — u habit ajo!

— Të plota, — u përgjigj Alqi.

— Jam shumë kurioze t'i shoh?

— Do t'i shohësh, janë afro treqind copë të trefishuara. — Ai shtrëngoi nën sqetull cilindrat e letërvizatimeve.

Mihës dhe Torit u ndriti fytyra dhe vështruan Margaritën.

— E, Margarita, si thua ti? — pyeti Miha.

— Po të vihet në rrugë kjo çështje, do na bëhet zemra mal të gjithëve — tha ajo.

— Kjo është e qartë, po duhet t'i bindësh kolegët e tu, inxhinierët, që të aktivizohen me të gjitha forcat, se disa akoma kanë koncepte frenuese në kokë.

— E kuptoj, shoku Miha, se duhet të bindim edhe vreten, edhe të tjerët, — tha ajo.

Miha, Tori e Margarita u larguan, ndërsa Alqi e Arbeni po ecnin ngadalë. Arbeni kishte humbur në mendime. Dukej se edhe bisedën nuk e kishte ndjekur fare.

— C'mendoni, apo ju ka ndodhur gjë?, — pyeti Alqi.

— Po, në oficinë na ka plasur një zjarr, — tha Arbeni me fytyrën si meit.

— Pati dëmtime?

— Dëmtime s'pati, por ende nuk éshtë zbuluar shkaku apo shkaktari.

— Po tē jetë gjë me qëllim, do tē dalë se s'bën, — e qetësoi Alqi.

— A thua?

— Si një e një që bëjnë dy. Po kjo s'do tē thotë që ti tē flesh gjumë, përkundrazi, se populli nuk thotë kot: «Lumi fle, po hasmi s'fle...».

### 3.

Sofia Korça u tremb nga zjarrllëku që i kishte hipur tē birit! Ajo i leu me shéllirë muskujt e fuqishëm të Arbenit kur pa se tē nxehjtët nuk po i binte, mori landro dhe e zjeu në xhezven e bakërtë. E leu djalin me atë lëng tē verdhë shumë tē hidhur e mbas pak trupi i tij i fuqishëm u la në djersë.

— Tani që djersive, ta dish që shpëtove, — i tha ajo duke ia fshirë djersët me peshqirin e madh tē bardhë!

Arbeni ndjeu një lehtësi tē trupit e tē kokës dhe filloi t'i merrte tē gjitha ngjarjet me radhë për tē gjetur shkakun e vërtetë tē zjarrit.

— Ja!... Unë e shkreta e kisha frikën, më shkonin nëpër mend rreziqet që ka përgjegjësllëku, po ku tē më vente e shkreta mendje te zjarri! Po si tē ndodhi kështu, o bir? Tregomë mua, tregomë, se e kam mendjen atje tek oficina jote, që kush u bë sebep dhe ta dhanë në shpatulla ty. Vallë do tē tē bëjnë gjë, Arben?

— Çfarë tē më bëjnë?

— E! Ashtu mos fol ti, sepse i thonë qeveri kësaj, por nuk më thua tē thanë gjë apo jo?

— Zjarri nuk éshtë shkaktuar nga unë që tē më thonë gjë!

— Qoftë larg! Si flet kështu ti? Ti nuk e ke vënë zjarrin, por ama përgjegjësi i oficinës ti je. Pa më thuaj, a u bë shumë dëm në oficinë?

— Asgjë! Vetëm sa u nxi tavani.

— Ama tavani është nxirë! Shyqyr që nuk është bërrë gjë, se atëhere belatë do të ishin më të mëdha. Ca njerez zunë të llomotisin. Na e ngrinë gjakun.

— Dhe për këtë më vjen të ha veten me dhëmbë.

— Po si, të hash veten me dhëmbë! Përse ta hash? Ja! Tani që e mori qeveria punën në dorë, ta dish se ka përtua zbuluar fajtorin. Me këtë qeveri nuk ka shakara, sepse ajo e zë lepurin me qerre!...

— E zë, e zë, po pse të ndodhët kështu?

— Nga sëkëlldia je sëmurur.

— Pse pak të duket ty një gjë e tillë?!

— Si të më duket pak, po atje në Parti të thanë gjë?

— Jo! Ku jemi mbledhur! Në këshillin teknik më bënen një dush të mirë, por dhe atje puna nuk ka mbaruar, vetëm që ka mendime se atë zjarr e ka vënë kastile ndonjëri për të më rënduar mua.

— Kur të thérresin atje në Parti, me kujdes të keqen nëna, mos të të bëjnë gjë, o bir!

— Ke frikë se mos më përjashtojnë?

— Qoftë larg! Nëna të vdekur të qan, por të mallkuar nga Partia nuk të qas kurrë, se kjo Parti na solli në drithë.

— Po dhe unë nuk kam ç'ta dua jetën po ndodhi ajo gjë, moj nënë.

— Partia na rriti, bir, e na t'ia shkelim bukën, është haram dhe na zëntë sytë buka e Partisë.

— Mos u bëj merak, moj nënë, se nuk të turpëroj kurren e kurrës!

— Arben, më dëgjo mua plakën!

— Ja po të dëgjoj.

— Nuk më pëlqen këmbëngulja jote për gjilpërën. Inxhinierët janë me shkollë të madhe e thonë nuk bëhet, kurse ti me pak shkollë e thua bëhet.

— Bëhet, bëhet, po ndonjëri nga ata, meqë nuk e ka bërë vetë, nuk i vjen mirë ta bëjmë ne të tjerët që nuk ia mbushim syrin.

— Po Kopi e Miha çfarë thonë, mor bir?

— Edhe ata thonë bëhet.

— Si të jetë më mirë, të bëhet, por frikën e kam ama, se ata që thonë nuk bëhet, kushedi, po të ngatërrojnë ndonjë gjë, dhe, po s'arrite ta bësh, atëherë bëhesh gazi i dhet Arben!

#### 4.

Mendimi për derdhjen, formën dhe masën e madhësisë së trupit të parë, që do të ishte njëfarë ndarje e zgjatur nga bazamenti i gjerë i makinës së gjuhëzës Arben Korçës i lindi në kokë kur ai po nxitonë për të vajtur në stadiumin e qytetit ku do të zhvillohej një ndeshje interesante e kampionatit kombëtar të futbollit.

Nga frika se mos kjo rreze drite i shuhej dhe i humbiste, ai nxori nga xhepi i brendshëm stilolapsin dhe bllokun e vogël dhe shënoi me të shpejtë idenë që i shkrepi papritur, nga frika se do t'i avullonte si vesa. Arben Korçës iu kujtua në çast porosia që i kishte dhënë Miha.: «Njerëz jemi, dhe nuk dihet se kur të pjell truri, apo dëgjon një mendim të vlefshëm nga të tjerët e, që ta mbash mend, duhet ta shënosh, përndryshe të iku, se nuk e mban mend...».

Arbenit, duke vrapiuar për në stadium që të shihte ndeshjen, vetëm kur arriti te shkallët iu kujtua të fuste bllokun e stilolapsin në xhep. Gjatë ndeshjes as që e pati mendjen te loja, as rezultatin e saj nuk e kishte të qartë. Ai kishte humbur në projektet e tij. Mendja po i punonte vetëm për makinën e gjuhëzës së gjilpërës. Turma e spektatorëve të shumtë si një valë e papërmabjatur e nxori në bulevardin e madh. Ai nuk e kuptoi dhe vetë se si ndeshi përballë me Margaritën që kishte ditë pa e parë dhe as që e mendonte se mund ta takonte në atë valë të madhe njerëzish, që flisnin vëtëm për gjuajtjet, për golat, për rezultatet.

— Të paska rrëmbyer vala, — tha Margarita duke buzëqeshur.

— Më kot u përpoqa t'i shpëtoja valës. Brinjët e mia

kaluan nëpërmes bërrylave, që desh më morën fryshtës,  
— tha ai dhe fshiu ballin e djersirë.

— Shiko, shiko! Ke filluar t'u japësh një nocion teknik fenomeneve të ndryshme të jetës. Kjo tregon se je zhytur thellë pas fantazisë sate.

— Margarita, më mirë po e lëmë këtë bisedë, ti nga e ke rrugën? — Ai u tregua i ftohtë ndaj saj, gjë që ajo nuk e pati menduar.

— Dikur hidhje dhe prisje shaka.

— Tani nuk kam kohë për to.

— Sa keq!

— Pse?! — u habit ai.

— Sa e bukur është dita sot, Arben! — Ajo i bëri bisht pyjetjes së tij.

— E bukur.

— E ndien afrimin e pranverës?

— Si të them!

— Unë e ndie... Ja, së shpejti kanë për të ardhur edhe dallëndyshet...

— Dallëndyshet.

Arbenit i kujtohet vegjëlia. Fshati i vogël dhe gryka e madhe e luginës ku ishte vendosur. Arbenit nuk i shqiten nga mendja përrallat që i ka treguar gjyshe Thomaidha. Nëna Sofia nuk kishte nge për t'i treguar përralla. Ajo ngrivej herët në mëngjes e Arbenit i dukej sikur ishte ende natë dhe kthehej përsëri në shtëpi vonë. Kështu që për të emën ai mendonte se natyra e kishte gatuar për të genë në shtëpi vetëm natën.

— Ç'ke kështu?

— Asgjë!

— Ti dukej si i përhumbur.

— Jam lodhur pak.

— Kjo duket! Je tretur!, — tha Margarita.

Ecën në heshtje të plotë. Hapat po i hidhnin të ngadalshëm. Të dy ishin zhytur në mendime dhe prisin njëri-tjetrin të thoshte diçka.

— Ti nuk e di?, — theu heshtjen Margarita.

— Çfarë të di?

— Unë u zura keq me Stefanin!, — tha ajo.

Arbeni nuk foli, vetëm e vështroi pingul dhe vazhdoi të ecet po me atë hap të ngadalshëm.

— Ti pate të drejtë. Ai është një tip i keq. Si nuk e kam nuhatur më parë xhanëm? — Ajo vazhdonte të fliste me bindjen se ajo turielë e historisë së zënies së saj me inxhinierin do të hapte vrima të reja për të sjellë më shumë dritë në miqësinë e tyre, që ishte mjegulluar nga debatet e grindjet për çështjen e linjës së gjilpërës.

— Ti duhej të grindeshe më shpejt me Stefanin! Ai nuk i ka cilësitë që i duhen njeriut tonë. Ai shkollën dhe zotësitë që ka nuk i jep për të mirën e shoqërisë por për t'u krekosur. Aq më keq ai na paska dalë edhe jashtë shtetit për të ndërtuar linjën e gjilpërës dhe nuk e vau koken për këtë çështje, por na krekoset me rreckat që solli nga jashtë. Të paktën të mos pengojë të tjerët që kanë vendosur t'i hyjnë kësaj pune! Haram djersa e popullit, që e ushqeu për vite me radhë për ta bërë kuadër. Jo të zihemi me Stefanin e Stefanët, po t'u kërkojmë hesap deri më një, Margarita!, — tha Arbeni dhe e mbuloi me vështrimin e tij.

Vajza heshti dhe ra në mendime. Ajo u skuq kur ai zuri në gojë punën e Stefanit që kishte shkuar jashtë shtetit.

— Nuk thua keq, Arben, — tha ajo, po nuk e zgjati më tej. Ajo po ndiente diçka si mornica në trup. Jashtë ishte ftohtë, megjithëse marsi po mbante për mbarë, era e veriut që po zbriste në buzëmbrëmje të kujtonte dhe një herë kujdesin që të mos e hiqje pallton para kohës, se gripin e kishe prapa shpinës.

— Atëherë pse hesht? Në vend që ai të japë hesap, hedh gurë nën rrota e na pengon në punë.

— Të kam thënë, Arben, që të mos ngutesh.

— Të rri në vend numëro!

— Jo në vend numëro, por të mos shpejtohesh në mendime, as në veprime.

— E mora vesh, — tha ai dhe i zgjati dorën.

— Po shkon?

— Ika, se s'kam kohë të merrem me llafe të kota.

- Sot éshtë e diel, ti duhet dhe të pushosh.  
 — Kam diçka që duhet ta hedh në letër vizatimi, sot më shkrepit në kokë dhe s'ndoqa dot as ndeshjen.  
 — Për makineritë e gjilpërës?  
 — Mendoj ta filloj nga më e vështira e të gjitha makinave të linjës së gjilpëravë.  
 — Nga ajo e gjuhëzës?  
 — Po!, — iu përgjigj Arbeni.  
 — Atë makinë aq të ndërlikuar kërkon ta ndërtosh fare pa projekt?  
 — Projekti i saj së shpejti pothuajse do të jetë gati, për këtë një ndihmë të çmuar më ka dhënë Alqi Katroja.  
 — Merr vesh ai nga ato punë aq të ndërlikuara e të vështira?  
 — Duhet të kesh më tepër besim te njerëzit, Margarita!  
 — S'po të kuptoj!  
 — Mirë, unë s'po ta mbush syrin, po s'po ta mbush syrin as inxhinier Alqi Katroja, — i mëshoi zërit Arbeni.  
 — Më fal se nuk kam kohë të zgjatem.  
 — Sa i brishtë je, more Arben!  
 — Natën e mirë! — Ai iku pa e zgjatur më tej.  
 — Arben!..., — thirri ajo dhe për një çast shtangu në vend. Koka po i ziente.

## 5.

Sofie Korça tanë u mësua me gjendjen e re që mori shtëpia e saj. Projektet e hapura si çarçafë të bardhë në kuzhinë, në dhomën e pritjes dhe në atë të gjumit i jepnin asaj kënaqësinë e punës. Ajo u mësua dhe me miqtë e Arbenit. Kështu që tanë ajo e dinte shumë mirë se si e pinte kafenë Miha, ai burrë aq i shtruar, që hynte e dilte pa u ndier; se si e pinte kafenë Alqi, ai djalë me ata sytë e mëdhenj, që Sofies i dukej sikur e kishte vëlla Arbeni. Për Alqi Katron Sofia ndiente një dhembushuri të veçantë sepse ai kishte mbetur pa nënë që në vogëli.

Sofia e dinte se pasdreke çdo ditë aty vinin Miha e

Alqi dhe që të tre kokë më kokë, bisedonin dhe pastaj harroheshin në punën e tyre deri vonë. Ajo përpiquej të kuptonte bisedat e tyre, por nuk po e merrte vesh atë gjuhën e tyre teknike dhe kjo e nevrikoste pa masë, po nuk fliste.

I vëshronte duke thurur çorape dhe habitej se si ata tre burra shkriheshin dhe treteshin pas atyre letrave të hapura si çarçafë. Përpala tyre ata kyçnin gojën, shtrëngonin dhe me pëllëmbët e duarve nofullat e fuqishme dhe shkriheshin në mendime aq lodhëse, saqë heshtja e tyre të fuste në mendime e në dyshime. Ajo e linte punën dhe hopa me të shpejtë sulej përsëri në vatren e zjarrit dhe u bënte kafetë! Kishte raste që puna nuk shkon te fare dhe midis tyre fillonte një debat i gjatë. Atëherë Sofia e ndiente veten tepër ngushtë, pikëlllohej dhe nuk dinte se çfarë u mungonte. I vinte të dy duart në ije dhe vështronë e vështronë ato letra të hapura, por mendja e saj nuk e kapte dot atë lëmsh me vija, që ajo kishte parë në projektet e shtrira dhe nga frika se mos u priste punë, nuk fliste.

— Po ç'është kështu me ju, o Miha? Keni kohë dhe nuk po e gjeni dot rrugën për ku jeni nisur!, — tha ajo, se s'po i durohej dhe mbajti vesh.

— Kjo rrugë ka shumë të fshehta, Sofie, prandaj po vrasim mendjen për ta gjetur.

— Kur ju shoh të tre kokë më kokë që po shkriheni mbi këto letra, më pikon këtu në zemër, Miha. Po ata inxhinierët që kanë gjithë atë shkollë, nuk e gjejnë?

— Deri sot jo, pa të shohim, — gjegji Miha dhe u shkeli syrin Arbenit e Alqit.

— Edhe ti si Arbeni, o Miha!

— Çfarë?

— Ja, kur i them shiko, bir, të fejohesh e të martohen, pa të keq më përcjell me një «ka kohë, të shohim»!

— Gabim e ka Arbeni, se çdo gjë me vakt e me kohë, — tha Miha.

— Hë të keqen, o Miha, se nuk ta fsheh, ja këtu në zemër lëmsh e kam martesën e Arbenit. Ja, i iku mosha,

vërsnikët e tij me kohë i kanë bërë nënët e tyre gjyshe e mua më digjet zemra për kolopuçët e mezi po i pres të vijnë, t'i mbajë Sofia në duar, t'u këndoje ninullat.

— C'bëri Miha kështu? Hajde e mbyllja gojën tanë nënës!, — i tha Arbeni Alqit që po vështronët një detal me vëmendje.

— Më duket se kanalin me kiavetë e kemi harruar pa e hedhur në vizatimin teknik, — iu përgjigj Arbenit me nxitim Alqi pa e pasur fare mendjen te shqetësimi i tij.

— Ku është?

— Ja! — Ai vuri majën e lapsit.

— Po!

Kanali me kiavetë ishte harruar dhe për këtë punë të nxituar e gjithë barra i binte Arbenit.

— Miha, o vëlla, më trego se si është ajo çupa që e keni ju atje inxhiniere...

— Ama tanë e teprove!..., — shpërtheu Arbeni dhe e vështroi të ëmën me vërejtje.

— E di, e di, mor bir, po s'po llafos me ty, por me Mihën.

— Njëqind vjeç të na bëhesh, o Sofie, që po na heq lodhjen me këto biseda!

Ra një heshtje e thellë. Ndihej edhe gërvishtja e pënavë që punonin në letrën e dyllosur. Puna e gjatë mbi ato letra ua kishte mpirë gjymtyrët. Secili po bluante diçka në kokë, po asnjë nuk po fliste. Atë heshtje të rëndë Sofia nuk e duronte. I dukej se po i zinte frymën. Ngrihej e dilte në korridor, por përsëri kthehej duke ecur mengadalë nga frika se mos po ua trembte mendimet.

Kishte kaluar ora njëzet e një kur Miha e Alqi veshën palltot e trasha dhe u larguan. Sofia me Arbenin nuk ndërruan më asnjë fjalë. Atij po i mbylleshin sytë. U shtri në krevat. Ai ndjeu kërcitjen e lehtë të derës dhe hapat e saj, pastaj iu rënduan qepallat.

Në mesnatë Sofia e hapi me kujdes derën, kaloi si një hije duke ecur në majë të gishtërinjve, dëgjoi frymë-marrjen e tij të rëndë e i mbuloi shpatullat e zbuluara. Ai po buzëqeshtë në gjumë.

Shpërthimi i zjarrit në oficinë e vuri si organizatën — bazë të partisë, edhe drejtorinë në një telash të madh.

Diskutimi i gjatë dhe i ashpër ishte bërë dhe në organizatën e partisë, por çështja atje ishte svaruar dhe Arbeni kishte dalë faqebardhë. Prandaj Dhosi Qafëzezi nuk po e nxirrte nga goja dhe iu bë qejfi kur Nesti i tha që të shkonin nga Arbeni dhe ta merrnin për një kafe.

Dhosi me Nestin po ecnin duke biseduar për problemin e rezervave të gjilpërave. Arbenin e gjetën duke vështruar një tog me lecka të lagura me benzinë të hedhura pranë bazamentit të gurzmerilit. Ato ia solli një punëtor i ri, një djale shtatëmbëdhjetë vjeç. Ky fakt Arbenin e kishte vënë në mendime, që s'po u jepte rrugë.

— Çfarë ka ndodhur?, — u habit Nesti.

— Mos kanë luajtur mendsh këta njerëz?, — shtoi Dhosi.

Arbenit i ishin zmadhuar bebet e syve. Po ta dinte shkaktarin, ishte gati t'i hidhej në grykë.

— Ndoshta ka hyrë ndonjë shofer, — tha Anastas Kitra që ishte skuqur si një piperkë.

— Shofer?! Po ku ka hyrë shofer sot në oficinë?!, — ia priti Vasil Dishnica që shfryu hundët fort.

— Dikush e bën kastile këtë punë të poshtër, por nuk e kapim dot, — ia priti me atë zérin bas Hamit Dëllinja.

— Ju jeni që të gjithë syleshë.

— Arben, unë tanë sa erdha nga klinika, apo nuk të mora leje ty!, — tha Hamit Dëllinja.

— Nesti, më deshët për ndonjë gjë?, — pyeti Arbeni.

— Asgjë, Arben! U kthyem vetëm për t'ju ftuar për kafe.

— Falemnderit, po ja që na doli kjo çështje që duhet ta zgjidhim.

— Lërrja Koço Opingarit ta ndjekë këtë çështje, — tha Nesti, — e hajde të pimë një kafe.

— Mirë, Arben, shkon! — tha Koço Opingari, që sapo vajti aty.

Që të tre po ecnin pa folur. Arbeni dukej se po bluan te diçka te mundimshme ne kokë.

— Një pakujdesi e vogël hap telashe te medha, — theu heshtjen Dhosi.

— Ashtu eshtë, xha Dhosi, po mua s'ma ha mendja që eshtë thjesht pakujdesi, po diçka tjetër, — tha Arbeni me sy te skuqur.

Nesti nuk foli. Ai nuk dinte ç'të thoshte per atë që ndodhi. Hynë ne bufe. Nesti porositi tri kafe dhe tri gota uje me sifon. Kafet ishin te mira, por Nesti, posa mori filxhanin e ciflosur, mblodhi buzët dhe i tha banakieres:

— Nuk kuptoj xhanëm, perse jepni kafe ne filxhana te ciflosur?

— Keni te drejtë, — tha banakierja, — këtë çështje ia kemi thënë drejtorit te hozarshotit, por...

— Çfarë por? — tha Nesti me vetulla te mbledhura. — Banakierja rrudhi supet dhe u skuq.

— Vërejtjet e klienteve duhet t'ia thuash drejtorisë, — tha Nesti.

— Do t'ia them perëséri, — u përgjigj banakierja.

— Më kanë thënë se projektin e makinës së gjuhëzës e keni ne perfundim e sipër, Arben, ë?, — hapi bisedën Nesti.

— Do dhe pak kohë. Duhen dhe disa plotësime e gjithçka do te jetë gati por unë kërkoj nga ju, shoku Nesti, që te na ndihmoni, duke na dhënë disa detale që janë te gatshme ne magazinën tonë!

— Për çka disponon magazina, pse jo, por lidhur me këtë ti, Dhosi, duhet te hapesh një dokumentacion me emërtim te posaçem, ë?

— Dokumentacioni i gjilpërës? — tha Dosi gjithë gëzim.

— Sigurisht, — pohoi Nesti.

## KAPITULLI I DYMËDHJETË

### 1.

Tori Pini u nxeh nga përgjigjja që mori nga seksioni i industriisë në Komitetin Ekzekutiv, i cili nuk po i shtyn te urët e zjarrit për të vënët në funksionim linjën e makinës së vatës. Jo vetëm kaq, por punonjësi i atij komiteti nuk e kishte pritur mirë Tori Pinin.

Tori Pinit i kujtohet ajo ditë me një shi të vakët, kur ai festoi pesëdhjetëvjetorin e ditëlindjes së tij dhe për gjëzimin e tij e uroi i gjithë kolektivi dhe u thanë gjithë ato fjalë të mira, ndërsa Tori Pini tha vetëm dy fjalë: «Unë, shokë e shoqe s'kam bërë asgjë veç detyrës si qytetar dhe për këtë kurrë s'do të kursehem...», dhe uli kokën i skuqur në fytyrë. Të tjerët duartrokitën me të madhe.

Kur i thanë Tori Pinit që e kërkonte një gazetar që kishte ardhur nga qendra, aty për aty u step në vend.

— Shoku Tori, redaksia më ka ngarkuar të shkruaj për novacionet që keni bërë, për kursimet që janë realizuar, që arrijnë miliona lekë, — tha gazetari, një djale i ri me flokë onde-onde. — Prandaj dua të më thuash gjerë e gjatë si i ke arritur këto novacione, që t'ua bëjmë të njo-hura gjithë lexuesve të gazetës sonë.

— Kë do të vësh në qendër të shkrimit?

— S'do mend, autorin e novacioneve.

— Kjo është pak. Që këtu cungohet e vërteta.

— Pse cungohet e vërteta?

— Sepse ju harroni që, për të mbërritur deri tek unë, janë gjithë ata punëtorë duarartë që kanë bërë gjithë atë punë.

— Këtë shkrim do të ta kushtoj ty si autor të këtij novacioni.

— Çfarë kam bërë unë? Asgjë! Kam vendosur shablonet në rrugën e stofit të shtrirë në tavolinë me kujdes e me përpikmëri që cilido shablon të zërë aq vend sa i takon, sepse ka edhe njerëz që shtrihen aq shumë e përhapen duke shtrirë gjymtyrët në jetë sa zënë shumë vend për veten e tyre dhe i lënë të tjerët më këmbë. Ja, kështu i kam shtrirë shablonet aq sa të shtrihen që të gjithë që asnjëri të mos mbetet më këmbë dhe kam kursyer miliona.

— Pse e pakët është e gjithë kjo? — Ai filloi të mbante shënimet në bllok.

— Edhe ndonjë gjë e madhe s'është.

— Sa modest që jeni, shoku Tori, — foli djaloshi dhe shënoi diçka në bllokun e tij.

— Pse çuditeni? Ky është tipari kryesor për të gjithë njerëzit tanë të punës dhe kjo forcë e mrekullueshme të nxit për të hyrë me gjithë shpirt e vendosmëri në luftë me atë që kérkon të mposhtesh, me atë që kérkon të krijosh për të mirën e popullit e të atdheut. Ja se cila të sjell gëzim, kënaqësinë e fitores. Këtu ka njërez të mrekullueshëm që e bëjnë natën ditë për të çarë bllokadën e rrethimin imperialisto-rezisionist. I tillë është novatori komunist që po punon për ndërtimin e linjës së gjilpërës, që deri më sot është monopol i ca shteteve imperialisto-rezisioniste. Kështu, ju duhet të shkruani për autorin e saj të mrekullueshëm, për figurën e komunistit të vërtetë që po ndeshet dita-ditës me koncepte frenuese dhe me të panojohurat e teknikës, por nuk thyhet, e jo për mua. Fundja racionalizimi im nuk ngre aq peshë.

— Cili është ai?

— Arben Korça.

— Arben Korça. Le ta ndërtojë makinën, se edhe për atë do shkruajmë, por këtë radhë unë jam i porositur që të shkruaj për ju, shoku Tori.

## 2.

Ofiçina ziente nga gjëzimi. Kishte filluar puna për prodhimin e detaleve të para të makinës së gjuhëzës. Tornot ishin pastruar. Kështu ishte vepruar dhe me të gjitha makinat e tjera. Vajzat e filaturës që e kishin repartin e tyre pranë oficinës, me të marrë vesh lajmin e gjëzuar, u lëshuan që të gjitha atje dhe e bënë vendin drithë.

Shkëlqente nga pastërtia e gjithë oficina! Kur pa këtë ndryshim, Arben Korça u habit dhe, duke qeshur nën buzë, tha:

— More! Sikur nuk është oficina jonë!

— Kot, të gjithë këtë punë e bëtë kot. Më duket sikur na kanë futur në zyrën e drejtorit të limojmë me lima, — tha Vasfi Dishnica dhe teshtiu me forcë!

— Foli të vërtetën usta Vasfiu; prandaj dhe teshtiu, — e shpoi me marifet Anastas Kitara.

Arben Korça ishte në një gjendje shpirtërore sa të dukej se fluturonte nga gjëzimi. Sa njerëz të mrekullueshëm që paskësh ai në oficinë, të dashur, të sinqertë, të gatshëm për të ndihmuar njëri-tjetrin.

Papandehur në oficinë erdhi Margarita. Ajo kishte veshur një përparëse të mirë me xhepa të mëdhenj. Vajza i erdhi njëherë rrith e rrotull nga tornot e pastaj, si të kishte dalë për inspektim, u kthyte nga ana e gurzmerilit. Aty pranë gurzmerilit i zuri syri një tufë me lecka ngjyra-njëngjyra. Porsa i zuri me dorë, hundët e saj i shpoi era e benzinës.

— Arben, ç'janë këto lecka këtu?

Arbeni rrudhi supet dhe ndjeu t'i rrihte zemra me një forcë të çuditshme, që nuk e kishte provuar më jetë. I mori leckat në dorë.

— Vallë cili është ai i poshtër që dashka të na përvëlojë në zjarr ditën për diell? — tha Arbeni me fytyrën si meit dhe kërkonte një rrugëzgjidhje.

— Arben, hap sytë, se kjo është një pakujdesi e madhe, që të ngarkon me përgjegjësi të rëndë!

— Ke të drejt, Margarita, po një gjë po them, këtu nuk është çështje pakujdesie. Këtu kemi të bëjmë me një punë armiqësore.

— Ke fakte?

— Ja, fakt i gjallë janë leckat me benzinë dhe pikërisht sot që për të parën herë fillojmë të prodhojmë detalet e makinës së gjuhëzës!

— Mos i merr punët kaq thjesht, Arben! Çfarë detalesh do të bëni sot, kur ju akoma nuk keni filluar të derdhni skatullën e kësaj makine?!

— Dhe atë do ta derdhim.

— Ku do ta derdhni? Ajo do një fonderi speciale, një mjeshtër të zotin, një ambient të pastër, një rërë të rrallë, eh, sa vështirësi të tjera keni përpara!...

— Kështu më fole edhe për projektin e makinës, por dihet nga të gjithë se atë tanë e kemi vënë në rrugë.

— A nuk është akoma shpejt të themi se linjën e keni vënë në rrugë, a?

— Për mendimin tim jo.

— Ja mendjemadhësia!

— Koha le të na gjykojë!

— Mirë, le t'ia lëmë gjykimin kohës!..., — tha ajo dhe u largua me vetulla të vrenjtura.

### 3.

Arben Korça e kuptoi se prodhimi i akseve, që ishin detalet më të lehta, dhe mund të prodhoheshin pa vështirësi nga mjeshtrit Koço Opingari etj., por nuk do të thoshte se puna e ndërtimit të makinës së gjuhëzës kishte filluar. Në këtë drejtim, ndonëse nuk ia tha, i jepte të drejtë Margaritës.

Ai tanë po e vriste mendjen për vështirësitë që paraqiste ndërtimi i disa dhjetëra gungave ekcentrike, gungave me kanale të përdredhura, kokave me një pikë kryqe të maltës, rrrotave me një dhëmb, pjastrave, akseve të deformuara dhe një morie të tërë me gjymtyrë vidash e pjesë të paemërtuara. Pastaj vinin me radhë kallëpët e skatullës së makinës që ishte sa e frikshme, aq dhe e habitshme. Vallë si do të ndërtoheshin këto kallëpe? Kush do t'u bënte modelin? Matjet? Në cilën fonderi dhe cili fonditor

do t'i derdhte? Vallë ai që do ta merrte përsipër këtë punë do të ishte i aftë pér t'ia dalë në krye, apo këtu do të ngecën?

Në oficinë vajti dhe Miha! Ai ia prishi gjakun. I tre-goi se asnjëra nga ndërmarrjet e qytetit nuk merrte përsipër derdhjen e gjithë atyre detaleve aq të komplikuara. Nuk kishin mundësi, e jo se u mungonte dëshira pér t'i ndihmuar.

— Po tanë si do të bëjmë?

— Mua më pyet, o Miha?!

Miha Voskopoja heshtë! Ra në mendime dhe nuk din-te se ku ta hidhte atë vështrimin e tij plot shqetësim: po të ishte puna pér ato akset, hajde se do të rrinte një muaj vetë ai jashtë orarit dhe gjithçka do të mbyllej me kaq, por puna tanë ishte krejt ndryshe.

Heshtjen e rëndë e prishi Kopi, i cili vajti së bashku me shefin e llogarisë.

— Hë? Tani ju hasi sharra në gozhdë, ë?, — pyeti Kopi fytyrëngrysur.

— Dhe janë gjithë ato shpenzime!, — shtoi Nesti.

— Ja, po mendohemi, — tha Miha!

— Mendohuni, por pér këtë të ishit menduar më parë, — tha Nesti.

— Si t'i justifikojmë të gjitha këto shpenzime të kota?, — tha Kopi.

— Gjithçka do të rregullohet, drejtor. — Miha siç du-kej do të ishte mbërthyer me Kopin, prandaj nuk po i fliste me emër.

— Duhet shkencë, me shkencë shkohet përpara, të gjitha fajet i kam unë, Kopi, dhe mirë të më bëhet.

— Pse i keni ju që të gjitha fajet?

— Si nuk kam faj, Arben? Unë, që lejoj të shpenzo-het energji elektrike, metal i cilësisë së lartë. Dhe përsë? Pér t'ju kënaqur ju si një fëmijë grindavec që shpenzon familjen me tekat e tij pér të blerë një avion të madh lodër prej 100 lekësh!

— Shoku Kopi! Nuk lejoj të më ofendon kështu?!

— Pse ofezë është kjo? Ai që po na ofendon jeni ju!

Ku janë premtimet tuaja? Ku janë rezultatet? Unë ju kam bësuar, ju kam dhënë të gjitha ndihmat. Çfarë kërkon më shumë? Mos vallë doni që të shkatërrojmë të gjithë kombinatin për ju?

— Megjithatë ju, shoku drejtor, mos flisni me këtë gjuhë! — Miha mori anën e Arbenit.

— E me c'gjuhë të flas?

— Me gjuhën e Partisë, shoku drejtor, se Arbeni për interesin e përgjithshëm po shkrihet në punë.

— Puna matet me rezultate e jo me premtime, Miha, prandaj ejani ta bisedojmë shtruar në zyrë.

— Shkojmë, pos!

Që të katër morën rrugën për në drejtori. Dhimitrulla, që merrej me pastrimin e korridorit, vërejti se ata ishin aq të zemëruar, saqë u ishin skuqur dhe sytë. Ajo u më-njanua dhe, posa dera u mbyll rrëmbyeshëm, u largua me të shpejtë nga korridori që të mos dëgjonte ndonjë sherr midis tyre.

I pari që doi nga zyra ishte Arben Korça. Ai dukej si një gjuhë flake që dilte nga një zjarr i madh, pastaj qetësia e shkallëve u prish nga fryma e nxehjtë e fjalëve të forta. «Kjo nuk do të mbetet vetëm me kaq, keni për ta parë se çfarë qëndrimi do të mbahet nga organizata për këtë sjellje të padenjë!», — tha Arbeni dhe doli jashtë në ajrin e freskët që ia përkëdheli fytyrën e skuqur.

Duke ecur me nxitim pa ditur se nga shkonte, gjoksi i shkopsitur i hidhej përpjetë si një kacek që mbushej e zbrazej me ajër dhe zemra i rrihte me forcë. Ku shkonte vallë? Përse nga veshët që i digjeshin nuk i shqitej ajo zukatje e habitshme e flatrave të krahëve të pilivesës? Pilivesë... Jo! Ajo nuk ishte pilivesë. Ajo ishte gjilpëra që kishte marrë formën e atij insekti. Ajo doli së bashku me të, e ngjallur nga dheu e që u formua në drejtori nga kundërshtimi i Kopit dhe i Nestit. Ja, u ngjall ajo flutura, pilivesa, insekti!.. Ai ikte, po ajo e ndiqte prapa! Ai ndiente zukatjen e krahëve të saj. Pastaj ndjeu një mpirje të kokës prapa. Dhe ja, gjilpëra s'i hiqej nga koka. Pas saj e klitura e Kopit: «Kush përgjigjet për të gjitha

shpenzimet? Pse kështu mbahet fjala? Ku janë rezultatet?

— Nuk jam mësuar të kthehem nga rruga unë, jo!, — foli ai me vete duke përsëritur dhe një herë atë betim që e kishte futur thellë në gjak.

— Ej, Arben! Kujt i flet kështu?! — Dhosi po e vë-  
shtronte Arbenin e dalldisur.

— Unë? Vetes sime po i flas!

Tani Arben Korça ishte i vetëm në zyrën e vogël me xhamillék që dridhej nga tornot dhe trapanot. Punëtorët po hanin me limë metalin e ftohtë ashtu siç e hanin atë brengat e mbledhjes. Ai po peshonte se sa i rëndë ishte gabimi i tij. Po ai ishte i bindur se linja e gjilpërës ishte e mundshme. Përse i janë kundërvënë ata? Kush e kryeson atë kryqëzatë gjilpëre? Stefan Grabova? Apo mos vallë drejtori? Jo! Kopi nuk kishte përse ta bënte atë punë. Ai kishte qenë qysh në fillim dakord mbas projektit të tij. Atëherë kush?

Mornica i shkuan në trup kur mendonte kështu! Pas-taj nga xhamat e larë të zyrës së tij ai vuri re grumbullin e detaleve të prodhuara me punë jashtë orarit. Ja se si vezullonte trupi i tyre si i larë në nikel. Një punë të tillë shumë të kujdeshshme e kishte bërë Koço Opingari, për të cilin Arbenit i kishin thënë se ishte një egoist, një me-njemedh, një njeri konservator, që përfitonë nga sho-qëria që kishte me drejtorin dhe bënte siç i donte qejfi në oficinë pa qenë aspak i detyruar t'i jepte kujt llogari. Por Koço Opingari nuk ishte aspak i tillë. Ai ishte një mjesh-tër i palodhur me duar të arta. Apo nuk kishte dhe një shpirt të madh, një dashuri prej shoku, prej proletari... Duart e mëdha të tij shpeshherë ishin bërë për të duart e vëllait të madh dhe Arben Korça nuk dinte se si t'ia shpérblente.

Arbeni vendosi që për atë që ndodhi t'i drejtohej organizatës së partisë, duke i hapur zemrën, t'i tregonte vështirësitë, pengesat e njërit e të tjegrit, se vetëm ajo do ta vinte gishtin në plagë dhe do t'i gjente edhe ilaçin e shërimit.

Po sikur të mos e kuptionin, të mos i jepnin të drejtë,

t'ia hidhnin poshtë gjithë atë projekt si të pamundshëm?

Tori Pini e pat këshilluar që, për të thyer konceptet frenuese të inxhinierëve që nuk besonin në ndërtimin e linjës së gjilpërës, ai duhej të ndërtonte dy makinat e para, atë të gjuhëzës dhe atë të latimit të majës së gjilpërës, që quhej makina me çekan sferash. Vallë çfarë duhej të bënte që të bindte organizatën e partisë?

Mbledhja e organizatës së partisë e mori në shqyrtim punën dhe rezultatet e arritura për ndërtimin e linjës së gjilpërës, dhe konstatoi se ai në përgjithësi kishte punuar mirë dhe se duhej të shpihej deri në fund ndërtimi i makinës së gjuhëzës. Po organizata kritikoi rëndë si Arbenin, edhe Kopin për nxitimin dhe grindjet e kota, që pengonin punën.

Arbeni doli nga mbledhja i gjëzuar aq, sa të dukej se po fluturonte. Ai tani iu përvesh punëm me aq vrull, sa-që nuk i ra fare në sy as Margarita që po i qëndronte pranë me atë fustanin e bukur ngjyrë vjollce.

— Punë të mbarë, Arben!, — i tha ajo me atë buzëqeshjen eëmbël.

— Të mbarë paç!, — u përgjigj ai pa e ngritur kokën.

— Nuk më thua çfarë keni menduar për derdhjen e pjesëve të trupit të makinës së gjuhëzës?

— Për këtë, përparrë se të kérkonit rezultatin, duhej të mendonit seriozisht ti e Kopi! Megjithatë diçka do të bëjmë se s'bën.

— Vërejtje me vend, — pohoi ajo dhe buzëqeshi. Arben Korça nuk e kuptoi pohimin dhe buzëqeshjen e saj. E vështroi me vërejtje. — Arben, këtë çështje më duket se e kemi zgjidhur. Kemi biseduar gjerë e gjatë me Naum Shanon. Ai na dha fjalën se, ndonëse është pensionist, do të bëjë derdhjet që na kërkohen.

— Kush bisedoi me të?

— Unë e Kopi.

— Ashtu goftë!

— Nuk e beson?

— Pse të mos e besoj? Jo më pak se unë e Miha jeni edhe ju të interesuar për linjën e gjilpërës. Bile ju duhet të tundeshit nga vendi më tepër.

— Sa i ashpër je, Arben!

— E di...

— Çfarë?

— Nuk ju pëlqen kritika as ty, as Kopit. Dhe për këtë keni të drejtë, se nuk ju kemi kritikuar e t'ju fusnim të dyja këmbët në një këpucë, siç juva bëri këtë radhë organizata bazë e partisë.

— Domethënë fajin e keni ju!

— Ne e kemi.

#### 4.

Inxhinier Stefan Grabova e takoi Vasfi Dishnicën te klubit «Përparimi».

Inxhinier Stefani ishte ulur në tavolinën e fundit të rreshtit, atje ku shërbente një kameriere topolake, ndërsa Vasfi Dishnica i rrinte inxhinierit përballë duke e mbuluar atë nga balli tek shtrihej rruga e gjerë ndriçuar nga shkëlqimi i neoneve. Porositën nga një raki të fortë rruishi, prodhim i kantinave të verërave të qytetit. Pinin në heshtje dhe flisnin me zë të ulët.

— Ai u bë jashtëzakonisht i padurueshëm!, — tha Stefani.

— Tepër me vrap e ka marrë.

— Kur ra zjarri në oficinë, mendova se aq e pati, por ja, asgjë nuk i bënë. Vallë a nuk të habit kjo butësi e drejtorisë? Koço Opingari e pagoi shtrenjt vetëm për një kundërshtim urdhri!...

— Sa frikë kam pasur për çështjen e zjarrit, inxhinier.

— Je trembur kot së koti!

— Jo kot së koti, se, po ta diktonin se unë e futa atje atë leckë të lyer me benzинë, rrezik se do të më fluturonte koka!

— S'të kam ditur kaq frikacak, Vasfi! Përse trembesh? Plani ynë ishte aq i studiuar, saqë, edhe po të diktohej hedhja e leckës, s'mund të të vinte kush përpëra përgjegjësisë penale. E shumta një pakujdesi e asgjë më tepër.

— Vërtet, inxhinier, për të tilla ju pjell mendja, me gjithatë duhet të pranojmë se ajo ishte me rrezik të madh!

— Po nuk rrezikove, kurrë nuk fiton! Po ti duhet ta dish se ai është shumë i rrezikshëm për ne të dy. Ai e di se për linjën e gjilpërës ne u specializuam jashtë shtetit dhe s'bëmë asgjë. Fitorja e tij është disfatë e tmerrshme për ne! Tani për linjën e gjilpërës janë mobilizuar edhe Kopi e Margarita, që deri ditët e fundit lëkundeshin. Prandaj t'ua zbrazim bombën në duar, — tha Stefani dhe e mbuloi me vështrimin e tij. Vasfiu u zverdh. Ndjeu t'i ngjiteshin mornica në shtyllën kurrizore.

— Për shëndetin tënd, mjeshtër! Së shpejti do të pimë për suksesin tonë, ë?

— Gëzuar, inxhinier, po të mos themi hopa pa e kapercyer kanalin!

Ata i tokën gotat lehtë. Stefani kafshoi kofshën e pules, kurse Vasfiu largoi gotën nga buza dhe po rrinte si i hutuar. Dukej se e kishte pushtuar frika.

— Kështu, mjeshtër Vasfi! Tani s'kemi të bëjmë vetëm me Arbenin e Mihën po edhe me Kopin, Margaritën, Nestin.

— Pse me Koço Opingarin e gjithë punëtorët e ofisi-nës jo?, — ia priti Vasfiu. — Po s'ma ha mendja që i dalin në krye.

— Ata e kanë vënë punën në rrugë, ti, na flet dokrra!, — dhe e mbuloi me vështrimin e tij të vrazhdë.

Heshtën. Lokali filloj të mbushej me çifte që shkonin për të pirë nga një shishe birrë të freskët. Ai filloj të gumezhinte si një koshere bletësh në pranverë, gjë që Stefanit dhe Vasfiut ua ngriti nervat.

— Ka ca ditë që Arbeni e Koçoja nuk ndahen, po ditë-natë kokë më kokë. Seç bëjnë andej nga uzina mekanike e riparimit të traktorëve, — theu heshtjen Vasfiu.

— Koçoja përpinqet t'i hyjë në zemër Kopit e Margaritës, prandaj tregohet kaq i gatshëm t'i ndihmojë atij, që i zuri vendin.

— Përipiqet të bëhet bashkautor i «shpikjes», po ku lë Larua të hajë Balua!

— Domethënë kanë shkuar nga uzina mekanike e riparimit të traktorëve... — Stefani po fliste mendueshëm.

— Po! I rashë hilesë! Dëgjova se e kanë kurdisur edhe mjeshtër Naumin. E njoh mirë unë, ai është fonditor. Ne duhet të bëjmë çmos që atje t'u hasë sharra në gozhdë!

— Si?

— Ja, aty inxhinier i fonderisë është miku im, Qendro Kolonja.

— Bën gjë Qendroja?

— Pse të mos bëjë?

— Ai, përpara se të transferohej që këndeja, halë në sy kishte Kopin, Mihën e Arbenin.

— Ashtu është, po mos harro se Qendroja është sa hakmarrës, aq edhe frikacak!

Ata e pinë gotën me fund. Papandehur në lokal hyri vetë i dytë Anastas Kitara. Ai u ul përballë tyre në një rresht më tutje.

— Po ky?!, — tha Vasfiu.

— Ku e solli kokën djalli!, — tha Stefani dhe hodhi bisedën pér llojet e peshqve. Ai po fliste me zë të lartë me qëllim që ta dëgjonte Anastasi, kurse Vasfiu zuri të gaja-sej me të madhe dhe porositi edhe nga një dopio.

## 5.

Në uzinën mekanike Arbenit i thanë që Naum Shanon mund ta takonte në shtëpi. Mjeshtri, ndonëse kishte dalë në pension, në fonderi ai shkonte herë pas here vullnetarisht pér të mësuar kuadrot e rinj. Arbeni mendoi t'i bënte një vizitë në shtëpi mjeshtrit fonditor. Në rrugën «Partizani», në shtëpinë nr. 24 te balli i portës e priti lehja e një qeni të vogël. Arbeni shtypi butonin dhe dëgjoi trokëllimën e ziles. Ai, posa pa burrin që po zbriste shkallëve, e hoqi gishtin nga butoni dhe u skuq.

— Kë kërkon?, — pyeti burri me zërin e tij të trashë dhe me vetulla të mbledhura.

— Më falni... Mos banon këtu mjeshtri Naum Shano?!

— Unë jam Naum Shanoja! — Mjeshtri e mbuloi me vështrimin e tij dashamirës dhe buzëqeshi lehtë. — Po urdhëroni brenda!

— Kanë biseduar me ju Kopi Nanushi dhe kryeinxhinerja e kombinatit tonë për derdhjen e ca pjesëve në fonderi, prandaj erdha të merrem vesh kur jeni i gatshëm që të fillonim nga derdhjet.

— Ju jeni Arben Korça, ë?

— Unë, mjeshtër Naumi, po pa ndihmën tuaj kemi ngecur keq.

— Për iniciativën tuaj më ka folur edhe Kopi, edhe Margarita, që është mbesa ime. Kur dëgjoj se të rinjtë marrin iniciativa të tillë, unë e ndiqjet veten shumë më të ri dhe më vjen ta shqyej ndonjë inxhinier apo teknik, që i molepsur nga egoizmi profesional, shtrembëron buzët dhe bëhet pengesë. Tipave të tillë u duhen thyer hundët dhe hundët u thyhen vetëm me rezultate konkrete e jo me llafe e grindje shterpa. Atëherë e marrin vesh ata sa u vlen lëkura.

Arbenit i ngazelleu ftyra. E kuptoi se Kopi e Margarita e kishin marrë seriozisht çështjen. Tani e ndjeu veten më të sigurtë se kurrë.

— Jemi duke përgatitur një nga makinat më të vështira të linjës së gjilpërës, por pa ndihmën tuaj, xha Naumi, s'ia dalim dot në krye.

— E çfarë mendoni të derdhni tani për tanin?

— Skatullat e makinës së gjuhëzës. Ato janë të vizatuara në projekt.

— Unë nuk do të kursehem, po kur ju duhen ato vegla?

— Sa më shpejt, aq më mirë.

— E sa janë?, — pyeti ai me kureshtje duke fërkuar mjekrën.

— Shumë!, — iu përgjigj Arbeni gjithë frikë!

Në dhomë ra një heshtje saqë ndihej vetëm frysë-marrja e plakut që dukej që ai kishte gulç! Në korridor u dëgjuan ca hapa të rëndë.

— Po na vjen plaka, — tha Naumi që e njohu nga hapat.

— Si je, more bir, mirë je?, — foli ajo dhe i dha dorën topolake si mafishe e fryrë!

— Falemnderit, nënë! — Ai ishte ngritur në këmbë.

— Po ulu, more bir, ulu! I kujt je, more bir? — Ajo s'po ia lëshonte dorën.

— Qerase mikun, moj, e lëre të ulet se e le në këmbë me këto pyetjet e tua!

— Edhe ti, o burrë, gjithmonë nxitohesh e nxitohesh sikur të presin punët e shtetit! Tani shqyr je në pension. Si e ke emrin, o bir?

— Arben Korça, — u përgjigj ai duke lëvizur nga krrigia, për t'i dhënë të kuptojë se ai nuk kishte aspak nge siç mendonte ajo, mbasi atje në oficinë e prisin punë të ngutshme.

Plaka ngadalë si një patë u nis nga një dollap i madh dhe nxori një shishe litroshe me raki rrushi! Fytyra e plakut ndriti.

— E kur mendoni të filloni derdhjen?, — pyeti xha Naumi pasi ngritën gotat.

— Po të jeni ju i gatshëm, që nesër, mjeshtër!

— Mirë, ditë e re, nafakë e re. Naumi nuk është kurssyer kurrë, po tani që duan të na marrin frymën me bllokadën e tyre të mallkuar do t'u tregojmë se ç'është në gjendje të bëjë klasa punëtore e Shqipërisë. Po, po, t'u tregojmë se s'bën!

Arbeni desh po fluturonte nga një gëzim i papërmbajtur. U ngrit dhe e rroku për qafe fonditorin zemërluan, nëpër faqet e të cilët u rrokullisën dy pikë lot gëzimi.

## *KAPITULLI I TREMBËDHJETË*

### 1.

Sofie Korça u nis tërë inat dhe zemërim për te Miha Voskopoja. «Ai le të ishte kudhra e kalitjes së djalit si sekretari e shoku i tij, por ajo nuk duhej harruar, se ajo ishte nënë...» Kështu mendonte Sofia dhe shkonte me mendje të ngritur për t'u zënë me Mihën, por, kur pa se Miha ishte me sy të buhavitur dhe të skuqur, Sofies i iku gjithë inati.

— A! Sofia!, — u habit ai.

— E, unë jam! — Plaka u krekos si për ta marrë vesh se ajo mundej të shkonte atje dhe natën!

— Me nerva dhe ti qysh në mëngjes?

— Si të mos jem me nerva, ku është «pëllumbi» që ka ardhur në mesnatë dhe pa gdhirë ka dalë nga shtëpia?

— Tani apo iku në uzinën e riparimit të traktorëve, në fonderi, ndoshta ka shkuar nga ofiqina e ndërmarrjes së pyjeve, por deri në mesnatë jemi marrë me tornimin e dy akseve shumë të vështira.

— È më ju lumtë! Po nuk e kuptioni se kështu siç ia keni nisur do të shkatërroni shiendetin dhe s'mbeteni as për shtëpinë, as për Partinë, ë?

— Eh, moj Sofie, e bekuar grua që je. Këto kohë kështu e kemi punën. Tani, po të duash, shko e na përgatit një lakror me dy petë, me qepë, domate e piperka.

— Si janë këta njerëz! Vjen për t'i sharë dhe ja, ta kthejnë mendjen për t'u bërë lakror! Do të vini me Arbenin?

— Më mirë sille me gjithë tepsi ja këtu në këtë vend. Arbenit do t'i telefonoj. Ika, Sofie, se nuk kam kohë, se, po s'i gjeti akset gati Arbeni, më vrah, — tha ai dhe i dha dorën e u largua me nxitim.

— Miha, o Miha! Po kur ta sjell lakrorin?

— Nga dreka, — tha ai pa kthyer kokën.

Sofia u kthye duke qortuar veten. Po ecte si e përgjumur. U ndal te baraka e zarzavateve dhe prej andej me një kurorë qepësh në duar hyri në dyqanin ushqimor dhe bleu dy qeska me miell gruri nga ai i cilësisë së parë. Donte të kënaqte Mihën e të birin që kishin punuar tërë natën. Po nga ana tjetër dëshironte që ta merrte vesh edhe Miha se ç'lakror të shijshëm gatuante Sofie Korça dhe mbushi cep më cep atë tepsinë e madhe që e përdorte vetëm për raste të veçanta.

Porsa e nxori nga furra, mori tepsinë në duar dhe nxitoi t'ua çonte ashtu duke avulluar. Sofia u habit kur së bashku me Mihën e Arbenin u ul edhe një burrë i moshuar, të cilit Arbeni i bënte aq nder. Miha dhe Arbeni e nxisnin të hante.

U afroa Margarita dhe ndaloj pak larg Sofies duke vështruar si me keqardhje tepsinë që tregonte tanë vetëm vitin e martesës së zonjës së saj!

— Margaritën siç duket nuk ka për të dashur vjerra!,

— i foli me shaka Miha.

Sofia e vështroi njëherë me vetullat e lëshuara Mihën për atë fjalë që hodhi.

— Si nuk i latë çupës një kafshatë, more Arben?

— Sofie, ne sot ishim si ujq të uritur.

— Nëna e Arbenit sa herë të kesh lakrorë të tillë, na e sill, se jemi gati ta përlajmë!, — tha burri i moshuar me trup të imët e thatanik dhe fshiu buzët me shpinën e dorës.

— Zotrote si të quajnë?

— Naum më quajnë!

— Naumi éshtë xhaxhai i Margaritës, moj nënë, — i tha Arbeni që ishte skuqur nga faqet!

— Ba! Por sa mirë që shkoi! Pastaj? Pastaj çfarë të keqe ka?

Sofia hodhi vështrimin nga Margarita që buzëqeshte lehtë dhë iu drejtua Naumit:

— Ma jepni çupën, pa mos ma qani hallin për lakrorët sikur të jeni dhe njëqind krushq!

— Nënë! — Arbeni ishte ngritur në këmbë dhe vështrimi i tij kërkonte që ajo ta linte atë bisedë.

— Sa i nxítuar që je! Po nuk e vështron se po bëjmë shakara, sepse me shakara më dukesh ti ngopesh me shumë sesa të martohesh me të vërtetë!

— Sofie, kështu eja çdo ditë, se nuk na besdis, po na glodh, — tha Miha.

— E ku të lë Beni të bësh shaka!

— Mirë thotë Miha, nënë!, — tha Margarita. Sofies i erdhi mirë që ajo iu drejtua si nusja vjehrrës.

— Si thua ti, o Beni i nënës? — Kjo pyetje e bëri atë që t'i skuqeshin faqet dhe të vështronte poshtë në lihadhin e veshur me gjelbërim.

## 2.

Afshi i nxehthë të shponte gjoksin dhe të mbushte mushkëritë gjithë avull. Një kollë e thatë po e ngiste Naumin, por ai nuk u shqetësua. Nga format e mbushura me metal buiste afshi dhe tymi gjithë karbon që po i vështirësonte frysma marjen.

Arbeni, ngaqë nuk dinte të ruhej, qe nxirë e bërë për ibret, aq sa nuk do ta njihet dhe vetë Sofia.

Kishin gati dymbëdhjetë orë që po punonin atë proces lodhës që të shkallmonte shpatullat e të bënte që ta ndieje dhimbjen në mesin e peshkut të kurrit. Por Arbeni, ndonëse dhimbja e kokës i ishte bërë si një migrenë nga ajri i lagësht dhe gjithë pluhur i fonderisë, nuk po pyeste dhe kaq shumë për buisjen e avullit, për dhimbjet

e kokës dhe për mpirjen e muskujve. Mjaftonte që gjithçka të kalonte mirë, të dilte derdhja e pastër dhe më vonë detalet e makinës së gjuhëzës. Gjysma e punës do të quhej e mbaruar dhe me sukses, atëherë kur të mbaronin dhe, po të dilnin me cilësinë e kërkuar disa derdhje të tillë, Arbeni kishte besim që ajo derdhje e kungave me gjithë ato përdredhje do të dilte mirë. Këtë besim ia kishte krijuar kujdesi që po tregonte fonditor Naumi ndaj formave prej argjili të ngurtësuar.

Arbeni vështronët mjeshtrin e derdhjes dhe vërejti që ai la të hapura kanalet e holla si damarët e gjakut, nga të cilat do të kalonte me vrull metali i lëngshëm si një masë e zjarrtë.

— Ja, o bir, — i thoshte ai Arbenit, — kështu përhapet dhe gjaku nëpër damarët e njeriut.

Arbeni e kuptoi se në fonderi, ku derdhej çeliku e merrte lloj-lloj formash sipas fantazisë së shpikësit, kri-heshin mendimet, hidheshin poshtë vogëlsirat, pastrohej nga ndërgjegjja skorja siç pastrohej prej saj vetë metali.

Arbeni vështronët plakun, që, ndonëse gjithë ditën e ditës nuk ishte çlodhur, afroi faqen e tij nga kapulicat tek ishin derdhur detalet dhe, si shtriu pëllëmbët e duarve të tij mbi ato kapulica, e ndjeu se tanë ishte koha për t'i nxjerë nga dheu detalet e derdhura. Dhe i nxori, siç dalin patatet nga prushi.

Arben Korça u shtang. Detalet kishin dalë të pastra dhe pa pore, pa difekte. Ato llamburisnin e feksnin si të ishin të zbuluara nga një veshje varaku.

Mjeshtri i vështroi ato duke picërruar sytë e vegjël që ia vrah pak drita që hynte si një valë nga një e çarë e murit të djaththë.

Arbeni i mori në duar. Ndjeu një gëzim që ai nuk e kishte provuar kurrë ndonjëherë në jetën e tij. Iu duk sikur fonderia ishte ndriçuar nga projektorët.

Përballë tyre rrinte e vështronët duke buzëqeshur me cinizëm inxhinier Qendroja.

— Ku jeni, o Ali Baba me dyzet hajdutë, — tha ai.

Naumi dhe Arbeni e vështruan vëngër, po nuk folën.

Inxhinier Qendros iu duk sikur e qëlluan me shuplakë në fytyrë.

— Kush ju ka lejuar të punoni ju këtu?

— Ik na lër rehat, — i tha Arbeni që nuk donte ta prishte gëzimin që ndiente.

— Jo, Arben Korça! Këtu nuk është oficina e kombinatit që ju të komandoni si të doni. Këtu komandoj unë! Kush ju ka lejuar të punoni këtu, ju pyes ju, shoku Naum? Mos vallë ju u bëtë Hero i Punës Socialiste që të vini dhe të derdhni koka të ndryshme për punë private?

— Inxhinier! Mësoje gojën të nxjerrë fjalët, kush po bën këtu punë private?!

— Përderisa punoni pa leje, sigurisht që të tillë punë duhet të bëni!

— Largohuni, — i tha Arbeni!

— Në goftë se ka njeri për t'u larguar, ai jeni ju, apo vallë keni harruar se çfarë trajtimi më keni bërë atje në kombinat?

— Inxhinier Qendro, mendoje mirë se ç'po flet! — iu hakërrye Arbeni.

— Ha, ha! Ju mendoni se ju kam frikën! Jashtë. Të dy jashtë! Jashtë nga kjo ndërtesë shtetërore!

Arbeni nuk foli, por u nis drejt tij.

— Arben, — thirri Naumi. — Mos u merr me këtë që s'di ç'hotë. — Arbeni u ndal, por sytë po i nxirrin xixa.

### 3.

Tri ditë më pas Arben Korçën e thirrën në drejtorinë e uzinës mekanike. Sekretari i partisë i uzinës, një djalosh i gjatë me një vështrim të mprehtë dhe të ëmbël, i shtrëngoi fort dorën dhe i tha:

— Organizata-bazë e Partisë dhe drejtoria e diskutoi sjelljen e pahijshme të inxhinier Qendros ndaj jush dhe vendosi ta dërgojë për riedukim një vit në një repart të uzinës sonë. Ju do të punoni në fonderinë e re të ndërmarrjes sonë. Për këtë s'do të keni asnje pengesë.

— Ju falemi nderit për ndihmën që po na jepni!

— Ç'thoni ashtu? E kemi për detyrë t'ju ndihmojmë, ju po luftoni për një çështje shumë të rëndësishme. Kjo na preokupon edhe ne.

Ata i shtrënguan fort dorën njëri-tjetrit. Arbeni s'po e fshihte dot gjëzimin e tij. «Ja, ky është solidariteti i klasës, shpirti i klasës!», — pohoi ai me vete.

Ishte një ditë plot diell. Arbeni po ecte me hap të shpejtë. E ndiente veten të lehtë si një pupël.

Margarita e pa Arbenin kur ai po kapércente në kthesën e gjysmëharkut. Ajo nxitoi hapin që ta zinte para se të kalonte në bulevardin e gjërë.

— Je bërë shurdhaman, — i tha ajo. — Si duket puna në fonderi të paska mbushur kërmijtë e veshëve me pluhur. Të thirra kaq herë, por më kot!

— Më fal, se nuk të kam dëgjuar!

— S'ka gjë, po desha të të flisja për projektin e plotë të makinës së gjuhëzës. Vallë ai është kaq i plotë saç fli-tet?

— Sigurisht!

— Nuk ka asnjë mungesë?

— Asnjë mungesë! Për këtë çështje unë kam punuar së bashku me Alqi Katron. Nuk besoj që ai të ketë gabuar!

— Keni punuar vetëm ju?

— Jo. Kemi bashkëpunuar edhe me Mihën. Pse çfarë ka ndodhur?

— Asgjë! Po, në qoftë se keni nevojë për ndihmë, thashë që të interesohem, se çështja e projektit është te-për e rëndësishme.

— Të falemnderit, Margarita. Ti na ke ndihmuar shumë me gjetjen e Naumit. Ai ka vullnet të çeliktë e duar të arta.

— Nga xha Naumi mund të përfitosh shumë.

— Nga usta Naumi ke ç'të mësosh në çdo drejtim.

#### 4.

Anastas Kitara kishte hipur në bankën e madhe të ofiqinës dhe me kitarën varur në qafë po i shqepëtë së qeshuri të gjithë punëtorët e punëtoret e ofiqinës që po bënin pushimin e drekës.

- *Stefan, Stefan,  
pa eja pak këtu.  
Jam Burbuqja  
faqeikuqja,  
me shtëpi e katandi,  
mermë nuse ti!*
- *Ah, moj Burbuqe,  
mbushur me huqe!  
Nuk të dua shtëpinë,  
por dashurinë...*

E qeshura sa vinte shtohej më shumë. Të dukej sikur tundej ofiqina.

— Pushoni, pushoni, po fillon Anastasi!, — tha dikush. Ra qetësia.

*U ngrit një punëtor,  
dhe bëri propozim:  
— Këtu, o shoku inxhinier,  
ka vend për modifikim!*

— *Pusho, o teknik,  
kokën si shinik,  
këtu e kam fuqinë,  
si kryemekanik!*

*E kryemekaniku  
tendencia sovjetiku  
mbeti i shtangur  
nga shpikja e shinikut!...*

Filluan tē këndonin kupletin që Anastas Kitara e kishte ndërtuar vetë dhe që oficina e këndonte pér punën e Arben Korgës.

— Pushojeni atë djallo këngë!, — thirri Vasil Dishnicëa dhe e vështroi vëngër, tē gjithë grupin e tē rinjve, pastaj ia mbërtheu sytë e inatosur Valentinës së brishtë.

— Ishim mirë e bukur dhe, ja, erdhët ju dhe u vutë tē gjithave pishën! Ku është puna e mekanikut pér duart e brishta tē vajzave?

— Ç'ke me vajzat, ato nuk tē bënë gjë?!, — u doli në krah atyre Koço Opingari?

— Nuk bëjnë gjë! Nuk e sheh se u harlisën djemtë si mos më keq dhe ja ku e ke këtë llozin me kitarë që si një këndes Berati hipën mbi tavolinë si në qymez dhe ia thërrët këngës ki, ki, kiu!

— Në orar tē pushimit janë!

— Kështu thua ti, Koço Opingari, por orari i pushimit nuk është pér tē vënë prestigjin e tē tjerëve në lojë!..

— Vëri fré gojës, o Vasfi, se ne s'po vëmë në lojë prestigjin e tē tjerëve, këtu po përqeshen konceptet frenuese.

— Këtu po vihen në pozita qesharake inxhinierët tanë tē nderuar.

Dialogun midis Koço Opingarit e Vasfi Dishnicës e prishi përsëri Anastas Kitara.

*Usta Vasfiu, bre vëlla,  
ish cirak u bë usta,  
kapital na vuri shumë,  
treqind kunguj përmbi lumë...*

Salla oshëtiu nga tē qeshurat.

— Çfarë bëhet këtu xhanëm? — Në oficinë kishte hyrë si hije Nesti.

— Përqeshin tē tjerët, shoku shef i llogarisë. Nuk ka-në turp! Dhe me kë tallen? Me njerëzit e nderuar. — Vasfiu fliste me zemërim tē papërmbytjurt.

— Kush tallet me ju, o Vasfi?

— Ja, ky këtu. — Ai tregoi me dorë Anastas Kitarën!

— Ju! — Nesti e vështroi vëngër.

— Nuk është e vërtetë. Ai shpif.

## 5.

Në fonderinë e re të uzinës mekanike kishte vajturi një grup shokësh për të vështruar derdhjen që po bëhej nga usta Naumi e Arbeni. Ata vështruan me kureshtje derdhjen e metalit të zjarrtë e të lëngshëm në vrimëzën e formës së trupit më kryesor të toraksit të makinës së gjuhëzës.

Naumi me fytyrë të pluhurosur ndezi një cigare dhe u buzëqeshi atyre që kishte pranë.

Kaluan dhjetë minuta. Ra një heshtje e thellë. Sekretari i partisë, Petriti, i doli në krah Naumit e Arbenit. Që të tre e kapën me ganxha dhe e tërroqën modelin, duke e ngritur ngadalë e ngadalë e ja së fundi i gjithë toraksi doli në jetë si ta nxirrnin nga barku i dheut. Të gjithë i afroan kokat dhe e vështruan me kureshtje.

- Mrekulli!
- Derdhje fantastike!
- Kjo nuk është derdhje, por art!
- Duart e arta i ka usta Naumi.
- E ka hak yllin e artë!

Arben Korça nuk përmbahej nga gjëzimi. Nuk po e ndiente lodhjen nga puna që kishte bërë tërë atë ditë në fonderi së bashku me usta Naumin. Tani ishte pushtuar nga emocionet. Duartrokjet dhe urratë e punëtorëve të fonderisë, që shpërthyen papritmas, si usta Naumin dhe Arbenin i bënë me krahë.

Me atë derdhje ata kishin arritur të rrëzonin mendimin e gabuar të inxhinier Stefan Grabovës, që iniciativën e Arben Korçës e kishte quajtur një èndërr në diell.

Arbeni as që po e kuptonte se si po iknin orët e punës pa i ndier. Vetëm kur filluan t'i bërtisin zorrët u kujtua të vështronte orën. Ajo shënonte tre pas dy mbëdhjetës. Fshiu duart me përparrëse dhe vajti në mensën e punëtorëve për të ngrënë. Lau duart me sapun dhe zuri vend në një tavolinë në cepin e fundit. Ajo ishte e pastër.

Manushaqja i vuri përpëra një makaronë dhe një mish me lakra. Po ajo nuk harroi ta qortonte përsë ai

gjithnjë vinte me aq vonesë, kur në mensë kishte mbetur vetëm fundi i kazanit. Ai tundi kokën, po nuk foli. Dukej se mendja po i bluante gjetkë.

— Të bëftë mirë, Arben trimi!, — i tha Dhosi.

— Falemnderit, xha Dhosi. Ulu të pimë një kafe. — Dhosi e pikasi se Arbeni ishte pushtuar nga një gëzim i papërmabjatur.

— Të shoh shumë të gëzuar, apo më bëjnë sytë, Arben?

— Po, xha Dhosi, sot derdhëm të gjitha pjesët e gjoksit të makinës së gjuhëzës.

— Dhe atë që ishte më e vështira?

— Edhe atë arritëm ta derdhim, xha Dhosi.

— Ju lumshin duart, hallall e paçi bukën, tani jeni në pragun e fillimit të montimit të tyre, apo jo?

— Ka akoma shumë punë. Kërkohet një punë shumë e kujdeshshme për tornimin e vetë skatullave të trupit të makinës së gjuhëzës. Pastaj mund të fillojmë nga montimi.

— Paska pasur të drejtë inxhinier Stefani që s'ia mbante t'i futej kësaj pune.

— Ai s'kishte aspak të drejtë.

— Kështu flet, por ti e di, Arben, se ç'telashe po heq dhe akoma nuk ke nxjerrë gjë në dritë!

— Mos u nxito, o xha Dhosi. Pa telashe s'bëhet asgjë, jo më të thyesh konceptet frenuese, mosbesimin në forcat tona.

— Për vullnetin, këmbënguljen dhe besimin e patundur që ke në forcat e tua, të marr dorën.

— Jo në forcat e mia, po në forcat dhe në aftësinë krijuese të klasës punëtore, xha Dhosi.

— E drejtë, e drejtë, por, kur inxhinier Stefani thotë «s'bëhet» e ti thua bëhet, po nuk arrite t'i dalësh në krye, dije se bota do të qeshë me ty, ama!

— Të jesh i bindur pra se kjo do të bëhet se s'bën! Atëherë ç'do të thonë bota?

— Ty, Mihos, usta Naumit, Alqi Katros, Koço Opingarit e të tjerëve, që po bëni këtë mrekulli, do t'ju rrabin supet kurse inxhinier Stefanit dhe ndonjërit që i shkon pas, do t'u thonë: «U rroftë diploma!».

## KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

### 1.

Tori Pini së bashku me Alqi Katron u takuan rastësisht me inxhinierët Qendro Kolonja dhe Stefan Grabova. Ishte një ditë e vrenjtur. Gjithë sfondi i qiellit ishte nxirë nga retë e ngarkuara që po bridhnin me shpejtësi pa ditur se ku do të shkarkoheshin.

— Vërtiten retë e zeza, nuk dinë se ku të shkarkojnë barrën e tyre, — i tha Tori Pini Alqi Katros, — po do të ishte një shëtitje e mrekullueshme në bregdetin e Adriatikut apo të Jonit.

— Kurse mua më pëlqen më tepër këtu në këtë bufe të pastër, sepse e ndiej afshin e ftohtë brisk që retë po e sjellin nga deti i egërsuar, — tha Alqi.

Tori Pini nuk foli asnje fjalë. Ja, pikërisht ky dialog po e tërhiqte nga kapistra mendjen e tij që po kulloste nëpër dallgët e kërleshura të detit. Një kohë e tillë gjithmonë atij i sillte ndër mend detin e egërsuar. E kishte një dobësi të tillë që shpeshherë habiste dhe ata shokë që ua tregonte sekretin e shpirtit të tij. Deti që i ngrinte dallgët përpjet dhe i lëkundte anijet e mëdha duke u trazuar zorrët pasagjerëve, por që detarët s'donin t'ia dinin, Tori Pinit i shkonte për zemër. Atij i vinte inat që nuk ishte bërë marinar e të nënshtonte detin siç nënshtonte copkat e mbeturë të stofit.

Në këto mendime ishte Tori Pini kur ndeshi në vështrimin pingul të Stefan Grabovës dhe të Qendro Kolonja.

njës, që po çonin nga një konjak në tavolinën përbri dhe po bisedonin në intimitet me zë të ulët.

— C'të reja kemi, o Tori? — pyeti Stefani. — Se po më dukesh si tepër i preokupuar. Sigurisht për ndonjë shpikje a racionalizim e lodh mendjen, ë?

— Edhe bufi e di që më lehtë është të thuash kjo apo ajo nuk bëhet dñe të mos e vrasësh mendjen për asgjë, kurse ata që kanë besim në forcat e veta, më parë vrasin mendjen e thonë bëhet, dhe fjalën e bëjnë realitet.

— Unë nuk e kam zakon të them «hopa» pa kapërcyer kanalin, o i dashur Tori, se premtimet e mëdha të bëjnë qesharak!...

— Po mos harro, inxhinier Stefani, se populli thotë se, një ujë që s'ecën, nuk pihet.

— Edhe atë e kam dëgjuar.

— E keqja është se nuk ke përfituar prej saj.

— Do ta kem parasysh këshillën tuaj, — ironizoi Stefani, kurse Qendro Kolonja picërrroi sytë.

— Jo këshillën time, po realitetin e kohës. Hë, mo inxhinier Stefani! Luaj vendit. Vëri gishtin kokës. A s'po e sheh se ç'po bën klasa punëtore, shokët e tu inxhinierë, teknikët e me radhë, ë?

— Unë mendimet e mia i mbështes në shkencë, o babaxhan, se e di që pa krahë nuk fluturohet.

— Ti je si qyqja, gjithmonë vezët i le në foletë e shpendëve të tjerë, sepse je i pazoti për t'iu futur novacioneve e racionalizimeve. Kur Atdheu kërkon nga secili të vrasë mendjen, ti mjaftohesh me teorizime.

— I dashur Tori, ty s't'i marr për keq as këshillat, as kritikat, sepse je autor i disa racionalizimeve të dobishme dhe je kuadër me nivel shkencor, — e zbuti bisedën Stefani, — por disa që s'kanë as minimalen e kulturës dhe ngrenë zërin në kupë të qiellit dhe premtojnë shpikje nga më të komplikuarat, nuk durohen.

— Fjalën e ke për Arbenin, Mihën, Koçin etj., po dije se gabohesh.

— Ndoshta, ndoshta!..., — e mbylli bisedën Stefani dhe fshiu buzët e holla me shaminë e verdhë që nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës dopiolet.

## 2.

Pas derdhjes së pjesëve dhe të detaleve të makinës së gjuhëzës, Arbenin e priste një punë tjetër e vështirë. Ato duhej t'i nënshtroheshin një për një axhusterisë.

Në vështrimin e parë, axhustimi të dukej një punë e thjeshtë dhe fare pa rëndësi. Por nuk është ashtu. Një profan që e vështron axhustatorin me një limë në duart që ha metalin e detalit, i shkon mendja se ja së fundi dhe ai gjeti një punë të lehtë siç është ajo e limimit dhe se tani, me të marrë limën në dorë, gjithçka do të shkojë si në vaj dhe detali është gati për punë. Por Arbeni e dinte se për këtë gjë duhet të jesh një mjeshtër i përsosur i limës, dhe me një durim të përsosur për të nxjerrë nga lima një sërë detalesh që zor ta besosh se mund të jenë bërë nga duart e njeriut.

Arbeni vështroi pircun e madh të detaleve që ngriheshin në qoshen e madhe të tavolinës së punës. Nuk ishin pak, gjithë ata gjymtyrë të habitshëm me lloj-lloj formash e madhësish. Vallë a do të kishte ai aq energji sa të mbaronte axhustimin e tyre?

E diel! Ditet pushimi. Arbeni ndodhej në repart. Po e lodhë mendjen për axhustimin e detaleve, kurse Sofia me siguri do të kishte ndezur zjarrin në ashef dhe do të grindej me veten e saj duke qortuar Arbenin që kthehej vonë në shtëpi dhe s'po i mbushej mendja të vente ujin në zjarr për t'u martuar.

Grüpë të rinjsh nga kombinati kishin mbushur torbat me ushqime, dhe me rrjeta nëpër duar kishin filluar atë marshim të gjatë mes shpatit të malit që ngrihej përpjetë mbushur gjithë oksigjen të pastër, pisha dhe bukuri të rrallë.

Ja, sa të mbaronte premtimin e dhënë, dhe ai do të pushonte, do të kompensonte gjithë gjumin e humbur dhe pastaj të dielave do të ngrihej përpëra se agu i ditës të merrte fluturimin për në kupë të qiellit. Kështu, për dore me Margaritën do të ngjitej lart në mal.

Përpëra tij ishte detali dhe pirgu i miellit të metalit

që kishte axhustuar. Iu mpinë duart dhe ndjeu se po i dhimbnin, por nuk donte ta linte punën.

U hap porta. Arben Korça i qetë e vështroi Mihën që hyri me rrobat e punës. Midis tyre u ndez një bisedë e gjatë dhe e ngrohtë. Arbeni nuk e ndiente lodhjen që i kishte mpirë krahun.

— Sot do të vij të ha lakrorin nga ju, Arben!, — e filloi bisedën Miha hokatar e gojëmbël.

— Nëna ka vënë mish me fasule! — iu përgjigjë ai.

— Për ato s'dua të të shpenzoj.

— Unë i ha shumë!, — ia priti Arbeni dhe e vështroi me dashamirësi.

— Ti punon me orë të zgjatura dhe lodhesh shumë, Arben.

— Si të tjerët, — tha Arbeni duke limuar detalin me kujdes.

— Unë sot kisha vendosur të pushoja, po, kur mora vesh se ti ke ardhur për të punuar, s'm'u bë të rrija. S'desha të të lë vetëm.

— Bëre mirë që erdhe, se pata filluar të mërzitesha, bile më vajti mendja për keq. Thashë, ja të tjerët pushojnë, dëfrejnë, kurse unë...

— Vështirësinë kryesore e kaluam, konceptin e gabuar «s'bëhet» e kemi tronditur.

— Ashtu është, por konceptet e gabuara mund t'i thyejmë vetëm kur të kemi arritur prodhimin e gjilpërës, Miha!

— Ke të drejtë, Arben, por shëndetin duhet ta ruash me kujdes se populli thotë: «Ai shkon me okë, po vjen me derhem».

Në oficinë u fut Anastas Kitara. Ja një rast i veçantë që ata të dy nuk e prisnin.

— Çfarë ere të fryu xhanëm këndezaj?, — pyeti Miha.

— U mërzita në shtëpi, kur nuk shkova njëherë, i thashë vetes, të vështroj se çfarë bëhet andezaj, dhe erdha.

Nuk kishin kaluar as dhjetë minuta kur në repart u fut me nxitim, si të ishte vonuar në punë e jo në ditë pu-

shimi, Koço Opingari. Ai për pak u pengua në gjithë ato detalet. Hoqi xhaketën dhe e vuri në gozhdë dhe filloj nga puna pa e ngritur kokën.

Arbeni, Miha e Koçoja si në garë me njëri-tjetrin po limonin detalet pa ngrtiur kokën dhe pa këmbyer ndonjë fjalë. Punuan deri në orën dy mbas mesditës. Pirgu i detaleve të dukej po ai që ishte. Duheshin ende forca më të mëdha, më të shumta që punët të shpejtoheshin. Por ku t'i gjenin ato forca të specializuara?

— Të kishim dhe nja dhjetë axhustatorë të kualifikuar që ta shpejtonin procesin, se kështu do të vonohemi.

— Ku t'i gjejmë, Miha vëllai?

— Shkolla mekanike mund të na ndihmojë në këtë drejtim, — tha Miha. — Nxënësit e vitiit të tretë e të katërt bëjnë punë me cilësi.

— Vallë do të jemë të gatshëm?, — pyeti Koço Opingari.

— S'kanë për t'u kursyer. Ata kanë marrë gjithë ato iniciativa revolucionare për të ndihmuar fshatin. Bile do ta quanin detyrë të kontribuonin për linjën e gjilpërës që çan bllokadën.

Biseda e tyre u ndërpren kur në derë u dha Kopi. Drejtori, i veshur me kostumin e ri, dukej që nuk ishte nisur enkas për të parë punën e tyre. Ai ndoshta ishte përgatitur për të dalë shëtitje me bashkëshorten ose për ndonjë vizitë dhe ja si rastësisht kthehet dhe vështron një herë se si shkojnë punët në oficinë. Por Kopi nuk është nga ai brumë njerëzish që vështrojnë me sytë e qetë rrjedhjen e ngjarjeve. Jo! Ai dhe në kohën e pushimit ka merak se si shkojnë punët në kombinat. Jeta e tij është lidhur e bërë njësh me jetën e kombinatit dhe nuk shqiptej dot prej saj.

— Eja, eja këndezaj nga ne, Kopi, — e ftoi Miha që i doli përpëra duke qeshur.

— Punoni edhe të dielën, ë? — Kopi ishte i ngazëllyer nga që të gjithë punëtorët ishin bërë njësh si një grusht për çështjen e linjës së gjilpërës. — Ju lumtë, ju lumtë, po q'e do, s'ia them dot edhe unë limës.

### 3.

Arbeni ndihej aq i gëzuar, saqë nuk e mbante vendi. Ai tërë shend e verë i tha s'ëmës se edhe pak ditë e makina e gjuhëzës do të përfundonte.

— Shyqyr, or bir, se e harrove veten, — tha Sofia dhe e vështroi si me lutje.

Arbeni e dinte se ku i rrihte asaj, po nuk foli. Jashtë shkëlqente hëna. Ai ra në mendime. E gjykonte veten në një gjyq të heshtur dhe të fortë. Mos vallë i ka shkuar mosha dhe pastaj, kur ai të kujtohet, do të jetë shumë vonë? Numëroi shokët e tij bashkëmoshatarë dhe për habi të gjithë i dilnin të martuar me përjashtim të një shoku që punonte mësues në një fshat të largët. Mendja e çoi te bisedat e buzëqeshjet eëmbla, te debatet e ashpra që kishte shkëmbyer me të e pastaj te shëtitjet e këndshme dhe miratimi i mendimeve të tij që i kishte bërë Margarita me tundjen e kokës.

Sofia ngrihej qysh në orën katër pas mesnate. Ajo e dinte që i biri shkonte herët në punë. Kishte mësuar prej tij gjithçka e shqetësonte atë dhe mendonte kohën që kur ai u fut në atë valle të furishme dhe me pikëllim psherëtiu. «Eh, si fluturojnë ditët, javët e muajt, stinët, viti! E ja, kaluan dy vjet, të duket çudi. Të tjerët, duke dashur të më trembin, thonë: «Kanë kaluar dy vjet dhe akoma s'po shohim asgjë».

«Dy vjet!...»

Kishte duruar gjithë këtë kohë të gjatë. Ja, tani nuk kishin mbetur më shumë se disa ditë që gjithçka të dilte në dritë e të mbyllte gojët e këqija. Arbeni kishte një nënë, që tani e kuptonte, por ajo si nënë priste dhe një gëzim tjetër që t'ia ngazëllente shtëpinë.

— Fli dhe pak, je ngritur shumë shpejt!

— Jo, nënë, bile jam vonuar.

Sofia ngriti vetullat lart me habi. «Ora nuk ka vajtur pesë dhe thotë jam vonuar!».

— Të kam vënë dhe dy-tri kokrra mollë, — i tha ajo kur i dha torbën me ushqime.

Arbeni mori torbën e doli përgjumshëm. Sofia e vështroi nga dritarja gjersa ai kaloi bërrylin e rrugës.

#### 4.

Puna ndoshta do të kishte ecur më shumë dhe makinë e gjuhëzës do të ishte gati, në qoftë se nuk do të kishte ndodhur një avari e paparashikuar qysh në furrën e temperimit të uzinës së prodhimit të pjesëve të këmbimit të traktorëve në Tiranë.

Arben Korça kishte udhëtuar me një kamion të spacionit që ia kishin dhënë në dispozicion për të shkuar në Tiranë. Inxhinieri që merrej me shmangien e difektit të furrës elektrike, një djalosh i ri që kishte mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, e priti me përzemërsi dhe u tregua i gatshëm për temperimin e detaleve sa më parë, duke e quajtur detyrë të rëndësishme. Por skraparliu u bë kureshtar kur pa gjithë ato pjesë të imëta që s'ia kishte zënë syri ndonjëherë.

— C'janë të gjitha këto vegla të brishta?, — pyeti ai Arbenin.

— Janë veglat e një makine, të cilën po e ndërtojmë për herën e parë në vend, është një makinë e ndërlikuar.

— Kush është autorë?

— Është një kolektiv autorësh, është vepër e vetë kolektivit tonë.

— Nuk më tregoni, përse duhet kjo makinë?

— Për prodhimin e gjilpërave, pa të cilat makinanat e trikotazhit mbeten në vend numëro.

— Mrekulli. I lumtë, i lumtë kolektivit tuaj!

Ishte fundi i vjeshtës së parë. Tirana gumëzhinte nga zërat e kalimtarëve të ndryshëm që vërshonin për nga qendra. Autobusët urbanë të mbushur plot e përplot kalonin njëri pas tjetrit.

Arbeni vështroi me ngulm monumentin e heroit

tonë kombëtar. Kalorësin e pa nga poshtë dhe çuditërisht u habit nga vështrimi tejpamës dhe nga krahу i fuqishëm i Skënderbeut.

— Një fotografi përballë Monumentit të Skënderbeut do të jetë një kujtim i rrallë dhe i bukur për ju. Prej nga jeni? — i foli fotografi, një burrë rreth të pesëdhjetave.

— Ju falem nderit, por unë nuk banoj në Tiranë dhe nuk kam mundësi t'i tërheq fotografitë.

— Foto «Natyra» nuk i shërben vetëm kryeqytetit, por gjithë klientëve të Republikës. Na lini adresën dhe fotografitë jua dërgojmë në vend.

Arbeni, pasi bëri dy poza dhe futi biletën në xhep, vajti në drejtim të rrugës «Bajram Curri», por ndërroi rrugë. Vendosi të vizitonte Pallatin e Kulturës.

Vështroi orën e madhe që ngrihej përparrë syve të tij majë kullës së lartë dhe u habit që akrepat tregonin orën dy. Vajti për të ngrënë drekë në restorant «Vjosa». Aty gjeti Mihën dhe Kopin, të cilët i kishin thirrur në ministri së bashku me Arbenin për problemin e makinës së gjuhëzës. Arbeni u fut në mendime të thella. E ç'do të thoshte në ministri! «Ata s'duan të dëgjojnë për pengesat, por duan rezultatin...», — mendoi ai.

## KAPITULLI I PESEMBËDHJETË

### 1.

Kopi, Miha dhe Arbeni mëngjesin e hëngrën pa oreks. Edhe natën kishin dremitur, jo ngase patën ndërruar vendin e fjetjes, por nga preokupimi për çështjen e makinës për prodhimin e gjilpërës, për të cilën i kishin thirrur në ministri. Secili se q'po bluante në mendjen e vet.

— Q'po mendohesh, o Miha?, — prishi heshtjen e rëndë Kopi.

— Mendoja për gjilpërën!

— Për gjilpërën, ë?, — theksoi Kopi dhe vështroi Arbenin.

— Sigurisht, ajo na solli deri në ministri. Pak të duket kjo, shoku Kopi?

— Jo, por ende është shumë shpejt për t'u lavdëruar për rezultatet e saj. Mua më ha fjala e thënë nga inxhinier Stefani.

— Qfarë ka thënë ai?

— Ai ruan mendimin e tij që shfaqi që në fillim në këshillin teknik.

— Me rezultatin që do të arrijmë edhe ai do të bindet më në fund se ishte i gabuar, — tha Miha.

— Kurizon vetëm varri e ndreq, — tha Arbeni i vrenjtur.

— Arben, mos u nxito në mendime!, — i tërroqi vëmendjen Kopi dhe vështroi orën. — Ejani të shkojmë, se në orën dhjetë duhet të jemi në ministri.

## 2.

Njëzet marsin e viti 197... Arben Korça e tiposi në mendje për të mos e harruar kurrë. Ishte një ditë e përhime. Ftohtë, një të ftohtë i hidhur që vinte nga qafa e malit që zbardhët nga dëbora dhe nga toka e ngrirë e bërrë kallkan. Sido që gjithçka në natyrë ishte ngrirë, si një bllok i vetëm, në oficinë gjithçka ishte në rregull. Arbeni kujtoi natën e ditës së djeshme që iu duk aq e gjatë. Ai së bashku me Koçon e Mihën kishte punuar deri në orët e vona të natës dhe vetëm kur kishin ngritur në këmbë makinën e gjuhëzës, ata, të mbështjellë me shalle leshi e xhupa të trashë, kishin dalë nga oficina. Të nesërmen, më 21 mars, vendosën të bënин provën e parë.

Edhe pasi vajti në shtëpi, nuk po i ikte nga mendja ajo hija që kishte lëvizur në njëmbëdhjetë të natës përreth oficinës. Ai kishte hedhur xhupin e trashë dhe ishte hedhur përjashta, por s'kishte kapur asgjë veç dëborës, që e përplaste era me furi. Ishte futur brenda, por as Mihës, as Koços nuk u kishte folur për dyshimin që i pat lindur. Mendja i vajti te zjarri që kishte plusur më parë në oficinë dhe shigjetat që qenë drejtuar atëherë drejt tij. I shkuan mornica në trup, po nuk foli, vetëm mbloodi pëllëmbët e tij grusht.

Gjumi s'po e zinte. Po vërtitej në krevat, por tani që ata ishin përpara provës së makinës së gjuhëzës padashur mendja i vajti për keq. «Po sikur prova të mos na dalë me sukses, ku do të futemi? Si do të dal përpara kolektivit, qytetarëve të qytetit tonë që e kanë marrë vesh, lëre më para ministrisë. Caktuam edhe afatin e provës!...».

## 3.

Ishte fillimi i marsit. Inxhinier Stefan Grabova i vajti në shtëpi Vasfi Dishnicës, i cili banonte në periferi të qytetit.

Vasfiu e priti mikun e tij në dhomën e madhe të

shtruar me qilim të kushtueshëm e të pajisur me kolktukë të rëndë.

— Rakinë e paske shumë të mirë, o Vasfi, — i tha Stefan Grabova posa e largoi gotën nga buzët.

— Ballë kazani, për miq të veçantë, — ia ktheu Vasfiu dhe hetoi reagimin e Stefanit, që rrinte i zhytur në mendime.

Vasfi Dishnicës i kujtohet e kaluara, pushkatimi i të atit nga partizanët, largimi në një vend tjeter,jeta e tij në qytet duke përbiruar si urithi nën dhë.

Punoi i heshtur duke mbajtur një mbiemër tjeter dhe gjithnjë veshët pipëz e mendjen të ngritur çark, duke endërruar që një ditë të përdorte mbiemrin e tij të vërtetë.

Vasfi Dishnicës iu kujtua ajo natë me furtunë. Oficina e vetmuar dhe thikat e vidiove të prishura. Ai po shkonte për t'u çlodhur. Ishte i kënaqur që diçka i kishte prishur këtij pushteti, diçka kishte marrë hak për shpirtin e babait, që i shfaqej në gjumë duke i kërkuar që të mos rrinte duarlidhur, por të hakmerrej.

— Ti kështu, Vasfi?! — i kishte thënë Stefan Grabova.

— Jo, inxhinier, por..., — atij i ishte marrë goja dhe kishte ngrirë në vend. Ishte zverdhur dyllë. Iu duk sikur ia vunë hekurat. Tmerri i kishte kyçur nofullat.

— Sa dinak që qenke! Si kështu po i flak vidiot e shtetit?

— Në dorën tuaj, inxhinier!

— Zhduku, pastaj do të bisedojmë....

Këtë skenë dhe bisedimet që kishte bërë pastaj me Stefanin po shkonte nëpër mend Vasfiu kur tokën gotat.

— E sheh që punën e kanë vënë në vijë dhe po i afrohen rezultatit?, — pyeti Stefani dhe e mbërtheu me vështrimin e tij.

— E shoh, inxhinier dhe, sado që po e vrash mendjen, s'po e gjej dot se si të veprojmë që t'i lëmë me gisht në gojë!

— Në teknikë gjithçka mund të ndodhë. Ja, për shebull, thyhet një ingranazh!...

— E pastaj?

— Që të thyhet e gjithë skatulla e makinës së gjuhëzës nuk duhet asgjë më shumë sesa një kokë videoje prej çeliku mangani 65, — shpjegoi Stefani, që dukej sikur lexonte ndonjë monolog të Makbethit. — Jo për të të bërë qejfin, por ty, Vasfi Dishnica, nuk ta ha dot qeni shkopin! Këtë detyrë duhet ta kryesh se s'bën.

Vasfi dukej si i ngurosur, por nuk kundërshtoi. Stefani mbushi gotat dhe ngriti një shëndet për të zotin e shtëpisë.

— Gëzuar, inxhinier Stefani!, — u përgjigj Vasfiu me fytyrën meit e të shtrembüuar.

— Për Arbenin, Mihën, Koçon e kompani mos i kurse lëvdatat, kurse në anën tjetër thuaj «Ja, jeta po vërteton se inxhinier Stefani nuk kishte të drejtë». Këtë do ta them edhe unë pa ngurruar, se puna na e do që, përpara se të hedhim gurin, të mendojmë njëqind herë se si ta fshehim dorën...

#### 4.

Vasfi Dishnica gjithë ato ditë kishte derdhur vështrimin e tij në detalet e makinës së gjuhëzës që punoheshin me kujdes e durim të rrallë. Ai vëzhgonte gjithçka që e rrethonte në oficinë. Me kujdesin e tij tinzar vërejti se ku liheshin detalet më të rëndësishme, më të komplikuara. Mësoi dhe qoshen ku vendoseshin arkat me vidhat e veglat, që nga madhësia nuk ua kalonin atyre të orëve të dorës.

Kur makina u montua dhe mori pamjen e saj të plotë, ai as që u tregua kureshtar siç po bënin të tjerët.

Njerëzit ishin kureshtarë dhe donin ta shikonin me sy dhe ta preknin me dorë atë makinë që do të prodhonte gjilpërat, por drejtor Kopi kishte urdhëruar që askush, përveç punonjësve të oficinës, të mos futej në oficinë. Urdhri i dhënë nga drejtori Vasfiut i ra si bombë. Të nesërmend, më 21 mars, do të bëhej prova përfundimtare.

«Sonte do ta provoj unë, nesër ju do t'ia mblidhni

kockat..», — pëshpëriti ai me vete dhe tërë ditën punoi kokulur e pa i kthyer sytë nga makina e gjuhëzës. Mbas-dite Vasfiu u largua në orarin e caktuar duke lënë aty Arbenin e të tjerë. Në orën shtatë të mbrëmjes iu afrua oficinës nga prapa. Hipi mbi fuçitë boshe të hedhura e të flakura pas oficinës. Arriti te dritarja që kishte pikasur më parë, por desh ra. Vështroi brenda dhe ndeshi në ftyrën e hequr të Arbenit. Kështu ai qëndroi gjatë dhe, kur Vasfi Dishnica lëvizi, Arbenit i ra në sy një hije dhe një krismë e lehtë.

Arbeni doli përjashta dhe përgjoi, po nuk ndjeu asnjë, kurse Vasfiu ishte struktur në një fuçi. Ai ndjeu frymëmarrjen e Arbenit, hapat e tij të ngadalshëm që u larguan duke bërë plluq, plluq.

U sigurua se nuk kishte njeri në oficinë. Përgjoi rrith e rrotull, nuk dëgjoi gjë. Iu afrua portës, nxori çelësin kopil, por, kur vërejti se porta ishte me dy dryna «Tutius», shtrëngoi nofullat dhe mallkoi veten që nuk i kishte vajtur mendja. Vështroi përreth, nuk pa njeri. U largua me hap dhëpre dhe nxitoi që të dilte në rrugën kryesore. U gëzua që po binte déborë me furi dhe nuk linte asnje gjurmë. Vetëm kur u fut në shtëpinë e tij, ndjeu se po i shkrinte gjaku, por zemra ende po i rrihte me furi.

Vasfiu tërë natën nuk shtiu gjumë në sy. E si do t'i thoshte Stefanit që ia kishte vënë të dyja këmbët në një këpucë? Doli herët dhe shkoi te baraka e qoshes që frekuentohej që nga ora gjashtë e mëngjesit e deri në dhjetë të mbrëmjes.

Vasfiu u tregua i qetë, i qeshur e dorëlëshuar. Kjo u ra në sy edhe të tjerëve.

— Po me ndërtimin e asaj linjës së gjilpërës, ç'po bëhet o Vasfi?, — e pyeti shofer Kiçoja.

— Në prag të suksesit jemi, — tha Vasfiu.

— Vërtet thua, apo?...

— Vërtet. Pse ç'pandeh ti, se mos rrëshim ujë në havan si inxhinier Stefan, që thotë s'bëhet, a?

— Ju lumtë, ju lumtë!

— I lumtë Arben Korçës që u bë iniciatori kryesor të thyejë konceptet frenuese, se deri vonë edhe unë mendova që inxhinier Stefani kishte të drejtë, por u binda që nuk kishte goditur në shenjë.

— Ke ndihmuar ti për linjën e gjilpërës?

— Me aq sa ma pret mua, nuk jam kursyer dhe s'do të kursehem.

— Po Stefani?

— E ka ndier ngurrimin e tij, por i vjen rëndë t'i për-ulet Arbenit me shokë.

— Domethënë ka lakra!...

— Lakra nuk ka, po helbete sedër profesionale ka, — tha Vasfiu me zë të lartë që ta dëgjonin edhe të tjerët përreth dhe vështroi orën.

## KAPITULLI I GJASHTËMBËDHJETË

### 1.

Në të gjitha repartet u shpërnda thirrja e komitetit të partisë së kombinatit. Thirrja ishte e qartë dhe shumë e thjeshtë. Miha Voskopoja nuk e pati të vështirë formulimin e saj. Të gjitha problemet që rritheshin në thirrje dhe shqetësimet që trajtonte ajo, patën dalë nga mbledhjet e zjarra të organizatave-bazë të partisë nëpër reparte. Miha Voskopoja së bashku me Kopin nuk lanë mbledhje të tillë pa marrë pjesë e u habitën për gjithë atë shpirt sakifice dhe për entuziazmin që pat shpërthyer në të gjitha organizatat për linjën e gjilpërës. Besimi që kishin ato në realizimin e kësaj ndërmarrjeje shumë të guximshme e shumë të rëndë, i vinte në pozita më luftarake, atje ku duhet të luftojë komunisti i vërtetë.

U vendos që thirrja të punohej në organizatat e bashkimeve profesionale dhe në organizatat e rinisë. Për këtë qëllim ishin instruktuar komunistët më të dalluar, që qëndronin gjithnjë në ballë të sulmit dhe nuk dinin të kthehen prapa.

Thirrja e komitetit të partisë ngriti peshë të gjithë kolektivin e kombinatit. Ajo u pasua nga ndërtimi i ashensorit të madh që do të shërbente për ngjitet e zbritjen e prodhimit. Atje Miha mbajti një fjalim të shkurtër tërë zjarr duke folur për përpjekjet e ethshme të revizio-

nistëve hrušovianë, titistë e të tjerë që së bashku me imperialistët e reaksionin botëror s'linin gur pa luajtur pér të sabotuar ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Stefan Grabova thartoi buzët. Vasfi Dishnica diçka i pëshpëriti Stefanit në vesh.

— Shët! Pusho!, — u përgjigj ai i ngrysur.

— Dëngla!

— Pusho! Shët!

Stefan Grabovës iu kujtua shefi i tij, Ipolit Matjeviçi, me të cilin e pat prezantuar Ljuba topolake. Ipoliti e pat qortuar përpara shefit të ardhshëm të spiunazhit «Qenkeni shumë guximtar, pëllumbi im, aq i guximshëm sa të puthësh vajzën e shefit të madh!». «Kushedi se ku është ai. Në Jaltë sigurisht. Po Ljuba? Ku vallë do të jetë Ljuba? Në djall le të vejë! Në qoftë se ajo nuk do të më qëndrojë besnikë, do ta braktis se s'bën! Pse pak vajza ka Rusia e gjerë, ë?...».

Mbas inagurimit të ashensorit të ri grupi i teatrit të kombinatit fitoi çmimin e parë në takimin e teatrove diletantë në rang Republike dhe kjo e bëri Tori Pinin që të gjithë javën të mos pushonte së lëvduari grupin që e kishte nderuar.

U prodhuan dhe hënxit<sup>1)</sup> e makinave qepëse. Jeta në kombinat po ziente si kurrë ndonjëherë. Brigada e të rejave të inderlogëve mori një zotim shumë të guximshëm. Ato premtionin se nuk do të nxirrin nga duart e tyre asnë centimetër stof skarco. Reparti i çorapeve iu përgjigj repartit të inderlogëve se ai nuk do të nxirrte asnë çorape skarco.

Manushaqja, si sekretare e komitetit të rinisë, nuk dinte se nga të shkonte më parë. Vetëm që ata të rintjtë e inderlogëve i patën pickuar keq të rejat e çorapeve kur u kishin thënë se «edhe skarco të jenë çorapet, ato nuk duken nga këpuca dhe se çorapet e tyre nuk do të mësohen dot kurrën e kurrës të rrinin në këmbë pa rrëzuar qafat!».

1) pjesë këmbimi për makinat qepëse

Kopi djersinte duke vajtur sa në një repart në tjetrin. Iu kujtua lodhja që pati ai njëherë që udhëtonte jashtë shtetit.

— Për të thyer konceptet frenuesse, ne komunistët duhet të krijojmë bindje të plotë te vetja jonë, pastaj duhet ti bindim njerëzit tanë, punonjësit me fakte të gjalla se klasa jonë punëtore, specialistët tanë, kuadrot tanë janë në gjendje të zgjidhin shkencërisht problemet e vështira dhe të prodhojnë me forcat e veta linjën për prodhimin e gjilpërave!...

Zëri i ngrohtë i Miha Voskopojës e zgjoi Kopi Nanushin nga èndërrimet, nga luhatjet e mëdyshjet që kishte pasur nga këmbëngulja e inxhinier Stefan Grabovës, i cili iniciativën e Arben Korçës e kishte quajtur «një èndër të bukur» e asgjë më tepër.

Kopi e hapi zemrën përpara shokëve të tij, përpara organizatës, dhe bëri autokritikë të fortë, aq sa ballin e tij të gjerë e kishin mbuluar djersë të ftohta.

Ishte natë, një natë e kthjellët, e qelli i veshur me yje. Në qytetin e qetë ata ecën krah për krah në heshtje. Ndiheshin hapat e tyre të rëndë.

— A të kujtohet ajo ditë që u plagosa? — pyeti Kopi.  
— Më kujtohet!

— Më shtrinë në një kapotë dhe nën kokë më vunë kondakun e automatikut.

— Ti shtrëngoje nofullat, por nuk ankotheshe nga dhimbjet!

— Unë kështu e kam zakon, Miha, kafshoj buzët e nuk ankohem, është një zakon që na e kanë lënë të parët, se me ankime nuk bëhet gjë.

Por qëllimi nuk është këtu, fjalën e kisha tek ajo natë që isha plagosur e ti më rrije pranë. Aq pranë, sa faqja jote e butë bashkohej me faqen time, sepse më mba je në supe, në supet e tua, Miha. E unë vështroja qielin. A e di ti, Miha, përsë vështroja qielin?

— Jo.  
— Eh! Miha, Miha! Vështroja yjet!...  
— Gjithnjë yjet mbeten ato që janë!

— Jo, Miha! Kam parë yjet që këputen, thërrmohen e shkrihen si pluhur!

— Natyra ka evolucionin e saj sipas ligjeve të brendshme të saj, shoku Kopi...

— Nuk e kisha fjalën aty, Miha, por te njerëzit, tek idealet e tyre, për të cilat luftojnë. Ja, atëherë në llogoret e luftës çlirimtare m'u gjete në krah, ja edhe tani po aq i thjeshtë, i dashur, i dhimbësur, bëre që unë të kuptoja gabimet e mia, të luftojë me forcë për t'i ndrequr ato, se, qoftë edhe një komandant skuadre, po s'qe i bindur për detyrën e tij luftarake, po s'pati besim të patundur në forcat e veta, të skuadrës që komandon, s'mund ta pushto-jë kurrë një kuotë të armikut...

## 2.

Kopi Nanushi i kishte të qarta vështirësitet e mëdha që do të ndeshte edhe në të ardhmen, por ama tani ishte i bindur se prodhimi i makinës së gjilpërës kishte marrë rrugë. Vendimi i komitetit të partisë të kombinatit për të bashkëpunuar me ndërmarrjet simotra i dukej i drejtë dhe tani po e vriste mendjen si e si ta kryente këtë detyrë që i ishte ngarkuar atij si komunist e drejtor.

Mbas debatit të ashpër që kishte pasur me Miha Voskopojën, drejtor Kopi gjithë natën nuk kishte shtënë gjumë në sy, por me cigare në dorë, ndiz e shuaj, e kishte zënë mëngjesi me gojën helm. U kishte hedhur një grusht ujë faqeve, kishte pirë një kafe të fortë dhe ishte nisur për në kombinat. Gjyqi i ndërgjegjes së një komunisti, kur ndizet në ndërgjegjen e tij, është i ashpër e shumë i fortë. Ai i ngjan një farke ku kalitet në kudhrën e Partisë vetëdija e tij duke pastruar nga ndërgjegjja të gjitha skorjet. Kështu po ndodhë dhe me Kopi Nanushin, që për një kohë u besoi mendimeve frenuese të inxhinier Stefan Grabovës, i cili iniciativën e Arben Korçës e quante vetëm «një dëshirë, një ëndërr të bukur me sy hapët!...». Kritika e fortë që i bënë shokët ia zgjoi ndërgjegjen e ai

gjyq i filluar në organizatë e vazhdoi rrugën e tij në punë, në shtëpi, në gjumë e kudo, sepse gjyqi i ndërgjegjes së një komunisti nuk pyet se ku ndodhesh e me se merrresh. Ky gjyq të kalit e të bën njeri me virthyte të larta komuniste. Kopi Nanushi e kuptonte që ai duhej të ishte shembelltyra e gjithë punëve të mira, që me shembullin e tij t'i tërhiqte të tjerët pas vetes.

Me të tilla mendime ai mbërriti në hyrjen e uzinës së re, që ishte ndërtuar vitet e fundit përbri oficinës së ri-parimit të traktorëve.

Gjithçka kishte ndryshuar. Tani nuk dukej më kisha e zymtë dhe kolibet përdhese. Vendin e tyre e kishin zënë ndërtesat shumëkatëshe, kopshtet e çerdhet e vogëlushëve, më në periferi kombinati, uzina...

Kopi Nanushit i kujtohet vogëlia, pastaj vitet e lutfës, rindërtimi i vendit, ndërtimi i veprave industriale, bonifikimet e me radhë.

— Urdhëroni, shoku Kopi!, — e ftoi drejtori i uzinës, një djalosh i gjatë, i cili i ofroi paketën dhe i ndezti cigaren.

— Kam ardhur për miell hua, shoku Isa.

— Urdhëroni!

— Kemi ngecur për prodhimin e disa detaleve të imëta që na duhen për ndërtimin e linjës së prodhimit të gjilpërës. Ndodhem përpara një prove të madhe për çarjen e bllokadës. Pérndryshe...

— Duhet të më kuptoni drejt, shoku Kopi, se ne jemi një ndërmarrje shumë e re dhe kemi vështirësitë tonë. Megjithatë ne s'do të kursehemi, se e kemi për detyrë. Për këtë çështje po bisedojmë konkretisht me kryeinshinierin.

U hap dera e zyrës dhe u dha kryeinshinieri, i veshur me rroba pune. Ai ishte një djalë i ri, i cili dukej se nuk i kishte kapur të tridhjetat.

Isai i tregoi shkurt **ndihmën** që kërkonte Kopi **Nanushi** dhe e porositi kryeinshinierin që edhe për këtë çështje duhet të preokupoheshin dhe ta ndihmonin për prodhimin e detaleve të linjës së gjilpërës.

— Shoku Isa, ju e dini që ne jemi shumë të ngarku-

ar me porositë e enteve, të cilat janë prapa nga plani i prodhimit, mbasi ka ndikuar edhe mungesa e çelikut.

— Ashtu është, inxhinier, po tani shtrohet çështja si mundemi ta ndihmojmë shokun Kopi, se këtu flitet për çarjen e bllokadës!...

— Detalet që kërkoni, — tha kryeinxhinieri, — janë shumë të vështira për t'i punuar. Ato kërkojnë një pre-cizion shumë të disiplinuar. Mjeshtrit më të mirë janë shumë të zënë me punë të planifikuara.

— Le të punojnë jashtë orarit, fundja pagesën e tyre e bëjmë ne, — tha Kopi.

— Kjo nuk është në kompetencat e mia, — tha Isai, — por ne do të bisedojmë me punëtorët. Ata me siguri do ta marrin përsipër vullnetarisht këtë aksion të rëndë-sishëm dhe do t'ju njoftojmë.

Kopi Nanushi u largua i ngazellyer, por jo me mendje të fjetur.

### 3.

Arben Korçës iu kujtuan bashkënxënësit e tij të shkollës së natës. Iu kujtua Ylli, Ylviu, Skënderi, Aleksi. Që të katër punonin në atë uzinën e re. Ata njëherë ia patën ngritur mendjen Arbenit për t'u larguar nga oficina e kombinatit e për të vajtur në uzinën e re, por organizata e partisë dhe drejtoria nuk e patën lejuar të lagohej.

Arbeni po priste Kopin e Mihën në sheshin e gjerë ku e kishin lënë për t'u takuar. Ai po vështronët kalimtarët, pastaj ndërtesat e larta pesëkatëshe, në fasadat e të cilave ishin shkruar parulla me shkronja kapitale: «Të shpartallojmë bllokadat imperialisto-revisioniste!», «Ne ndërtojmë socializmin duke mbajtur në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën!», «Lavdi marksizëm-leninizmit!», «Lavdi PPSH dhe udhëheqësit të saj largpamës, shokut Enver Hoxhal!».

Këto parulla Arbenit i sollën në mend tatatatë e bo-

rizanit në kohën e luftës partizane dhe thirrjet e komisarit «Para, partizanë!» për t'u hedhur në sulm mbi pozicionet e armikut.

Arbeni nuk vuri re fare se si inxhinier Sotir Filloja ndaloi hapat dhe po e vështronte me habi.

— Çfarë po vështroni kështu, shoku Arben? Apo mos vallë mendja juaj po projekton tani ndonjë shpikje të re?...

— Po vështroja parullat. Ato të frymëzojnë, inxhinier, për beteja të reja!...

— Arben, megjithëse jeni ca i nxituar, unë e çmoj guximin tuaj.

— Unë e pranoj se pa ndihmën e çmuar të inxhinierëve tanë të talentuar nuk mund të bëjmë shpikje të rëndësishme.

— Unë ende nuk kam besim se linja e gjilpërës do të ndërtohet këtu me forcat tona, Arben!

— E unë po ju them se mendoni gabim!

— Ndoshta... — Ai vështroi drejtorin që së bashku me sekretarin e partisë po vinin duke biseduar.

— Shkojmë, Arben, — tha Kopi, — se na presin.

Inxhinier Sotiri po i vështronte ata që vajtën në drejtëtim të uzinës së re. Psherëtiu dhe qortoi veten: «Hajvan që u tregova! Ata vërtet kanë një besim të habitshëm, por unë, unë çfarë po bëj në këtë situatë?!...». Lexoi parullat që ishin përkarshi dhe nxitoi hapat si ta ndiqte njeri.

Kopi, Miha e Arbeni u priten me ngrohtësi nga drejtori i uzinës së re. Drejtor Isai i shoqëroi vetë për në repartin e tornove që ndodhej jo larg prej hyrjes kryesore, me një ambient vërtet shumë shembullor.

## KAPITULLI I SHTATËMBËDHJETË

### 1.

Ylli, Ylviu, Aleksi dhe Skënderi iu hodhën me duar në qafë Arbenit.

— Ja solidariteti i klasës!, — tha Kopi dhe i shkeli syrin Mihës.

— Solidariteti i klasës punëtore është më i fortë se çdo lloj çeliku në botë!, — tha Miha dhe Isai miratoi me kokë.

— Shoku Kopi! Më duket se ne të dy u shqetësuam kot së kati, mbasi «kapedanët» dhe pa ne do të ndihmonin njëri-tjetrin. Kjo nuk është kaq e vështirë për ta marrë vesh, ja, vështroi se si u qeshin sytë!

— Mirë thua!, — ia priti Kopi.

Kopi, Isai e Miha dolën nga reparti duke biseduar, kurse Arbeni po bisedonte shtruar me ish-shokët e tij të shkollës.

— Arben, djallo punë, kaq shok dhe na ke fshehur sekretet e tua, — e thumboi Ylli.

— Nuk ju kam takuar.

— Filloi të justifikohet, — ia priti Aleksi.

— Nuk e besoj! — Skënderi nuk kishte lënë asgjë nga e kaluara, bile dhe nga fytyra nuk pati ndryshuar.

— Ta dënojmë!, — shtoi me të shpejtë Ylviu.

— Me çfarë?!

— Me nga tri shishe birre Korçë.

Qeshën e goditën njëri-tjetrin duke mos kursyer ro-

muzet. Pastaj, kur vështruan se nga ana e tyre po vështronin vajzat, ata u tërhoqën dhe u mënjanuan pakëz te muri ku ngríhej dollapi i rrrobave.

— Na trego, Hipokrat, qfarë ke bërë?

— Na kanë thënë se inxhinier Grabovën po e lë me gisht në gojël...

Arbeni ua dinte zakonet. Po të të vinin ata poshtë me romuze e shakara, hajde t'u dilje më anë.

— Unë kam hall dhe ju po talleni, Skënder!

— Fol, Arben!

Arbeni vështroi njëherë fytyrat e tyre të heshtura që morën atë ngjyrë që tregonte se ata po e dëgjonin seriozisht.

— I kemi hyrë punës pér të ndërtuar në vend linjën e gjilpërave, por kemi shumë vështirësi e pengesa, të cilat, pa ndihmën e ndërmarrjeve motra, s'ia dalim dot. Kërkjmë ndihmën tuaj pér detaletë imëta, që kërkojnë precizion të lartë!

Ata vështruan njëri-tjetrin dhe ranë në mendime. Arbeni po priste në heshtje.

— Detaletë imëta precizioni të lartë, ë?, — pyeti Skënderi. — I bëjmë dot ne?

— I bëni, — tha Arbeni.

— E kur duhen detalet? — Skënderi e kishte pér zakon të hynte drejt e në temë.

— Sa më shpejt, — iu përgjigji Arbeni.

— E si thoni ju?, — iu drejtua Skënderi shokëve të vet.

— Pér një gjë të tillë ne s'kursejmë as gjumin, por afatin duhet ta dimë, që të planifikojmë kohën, se ato do t'i bëjmë jashtë orarit, se kemi plan prodhimi!... Kështu i dhamë fjalën edhe drejtorit tonë, apo jo?

— Në organizatën e partisë jam zotuar që në festën e Një Majit makinën e gjuhëzës ta kemi të përfunduar, — tha Arbeni i ngazëlyer.

— Jeni zotuar, ë?

— Po, po kemi dhënë fjalën dhe kjo duhet mbajtur se s'bën!...

— Si thua, Ylvi?

- Nuk jemi mësuar ta lëmë shokun në baltë!
- Kjo s'është punë shoku, o derëzi, — tha Skënderi, — kjo është luftë për të çarë bllokadën!
- Për këtë i dhamë fjalën Isait, po duhet të aktivizojmë edhe të rinjtë e tjerë, do të na ndihmojnë dhe vajzat, apo nuk janë të gjitha shumë të gatshme, — tha Ylli.
- Mos harro, Ylli, se detalet janë të një kërkese të lartë e shumë të imëta!
- Mos ki merak për asgjë, Arben, vetëm duhet të na sjellësh vizatimet teknike për çdo detal.
- Do t'jua sjell që të hënën.
- Po i pate gati, na i sill që sot, se ndoshta fillojmë qysh nesër! — Arben Korça tani nuk përmbahej nga gjëzimi. Gatishmëria e tyre e entuziazmoi pa masë. Ja, edhe drejtor Isai kishte punuar si të ishte anëtar i kolektivit të kombinatit. Arbenit diç iu kujtua. Nuk e dinte nëse pas derdhjes së detaleve qenë ruajtur nga Alqi Katroja vizatimet teknike, apo qenë hedhur. Po sikur të mos i gjente ato, sigurisht që puna do të pengohej e do të gjendeshin përpëra pengesave të reja.
- Në qoftë se nuk gjej dot vizatimet teknike?
- Atëherë na sill vetëm detalet! Fundja do të fillojmë ne të katër së bashku, qëllimin e patëm për të vënë në lëvizje dhe vajzat, por ato janë mësuar të punojnë me shkencë, o babaxhan..., — tha Aleksi.
- Filloni njëherë ju luanët e vjetër me detalet e unë do të përpinqem për vizatimet teknike. Diçka do të bëjmë edhe për ato.
- Mrekulli!
- A dini se më bëtë me krahë?
- Filluat nga lëvdatat?
- Jo!
- Arben, léri ato, se s'të kanë lezet!
- Epo për mbarë na qoftë, pra!, — u shtrëngoi duart Arbeni dhe i përqafqoi me përzemërsi.
- Kam një mendim. — Skënderit mendja i shkonte te mendimet e mira.
- Bjeri shkurt, Skënder.
- Shkojmë te Flutura.

Arbeni nuk dinte se cila ishte Flutura. Sidoqoftë ai e dinte se ata nuk e çonin ku s'shkohet.

— Kush është Flutura?, — pyeti ai.

— Sekret!

— Unë nuk vij!

— Të kemi në dorë!

— Na erdhe në shteg!

E vunë në mes. Ecnin një korridor të ngushtë, por të pastër e plot drithë. Më tutje zbritën një palë shkallë që të shpinin në një lokal të nëndheshëm që nuk dallohej nga të gjitha lokalet e tjera e që nuk ta mbushte mendjen se atje duhej të ngrihej mensa e punëtorëve dhe bufeja.

— Ja dhe shpirti i repartit tonë, Arben!

— Të pëlqen?

— Kështu e keni dhe ju në kombinat?

— Çfarë pastërtie, ë!

— Mos u habit, Arben, këtu i gjithë ambienti është pasqyrë.

— E shoh, e shoh. Ju lumtë që e mbani kështu!

— Një ndër pikat e garës që kemi shpallur me të gjitha ndërmarrjet, kemi vënë edhe pastërtinë e ambientit brenda e jashtë uzinës, — tha Ylli.

— Flutura!, — thirri Skënderi.

— Urdhëroni!, — u përgjigj një vajzë e veshur me skufje të bardhë dhe me përparëse bojë qielli. Ajo ishte simpatike.

Arbenit se pse iu kujtua Margarita.

— Ky miku do gjëra të forta.

— Rakia tanë m'u mbarua.

— Nga një konjak nga ai i Korçës.

— Më falni, po unë nuk e pi, — tha Arbeni.

— Atëherë nga një dopio kadaif, apo edhe këtë ta këndaluar doktori?, — u gajas me të madhe Ylli.

Arbeni u shkri së qeshuri kurse Skënderi, Ylli, Alessi dhe Ylviu zunë të tregonin qyfyret e moshës së tyre djaloshare.

## 2.

Naum Shanoja dhe Arben Korça zgjodhën rërë të re pér të bërë derdhjen e detaleve që u kërkoheshin me ngut. Ata rastësish takuan në rrugë Alqi Katron, i cili kishte në duar ca cilindra letre vizatimi.

— Të përkulen shpinën vizatimet, o Alqi, — e shpoi Arbeni atë.

— Ashtu është, Arben. Kam pasur punë e halle plot.

— Çfarë ka ndodhur kështu?

— Kam teton shumë të sëmurë, me ditë të numëruara. Por, ajo që më bën të mendohen, është se nuk ka njeri në shtëpi.

— Alqi, të më falësh, por unë kam nevojë urgjente pér vizatimet teknike. A ju kujtohet se ku i lamë?

— Më kujtohet. I kam që të gjitha në shtëpinë time, Arben.

Arbeni u gëzua pa masë, por i erdhi keq pér Alqin, i cili ishte aq i shqetësuar pér teton e vet.

— Nesër projektet i ke në zyrën e drejtore, — i tha Alqi, i cili nxitoi hapat.

Naum Shanoja e vështroi me vëmendje Alqin derisa i doli nga sytë. Tundi kokën, po nuk foli. Po shkonte në-pér mend projektet, teton e sëmurë, derdhjen e detaleve. Secila nuk priste, por Naumit më urgjente nga të gjitha i dukej derdhja e detaleve. Ai ishte fonditor. Si derdhës i mineralit të shkrirë Naumi e vinte veten në atë shkallë që qëndronte dhe kovaç Efes, që perënditë e vjetra e kishin lënë të gatuante armët dhe zjarrin. Iu kujtua se pér Efesin kovaç Naumi pat dëgjuar te një miku i tij, por, kur pat dëgjuar pér Prometeun që i shërbeu njerezimit duke i dhënë zjarrin, ai në radhë të parë admironte Prometeun, pas tij vinte Efesin kovaç.

Naum Shanoja kishte një karakter të fortë. Ai së bashku me Arbenin nxituan pér nga uzina ku ndodhej fonderia e re. Në uzinë i priste Miha së bashku me Kopin e sekretarin e partisë të uzinës.

— Ka kohë që po ju presim! — Kopi vështroi orën.

— Më falni, por rrugës takuam Alqi Katron e kështu u vonuam, sepse biseduam pér projektet.

— Çfarë tha ai pér to? — Kopi e vështroi njëherë në sy Mihën dhe u tregua më i butë.

— Na premtoi se do t'i sjellë nesër në drejtori, shoku drejtor.

— Mrekulli, kjo e shpejton punën më shumë sesa mendoja unë! — Kopi tani kuqonte gjithçka që lidhej me procesin e shpejtimit të detaleve.

— Fillojmë, shokë? — Sekretari i partisë i uzinës mekanike priste vendimin e tyre.

— Duhet të pyesim njëherë mjeshtrin Naum, — tha Miha dhe vështroi anash.

Mjeshtri plak shkoi dhe iu afroa furrës, në të cilën shkrihej giza.

Brigada e të rinxve, që drejtohej nga sekretari i partisë i uzinës pat bërë një punë parapërgatitore.

— Mjeshtër, këtë radhë nuk na kap në gabim!, — tha njëri nga fonditorët, i cili ishte i larë në djersë. Të tjërët qeshën me të madhe.

— Hej, djema!, — thirri Naumi. U vendos qetësia. Mjeshtri me sytë e qeshur i vështroi që të gjithë që u rreshtuan në formë rrethi, të gatshëm pér të filluar nga derdhja.

— Fillojmë nga derdhja, shokë?, — tha sekretari i partisë. Ata miratuan me kokë.

Arben Korça ndjeu një gëzim të papërmbajtur. I dukej sikur nga çasti në çast do t'i hapej kraharori e zemra do t'i fluturonte si një shpend, ndoshta si ata harabellat që ai ndeshi në shëtitjen me Margaritën. Nga kjo gjendje e nxori pyetja e Kopit që, me sa dukej, ai nuk do të kishte pasur ndonjë rast pér të vështruar se si kryhej derdhja e gizës.

— Mos vallë jemi afér derdhjes së gizës e kështu prishim punë?, — pyeti Kopi.

— Nuk na pengoni, jo, po ruhuni nga zjarri, — tha Naumi.

— Punë e vështirë, përleshje me zjarrin..., — tha Ko-

pi dhe po i vështronte me shumë simpati fonditorët që, të mbytur në djersë e të nxirë nga pluhuri i rërës dhe i ty-mit të qomyrit, me shtangat e tyre me shpejtësi shponin fundin e furrës nga do të dilte përroi i gizës.

— Pa skorje, pa skorje!, — buçiti zëri i trashë i Nau-mit.

Brigada e rinisë qe zotuar përpara organizatës së rinisë që derdhjet e detaleve t'i bënte të një cilësie të lartë dhe pa skorje.

Të rintjtë mbërthyen vështrimin e tyre te mjeshtri Naum Shano, por Heroi i Punës Socialiste kishte mbë-shtetur faqen në dhë dhe po vështronte me shumë kuj-des sikur në atë ngjyrë portokalli të varej e gjithë madhështia që ka një derdhje e tillë e për një çast Arben Korçës iu duk sikur bebëzat e plakut po mbërtheheshin me flakën. Por ja, Naumi seç nuhati, një ndryshim ngjy-rash që nuk e kapi asnjëri prej tyre dhe dha shenjë për derdhje.

Përroi i metalit të kuq si një vorbull uji u derdh mes kanaleve dhe giza mbushi kanalet dhe vrimat e formës e mbas ca minutash të gjitha ishin bërë tërë blozë.

Plasi një e qeshur e hareshme, që mbushi fonderinë. Kopi, duke vështruar Mihën e Arbenin tërë pluhur dhe duke mos pasur mundësi të vështronte veten e tij, u shkul së qeshuri me ta. E njëjtë gjë ndodhë edhe me Arbenin, Mihën dhe Naumin që, duke parë fytyrën e Kopit dhe të sekretarit të partisë të uzinës tërë blozë, u shkrinë dhe ata së qeshuri.

Një keqkuptim të tillë Kopi Nanushi nuk e pat nde-shur asnjëherë, prandaj s'po e mbante dot gazin.

Ka raste që njeriu, duke mos e ditur as vetë, ndo-dhet në një ambient që e bën të shkulet nga gjendja e mërzitur e ta futë në një ambient gazmor që i ngjitet në shpirt e nuk e harron kurrë. Kështu ndodhi me Kopi Nanushin. Një gëzim i tillë! Për veten e tij nuk e mbante mend se sa vite patën shkuar pa i provuar lot të ngrohtë të dalë nga e qeshura.

— Eh, si je nxirë ti, Miha, e ti, Arben!

- Po dhe ti nuk ke mbetur prapa nesh.
- Nuk është e vërtetë unë nuk jam nxirë.
- Më shumë se ne po, shoku Kopi.
- Ju flisni për veten tuaj e kërkonit të më ngatërroni dhe mua!

— Nuk ju gënjejmë, jo.

- Jam nxirë unë?, — e pyeti Kopi sekretarin e partisë të uzinës, Ai u shkul së qeshuri dhe Kopi instinktivisht hoqi pëllëmbën mbi faqet dhe pa mollëzat e gishtave tërë blozë.

— Si është e mundur?

— Hë, pra?

Kopi Nanushi në zemrën e tij ndjeu një gjësim të papërmabjatur.

Mbas tymit u ngritën shtëllungat e bardha të reve nga kapulicat e rërës së zjarrtë. Një pamje e tillë ende nuk kishte tërhequr penelin e ndonjë piktori, i cili, duke ndeshur në këtë skenë, sigurisht që nuk do ta lëshonte t'i shkiste si ngjalë një pamje aq fantastike.

— Miha, Miha vëllai! — Kopi mbeti i shtangur nga gjithë ato vështirësi që mposhtën përpara vullnetit të njeriut, përpara forcës që ka Partia për të mbrujtur njëriun tonë të ri me moralin komunist që çan gjithnjë përpara.

— Vështroni, vështroni! Derdhje të tillë nuk ka bërë në jetën e tij Naumi, — tha Arbeni.

Miha dhe Kopi hodhën sytë nga kapica e nxehur që nxirrte ende shtëllunga avulli dhe ngrinë. Atyre u dukej sikur po zbulonin një njeri, një kalorës të veshur me pancir prej hekuri e gjoksorja e metaltë ndriçonte si të ishte prej ari... Vezullimi i saj i la fare të shtangur. Vallë a ishte e mundur një gjë e tillë? Arbeni ishte pushtuar nga emociionet, por nuk i kishte dalë frika për rezultatin.

— E mrekullueshme, Arben!, — tha Naumi tërë blozë dhe e rroku për qafe.

— Të falemnderit, xha Naum!

Era e freskët përkëdhelte perdet e bardha të varurë në zyrën e Kopi Nanushit. Derdhja e detaleve të makinës së gjuhëzës e ngazelleu atë aq sa s'po e ndiente fare lodhjen e atyre ditëve. Ai s'kishte pushuar dy-tri të diela me radhë.

Kopi Nanushi sillej mirë me vartësit e tij. Ai gjëzohej që rrëth tij ishin gjithë ata njerëz të mirë. Të punosh midis njerëzve të tillë, sigurisht që është një kënaqësi e Kopi Nanushi, megjithëqë lodhej, ndihej i lumtur.

U dëgjua trokitja e lehtë e shefit të llogarisë. Kopi si drejtues i njihte vartësit dhe nga e trokitura. «E trokitura ka diçka të ngjashme me hapin e zemrës» — mendonte Kopi. Ja, një të trokitur të rëndë kishte inxhinier Stefan Grabova. Bile dhe të ecurit e tij mes korridorit, që gjëmonte, tregonte se atje po kalonte ai njeri.

— Hyr! — Kopi Nanushi nga e trokitura e kuptoi se ishte Nesti, pikërisht ai që i shkonte çdo të mërkurë e të premte me dosjen e tij nën sqetull për të raportuar se ku ndodhej vetë Kopi si drejtor me zbatimin e ligjshmërisë ekonomike. Një shef i mirë llogarie ishte garda e mbrojtjes së drejtorit nga gabimet e mundshme, nga ndonjë shkelje financiare që mund ta bënte pa e kuptuar.

— Ç'kemi, Nesti? Çfarë na thua ndonjë të re?

— Sot më dukeni më i gëzuar se asnjëherë, shoku Kopi.

— Jo, more. Kjo është e reja e sotme? Mrekulli.

— Më falni, por njëqind copë kushinetat e fundit mos keni dhënë urdhër ju për t'ia dhënë uzinës mekanike?

— Po, Nesti. Ata na ndihmuani kaq shumë sa jemi borxhlinj. Klasa jonë punëtore, o Nesti, hidhet në zjarr për të çuar në vend fjalën e dhënë Partisë!

— Ashtu është, shoku Kopi! Ja, edhe kombinati ynë po zien nga të gjitha anët. Iniciativa pas iniciativash po merren dhe po bëhen kursime. Zotimet e organizatës profesionale dhe të organizatës së rinisë për ruajtjen e fillit sjellin miliona lekë kursime.

— Vetëm Stefan Grabovës ende nuk i është mbushur rradakja për prodhimin e linjëse së gjilpërës, po edhe atij do t'i mbushet, se s'bën — tha Kopi.

— Interesant, Stefani çdo iniciativë që merret nuk e lë pa i vënë një por mosbesimi.

— Pseja e por-eve të tij duhet parë, se ndikon keq të të tjerët. Ja, inxhinierët e tjerë tani janë entuziastë për iniciaivën e Arbenit. Inxhinier Andrea Bunça po bën çmos si e si të ndihmojë në të gjitha vështirësitë e pjesëve të imëta.

— Po kështu edhe të tjerët u lidhën me linjën, me luftën për të çarë bllokadën.

— Kemi një inteligjencie revolucionare të lidhur ngushtë me klasën punëtore, i dashur Nesti. Iniciativat na vënë në lëvizje. Ja, linja e gjilpërës na vuri në lëvizje që të gjithë. E shoh që aftësitë tona u rritën dhe besimi në forcat tona edhe në këtë fushë u bë i patundur!

— Ky besim mbisundon kudo në kolektivin tonë, prandaj edhe ndonjë por mosbesimi që mund të lëshojë ndonjë skeptik, shkrihet si bryma para diellit.

Hyri Miha pa trokitur së bashku me një vajzë të gjatë e të bukur si dielli. Kopi u hutua.

— Njihuni, shoku Kopi Nanushi. Është zëvendësja juaj. — Ai u habit. Si djallin kishte ardhur kaq papritur ajo zëvendësja e tij, të cilën ai kishte javë që po e priste.

— Si jeni! Po urdhëroni, urdhëroni!

— Ti, Miha, se si hyn nganjëherë në zyrë kështu si hije dhe na gjen të papërgatitur.

— Nuk ka gjë, — ia mori përgjigjen nga goja Mihës. Vajza që i kishte sytë të gjallë shpuzë.

— Ja dhe përgjigjja ime, shoku drejtor. — Ai i buzë-qeshi drejtorit.

— Ia ke bërë mendjen për vete që jashtë ti, Miha. — Vajza qeshi ëmbël. Dhëmbët e saj të bardhë i jepnin një pamje joshëse.

— Sa ju kemi pritur, — tha Kopi i gjëzuar. Vajza u skuq në fytyrë, nuk foli.

#### 4.

Po binte një shi i imët. Alqi Katroja trokiti me frikë në zyrën e drejtorit. U habit kur ndeshi me vështrimin e një vajze të bukur që rrînte e qeshur në vendin e Kopit. Kush do të ishte ajo? Mos vallë ndonjë brigadiere e dall-disur pas shakave të trasha gûxonte e rrinte në karrigen e Kopi Nanushit? Në ishte kështu, sigurisht që ai do të zemërohej shumë dhe ajo do të përpëlitechë përpara zemërimit të tij.

Alqi Katroja u turbullua. Fundja nuk i binte atij që të merrej me rregullin e disiplinën që duhej të reflektohej kudo në kombinat. Ai vështroi njëherë vajzën e qeshur me atë respekt që ka një mashkull përpara një feme dhe, duke u zmbrapsur, i foli:

—Më falni, drejtor Kopi nuk eshtë këtu?

Vajza u ngrit nga vendi dhe i doli përpara. Ajo kishte një trup të drejtë si lastar. Fundi i gjerë ngjyrë violce sa nuk puthte kupat e gjunjëve të saj.

— Ju jeni Alqi Katroja?, — e pyeti ajo duke i zgjatur dorën përzemërsisht.

— Unë.

— Marika Milko, zëvendësdrejtoresha e kombinatit. Uluni. — Ajo i tregoi një nga karrigjet e shumta të rreshtruara në anën e djathë të tavolinës së gjatë.

— Ju falemnderit, por nxitohem! — Ai i hutuar nuk dinte se çfarë të fliste.

— E pse të nxitonni, jashtë bie shi.

— Mirë, — tha Alqi dhe u ul, por nuk dinte se ku t'i linte skicat. Ai spo e kuptonte se cila forcë vallë e mbërtheu atë në vend si një gozhëdë.

— Ç'i keni ato skica?

— Për to kam ardhur.

— Më ka folur shoku Kopi. Mos vallë janë skicat përlinjën e gjilpërës?

— Po shoku Kopi nuk ju ka folur se çfarë mrekullie ka krijuar Arbeni përmes këtyre skicave? A e dini, shoqja Marika, se, duke i mbajtur ato nën sqetull, nuk e ekzagje-

roj që më duket vetja sikur mbaj partiturat e Bethovenit, Moxartit, Shopenit, Bahut e Verdit?

— Mos vallë Arben Korça ka bërë ndonjë kompozim?  
— Vajza, e hollë nga shijet, kërkonte të zbulonte më shumë nga dijet e djaloshit në fushën e muzikës. Ky hap i gabuar i hedhur prej tij, sigurisht që mund të ndërlidonate pakëz gjendjen, por Alqì Katroja merrte vesh edhe nga fusha e muzikës.

— Megjithëse iniciativa e tij është në fushën e teknikës, ju nuk bëni asnjë gabim në qoftë se e krahasoni atë me kompozimet e mjeshtërve të mëdhenj.

— Sigurisht ju e keni fjalën për nga rëndësia politike dhe ekonomike e ndërtimit të linjës së gjilpërës, ë?

— Sigurisht!

— Për këtë ndoshta keni të drejtë!

— Plotësisht të drejtë. Ju ndoshta ngurroni, ngaqë nuk jeni e njohur me problemin, por ju them me sinqueritet se ajo radhitet me novacionet e rëndësishme që janë bërë deri më sot në vendin tonë.

— Më pëlqen të më tregoni hollësira për këtë novacion, inxhinier. Apo nuk jeni inxhinier? Më falni për nxitimin.

— Unë jam gjysminxhinier, gjysmëpedagog, por si t'ju vijë më mirë, ashtu më quani!

Një çiltërsi e tillë e bëri Marikën ta vështronte atë fytyrë të verdhë e të rrumbullakët me ata sytë e kaltër me shumë interes e, për habinë e saj, ajo fytyrë se pse po i pëlqente.

— Kjo është dita e dytë e punës sime në këtë kombinat, — tha Marika, — por më bëri përshtypje të madhe e gjithë kjo lëvizje, e gjithë kjo dyndje nëpër oficinat, një gjallëri e tillë e kolektivit të rrëmbej, të shtyn përparrë.

— Vërtet ashtu është. Ju mendoni sikur jeni hipur në një dërrasë e rrjedhja e shpejtë e ujit ju tërheq me vrull përparrë, ndieni flladin e erës e kënaqeni, apo jo? Afërsisht kështu të çon përparrë dhe vrulli i forcave të kolektivit!

Krahasimi që bëri Alqi i pëlqeu Marikës. Ajo u zhyt në mendime dhe po e vështronte atë me vëmendje.

Në çast ra zilja e telefonit. Ajo mori receptorin dhe filloi të bisedonte. Dhëmbët e saj të bardhë vezulluan.

— Më falni, por ishte bisedë e domosdoshme, telefoni të ndan shpeshherë nga bashkëbisedimi.

— Nuk ka gjë!

— Domethënë ndërtimi i linjës së gjilpërës ka rëndësi të madhe.

— Po, kjo ka rëndësi të shumëfishtë, — theksoi Alqi, — sepse shumë shtete me një industri më të zhvilluar nuk janë të zonjat ta prodhojnë linjën e gjilpërës! A e dini se sa shtete në botë e prodhojnë sot atë?

— Nuk e di.

— Vetëm ca shtetë imperialisto-revisioniste të industrializuara që na kanë halë në sy.

— Ashtu?, — shprehu habinë Marika.

— Ja, i vetmi vend socialist që do të thyejmë monopolin e vendeve imperialiste e revisioniste edhe në këtë fushë do të jemi ne.

— Kjo e nderon autorin përpara Atdheut dhe Shqipërinë socialiste përpara botës, — tha Marika.

— E thatë tamam. Skicat po i lë te ju, — tha Alqi dhe u ngrit për të ikur.

## 5.

Të zënë me përgatitjet e pjesëve dhe detaleve të linjës së gjilpërës, asnjërit në kombinat nuk po i binin në sy përpjekjet e heshtura që po bënte Tori Pini për një racinalizim tjetër të rëndësishëm në fushën e kursimeve.

Tori Pini, i nxitur nga puna këmbëngulëse e Arben Korçës me shokë, mendoi gjatë për kursimin e leckave dhe për t'i kthyer ato në vatë mbas një përpunimi të bëre me makinë. Po kush do ta krijonte këtë makinë vate? Arben Korça që nuk merrte dot frymë?

Ai e vrou mendjen për ditë e net të tëra dhe si në

**ekran tē televizorit shikoi tē gjitha fytyrat e mjeshter** tē zotë që mund tē angazhoheshin në këtë punë. Kush prej tyre do t'ia dilte mban kësaj pune? Tori Pinit iu ngulit mendimi te dy djelmosha tē rind që përpara disa muajsh qenë dalluar pér një novacion tē thjeshtë, por që kursimet e dala prej atij novacioni i kalonin milionin.

Ata me riparimin dhe vënien në punë tē akseve tē bobinave, tē cilat pas një difekti tē vogël flakeshin poshtë si tē pavlefshme, u zgjatën jetën dhe kursyen mbi një milion lekë.

Novatorët, dy djelmosha tē thjeshtë, punuan pa bujë dhe novacionin e tyre e paraqitën në këshillin teknik. Kopi Nanushi dhe Miha Voskopoja i patën përgëzuar pér novacionin e tyre. Kjo u bë nxitje pér novacione tē tjera. Bile Kopi Nanushi urdhëroi që ky novacion tē vihej menjëherë në jetë. Rezultatet qenë vërtet tē shkëlqyera.

Por iniciativa e Arben Korçës pér linjën e gjilpërës eklipsoi novacionin e tyre. Megjithatë djelmoshat po vazhdonin punën në repartin e tyre që u krijuau pér riparimin e akseve tē bobinave.

Jeta e tyre ndoshta do tē kishte rrjedhur e qetë, sikur tē mos ishte kujtuar Tori Pini pér t'i futur përsëri në rrymën e vrullshme tē novacioneve. Tori Pini më në fund e gjeti çelësin pér novacionin e ri, por që këtë radhë ishte më i vështirë se i pari.

Tori Pini nuk harronte dhe pér detyrimet që ai kishte ndaj iniciativës së Arbenit e gjilpërës, më tē cilën po merrej aq seriozisht organizata e partisë dhe drejtoria, organizata profesionale dhe ajo e rinisë e kombinatit. Të mendoje pér makinën e copëtimit tē trikove, nuk do tē thoshte aspak që tē harroje rëndësinë e linjës së gjilpërës. I nisur nga ky detyrim, Tori Pini nuk e quante veten tē larë me gjetjen e pompave tē vajimit pér makinën e gjuhëzës dhe pér tē gjitha makinat e linjës së gjilpërës, numri i të cilave sipas bisedimeve me Arbenin, Alqin, Mihën, Koçon do tē mbushte një repart tē tërë. Një industri e tërë duhej pér tē përgatitur kaq makina tē ndërlikuara, me detale e mekanizma shumë tē imëta.

**Jo më pak se Arbenin, edhe Tori Pinin e kishte tēbuar qëndrimi skeptik i inxhiner Stefan Grabovës, që ndërtimin e linjës pér prodhimin e gjilpërës vijonte ta quante me zë tē ulët vetëm një dëshirë, një ëndërr me sy hapët.**

Kështu, si pér tē rrëzuar inatin që po e brente nga brenda, shkoi nga reparti i djelmoshave. Ata e priten buzagaz komunistin veteran Tori Pini, i cili si ekonomist e pati vlerësuar lart novacionin e tyre. Djelmoshat nxorën nga çanta një shishe me dhallë dhe e gostitën atë duke i uruar dhe pesëdhjetëvjetorin që sapo e pat festuar.

Tori Pini u mallëngjye, por edhe i erdhi turp që kishte kohë pa u vajtur në repart, e aq më tepër që nuk i kishte ftuar njëherë pér tē pirë kafe.

Reparti, një sallë e vogël e thjeshtë, e dëndur me arka tē mbushura me akse e rulemanë tē akseve dhe pjesëve tē ndryshme tē masurëve, nuk e tregonte madhështinë e mjeshtërve tē rindj. Një thjeshtëzim i tillë i ambientit nganjëherë gënjen dhe syrin më tē stërvitut tē gazetarit më tē zot që ikën dhe harron tē ngrejë në shtyp portretet interesante që bëhen shkas pér tē ngritur peshë mijëra njerëz tē tjerë në revolucionin tekniko-shkencor tē frysmezuar nga akti i tyre.

— Cila erë e mirë ju ka shtyrë këndezaj nga reparti ynë?, — i foli Petraqka, siç i thërrisin shokët atij djali tē gjatë, tē thatë si një degë thane, me flokë tē dredhur e tē ashpër.

— Unë e di se kush e ka térhequr këndezaj nga reparti ynë i vogël. Magneti i tij mbetemi ne! — Dhimtri ishte pakëz më i shkurtër se shoku i tij, truplidhur, me një shëndet tē fortë, i qeshur e téré energji.

— Jo pér t'ju bërë qejfin, tē dashurit e mi por ja që Dhimitraqi e nuhati se pér ju kam ardhur.

— Ke marrë frigorifer?

— Nuk kam ardhur pér punë personale, kam një ide më tē madhe në kokë.

— Shoku Tori, më qafsh mua, mos na ngatërr me copkat e tua, se kemi pér tē mbetur pa martuar!

— Pse tē mbeteni pa martuar?, — u habit ai.

— Vajzat do tē na hapin namin që ne jemi bërë kur-simtarë aq, sa merremi si Tori Pini me copat.

— E çfarë tē keqe ka këtu?

— Tē keqe nuk ka fare, por ajo që është më e keqja nga tē gjitha tē këqijat e tjera, është se vajzat sot nuk e duan shokun e tyre tē jetës tē jetë cingun. — Tori qeshi me tē madhe, pastaj tha: — Më ka shkrepur në kokë për prodhimin e një makine për copëtimin e copave, që ato t'i kthejmë në vatë.

— Vatë!, — u habit Dhimitri.

— E nga do ta nxjerrim vatën ne?, — pyeti Petraqi.

— Nga copat e leckave, — u përgjigj Tori.

— Përsëri në copat katandisëm!

— E pse mbetesh i pakënaqur ti, Dhimitër?!

— Nuk është ndonjë trimëri e madhe tē merresh me copat e stofit, mua më duket një punë e lehtë, me tē cilën duhet tē merren vetëm gratë!

— E lehtë, pos, por ti nuk di se çfarë leverdie kemi prej tyre! Kështu, duke prodhuar vatën në vend, i presim rrugën importimit dhe kursejmë valutën, nga ana tjetër realizojmë një kursim tē madh, që kap qindra mijëra lekë tē rinj.

— Gjë e madhe, — tha Petraqi.

— Gjene vatë është, — u përgjigj i pakënaqur Dhimitri.

— Punë burrash është ajo e Arbenit, ajo tē ngroh zemrën e tē kënaq shpirtin. Por vata...

— Dhimitraq, mos harro se edhe novacionet e racionalizimet më tē vogla ndihmojnë për tē çarë bllokadën. Vërtet, ndërtimi i një linje me makineri tē pradhura në vend ngrenë shumë peshë, po kurrë s'duhet t'i nënve-rësojmirë edhe këto që dikush i quan tē vogla.

Dhimitraqi e Petraqi u skuqën në fytyrë dhe për një çast heshtën si tē zënë në faj.

— Unë e kam tē qartë se ju nuk i nënvlërësoni racionalizimet, qofshin ato tē mëdha apo tē vogla, — theu heshtjen Tori Pini. — Ju keni bërë një novacion tē rëndë-

sishëm, që vetëm ndonjë mendjemadh mund ta quajë gjë të vogël e të parëdësishme. Shembulli juaj u bë nxitje edhe për vetë Arbenin me shokë.

Thëniet e Tori Pinit i ngazëlljen novatorët e rinj. Ata tani donin të bisedonin konkretisht, po s'dinin nga t'ia fillonin.

Tori Pini ishte i bindur se nuk kishte shkelur në dërrasë të kalbur. Ai kishte besim të patundur te rinia, posaçërisht në gatishmërinë dhe aftësitë teknike të Petraqit dhe të Dhimitraqit.

— Pa na thuaj njëherë shkoqur idenë tuaj, shoku Tori, — tha Dhimitraqi dhe e mbuloi me vështrimin e tij.

Tori shoi cigaren dhe e shkeli me këpucën e tij të rëndë, pastaj u shpjegoi gjerë e gjatë për atë që mendonte.

— Nuk besoj të jetë vështirë për të bërë një gërryese leckash! — Petraqi seç kishte një ironi të fshehur nën gjuhë.

— Kështu mendon ti?

— Kështu është! Një makinë e thjeshtë e tipit tuaj mua më ka shkuar kaq herë në mendje, por nuk mendoja se mund të na sillte kaq kursime...

— Dhe si e ke menduar ti, Petraq?

— Një gjë shumë të thjeshtë. Le të mendojmë njëherë që nga e majta e një perimetri të gjerë sa një tepsi do të jetë llamarina e bardhë, e cila nga e majta e saj do të ketë gojën e luanit, sepse kështu do ta quajmë vendin ku furnizohet me leckat tuaja, shoku Tori, dhe, mbasi të kalojë në dy furça dhëmbësh prej dy cilindrash teneqeja të dhëmbëzuar me atë hollësi e dendësi që kanë dhëmbët e kastorit që bren drurin, ato cilindra do të kenë dhe rrrotullim të kundërt duke copëzuar e grirë të gjitha leckat!

— Fantazi e pasur, por nuk na treguat më tej fatin e leckave, ku shkojnë ato.

— Ato nuk mbeten më lecka, por transformohen në vatë dhe vata do të ketë rrugën e saj në të djathtën e perimetrit të tepsisë prej llamarinë si dalje.

— Nuk është keq si fillim, por unë jam i pakënaqur

nga ai projekti juaj, mbasi mendoj që pér vatë tē futen tē gjitha llojet e leckave që mbeten pa shfrytëzuar. Ju ndoshta do tē habiteni, por nga shitja e tyre si lecka humbasim tē paktën disa dhjetëra mijëra lekë tē rinj e kjo humbje vetëm pér një makinë vatash!

— Dhe pér këtë qëllim mund t'i bëhet një modifikim makinës sonë, mjafton që cilindrat tē jenë tē lëvizshëm. Me një regjistrim i lëviz ato si t'ju dojë qejfi, shoku Tori Pini, — tha Dhimitri.

— Bukur, shumë bukur ju shkoi në mend, por mos vallë e gjithë kjo copëtuese leckash e makinë vatash duhet tē jetë si një makinë shirëse që duhet tē ketë edhe traktorin pranë pér ta vënë në lëvizje? Unë mendoj që ajo tē jetë e bukur dhe automatike.

— Ku ju shkon mendja ju, shoku Tori?

— Pse? Vetë ju më thatë tē vërtetën e bukurisë, apo nuk ju pëlqejnë vajzat, në qoftë se bëni një makinë gri-rëse tē bukur vatash? Përkundrazi, duke vështruar një makinë tē bukur e automatike, ato do t'ju simpatizojnë më tepër, — qeshi Tori.

— Në këtë drejtim asgjë s'fitojmë, — iu përgjigj Dhimitri shakasë, — sepse e gjithë vëmendja e kureshtja e vajzave është përqëndruar tek Arbeni.

— Kurse unë mendoj se novacionin tuaj do ta vlerësojnë shumë që tē gjithë, — tha Tori.

— Jo, tē gjithë, shoku Tori, — ia priti Petraqi. — Disa gra që preferojnë tē mos hyjnë në punë, po tē punojnë privatisht në shtëpi, që blejnë lecka dhe bëjnë qilima t'ua shesin tē tjerëve, do tē na mallkojnë edhe ne, edhe ty.

— Për këtë s'më shkonte mendja, — tha Tori, — po aq më mirë, se i presim rrugën sektorit privat, që doemos ne duhet ta shkulim me rrënjenjë.

— Unë tani po e kuptoj se ndërtimi i kësaj makine tē thjeshtë i pret rrugën punës private dhe pér mendimin tim kjo është leverdia më e madhe e jo kursimet që sjellë ajo, — tha Petraqi.

— Po pér vizatimin teknik si do t'ia bëjmë?, — pyeti Dhimitri.

- Këtë çështje do ta zgjidh unë, — tha Tori.  
— Atëherë për mbarë na qoftë!, — tha Dhimitri.
- Që të tre i tokën duart dhe i shtrënguan fort me njëri -tjetrin. Tori Pini desh po fluturonte nga gjëzimi. Një si-hariq të ri do t'i sillte Partisë dhe kjo në pragun e festës së Një Majit! Vajti në shkollën e mesme ku jepte mësim Alqi Katroja. Posa arriti në oborrin e shkollës, trigëlliu zilja elektrike. Oborri jehoi nga zhurma e të qeshurat e nxënësve që u derdhën me potere.
- Ç'e mirë të paska sjellë, o Tori?, — tha Alqi Katroja, i cili i kishte duart dhe rrobat të pudrosura me të bardhët e shkumësit.
- Na ka lindur ideja për ndërtimin e një makine përgirjen e leckave dhe prodhimin e vatës. Këtë e biseduam edhe me dy të rinj racionalizatorë, po kemi ngecur përvizatimet teknike. Do na ndihmosh?
- Tori, unë nuk kursehem për gjëra të tillë, po nuk di nëse do t'ia dal mbanë, se këtë kohë kemi shumë orë mësimdhënie. Pastaj kam marrë përsipër për të ndihmuar nxënësit e dobët.
- Kemi ngecur keq dhe s'kemi se kujt t'i drejtohem i dhe pa vizatimet teknike s'bëjmë dot asnje hap.
- Po kur mendoni të filloni nga puna?
- Menjëherë. Vetëm vizatimet teknike na pengojnë.
- Mirë, do të bëj çmos që t'ju nxjerr nga ky hall. Do të punoj natën, ndonëse kushtet e banimit s'i kam për këtë. Por nuk do të ishte keq që t'i kërkoni ndihmë edhe inxhier Andrea Bunçes.
- Andrea Bunça?, — pyeti Tori me habi.
- Ai do ta quajë për nder. Këtë e di mirë, — tha Alqi.
- Nuk e kam për t'i ikur kësaj pune, por kështu është më mirë, se tjetrin e vë në pozita pune, bile edhe në provë.
- Nuk thua keq. Do ta bisedoj, po sidoqoftë a ta fle mendjen te ti, apo....?
- Unë fjalën kurrë nuk e kam ngrënë. Për këtë fli rehat!
- Rrofsh, o Alqi Katro! Tani jam i qetë.
- Mirupafshim!

## KAPITULLI I TETËMBËDHJETË

### 1.

Arben Korça mbeti shumë i kënaqur nga puna e shokëve të uzinës së re. Ylli, Ylviu, Skënderi dhe Aleksi kishin bërë një punë shumë të kujdeshme për tornimin e detaleve të derdhura me kaq kujdes nga mjeshter Naumi. Ata, në tornimin e detaleve jashtë e brenda, kishin derdhur të gjitha aftësitë e talentin e tyre, gjë që nxirrte në pah jo vetëm aftësitë e tyre krijuese, por dashurinë e madhe për t'i dhënë sa më shumë Atdheut, për të çarë bllokadën imperialisto-revisioniste.

Arben Korça po vështronte vendet ku do të monto-heshin kushinetat, akset, rulemanët; boshllëqet ku ngri-heshin xhepat e vërtitjeve të tyre, vrimat nga do të kalonin akset e gungat eksentrike, premistopet dhe bokolat e bronzëta dhe nuk përmbahej nga gjëzimi. Gjithçka ishte bërë me precision.

Që nga projektuesi, derdhësi deri te tornitori, secili ka derdhur në to dashurinë e pakufishme për Atdheun socialist, urejtjen e thellë për kopenë imperialisto-revisioniste e lakenjtë e tyre.

— Kanë bërë punë e jo llafe shokët! — Arbeni po i le-dhatonte një nga një me gishtat e tij të gjatë. — Ja si i kanë lëmuar edhe faqet e vrimave të skatullës!

— Duket sikur faqja e tyre të mos jetë tornuar me

majën e thikave të rapidit, por të jetë ngrënë në gurzmeril.

— Nuk besoj të kenë përdorur rapid, duket që thikat kanë qenë prej vidiove.

— Mundet të jetë dhe ashtu, Miha.

— E si mund t'ua shpërblejmë atyre këtë nder kaq të madh që na bënë?, — pyeti Arbeni.

— Gatishmérinë dhe punën e tyre të ndërgjegjshme do t'ia bëjmë të njohur gjithë Shqipërisë me një artikull në gazeten «Puna».

— Atëherë të kërkojmë një gazetar, — tha Arbeni i entuziazmuar.

— Artikullin mendoj ta bësh ti Arben.

— Këtë nuk e bëj dot, shoku Miha.

— Pse?

— Ku di unë të shkruaj për gazeten? Unë në hartim kam qenë i fundit i klasës.

— Ti po projekton makina dhe thua s'mund të bëj një artikull për t'i treguar lexuesit gatishmérinë, solidaritetin, aftësitë, talentin e klasës sonë punëtore për të çarë bllokadën!

— Atëherë ta bëjmë bashkë, shoku Miha, se, të them të drejtën, unë s'ia shoh gasën që bëj gjë për të qenë.

— «Noti mësohet duke notuar», thotë populli, Arben! Megjithatë artikullin do ta bëjmë bashkë. Në artikull të vëmë në pah edhe punën e fonditorëve dhe të të gjithë kolektivave që kontribuan për ndërtimin e kësaj linje. Kjo do të frymëzojë edhe kolektivat e tjera.

Bisedën ua ndërpree Tori Pini, i cili i bombardoi me pyetje:

— Si ju shkon puna, o ndërtuesit e linjës së gjilpërës, se nga ju e ka drejtuar vëmendjen gjithë qyteti.

— Na duket se më në fund e kemi vënë në vijë, për së shpejti mund ta vëmë në provë, po ti si e ke punën me atë novacionin tënd për makinën e vatës?, — pyeti Miha.

— Fundi për hair! Tori Pini nuk nxitohet, punët e nxituara të lënë në baltë. Megjithatë, po mundëm, unë me ata petritat e mi (fjalën e kishte për Dhimitrin e Pe-

traqin), do t'jua marr në kthesë. Dhe për këtë kemi arsyë të fortë.

— Arsyë të fortë?, — pyeti Arbeni me habi e shqetësim dhe mblodhi vetullat.

— Si jo. Po e realizuat ju para nesh, kjo jona është aq e vogël, saqë askujt nuk i hyn në sy.

Të tre u gajasën me të madhe. Tori Pini ua futi grenzat dhe u largua si era dhe shkoi te Petraqi e Dhimitri, pastaj u kthyte nga magazina e pjesëve të ndërrimit. Aty gjeti inxhinier Stefan Grabovën dhe inxhinier Sotir Fillon.

— Urdhëroni, shoku kryetar i bashkimeve profesionale, — e ftoi Stefan Grabova dhe ndezi një cigare. — Meqë cigaren nuk e pini, po ju qeras me një sheqerkë! — I zgjati një karamele të mbështjellë me letër të lustruar. Ishte prodhim i repartit të embëlsirave që tymoste atje prapa kombinatit të tyre si një rimorkiator në bishtin e një anijeje transoceane, sic ishte ndërtesa e kombinatit.

— Po grindem për atë parullën që është vënë në hyrje të kombinatit, — tha Stefan Grabova. — Aty bëhet thirrje që të kursejmë kudo, kurse inxhinier Steli thotë se kjo s'ka të bëjë me punën time, se unë kam normativë e gramaturë të caktuar shkencërisht.

— Ajo ka lidhje me të gjithë ne, shoku Steli.

— Të doli fjala ime!, — u krekos Stefan Grabova. — Mirë thotë xha Dhosi, kudo mund të kurset, apo jo, shoku Tori?

— Fjala merr vlerë vetëm kur shoqërohet me vepra, — theksoi Tori.

— Kjo është e drejtë, — pohoi Stefani.

— Meqë është e drejtë, ti përsë nuk jep ndonjë shembull personal për kursimet, o Stefan?, — pyeti Steli për t'ia mbyllur gojën.

— Unë nuk kam të bëj me normativa materialesh, se, po të isha në vendin tënd, nuk do t'i kisha ngjyer lakrat me bojë.

— Një herë ndodhi ajo, po, edhe ti, po ta vrisje mendjen si Arben Korça, do t'i kurseje ekonomisë popullore

ndoshta miliona lekë, por e ke gjetur më lehtë të thuash «s'bëhet, s'bëhet!...».

— Po t'u pillte mendja të gjithëve, o Steli, atëherë do t'u binte vleëra edhe novatorëve. Unë gëzohem shumë që puna e linjës së gjilpërës shkon mirë.

— Atë s'e vëmë në dyshim, se vetëm armiqtë pëlcasin nga çdo sukses që arrihet në vendin tonë, — tha Steli.

— Na fute në të thella, o Steli, po ti një gjë e thua me vend, secilit duhet të na bredhë mendja për mirë. Por një gjë duhet ta pranojmë, se mendjet nuk janë njëlloj, dikujt i pjell mendja shpejt, dikujt më vonë, dikujt hiç fare.

— Ajo mendja jote në cilën kategori futet, o Stefan?, — e sulmoi Steli.

— Ta shohim, o Steli, vetëm mos u mërzit.

— Unë nuk mërzitem, vetëm mos u merr me teorizime, por me diçka konkrete. Kjo do të ishte më mirë.

## 2.

Alqi Katroja brodhi zyrë më zyrë nëpër korridorin e ngushtë të drejtorisë së kabinetit duke kërkuar Tori Pinnin, por më në fund dikush i tha se atë do ta gjente te ndërtesa përdhese afér ambulancës. Kur po kalonte nga një zyrë në tjetrën, Alqit i lindi dëshira dhe u mat disa herë të futej edhe në zyrën e nëndrejtoreshës, vetëm ta takonte, meqë s'po i dilte nga mendja, por nuk hyri, sepse s'dinte çfarë të thoshte.

Kokulur e zemërthyer, Alqi Katroja zbriti shkallët, nxitoi hapat përpara hyrjes së mensës ku gumëzhinin zërat e grave, dhe mori frymë thellë në rrugicat e shtruara me asfalt. E ndjeu aromën e këndshme që lëshonin bordurat e lulishtes.

Tek po ecte me nxitim, ende nuk po i dilte nga mendja shtati lastar dhe fytyra simpatike e nëndrejtoreshës. Edhe tingujt melodiozë të të folurit të saj nuk po i shqite shin nga koka. Nën sqetull shtrëngonte tubat e projekteve të makinës së vatës e nuk dinte se nga shkonin hapat e tij.

— Ngadaleni, ju për pak sa nuk na shtypët, inxhinier

— i têrroqi vëmendjen një zë. Alqi ngriti sytë e u habit nga kjo e papritur.

— Më falni, se nuk e kisha mendjen, shoqja nëndrejtoreshë!

— Keni humbur pas projekteve, inxhinier!, — buzëqeshi ajo.

— Po kërkoj Tori Pinin, i kam vizatuar projektet e makinës së vatës!

— Të bësh projekte, është gjë e lavdërueshme, po më e lavdërueshme është të guxosh t'i vësh ato në jetë,

— tha Marika tërë shend e verë dhe e mbuloi me vështrimin e saj me ata sy të mëdhenj e me vetullat lart.

— Alqi shtangu në vend. Nuk dinte si t'i përgjigjej, ndonëse ajo ia hapi shtegun.

— Edhe projektet, edhe zbatimin po e bëjnë punonjësit tuaj, shoqja nëndrejtoreshë. Unë vetëm me vizatimet teknike po jap kontributin tim modest.

— Jo, inxhinier, ju jeni bashkautor i linjës së gjilpërës. Këtë s'ju mohon njeri.

— Nuk pretendoj për asgjë, — tha Alqi. — E rëndësishme është t'i arrihet qëllimit, të thyejmë bllokadën.

— Kjo është kryesorja, — miratoi Marika, — pa ejani të pimë nga një kafe.

Ftesa e Marikës e ngazelleu pa masë Alqin dhe ai nuk e fshehu dot gëzimin që ndjeu.

Ecën krah për krah dhe u futën në mensën e punëtorëve të mbushur plot gra. Alqi u skuq në fytyrë. Në jetën e tij nuk i kishte ndodhur të shihte në një lokal aq gra. Ato e mbuluan me vështrimet e tyre kureshtare. Ato, të veshura me rroba të jeshilda dhe me dylbenka të bardha në kokë, i kujtuan një parcelë eksperimentale me pambuk të mbushur me bohga të bardha. Zunë vend në një tavolinë boshe në qoshkun e mensës. Marika Milka porositi kafetë.

Alqi Katroja u turpërua. Ja, në vend që të porosiste ai kafetë, Marika shpejtoi dhe e la atë si guak. Vështrimëve të grave kurioze ai iu përgjigj duke e ulur kokën e duke u skuqur më shumë. Ngjyra e fytyrës së Alqit nuk

u shpëtoi vështrimeve hetuese të grave dhe të vajzave, të cilat pëshpërisnin dhe buzëqeshnin me njëra-tjetrën.

— Kafenë e bëkan të mirë, — tha Alqi vetëm sa për të thënë diçka.

— Për këtë banakieren flasin mirë.

— Po të punosh e të sillesh mirë, të tjerët të duan.

— Më dukeni disi i zverdhur në fytyrë, — i tha Marika. — A mos vuani gjë nga stomaku?

— Jo, nuk vuaj nga asgjë.

— Ju pëlqen alpinizmi?

— Sigurisht, por ai zhvillohet vetëm në stinën e dimrit. Kam një pasion për bardhësinë e dëborës. Dua që ecja të bëhet me këpucë alpine mbi bardhësinë e ngrirë të dëborës, dhe ja, papritur, të dalë si një lëmsh i verdhë dielli e rrezet e tij të thyhen te dëbora, te syzat e veshura që të ruajnë nga ai shpërthim i ngjyrave të forta. Unë e kam fjalën për ngjyrën e bardhë të dëborës dhe ngjyrën e verdhë të diellit. Të dyja këto ngjyra digjen siç digjen shufrat e karbonit në një hark elektrik.

— Ndërsa unë e pëlqej shëtitjen e alpinizmit në kohën e pranverës. Ju nuk e dini se çfarë shpërthimi esencash ka në male nga lulet e posambira! Është shumë fantastike, sidomos kur ndesh me lulet e rralla «Fiori Alpini».

— Nuk e njoh këtë specie lulesh!

— Venus i Alpeve!

— Ku ta dish, mund të quhet kështu, por mua ky emër diçka më kujton, ndoshta ndonjë tregim a novelë të gjatë, por më duket se diku e kam dëgjuar!

— Çfarë lexoni më shumë?

— Poezi e drama, por muzika më pëlqen mbi të gjitha. Po juve, shoqja Marika? — Për herë të parë iu drejtua ashtu, sepse kishte vënë re se asaj nuk i vinte mirë kur i përmendte postin zyrtar.

— Lexoja shumë, por kohët e fundit nuk kam pasur aq kohë. Më shumë më pëlqeijnë romanet e autorëve tanë. Aty e sheh se si kaliti Partia njeriun tonë të ri, si dje në Luftën Nacionaqligjrimtare dhe sot për ndërtimin e vendit, duke mposhtur vështirësitë, punën armiqësore të armiqve

të jashtëm e të brendshëm. Heronjtë e letërsisë sonë të frymëzojnë për sakrifica e heroizëm. Apo s'është kështu?

— Keni të drejtë. Kjo rrymë e përshkon edhe muzikën tonë, — tha Alqi. — Ajo të ngazellen, të frymëzon dhe të ngrë peshë.

— Mua më pëlqen muzika popullore. Ajo të ngrë peshë, kurse muzikën e lehtë dhe atë operistike nuk e ndiej. Shpeshherë nuk merren vesh tekstet e këngëve të muzikës së lehtë, — tha Marika.

— Që të ndiesh muzikën, duhet të kesh vesh, — tha Alqi.

— Ndoshata..., — tha Marika. Alqi u pendua që foli pa u matur dhe heshti. — Isha tek Arben Korça, — tha Marika për të kaluar atë bisedë. — Ai i ka duart flori. Më foli për ju. Vlerëson shumë punën tuaj për linjën e gjilpërës.

— Nuk kam bërë gjë të madhe.

— Modestia ju zbuluron, shoku Alqi, por të projekto什 një mori skicash për linjën e gjilpërës, është një kontribut që shoqëria e vlerëson shumë.

— Po si i shkonte puna Arbenit, se ka ca ditë që nuk e kam takuar.

— Ka ndeshur në vështirësi të reja.

— Në montimin e detaleve sigurisht!

— Në automatizimin që ai kërkon t'i bëjë linjës së gjilpërës. Çfarë shpirti që ka, q'vendosmëri e këmbëngulje! I çiltër. Ai nuk di q'është kthimi prapa. Komunist i vërtetë që të frymëzon.

— Po q'mendonte për kalimin e vështirësive të reja?

— Është optimist. Për këtë çështje biseduam me kryeinixhineren. Margarita, më premtoi se gjithçka do të zgjidhet. Ajo ka aftësira të rralla si inxhiniere elektrike.

— Kam dëgjuar fjalë të mira për atë vajzë, — shtoi Alqi dhe vajti në banak për të paguar kafetë.

— Këtu jeni në shtëpinë tonë!, — kundërshtoi vajza dhe i tha banakierës të mos ia pranonte lekët.

— Ju ziheni për të paguar, ndërsa për mua nuk kujtoheni të më gostitni, — bëri shaka Tori Pini. Ata qeshën me të madhe. Marika e ftoi në tavolinë dhe i porositi një kafe.

3.

— E di përse të kam ardhur, o Dhosi?, — tha Stefani tërë qejf.

— Urdhëro, inxhinier.

— Dëshiroj të rrëklljej nga një dopio raki me ty. Jeta e beqarillëkut këtu më ka ardhur. Rakia thonë se del me raki.

— Kush zgjedh shumë, mbetet pa gjë, inxhinier! Pastaj pija nuk del me pije.

— Inxhinierët nuk i kërcënë ai rrezik, apo fjalën e keni vetëm përmua?

— Unë fola në përgjithësi.

— Këtu të jap të drejtë, Dhosi. Ty të punon mendja, e di ç'bën e ç'thua. E shoh se kam çfarë të mësoj nga ti. Prandaj dëshiroj të bëj dy para muhabet me ty.

Dhosì nuk po i binte në të se ku do të dilte Stefan Grabova me ato lëvdata që po i bënte dhe me ftesën përmë rrëkëllyer nga një dopio. Vendosi ta shoqëronte dhe ta dëgjonte, pastaj të shihte e të bënte.

Dhosì Qafëzezit i pëlqente të çonte nga një gotë, por kurrë s'pranonte të pinte qelepir. Përmë Stefan Grabovën kishte dëgjuar se pinte nëpër klube. I vinte keq përmë të dhe donte ta kthjellonte, jo vetëm që të mos pinte, por edhe të mos ishte aq dorëlëshuar, por të krijonte familje e të mbli-dhite mendjen. Tek po ecnin krah përmë krah, e vërejti se Stefani nuk kishte pirë, por hiqej si i tillë.

— Pse hiqesh si i pirë, Stefan?

— Ha, ha, ha, — Stefani u gajas me të madhe dhe e rroku Dhosin përmë qafe. Ishte një artist i vërtetë përmë t'u mbuluar.

Dhosì Qafëzezi po ndiqte me vëmendje bisedën e Stefan Grabovës, por nuk po i binte në të se ku e kishte hallin, ku do t'ia nxirrte kokën.

— Nuk më duken të ndershëm, o Dhosi, ata njerëz që bisedën midis shokësh e bëjnë muhabet pazari dhe e keq-interpretojnë...

— Ku e ke fjalën, inxhinier?

— Jo xhanëm, por ka disa që spiunojnë përmë të fituar pikë!

- Nuk po tē kuptoj, inxhinier.
- Tē marrim edhë nga një, se qenka rrush safi?
- Jo, falemnderit, — i tha Dhosi. U ndanë. Dhosi vajti në shtëpi, hëngri darkë, ra tē flinte po gjumi nuk po e zinte.

Si një makth në grykë i vajti biseda e bërë para ca kohësh nga inxhinier Stefani i cili nuk pat lënë njeri pa vënë në lojë. Që nga ajo bisedë Dhosi Qafëzezit inxhinier Stefani i dukej ndryshe nga inxhinierët e tjerë, tē cilët nuk flisnin kurrë me nëntekste, por i thoshin mendimet e tyre shkoqur. Inxhinier Stefanit mund t'i vejë në krah vetëm një inxhinier, Qendro Kolonjën.

Dhosì po e vriste mendjen si tē bënte për atë bisedë tē Stefan Grabovës tërë vrer. Në veshët e tij i tringëllinte e qeshura cinike e Stefan Grabovës, fjalët fyese e poshtëruuese: «Vetëm një profani, një kokëkungulli, një injoranti mund t'i mbushet mendja se mund tē zërë qiellin me dorë, me një hopa mund tē hipë në majë tē piramidës, ku kokave u janë dashur dekada e shekuj! Ha, ha, ha...».

Këto i pat thënë Stefan Grabova pa adresë, po Dhosi tani e kuptonte se ato u drejtosheshin ose Arben Korçës, ose Arbenit së bashku me Mihën, Kopin dhe Koçon etj. që kishin miratuar iniciativën e tij dhe po luftonin për ndërtimin e linjës së gjilpërës.

U ndien tingujt e sahatit tē madh «Tang, tang, tang, tang». Ora katër e mëngjesit... Dhosi Qafëzezin nuk po e zinte gjumi. T'ia thoshte Mihës ato thënie tē Stefan Grabovës, ishte vonë, tē mos ia thoshte, e gërryrenin përbredha. Në kujtesën e Dhosit, që ecën nëpër kuzhinë me atë hap tē ngadalshëm që tē mos bëjë zhurmë, rrahin si çekan fjalët e urta popullore: «Uji fle, hasmi s'fle...». Përpëra sysht i doli parulla e madhe me shkronja kapitale, që ishte shkruar në tē djathftë tē hyrjes së kombinatit: «Të mprehim vigjilencën politike kundër armikut tē klasës!».

«Më mirë vonë së kurrë», — tha me vete Dhosi dhe vendosi që t'ia thoshte menjëherë Mihës tē gjitha pikë e përpé. Miha do t'i siste e do t'i përsiste dhe do tē ndante miellin nga krundet, bile krundet e mykura do t'i fla-

kte poshtë ose do t'i groposte që të mos farmakosnin as pulat.

— Qenke ngritur shpejt, xha Dhosi!, — i tha banakierja që ende s'kishte ndezur ekspresin.

— Nuk më zuri gjumi.

— Edhe ti e vret mendjen për linjën e gjilpërës?

— Doemos, po s'ndihmoj dot gjë.

— I gjithë qyjeti e pret me padurim prodhimin e gjilpërës shqiptare.

— Ashtu është, moj çupë, — tha Dhosi, — por ka edhe ndonjë që nuk beson që shqipja mund të ngjitet në majatë tilla.

— Populli e beson, për të tjerët aq na bën, — tha banakierja.

— Mirë thua, moj çupë, — gjegji Dhosi dhe, posa rrufiti kafenë u nis për të takuar Miha Voskopojën.

#### 4.

Oficina shkëlqente nga dritat e neoneve. Një ndihmë të madhe për këtë ndryshim dha inxhinier Sotir Filloja. Arbeni nuk e dinte se inxhinier Sotiri banonte pikërisht në atë rrugicë që atij i kujtonte vitet e shkollës fillore.

Ndonëse i lodhur nga puna e gjatë në torno, Arbeni ishte i kënaqur, sepse tornimin e detaleve dhe të pjesëve më të rëndësishme të linjës së gjilpërës e kishte vënë në vijë. Të gjithë, gati të gjithë ishin mobilizuar dhë po punonin me orë të zgjatura. Bile Miha e Koço Opingari me dítë të tèra nuk po shkonin as për drekë në shtëpi, por së bashku me Arbenin po punonin për gjilpërën.

Arben Korça po i hidhte hapat më ngadalë. Dukej se ishte i lodhur dhe i zhytur në mendime. Në kthesën e rrugës, kur Arbeni mori në të djathtë për të dalë në bulvardin kryesor, i zuri syri inxhinier Sotirin.

— Pse me kaq përtim, o shoku Arben?, — i foli me ngrohtësi Sotiri, që po sodiste nga ballkoni i apartamentit në katin e dytë.

— Sepse më ka velur vapa sot, inxhinier, dhe e ndiejet veten disi të rraskapitur.

— Dukeni. Po punoni shumë me orë të zgjatura.

— Kështu e kërkon puna, inxhinier!

— Të lumtë, o Arben Korça, të lumtë! Urdhëro të çlodhesh pak dhe të bëjmë dy para muhabet...

Arbeni vështroi orën. U kthye. Sotiri i doli përpara në shkallë dhe e rroku për qafe sikur të kishte muaj pa e takuar. Dukej se e kishte me zemër. Arbenit iu bë qejfi. E ndoqi të zotin e shtëpisë prapa. Sotiri i veshur me ato pantofla të lehta po ecte duke u pihatur dhe e futi Arbenin në një dhomë, që dukej nga veshja e pastërtia se ishte dhoma e pritjes. Tavolina e vogël rrumbullake e mbuluar me një mbulesë ngjyrë kreml me qëndisma tulipanësh e karafilash të kuq krijonte një kontrast të këndshëm me qilimin shumëngjyrësh, me kolltuket e thjeshtë dhe me ngjyrën bizele të mureve e tavanin të bardhë. Sipër mbulesës së tavolinës ishte vendosur një vazo kristalli me një buqetë lulesh të freskëta.

— Paskeni apartament të mirë, inxhinier!

— Për bukuri. As ëndërr s'e kisha parë. Kur vij në shtëpi, çlodhem. Po ajo që më ngazelleu shumë, është muzika, Arben.

— Keni magnetofon?, — pyeti Arbeni.

— Kam incizuar ca këngë popullore, — tha Sotiri dhe shtypi butonin. U ndie një timbër i gëzuar, pastaj një melodi epike e shoqëruar me tingujt e çiftelisë dhe zërat e mprehtë të një okteti burrash që pushtuan dhomën. — E njihni këtë këngë?

— E kam dëgjuar, por titulli s'më kujtohet.

— Kënga e Shqipeve. Këndohet me zëra të fuqishëm. Është një nga këngët më të lashta të popullit tonë dhe një nga më të bukurat ndoshta dhe në botë. Mua më pëlqen shumë.

— Ndoshta ngaqë ka të bëjë me trimërinë dhe me shqiponjat, kjo këngë na është ngulitur në gjak, inxhinier.

— Prandaj ne bijtë e shqipes jemi të guximshëm dhe sypatrembur.

— Kjo është e vërteta. Në përgjithësi kështu është, por ka edhe ndonjë të lig që nuk e meriton këtë emër.

— Po ata janë të rrallë, inxhinier!

— Por janë të rrezikshëm, sepse me egoizmin e tyre profesional frenojnë mendimin e iniciativat krijuese të masës.

— Atyre që e bëjnë me qëllim, duhet t'u shtypim kokën, kurse të gabuarit duhet t'i sqarojmë, t'i bindim, prati'ndreqim, — tha Arbeni. Sotiri miratoi me kokë. Në dhomë hyri e shoqja. Viola, një grua simpatike e veshur thjesht. Rrobat e saj ndritnin nga pastërtia.

— Mirë se na erdhët!, — tha ajo dhe i dha dorën Arbenit.

— Viola, ky është Arben Korça, iniciatori i linjës së gjilpërës!

— Gëzohem që na keni urdhëruar në shtëpi. Më ka thënë Sotiri për guxminin e këmbënguljen tuaj. Për ndërtimin e gjilpërës flet i gjithë qyteti.

— Me ndihmën e të gjithëve po arrihet fitorja e linjës së gjilpërës. Unë jam vetëm një bashkautor i kësaj linjeje. Pa kujdesin e organizatës së Partisë, pa përkrahjen e kolektivit dhe të drejtorisë asgjë s'do të arrija të bëja në këtë drejtim, — tha Arbeni flakë i kuq në fytyrë.

— Egoizmi profesional, uni, e prish njeriun, e çorodit atë në mendime dhe në veprime, Sotir, — tha Viola.

— Po, Viola, vërtet e çorodit dhe e vë kundër interesit të përgjithshëm të shoqërisë. Dhe egoizmi profesional shpesh nxjerr krye te intelektualët e paformuar, — pohoi Sotiri.

## 5.

Sofie Korça e priti të birin me qortime të ashpra. Ajo e shihte se Arbeni, ca nga preokupimi i tepërt, ca nga puna me orë të zgjatura, çdo ditë po binte shumë nga shëndeti. Kishte frikë se një ditë ai do të zinte shtratin dhe pastaj edhe puna do të mbetej në mes të udhës dhe keqdashësit do të hapnin gojën.

- Nuk i ke tamam trutë në kokë ti, or bir!
- Nënë!
- Kështu më thërret edhe kur sëmuresh, por ka ku-  
fi gjithçka!, — i foli përsëri ashpër.
- Se mos jam duke punuar vetëm unë!
- Për të tjerët ka kush interesohet, po ti ke ikur nga shtëpia që në gjashtë të mëngjesit dhe më kthehesh në mesnatë. E sheh si të janë groposur sytë!
- Nuk isha në punë deri tani.
- Po ku ishe?
- Kaq gjë nuk e merr me mend ti, nënë?
- Më marrsh të keqen më marrsh, kush t'i hedh qu-  
rat?!
- Ja pra, me të isha!
- Margaritën?

Tani Sofie Korça u dorëzua. E hëngri trillin e tij. Arbeni nuk ia dilte dot, se çdo ditë dilte nga shtëpia me natë dhe kthehej në orët e vona të natës, prandaj detyrohej që ta qetësonte me atë mënyrë që ajo e pranonte më mirë.

— Kur éshëtë puna kështu, pse nuk më thua, qumësht i djegjur, i ciknosur?!

- Po ti më prish gjakun apo vij në shtëpi!
- Hé, se i shton gjérat ti.
- Ke të fala prej saj.
- Të fala?! C'më duhen ato mua, i thuaj kur do të vijë në shtëpi.
- Nënë!
- E de, e! Fundja nuse do ta marrim, nuk e lëmë në mes të rrugës!
- Si flet ti, nënë, si ato gratë e babaqemos!
- U më marrsh pleshtat, se ato që ti i quan gra të babaqemos kanë rritur heronj!, që ti s'u afrohesh gjëku-ndi!
- Pse, si të dukem unë ty?, — pyeti Arbeni. — Nuk ta mbush syrin?
- Nga binaja po, o tutkun-tutkuni, por nga të tjerat jo. Ti më duket se edhe Margaritën nuk e qeras një herë.
- Ajo ka rrogën e saj dhe më të madhe nga unë.

— Nuk ma hedh dot mua, nuk ma hedh. Të shoh në sy se nuk ke qenë me të, por po më gënjen!

— Të betohem që me të isha.

— Hiç mos u beto. Të dalësh natën nga shtëpia dhe të kthehesh në mesnatë. Unë që nesër në mëngjes do të shkoj te Miha dhe do t'ia them të gjitha. More vesh? Po, po, do ta bëj edhe atë që të mos dijë se nga të futet. Pse kështu punon njeriu??

— Pse flet kështu, nënë?

— E si të flas ndryshe me ty, mor bir?

— Kështu ma prish qejfin, nënë.

— Ty të prishet qejfi, por mua gjaku!

— E çfarë të bëj unë?

— Të martohesh!

— Po të thashë një herë se do të martohem!

— Bukur, shumë bukur, t'i dërgojmë krushqit!

— Oho! Pa mbaruar atë punë që kam filluar nuk e shpall fejesën.

— Por ajo punë mund të vazhdojë dhe dhjetë vjet, mor djalë!

— Ajo do të përfundohet së shpejti dhe atëherë unë e ti do të bëjmë dasmë.

— Luaj nga vendi, luaj nga vendi, pse deri atëherë do të presë nëna pa nuse në shtëpi?

— Punët e mira bëhen ngadalë.

— Mirë, mirë, lëre tani këtë bisedë! Unë e dua të mirën tënde, po ku dëgjon koka jote!

— Më hahet bukë, nënë!, — tha Arbeni që e kishte prerë uria.

Në odën e vogël Sofie Korça kishte sajuar kuzhinën. Një kuzhinë e thjeshtë, me një raft prej dërrase, që vite më parë e pat mbërthyer Koço Opingari në oborrin e gjerrë të shtruar me plloça. Këtë Koçoja e kishte bërë shpejt e shpejt sikur ta ndiqte njeri prapa. Megjithatë rafti pat dalë i mirë e Sofie Korça mendoi se ai mjeshtër me ato pëllëmbët e mëdha që përdorte me aq shkathtësi çekanin, zdrukthin, sharrën e sqeparin, i kishte duart flori.

— Ky raft do të ngatërrojë dynjanë, — tha atë natë Arbeni.

— Pse?, — iu përgjigj ajo e habitur.

— Do të thonë bota që është që në kohën e ilirianëve, gjetur në ndonjë gërmim arkeologjik.

— Ku të shkon mendja ty, apo mendon si disa ta bësh prej metali?

Sofie Korça pat parë në ndonjë shtëpi të shoqeve të saj rafte prej metali. Ato ndërtoheshin shumë shpejt duke salduar me elektrogjen shina në formë lëje, e pastaj distancat mes tyre prej hekuri tetësh. Sofia e kishte nuhatur që ajo punë mbante erë spekulimi, mbasi në shtet nuk shiteshin, e ajo shtet quante dyqanet e shitjes së orendive të ndryshme dhe e këshilloi Arbenin që sakën se sillte ndonjë raft të tillë në shtëpi, sepse ajo, jo vetëm që nuk do ta pranonte, por do të lajméronte menjëherë komitetin e partisë.

— Sa të prishet gjaku ty, nënë!

— Më prishet që ç'ke me të, se çdo gjë është vënë me djersë e gjak dhe disa pa derdhur edhe një pikë djersë marrin gjërat e shtetit e sajnjë për vete. E ku i çon mu-shka? Po ju komunistët çfarë bëni? Pse nuk i mbërtheni për gryke?

— Ne i mbërthejmë, po ata duhet t'i mbërthesh edhe ti, e jo t'i mbyllësh sytë dhe të më hakërrrehesh mua!

— Pika, po si ta nxjerr goja këtë fjalë!

— Shaka, shaka, vetë më ke thënë se duhet shakaja që të zbohet lodhja!

— Por shaka, o kungulli i nënës, e jo ofeza!

— Unë nuk të kam ofenduar!

— Mirë, mirë, por nganjëherë nuk di të përbahesh e kam frikë se mos kështu i shfrenuar flet edhe përpara shokëve, sepse një gjuhë e shfrenuar, ta dish që qorollis të zotin më shpejt se një kalë i harbuar!

— Filozofe je ti, nënë!

— Sigurisht që e tillë jam, se unë kam punuar dhe kam mësuar ngajeta. Kam mësuar nga të tjerët, por edhe të tjerët nga unë.

- Kursin e analfabetizmit nuk e mbarove deri në fund dhe në shkollën shtatëvjeçare me zor të shpunë.
- Kush t'i ka thënë këto?
- Ti më ke treguar.
- Talesha me ty dhe ti amin o hoxhë!
- Mbase tallesh edhe tan!
- Nuk kam asnë arsyë të tallëm, por më habit koka jote që është nganjëherë gdhe. Si nuk të shkon në mendje një herë se ti nuk do të bëheshe i mençur, i ditur si ata shkencëtarët e mëdhenj që bëjnë makina, po të mos kishe për damar një nënë si mua, po një duduken? Si nuk të shkon pak mendja, o derdimen?
- Unë i kam ngjarë babait.
- Xhanëm dhe atij i ke ngjarë, por më shumë ke rrëmbyer nga unë!
- Të pëgen ta thuash, apo kështu është?
- Ti je kopja ime, por nganjëherë sepse i ngjan babait, dhe a e di se kur? Kur bëhesh nevrlik, tëpkë si ai, që ndjesë pastë dhe i ndrittë shpirti atje ku është!
- Unë nuk besoj të kem ngjarë nga ti, sepse nuk kam fjalë shumë.
- Hëm, hëm... — Ajo u prek, sepse e shkeli në kallo. Pastaj, si të dojë që të ndryshojë bisedën e nisur tha:
- Më mirë tregomë se si janë punët, a ta mbaroi atë kulaçin ai krushku?
- Kë kulaç, nënë?
- Atë kolendrën që duhej të derdhë.
- Ti e ke fjalën për torsin e makinës?! — Ai qeshi me të madhe sa u tund shtëpia e lot i dolën nga sytë.
- Pusho! Ngrite të gjithë mëhallën në këmbë, i prishur nga mendja që je! U bëre burrë për fëmijë, por dhe fëmijë nuk ke, nuk ke as mendje!
- Ku të shkon mendja, moj nënë!
- Nuk më shkoi mendja mua jo. Por në furrën e bukës sa hyra unë dhe filluan të më vështronin gratë që e lanë fjalën e zënë qysh më parë. Siç duket gojë më gojë edhe popullit i ka vajtur në vesh puna që po bën ti, «shkencëtar».
- Po ku e di se flisin për mua?
- E po unë nuk merrem me magjira de!...

## KAPITULLI I NËNTËMBËDHJETË

### 1.

Arben Korça vizitoi makinën e kollarisjes. Shakaja e Torit që ndonjë ditë ajo makinë, «prishanikja» gjermane, mund të nxirrte të kollarisur Margaritën, e nxiti atë që të takonte njëherë vajzën dhe të merrte vesh prej saj se si qëndronte puna e heshtjes, largimit dhe vështirësive të reja që i dolën përpara. U kthyte në repart i heshtur. Aty nuk pipëtinte asgjë. Miza të fluturonte, ndihej. Vështroi makinën e kollarisjes. Ajo ishte e montuar plotësisht. Arbenit iu kujtua riparimi i përgjithshëm i makinës së kollarisjes, riparim që kërkonte çmontimin e të gjitha deta leve, pavarësisht nëse ndonjëra prej tyre nuk kërkonte riparim të pjesshëm ose kapital.

Djaloshi u shqetësua për Margaritën. Kishte kaluar një javë pa e takuar. Ajo javë atij i ishte dukur tepër e gjatë dhe e mërzitshme si ato romanet prej pesë-gjashtë-qind fletësh që u ke lexuar titullin, por nuk gjen kohë t'i lexosh.

U ndie një qeshje e gjatë plot shpoti e gëzim, por ai nuk e ktheu kokën prapa, sepse, po të qe se e qeshura e dëgjuar ishte e Margaritës, sigurisht që ai do ta njihte e do të kthehej.

Përpara tij kaluan dy vajza, të cilat shkuleshin së qeshuri, por ato ndeshën në vështrimin e tij, e prenë të qeshurën.

Arben Korça shpejtoi hapat dhe ngjiti shkallët me nxitim. Shkoi në zyrën e saj, por dhe atje nuk e gjeti. Atëherë filloi të kërkonte në të gjitha zyrat, por nuk e ndeshi gjëkundi. I dukej sikur Margarita të qe zhytur thellë nën tokë, si një mineral i rrallë.

Në zyrën e shefit të remontit ai ndeshi në vështrimin e ftohtë të Stefan Grabovës. Sytë dhe vështrimi i tij Arbenit iu dukën si sy dhelpre me një vezullim të metaltë. Arbeni eci nëpër korridorin e gjatë, i ndjekur nga vështrimi i tij dhelparak që tregonte se lufta e tyre e filluar për linjën e gjilpërës do të ishte e ashpër dhe prej atij ai nuk duhej të priste asgjë tjetër, përvëç dhelpërive që fshiheshin në vështrimin e ftohtë të Stefan Grabovës.

Në zyrën e Tori Pinit ai ndeshi në djelmoshat që, të mbledhur kokë më kokë, po vështronin në një pikë makinën e vatës të hedhur në kartë që në fillim nuk u shonte në mend që të kishte aq yçkla.

— Qëndroni, Arben. Kam një fjalë për ju!

Arbeni ngriti vetullën e majtë, gjë që tregonte habinë e tij.

— Lajm i mirë, apo i keq? — Ai nuk e fshihte dot nervozizmin.

— Ja, mbarova me djemtë.

Ata Arbenin e vështruan me respekt dhe nderuan me grusht. Ai së bashku me Tori Pinin, i cili e kishte futur krahun, dolën përjashta. Dukej se Arbeni ishte i pezmatuar.

— Ç'ke kështu, Arben? Nuk je si herët e tjera!

— Kërkoj Margaritën, por...

— Prandaj je i shqetësuar, ë? — Në tonin e tij Arbeni ndjeu një notë qortimi.

— Ka ditë që s'e kam takuar, — tha Arbeni që nuk e mendonte se shpërthimi i vrullshëm i ndjenjave të tij nuk e prekte aspak Tori Pinin, që shkrihej edhe ai në punë.

— Ta rrëmbyen, miku im, ta rrëmbyen!

Çfarë fliste kështu ai Tori Pini? Kush e kishte rrëmbyer Margaritën? Çishin ato shakara të rënda që po bënte Tori Pini? «Kohët e rrëmbimeve kanë vdekur një-

herë e përgjithmonë në Shqipëri», — mendoi Arbeni.

— Kush e rrëmbeu?

— Nuk më kuptove një herë drejt, o derëzi, se ku të shkon mendja e ja, e merr kallëp një shaka që bëj unë!

— Si të kuptoj drejt, kur të besoj deri në marrëzi.

— Si ata besimtarët e tempujve të lashtë.

— Tori, lëri tempujt, mua po më zien koka!

— Nuk e marr vesh përsë po të zien koka ty.

— Si vete puna kështu! Ja dhe ti që dukeshë më i urti, më i miri, ke filluar të më vësh në lojë, ë?

— Pse mos po tallem unë me ju?, — u habit ai.

— Ke një orë që po tallesh, më trego se ku është ajo.

— A! Po keni të drejtë, Margaritën e morën në Tiranë.

— Përse?

— Arben, më mirë kësaj pyetjeje t'i përgjigjet vetë ajo!

— Po ju diçka duhet të dini!

— Ndoshta, por nuk është as koha, as dhe vendi për të biseduar këtu. — Ai kërkonte si e si ta tërbonte atë.

— Më tregoni, Tori,

— Ju jeni ndërtuesi i linjës së gjilpërës, duhet të vrisni më shumë kokën për ta gjetur.

— Përsëri fillove nga shakatë!

— Çfarë të bëj?

— Por mos harro se të gjitha në këtë botë paguhën...

— A! Jo kështu. Hakmarrja është e ndaluar. Ajo i takon së kaluarës. Ne bashkë jemi shokë, apo jo?

— Përderisa ju po talleni, më falni, se unë po iki. Arbeni e mposhti më në fund Torin që ishte mbrehur për shakara.

— Iku në Tiranë, e kam shumë seriozisht.

— Përse?

— Nuk e di, dëgjova që e thirrën në ministri.

— Në ministri?

— Siç duket e kanë thirrur për çështjen e gjilpërës.

— A!

— T'u mbush koka?

- Ja kështu të më flisje qysh në fillim.
- A e di se ku kam arritur unë me makinën e vatis?
- Jo! Pse?
- Që të gjëzohesh.
- Unë kam hall, Tori, nuk di se ku do të gjej një elektromotor të vogël, qoftë dhe gjysmëkuaj fuqi.
- Për këtë çështje e kërkon Margaritën? Kaq fuqi ka dhe zemra, shejtan!
- Zemra është pompë e jo elektromotor.
- Béhet pompë kur bashkohet me atë tjetrën, për shpirt të nënës në të gënjej.
- Sot se si je ti, Tori!
- Jam i gjëzuar. Por të këshilloj të kërkosh ndihmë tek inxhinier Sotiri, ose më mirë akoma tek Adriani!
- Vallë do të më japid ndihmë ata?
- I ke acaruar dhe me ata marrëdhëniet?
- Jo, por ti e di që ata besuan thëniet e Stefan Gavovës që linjën e gjilpërës e quan një èndërr të bukur.
- Të jap një mendim. Shko tek Adriani dhe filloja bisedën anës e anës. I fol për artet figurative, për tablotë klasike, për Mikelanxhelon, Leonardo da Vinçin, piktorët e mëdhenj të botës si Rafaelon. Ke për të parë që do të rregullohen urët për të ndezur zjarrin e miqësisë me të.
- Këshillë e bukur, për besë, duhet të bëj shkollën e artit, pa t'i mbaj mend të gjithë këta piktorë!
- Ju i rrini prapa bisedës, fundja vij unë dhe e katranoj të gjithë punën!
- Paske kohë sot për shakara, unë ika, se më presin të gjitha ato punë.
- Qëndro dhe pak. Përse je i vrenjtur? Fundja një motor elektrik gjysmë kalë-fuqi e gjejmë në komunale. Në vend të tij marrim një gjysmë kali. Ja që puna u zgjidh.
- Falemnderit për kujdesin tuaj! — Arbeni e tërhoqi fort derën dhe doli me rrëmbim. Përjashta ai u ndesh me Margaritën që po bisedonte me Marikën. Zëvendësdrejtoresha seç përtypëtë në gojë dhe ai, kur u afroa pranë

tyre, dalloj mes buzëve të saj një fill, po që nuk dihej se si ngjitej deri atje e lozë me buzët e saj.

— Kujto qenin e bëj gati shkopin, — tha ajo duke e flakur perin e bardhë e duke vënë buzën në gaz!

— Kam plot një orë e gjysmë që po të kërkoj! — Ai e vështroi Margaritën. Fytyra e saj e tretur tregonte qartë se asaj punët nuk i shkonin dhe aq mirë.

— U bëmë si ata që humbanin duke kërkuar njëri-tjetrin. Ne dolëm njëherë nga reparti i interlogëve së bashku me shoqen Marika. Atje kanë filluar të harxhojnë shumë fill!

— Kjo vjen ngaqë u hoq shpërblimi i tejkalimit.

— A thua? — Marika u habit. Si ishte e mundur që mekanikët e turneve të mos e kuptionin thellë dobinë e heqjes së atij shpërblimi?! Por ajo harronte se kishte ende njerëz që përpara xhepit të tyre asgjë nuk u hynte në sy.

— Atë mendoj dhe unë, — u shpreh Margarita.

— Si është e mundur?, — habitej Marika.

— Kështu është, shoqja Marika.

— Po të jetë kështu, shoku Arben, përgjegjësia bie mbi ne komunistët që nuk kemi sqaruar mirë mekanikët e turneve për shkurtimin e këtij lloji shpërblimi.

— Mbeturinat kanë rrënëjë të thella, që nuk shkulen pa vështirësi e dhëmbje. Por ato doemos duhen shkulur me rrënëjë.

— Ashtu është, Arben. Metali duhet të pastrohet mi-ri nga skoriet.

— Ato duhet të shkulen nga ndërgjegjja e të gjithë neve, shoqja Marika.

— Ju keni të drejtë. Ato duhet t'i shkulni te vetja, pastaj te shoku.

— Mos ju shqetësoj?, — pyeti Nesti, shefi i llogarisë, që dukej i rënduar nga pesha e mendimeve që i zienin në kokë.

— Urdhëroni!, — tha Marika. Ai u dha dorën.

— A mund të na shpjegoni, shoku Nesti, se si është e mundur që të ketë shumë firo në interlogët?

— Mos u lodh shumë, shoqja Marika. E di se ku çalon ajo punë dhe kush i ka fajet?

— Mos do të thoni dhe ju për heqjen e shpërblimit?

— Ai është shkaku.

— Po më çuditni!

— Mos u çudit aspak, sepse çdo gjë e re nuk mund të zërë vend në jetë, po s'u ndesh fort me të vjetren. Ja, u hodhën të rinjtë mekanikë dhe kërkuan në mbledhje që dhe ata të bëjnë diçka si Arben Korça. «Ai po lufton që të ndërtojë linjën e gjilpërës, por ne, si të rinj a nuk duhet t'i presim festat e klasës punëtore me duart plot?», — thanë ata dhe morën iniciativë për shkurtimin e atij shpërblimi. — Disa teknikëve të interlogëve nuk u erdhë mirë, prandaj dhe ndodh kështu. Por me punën tonë edhe ata do t'i vëmë në rrugë. Edhe ata do të shkrihen në këtë lëvizje. Jo për t'i bérë qejfin, por Arbeni me iniciativën e tij për linjën e gjilpërës ka futur një lëvizje të gjallë në të gjithë kolektivin. Kjo frymë, kjo lëvizje për të prodhuar çdo gjë në vend, për të çarë blokadën, po përhapet me shpejtësi jo vetëm në qytetin tonë, por edhe në të gjithë vendin.

*Arbeni po qëndronte si në thumba. S'po i pëlqente zgjatja e asaj bisede, por po i vinte rëndë t'ia priste.*

— Po ju, shoku Arben, çfarë ju shqetëson?, — tha Marika:

— Kam nevojë për Margaritën. Kam ndeshur në një pengesë të re. Më duhet një elektromotor gjysmë kalë-fuqi!

— Kur flitet për teknikë, e kuptoj se jam e tepërt, — tha Marika dhe u largua bashkë me Nestin duke lënë Arbenin me Marikën.

## 2.

Tori Pini mendoi se puna më e mirë për të siguruar makinën e gjuhzës me atë elektromotor të rëndësishëm do të bëhej vetëm atëherë kur në vallen e menduar aq

mirë prej tij të futeshin edhe inxhinierët Sotir Fillo e Andrea Bunça. Atëherë fitorja do të ishte e sigurt. Prandaj, sa u largua Arben Korça i vrënjtur dhe i zemëruar më shumë nga shakatë e tij fare pa kripë, u ngrit nga zyra e drejtimin e mbajti nga zyra e Mihës. Por sekretari i Partisë nuk ndodhej atje dhe ai vendosi të shkonte nga magazina e Dhosi Qafëzezit.

Në magazinën e myllur, ai ndjeu zëra. Siç dukej Dhosi Qafëzezi rrihte ndonjë problem të rëndësishëm në bisedën e tij, prandaj dhe e kishte myllur derën e magazinës së madhe. Tori Pini nuk e kishte zakon të përgjonte, por posa deshi të largohej, u ndesh me inxhinier Sotir Fillon.

— Ku shkoni, inxhinier?

— Te Dhosi.

Tori Pini ndjeu kollën e thatë të Miha Voskopojës dhe zërin e tij që po bisedonte me Dhosi Qafëzezin. Mendoi që çështjen e elektromotorit për makinën e gjuhëzës t'ia thoshte aty për aty e shtruar inxhinier Sotir Fillos. Le ta provonte një herë, pa le të dilte si të diltë puna e elektromotorit.

— Sa mirë që u takuam!

— Përse?, — pyeti Sotiri si me habi.

— Arbenit me shokë u ka dalë një pengesë lidhur me vënien në funksionim të makinës së gjuhëzës. Ai ka nevojë për ndihmën tuaj. A mund ta ndihmoni atë djalë që po shkrihet për të ndërtuar linjën për prodhimin e gjilpërës?

— Për Arbenin nuk kursehem. Me iniciativën time, vetëm për ta ndihmuar, i kam bërë dritat e neonit në oficinë. Ai punonte natën vonë dhe nga dritat e forta rrezik t'i prisheshin sytë. Mendova ta ndihmoja disi, por pa i rënë fare në sy.

— Domethënë indirekt qenkeni angazhuar edhe ju për linjën e gjilpërës, ë?

— E dini se më pëlqeni shumë ju, Tori, sepse flisni ashpër, por ama drejt e në sy!

— Kështu duhet, sepse kështu e ndihmon shokun.

- Nuk të mora vesh, përse ka nevojë Arbeni?
  - Për linjën, makina e gjuhëzës paska nevojë për një elektromotor gjysmë kalë-fuqi.
  - Ho, ho!, — u habit ai.
  - Pse habiteni?
  - Hajde të gjesh një motor të tillë!
  - Duhet të bëjmë çmos që ta gjejmë.
  - Ku ka se?
  - Ta bëjmë vetë!
  - Sa lehtë të duket ty, o Tori Pini!
  - Dikush duhet ta bëjë këtë vogëlimë.
  - Inxhinier Adriani po... .
  - Shkojmë tek ai?
  - Shkojmë, por për besë vështirë ta marrë përsipër.
  - Kurse unë mendoj se edhe ai duhet ta ndiejë për detyrë, bile ta ketë për nder që të kontribuojë diçka për linjën e gjilpërës, për luftën kundër bllokadës, sepse edhe prodhimi i gjilpërës në vend kontribuon shumë për çarjen e bllokadës. Kjo duhet kuptuar mirë nga secili prej nesh, inxhinier!
  - Po, çështja e gjilpërës avash-avash na hyri në kokë dhe po bën një transformim.
  - Për cilin transformim flisni, shoku Sotir?
  - Për atë që ndodh në ndërgjegjen tonë e të gjithë këtë lëvizje e solli Arben Korça me iniciativën e këmbënguljen e tij. I lumtë!...
  - Shkojmë nga Adriani?, — i tha Tori Pini inxhinerit dhe e vërejti nëse mendimin e shprehur për atë lëvizje dhe autorin e saj e kishte me bindje apo ironizonte.
  - Po, po, shkojmë!
- Nuk vazhduan gjatë dhe inxhinier Sotiri ndaloj hapat e, duke vështruar me një fytyrë të përvuajtur, i foli Torit:
- Mos keni ndonjë aspirinë? Më dhëmb koka.
  - Mos pini aspirinë, ajo nuk do t'ju ndihmojë për

kokën. Më dëgjoni mua, inxhinier! Aspirina të prish stomaçun.

Soti Filloja e vështroi njëherë me indiferentizëm atë kundërshtar aspirinash e vazhdoi rrugëën më poshtë.

Adrian Bunça i priti ata hundë e buzë duke vënë shpejt në sirtarin e tavolinës katalogun e hapur. Bile ai që ata të mos e zinin me të në dore shpejtoi mbylljen e sirtarit dhe vrau gishtin e madh të dorës. Ndjeu një dhembje në thoin e gishtit të madh e pastaj një inat që mezi e përbajti. Ta marrë dreqi, ta marrë, ku e gjetën kohën dhe këtai!».

— Uluni, uluni, — u tha Adriani duke hapur krahët si polici në kryqëzim të rrugëve ku orienton automjetet.

Tori e Sotiri u ulën përkarshi tij, por në kënde të ndryshme. Ra një heshtje, që i shqetësoi të tre. Sotir Filloja, ngaqë nuk dinte se çfarë të bënte, e ndezi njëherë cigaren.

— Flisni, ju heshtët si memecë!

— I zoti i shtëpisë duhet të ngasë fjalën. Atij i takon të hapë bisedën. Këto janë tradita të vjetra!

— Por dhe konservatore. — Adriani u hoq sikur ai nuk gjëndronte dhe kaq larg nga fundi i kolonës së marshimit.

— Shtytja e bisedës bën pjesë në cilësitë e mira të popullit tonë. Për këtë të garantoj se nuk është aspak konservatore një traditë e tillë!

Nga jashtë u ndie biseda e tri grave. Biseda e tyre vinte lart te zyra e tyre e ngrohtë. «Posi! Ju keni nevojë, Kristavgji, ju sa herë që keni nevojë vini dhe më luteni, jeni grua e habitshme, por unë nuk kam për t'ju ndihmuar, kaq ta nxjerrësh dhëmbin, jo dhe jo!».

Një shqetësim i pat kapur që të tre punonjësit e zyrës së remonteve.

— Ç'erë ju ka sjellë në zyrën time, shoku Tori Pini? Ju deri më sot nuk ma dinit zyrën. Sikurisht ndonjë hall, ë?

— Hall! Jo, shoku Adrian, ju nuk u shprehët drejt, megjithëse halli është mes gjithë arsyeve që na sollën këtu!

— Ju gjithmonë i keni mirëpritur miqtë për vizita të tilla, koleg! — Në zërin e inxhinier Sotir Fillos ndihej një qortim i lehtë për nxitimën e tjetrit.

— Në qoftë se vizita juaj është thjesht një vizitë si midis shokëve, atëherë unë duhet të bëj autokritikë.

— Kjo tregon se po futeni në rrugë të mbarë, inxhinier, dhe ta dini se njeriu e ka vetë në dorë për të hyrë në këtë rrugë!

— Ju e bëni tjetrin për të qeshur, shoku Tori Pini!

— Ashtu? Por ja që natyra më ka pajisur me disa lehtësira të tilla për të mbledhur copkat, copkat e humorit!

— Nuk mund të dilni dot nga vetvetja. — Sotiri Filloja qeshi. Ai kishte një natyrë jashtëzakonisht të ndjeshmë!

— Jo për t'ju bërë qejfin, po jeni «shejtani» vetë, i dashuri Tori Pini!

— Pse? Mos vallë që kur zhvilluam bisedën për Koloseun e Romës ju keni ndryshuar mendim ndaj meje? — Tori e kapi në plagën tek ndihej dhëmbja më shumë në ndërgjegjen e Adrianit.

— Ndoshta!

— Më pëlqen sinqeriteti juaj.

— Kemi ardhur për një motorino gjysmë kalë fuqi.

— Më lehtë është për të gjetur një kalë se gjysmë kali.

— E kemi sinqerisht!

— Për kë e do me kaq ngut?

— Për makinën e gjuhëzës.

— Për Arben Korçën, ë?

— Jo për Arben Korçën, po për linjën e gjilpërës, inxhinier!

— Njëlloj është.

— E ju njësoni makinën e gjuhëzës me Arben Korçën?

— Nuk njësoj, por nënkuptojoj.

— Po Arbeni me shokë nuk po luftojnë për lavdi personale, po për interesin e përgjithshëm!, — tha Tori Pini dhe lëvizi pakëz trupin nga karrigia ku ishte ulur dhe i hodhi një vështrim të shpejtë e shumë kuptimplotë in-

xhinier Sotir Fillos. Ai vështrim i shpejtë i kërkonte ndihmë.

- Mendoj se kjo është e qartë. Apo jo, shoku Adrian?, — tha inxhinier Sotiri me një ton dashamirës.
- Më mirë të kishit pyetur kolegun tuaj.
- Përse?, — pyeti Tori Pini i shqetësuar nga një pyetje e tillë që nuk e priste.
- Sipas jush ne punokemi për lavdi personale, ë?
- Këtë nuk e thashë, po jeni keqkuptuar, inxhinier!
- Të flasim pa dorashka!
- Gjuha ime nuk ka dorashka!, — u nxeh Tori.
- Mirë, mirë. Por pse nxeheni?
- Nxehem se më keqinterpretoni.
- Ndoshta, por le ta zëmë shtruar bisedën. A e kujtoni atë skenën e mbledhjes së këshillit teknik? Arbeni na ka ofenduar, na ka ofenduar që të gjithë ne, inxhinierët, duke mohuar cilësitë e mira që kemi. Tani ai na shtrin dorën, por kjo është njëlloj sikur të pish ujë në pusin që ke pështyrë!

— Ju, inxhinier, i keqinterpretoni çështjet. Arbeni nuk ka ofenduar njeri. Ai vërtet me iniciativën e tij, më këmbënguljen e tij revolucionare, me novacionin e tij që u mirëprit nga kolektivi dhe u bë nxitje për novacione e racionalizime të tjera, sfidoi konceptet frenuese të Stefan Grabovës dhe të ndonjë tjetri, por jo inxhinierët që luftojnë me gjithë shpirt për të çarë bllokadën e egër imperialisto-rezisioniste, një nga të cilët jeni edhe ju, inxhinier Adrian!

— Mrë, mirëpo Arben Korça na ka quajtur njerëz me koncepte frenuese, keqdashës e konservatorë! Kjo si të duket?

— Arbeni ka kritikuar me të drejtë mendimet e konceptet frenuese të Stefan Grabovës dhe të atyre që e kanë përkrahur, kurse për ju s'ka thënë asgjë.

— Të gjithë na ka futur në një thes.

— E kush t'i ka thënë këto?

— Inxhinier Qendro Kolonja një, Stefan Grabova dy dhe i treti nga klasa punëtore, e kam fjalën për mjesh-

trin Vasfi Dishnica, Apo doni dhe dëshmitarë të tjerë, të cilët të vërtetojnë fjalët e këqija që Arben Korça ka thënë për ne?

- Dhe u ke besuar?
- Përse të mos u besoj?
- Sepse t'i kanë thënë me qëllim të keq.
- Sipas jush ata janë njerëz të këqij?

— Nuk tha kush se janë as të mirë, as të këqij, por në këtë rast ata janë keqdashës, sepse zjarrin e kritikës ndaj koncepteve të tyre frenuese përpinqen ta shpërndajnë mbi të tjerët! Dhe ti e paske ngrënë një kokërr të tillë ulliri!

— Mos fol kot së koti, Sotir! — i tërhoqi vërejtjen Adriani. Inxhinier Sotiri nuk e vështroi në sy, siç e kishte zakon sa herë ia ndërprisje fjalën.

- Ky është mendimi im.

Tori Pini e kuptoi se aty për aty nuk do të nxirrte gjë në dritë, prandaj e pa të udhës që të ngrihet dhe ta linte me kaq çështjen e elektromotorit. Por, përpara se të largohej, Tori Pini mendoi se do të bënte shumë mirë t'i lëshonte ato rrëkerat e furishme që fshihtë si një rezervuar shpirti i tij, dhe duhej t'i bënte të qartë Adrianit se çështja e ndërtimit të makinës së linjës së gjilpërave do të bëhej se s'bën, mbasi atë punë e kishte marrë në dorë organizata e Partisë, dhe tha:

— Unë jam i bindur, inxhinier, se pavarësisht nga konsideratat personale që keni për personin e Arben Korçës, ju do të jepni edhe këtë radhë kontributin tuaj të vlefshëm për linjën e gjilpërës.

Tori Pini i shtrëngoi dorën dhe u largua. Adriani nuk foli, por u bë flakë i kuq në fytyrë. Fjalët e Tori Pinit e vunë në mendime të thella.

### 3.

Miha Voskopoja dhe Kopi Nanushi u shqetësuan pa masë për pengesat e vështirësitë e reja që u dolën ndërtuesve të linjës së makinës së gjilpërës. Ata në fillim nuk

e besonin që mungesa e një elektromotori të vogël sa një pjepër njëkilogramësh do t'u sillte të tilla telashe. Por ja që mbetën në mes të rrugës, e kjo si pér inat të tyre, tanë në kohën e zgjidhjes së të gjitha telasheve, kur pritej nga çasti në çast që të fillonte prova e makinës së gjuhëzës, u doli një vështirësi e re. Margarita e vrenjtur si një natë me stuhi po vështronë me kujdes vendin ku do të vendosej elektromotori i vogël. Ajo po e vriste mendjen se si do ta zgjidhnin atë problem, ku do ta siguronin një motor të tillë, por s'po i binte në të.

— Ku djalin na doli në mes të rrugës një telash i tillë dhe nga një elektromotor gjysmë kalë-fuqi!

— Gjysmat kurrë s'më kanë pëlqyer! — Miha Vosko-poja e tregoi qartë se ai i ka urrejtur njerëzit që i kanë bërë punët gjysmake, njerëzit që punët e filluara i kanë lënë përgjysmë.

— Nuk i ke pasur qejf, nuk i ke pasur qejf! — Kopi nuk e fshehu shqetësimin e tij, inatin e tij.

— Mos u mërzit, Kopi!, — i dha zemër Miha.

Kopi nuk e dëgjoi shokun e tij, sepse të gjithë vë-mendjen e pat përqëndruar në fytyrën e Margaritës dhe mendonte se nga buzëqeshja e saj, nga vrenjtësira e fytyrës së saj fare qartë dallohej edhe mundësia e përgatitjes së elektromotorit që kërkohet.

— Si mendoni ju, Margarita? — Ai nuk duronte sa të merrte përgjigjen e vajzës.

— Diçka e vështirë, shumë e vështirë.

Që ishte punë e vështirë ndërtimi i një elektromotori të tillë, ai e dinte shumë mirë, por Kopi Nanushi nuk kërkonte prej saj vështirësinë e ndërtimit të tij, por mundësinë e ndërtimit të atij elektromotori të vogël që do ta vinte në lëvizje makinën e gjuhëzës, pér ndërtimin e së cilës ishte bërë e po bëhej një luftë e tërë konceptesh. Kopi Nanushi e vështroi dhe një herë me shqetësim Margaritën. Ai vështrim i thelluar iu duk vajzës sikur po thoshte: «Mendohu mirë, motër, mendohu mirë dhe pastaj na thuaj, na trego, na nxirr nga kjo situatë e vështirë, se-pse, po dolëm fitimtarë nga kjo luftë, ne do të triumfoj-

më edhe mbi vështirësi të tjera më të mëdha, do të kapi maja më të larta se linja e gjilpërës!».

— Diçka më kujton kjo madhësi e elektromotorit.

— Ajo doli nga përqëndrimi që i pat kushtuar makinës së gjuhëzës dhe vështroi në sy drejtor Kopin.

Kopi Nanushit në jetën e tij nuk i pat takuar të merrje me mekanikën. Të gjitha problemet e shqetësimet që shfaqeshin në këtë sektor të rëndësishëm ai ia pat besuar Margaritës e vajza si kryeinxhiniere e apasionuar e pat shkarkuar Kopin nga një barrë e vështirë e shumë e rëndë. Ai e kuptonte thellë në shpirt se ajo vajzë e ndihmonte atë në të gjitha anët e tekhkës që ishin probleme kryesore për ndërmarrjen dhe se zotësia dhe aftësitetë e saj dhe të inxhinierëve të tjerë e patën çliruar kombinatin nga shumë shpenzime dhe ecejake të inxhinierëve e të specialistëve të huaj, që për mendimin e tij shpeshherë ua kalonin inxhinierët e specialistët e kombinatit.

— Hë, si thua, Margarita? — Kopi Nanushi dalloi të sytë e saj njëfarë shkreptime shpresëdhënëse.

— Mendoj se dikush duhet ta zëvendësoj këtë tekanjoz që quhet elektromotor.

Kopi Nanushi kishte dëgjuar nga shokët e tjerë e nga inxhinierët për zëvendësimin e llambave, por ja që në teknikë mund të zëvendësoheshin dhe elektromotorët!

— E kush mund ta zëvendësojë?, — pyeti ai me kureshtje të papërbajtur.

Pas mbledhjes së organizatës së Partisë Kopi Nanushi ishte bërë një njeri tjetër. I hedhur mbas fjalës së dhënës në atë mbledhje, atë nuk e zinte aspak gjumi pa e shpënnë deri në fund detyrën e marrë në supe. Në karakterin e tij u zgjuan të gjitha ato energji që ndoshta ia shtypnin dhe punët e shumta e hallet e mëdha të detyrës. Por ja, erdhi Marika Milka dhe ai ia lëshoi një pjesë të peshës së madhe të punëve të drejtorisë, duke mbajtur për veten e tij ato probleme shumë të vështira që vajza do ta ndiente veten të rraskapitur, po t'ia linte dhe ato. Ishte i kënaqur prej saj. Si njeri i brumosur me mësimet e Par-

tisë, ai tek ajo pati një besim të madh dhe nuk kursehej ta ndihmonte që ajo të hynte sa më parë në thellësi të problemeve.

— Sa telash i madh me këtë elektromotor. — Marga-rita po e vështron te si me keqardhje fytyrën e tretur të Arben Korçës.

— Më vjen të çahem. Të vijë puna deri këtu e të mbe-tesh pér një vogëlsirë të tillë?

— Mos u nxeh kot së koti, Arben!

— Jo, shoku Miha, por të ngelesh në vend pér një ditë të tërë! Pér se? Pér një elektromotor!

— Ec dhe gjeje të lutem. — Kopi u hodh nga qoshja e tavolinës së madhe ku mbështetet e nuk vuri re se njolla e naftit ia vulosi pallton e mirë në brinjë.

Shpërthimi i nxituar i Arben Korçës e bëri Kopi Nanushin t'u tregonte Mihës e Margaritës se nuk pat lënë vend pa e kërkuar një vegël të tillë, por ja që nuk gjendej gjékundi.

— Janë vështirësítë e ngritjes këto, shoku Arben, e ju nuk duhet të humbni shpresën ashtu siç shpreheni.

— Interesant, këta njerëz kanë harruar të qeshin, — tha Anastas Kitara. Ai kërkonte të futej mes tyre, por ndeshi në mure të forta e nuk çau dot!

— Na lër rehat, o Anastas!

— Mos u bëj nevrik, çfarë faji të ka Anastasi?

— Jam bëre nervoz, Margarita.

— Qetësohu!

— Ikní, lëreni dhe ju këtë shaka të marrë.

Koço Opingari me ato shputat e duarve të mëdha e tërhoqi djaloshin me dashuri dhe diçka i foli në vesh si një sekret: «Lëri, Anastas, nuk është koha pér shaka!» Anastas Kitara u hutua si kurrë ndonjëherë. Nuk mendonte që ai do të acaronte më shumë atë ambient të thartuar nga mendimet e rrahura deri në atë pikë sa humbi vendin e saj shakaja. Ai që u prek më shumë në ndërgjegjen e tij sigurisht që Arben Korça, por ai nuk e kuptonte se çfarë gafe pati bëre dhe nesër kur t'i shtrohej gjykimit dhe gjaku të mos i hidhej më si pizgë përpjetë si një lodrim i më-

zit në luadh, ai sigurisht që do t'i kërkonte ndjesë për gjithë shqetësimin e krijuar rrëth tij, por vallë a do ta fatle atë Anastas Kitara? Por ja që ngjarjet në atë kohë zhvilloheshin me një ritëm e shpejtësi të rrufeshme.

— Më fal, Anastas, unë të keqkuptova, jam bërë si një kërthnjë tekanjoz që shpërthen ashtu papritur e pa kujtuar si një fëmijë që nuk e kupton shakanë e shokut, — i tha Arbeni pas ca orësh.

— Jo, shef; ndoshta unë pata gabim. — Ai nuk e dinë se ku ta fuste shqetësimin e tij.

— Jo, i dashur Anastas, ti nuk ke asnë gabim.

— Tjetër herë tregohu më i matur, Arben.

— Sigurisht.

Anastas Kitara uli kokën dhe u zhyt në punë së bashku me Koço Opingarin, i cili nuk dihej se si atë ditë nuk ua ndante atë vështrimin e tij syve të egërsuar të Vasfi Dishnicës.

— I shan të tjerët si të jetë një pronar, e pastaj nuk ka turp e u kërkon të falur, — belbëzoi ai mes dhëmbëve pa pasur aspak guxim pér të folur hapur.

— Edhe motorit do t'ia gjejmë anën.

— Inxhinier Adriani mund të na ndihmonte pér këtë problem?

Në oficinë u dha me të shpejtë Tori Pini së bashku me inxhinier Sotirin. Ata iu afroan grupit të heshtur që ishte mbledhur në qoshen ku ngrihej makina e re. Gjendja e heshtur i shtangu edhe ata në vend.

— Të bisedojmë me inxhinier Adrianin. — Kopi; i etur pér të shpënë gjithçka deri në fund, shfaqi mendimin pér ta biseduar këtë çështje me inxhinier Adrianin.

— Është punë e kotë, — tha Arbeni.

— Pse?

— Ai mban anën e Stefanit.

— E ke gabim, Arben, — tha Miha.

— Kam shpresë tek Adriani, — tha Margarita. — Nuk e besoj që ai të mbajë qëndrim indiferent.

— Po vijmë prej andezaj, sapo biseduam së bashku me inxhinier Sotirin!, — tha Tori Pini.

— E çfarë tha Ardiani?

— Ai është i inatosur, shumë i inatosur, shoku drejtor, ndaj Arbenit.

— Linja e gjilpërës nuk është çështje personale e Arbenit, për të po kujdeset organizata e Partisë. Ajo po e ndjek këtë problem!

— Ec dhe ia mbush kokën Adrianit se puna është kështu dhe jo ashtu siç e mendon ai.

— Nuk jam dakord me ju, shoku Arben.

— Mirë, po hesht.

Ra një heshtje e rëndë si një re e ngarkuar, që nga casti në çast dukej se do të shpërthente, do të zbarkonte të gjithë ujin e fshehur në barkun e saj. Dhe ja, ajo ikën duke mos bërë asgjë.

— Nuk po më kujtohet se ku e kam parë një motor të tillë xhanëm! — Margarita rrudhi vetullat e në cepat e syve të saj të mëdhenj u formuan disa trekëndësha të vegjël.

— Pa përpiku se mos vallë të kujtohet!, — i dha zemër si me shtyje Kopi.

— Jo, jo. Nuk më kujtohet.

— Mos ka në magazinë? — Kopi nuk dinte se nga të vërtitej dhe nuk i zinte vendi-vend.

— Nuk ka, kam shkuar kaq herë te Dhosi.

— Ndonjë ndërmarrje tjetër mos e ka këtë motor?

— Mundet, po kujt t'i drejtohem!

— Ai Adriani, ta marrë dreqi ta marrë, si një mikroborgjez mendon e vepron, po si nuk e kupton ai që ajo motorino nuk është për punën time?, — tha Arbeni tepër i shqetësuar. Ai së bashku me shokët kishte punuar ditë e natë derisa kishin arritur të ndërtonin makinen e gjuhëzës. Dhe, po të vështroje me syrin e mjeshtrit, ajo punë e bërë nuk ishte një punë e pakët e dosido, por një punë shumë e vështirë, sepse thyente konceptet frenuese e konservatore, çante bllokadën dhe conte përpara lëvizjen novatore.

Sotir Filloja, duke dëgjuar fjalët fshikulluese të Arbenit ndaj inxhinier Ardianit, uli kokën e nuk foli, por ama në ndërgjegjen e tij Arbenit i jepte të drejtë.

Atë atmosferë mendimesh të heshtura që mbisundonte në ofiqinë ku dëgjohej vetëm zhurma e tornove, pjalave dhe e frezave e prishi fjala që hodhi dikush:

- Iku dita.
- U bë ora dymbëdhjetë, — tha Miha.
- Dymbëdhjetë! Ptu! Iku dita, — tha Kopi.
- Nga puna nuk duket fare se si shkon koha.
- Vërtet që iku dita dhe...
- Më vjen të çahem më dysh, — tha Arbeni.

Ende nuk ishte gjetur ndonjë rrugëzgjidhje. Dialogu shqetësues u ndërpre kur në ofiqinë u dha inxhinier Adrian. Ai vajti me hap të avashtë dhe u afrua pranë tyre si i druajtur me duart pas shpine. I vinte turp që ata ndodheshin në atë gjendje të rëndë e ai shoku i tyre po shkonte me aq vonesë.

— Urdhëroni, inxhinier Adrian!, — i tha Kopi. Adriani nuk dalloi nëse në fjalët e Kopit kishte një respekt, apo një ironi therëse.

— Ja erdha dhe unë, — tha Adriani si të ishte nëën-dërr e nuk përmendej dot.

Përse foli ashtu? Kush i kishte thënë të vinte tek ata? Ja dhe ai, Arben Korça! Sa afér që e kishte, ja, një metër. Ta përshëndeste, nuk ia thoshte zemra, po edhe të mos i fliste, nuk bënte. Po Adriani nuk pat vajtur atje për t'u konsultuar apo për t'i kërkuar falje Arbenit, por për të dhënë edhe ai kontributin e vet si inxhinier, që këtë e bënte me gjithë zemër. «Fundja, këtë s'e bëj për Arbenin, por për popullin, për Atdheun tim, për Partinë që më bëri inxhinier...», — kishte menduar ai me vete dhe kishte vrarë mendjen tërë natën.

— Inxhinier Adrian, ju duhet të dini se ne..., — u nxitua Kopi, por fjalën ia ndau dysh kur Adriani nxori motorinon që e kishte mbështjellë me aq kujdes.

— Bre! Për këtë motorino grindeshim që të gjithë?, — u habit Kopi duke e vështruar me interes motorinon që solli Adriani.

- Kjo!, — dhe sytë i ndritën Arben Korçës.
- Sa mirë!, — tha Margarita.

— Mrekulli! — Miha Voskopoja i hodhi dorën në sup inxhinierit.

— Ta dish, ta dish... Se tē gjithë njerëzit e inxhinieret nuk mund tē futen në një kallëp, o Arben Korça!, — u drodh zëri i Adrianit duke mbuluar Arbenin me vështrimin e tij qortues.

— Jeni keqkuptuar, shoku Adrian, — tha Arbeni serioz me vetulla tē mbledhura.

— Ju lumtë, shoku Adrian! Keqkuptimet sqarohen!..., — tha Miha dhe i bëri shenjë Arbenit që tē mos e zgjaste.

— Ta dini, shoku inxhinier, se ju keni bërë një punë tē mirë, shumë tē dobishme. Ju lumtë! Ja edhe ju dhatë kontributin tuaj tē vlefshëm.

— Jo. Ta dijë, ta dijë Arben Korça, se nuk janë tē gjithë inxhinierët tē molepsur me koncepte frenuese e konservatore!...

— Pse tē merrem me llafe pa bereqet, inxhinier? Debate e luftë mendimesh do tē ketë. E rëndësishme është që secili tē luftojë pér t'i hapur rrugë së resë revolucionare, pér tē pasur besim në forcat tona, në aftësitë krijuese tē klasës punëtore, — tha Miha.

— Mirë. Ju kërkoj ndjesë, inxhinier. Jam gabuar ndaj jush. Këtë e pranoj. Më jepni dorën, — tha Arbeni dhe zgjati dorën e tij si tē kërkonte jo tē pajtohej, por t'i rrëmbente elektromotorin e vogël. Adriani i dha elektromotorin e qëndroi si i shtangur.

— Ne tē gjithë luftojmë pér një qëllim, s'na lejohet t'i mbajmë mëri njëri-tjetrit si kalamanët, — tha Miha Voskopoja. — Arbeni iu afrua Adrianit dhe ata tē dy u rrokin si dy shokë tē malluar prej shumë kohësh, por tē pezmatuar më shumë nga pëshpëshet e ndonjë keqdashësi, sesa nga debatet direkte midis tyre.

#### 4.

Dhos i Qafëzezi e ndiente veten tē lehtësuar nga bisidimi që pati me Miha Voskopojën. Ai ia tregoi fill e pér pe tē gjithë atë propagandë helmuese dhe ofezat e rënda

që kishte bërë Stefan Grabova kundër shokëve të nderruar, kuadrove drejtues të kombinatit. E nga kush se? Nga një inxhinier egoist i mbushur me të gjitha ato vese të këqija. Dhosi Qafëzezit i kishte rënë në sy edhe jeta e shthurur që bënte Stefan Grabova.

Dhosì Qafëzezit i kujtohet gjithçka e asaj dite. Bile ai në kujtesën e tij pat mbledhur dhe avujt e rrugëve të qullura si dhe një fletë të bardhë letre që pat zënë rrjedhjen e ujit të rrëmbyer në ato shkallaret e shkarkimit të gropës së ujit, nga shiu i rrëmbyer që s'po dinte të pushonte atë ditë.

Dhosì ndaloi dhe ngriti çadrën të vështronë se kush ishte ai që e thërriste.

— Të paskan lënë veshët, o «gardian» i veglave të këmbimit!, — i foli Stefani me zërin e tij të shtirur, duke e vështruar me ata sytë e mjegulluar e të përqullur.

Ashtu i lagur si mos më keq, inxhinieri që i buzëqeshët me dhëlpëri iu duk Dhosit si një kandil deti i nxirë që kërkon të zhdukë me çdo kusht kundërshtarët e tij. **Një mendim i tillë se pse ia ngriti qimet e kokës së lagur** Dhosi Qafëzezit.

— Qenkeni ju, inxhinier. Por çfarë pagëzimi më bëtë ju kështu?

— Më të bukurin, për të cilin dhe vetë Remarku do të pëlciste nga zilia.

— Cili është ky Remarku?

— Ti, o «gardiani» i veglave të këmbimit, ti, o ruajtës i shkëlqyer i thesarit të kursimeve, nuk e ditke se cili është Remarku? Atëherë më kot e quani veten të kulturuar!

— Sipas jush, inxhinier, ata që nuk e njojin atë Remarkun tuaj, qenkan të pakulturë e fatkëqij, ë?

— Dhe pyet?

— Juve askush nuk ju hyn në sy, inxhinier!

— Ju po. Me ju ndryshon e gjithë puna. Këtë duhet të ma besoni. Kjo vjen ngaqë për ju kam një respekt të thellë. Prej kohësh ju më keni hyrë thellë në zemër, — i tha Stefani dhe i futi krahun.

- Nga e keni drejtimin, inxhinier?
- Nga e majta e bulevardit.

Shiu po binte me rrëmbim. Ato po ecnin shllap e shllap nëpër ujë. Dhosi kishte ulur çadrën dhe s'po vështronët as dy metra përpara. Më në fund u gjendën përpara një ndërtese, qoshet e së cilës ishin me granil. Në shkallën e mesit të kësaj ndërtese banonte Stefan Grabova, i cili e ftoi Dhosi Qafëzezin për «kafe», por Dhosi nuk pranoi. Mirëpo Stefani iu bë rrodhe dhe s'po e lëshonte. Kështu, më në fund Dhosi shkoi prapa inxhinierit.

Ngjitën shkallët. Dhosit nuk i kujtohet se sa shkallë ngjitën, por ai e mban mend mirë që apartamenti i Stefan Grabovës ndodhej në katin e tretë. Këtë nuk e lozta as topi.

U futën brenda në korridorin e ngushtë. Dhosi ndeshi në errësirën e korridorit, por Stefani hapi dritën. Atëherë Dhosi ngriu në vend nga pamja që i doli përpara. Drita e bardhë qumësht e neoneve gërshtetohej me ngjyrën krem që inxhinieri ia kishte dhënë korridorit, ngjyrë kjo që i jepte asaj pamjeje një ngjyrë të mesme, të cilën Dhosi Qafëzezi nuk e njihte dhe nuk dinte se si ta emërtonte. Dhosi kaloi përmes asaj pastërtie shembëllore, por në kuzhinë ra si në një pus që ishte ngritur si kurth, i cili e fillonte djallëzinë e tij nga ai korridor i ngushtë. Një kontrast i tillë e habit shumë Dhosi Qafëzezin.

Kuzhina që ishte e ndriçuar për mrekulli mbante një erë të thartuar e të qelbur, gjë që tregonte jetën e shthurur që bënte i zoti. Nuk shpjegohej ndryshe që një palë çorape të palara e të forta nga djersa të ishin flakur mbi krevatin e zbuluar e me çarçafë të pisët. Dhosit i zuri syri edhe peshqirin e nxirë, me të cilin i zoti kishte fshirë këpucët. Dhosit i ranë në sy shishet e pijeve të ndryshme, të cilat, të boshatisura, ishin hedhur në fund të kuzhinës.

Stefan Grabova hapi dollapin e mbushur me pijë dhe nxori që andej një shishe me verë.

— Ju pëlqen muzika, moderne — pyeti Stefani dhe hapi radion e po kërkonte stacionin që preferonte.

— Muzika shqiptare po, — gjegji Dhosi me buzë të thartuara.

— Që të pëlqesh muzikën moderne të kohës, duhet të kesh vesh për muzikë, — tha Stefani dhe ngërdheshi buzët ku i dolën dhëmbët e verdhë nga nikotina.

— Mua më pëlqen muzika popullore, se ajo më prek telat e zemrës, o inxhinier. — Stefani nuk foli, por nxori nga dollapi një kuti të madhe me mish konservë. Duke vështruar atë kuti, Dhosit i kujtua ushtria italiane me ato kutitë e mishit, për të cilat thoshin bota se ishin kuti me mish kali.

— Mos u harxhonni, unë ja, vetëm dhjetë minuta kam për të qëndruar.

— Më falni për këtë çrrégullim, ju duhet të mendoni se jeta e beqarit është një jetë e vështirë, apo jo?

— Ju duhet të martoheni, inxhinier.

— Ju keni të drejtë, i dashur, por vajzat e bukura që ne i preferojmë nuk na hedhin sytë, kurse me të tjerat qe na duan nuk mund t'i mbyllim vetes portën. Kështu që kemi mbetur vetëm si korbat.

— Njeriu duhet të vlerësohet nga shpirti, zemra e cilësitet e moralit, po jo nga pamja, inxhinier.

— Cilit moral, i dashur Dhosi? A e dini se ju më pëlqeni, sepse jeni i ditur, një magazinier i mësuar e filozof.

— Po më ngrini lart, inxhinier! Megjithatë më dëgjoni mua, se nuk ju bie keq. Ju duhet të martoheni, sepse jeta nuk shkohet vetëm dhe pa njeri. Unë vetëm pasi u martova kam mësuar ç'është jeta.

Gjatë kohës që Dhosit po i shkonte goja si në gjalpë duke i bërë moral, Stefani e shtroi pijen mbi një tavolinë të vogël me xham të zi, mbi të cilën nga papastërtia formoheshin lloj-lloj figurash.

— Merrni, me këto që na u ndodhën, — tha Stefani dhe ia ngriti zërin radios që po jepte një muzikë çjerrëse që për veshët e Dhosit ishte e padurueshme. Dhosi rrudhi vetullat.

— Mbylleni atë dreq, se na shurdhoi!

— Gjynah që nuk e shijoni, — tha Stefani, që kuptoi shqetësimin e tjetrit.

— Shijet, inxhinier, përcaktojnë rrugën që ke zgjedhur për të ecur! Më duket se...

Stefan Grabova luajti nga vendi, lëshoi pirunin dhe u nxi në fytyrë, po nuk foli. Dhosit i ushtoi në kokë thirrja për vigjilencë. Ajo po i buçiste si një trumbetë lufte. Ishte lufta e klasave.

## 5.

Mbledhja e teknikëve të makinave të çorapeve, të cilët e patën shqetësuar më shumë Marika Milkën, u bë në një nga sallat e vogla të mjeshtërve, që ndodhej në qoshen e repartit të makinave. Filli i bardhë e pa klorofil Marika Milkës i përngjante me kërpudhat e bardha. Por ja që filli po harxhojej tej normativës dhe e gjitha kjo vetëm e vetëm se tekniku Andrea Gripi nuk qe dakord me iniciativën revolucionare që ca ditë më parë kishte marrë rinia e repartit për të hequr shpérblimin mbi normë.

Marika Milka u ul në një stol që ishte një improvizim nga disa masurë të dalë jashtë përdorimit që mjeshtrit me marifetin e tyre e kishin kthyer në një karrige të bukur. Në të majtë të saj u ul një vajzë e re që ishte zgjedhur sekretare e organizatës-bazë të atij reparti.

— Hë, shokë, flisni! Ja ku u mblodhëm për të dëgjuar! Në këtë takim pune të shfaqë secili shqetësimet që ka dhe çfarë mendon për kalimin e pengesave dhe të vështirësive që keni. Këto do t'i rrahim së bashku dhe do t'i zgjidhim së bashku.

Shefi i llogarisë, Nesti, që kishte vajtur në atë diskutim, dinte të hynte si një turjelë në shpirtin e tyre, të sqaronte ata e të bindte ata që nuk e kuptionin rëndësinë e kursimeve dhe të mirat materiale që sillnin ato. Ai foli shkurt e thjesht, fare thjesht, me fakte e shifra konkrete.

— Çfarë të flasim ne? Të na tregojë drejtori pse na e hoqi shpérblimin?, — pyeti njëri nga mjeshtrit.

Në grupin e vogël të mjeshtërve u ndie një lëkundje dhe murmuritje.

— Ajo nuk u pre nga drejtoria, u mor iniciativë nga ju vetë. Apo harruat iniciativën që shpalli organizata e rinisë së repartit, që bën pjesën dërrmuese të këtij reparti, — tha Nesti qetë-qetë.

— Iniciativën rinia e mori për vete, shoku Nesti, por jo për ne të tjerët... Familja ime ka derdhur gjak për këtë pushtet. S'është nevoja të flasin të tjerët për mua.

— Shoku Andrea, edhe ju jeni anëtar i këtij kolektivi. Ne të rinjtë morëm këtë iniciativë që të heqim këtë lloj shpérblimi dhe të kursejmë sa më shumë, kurse ti po vështron shumë interesin personal. A nuk ju frysmezon sadopak mjeshtri Arben Korça që po punon ditën e natën për linjën e gjilpërës pa asnjë shpérblim? Nga ti nuk priten këto llafe, se vërtet jeni familje e luftës, — i tha një djalosh fytyrëhequr.

— Bukur flisni, shoku Stelli! U hodh një i çmendur në lumë dhe ju, o burrani t'i sulemi prapa! Kështu, me të parë Arben Korçën që sheh èndrra në diell, edhe ju, o burrani, do të heqim shpérblimin!...

— Jo kështu, shoku Andrea, ju lutem flisni me respekt për shokët! Arbeni s'po sheh èndrra në diell, ai po ndërton linjën e gjilpërës. Me punën e tij na frysmezon të gjithë, — tha Marika Milka.

— Mirë e ke ti, moj motër, se shpérblimi nuk t'u pre ty, por mua. Dhe ja pasojat, u pre shpérblimi, filloj të harxhohet filli më shumë. Kështu ra prodhimi, sepse humbi interesit.

— Kjo është logjikë e jo shaka!, — u dëgjua një zë femre.

— Ama fjalë!, — foli mjeshtër Llazi i vrenjtur në fytyrë.

— Kështu thua tani, o Llazi, por ama gojën e hape më shumë kur shkove në bordero.

— Me thënë e mos me thënë unë jam me rininë, me thënë e mos me thënë, por ja që Andrea me thënë e mos me thënë, po i ngatërron punët.

- Mbylle gojën, gagaçi i djallit, — iu hakërrye Andrea.
- Andrea, mos ofendo të tjerët, se kolektivi do të marrë masa ndaj teje!. — Marika Milka e vështroi vëngër Andrenë.
- Unë po shpreh mendimin tim.
- Ti po fyen gjithë kolektivin. E kështu nuk të lejon njeri as në mbledhje, as në rrugë.
- Mirë e ke, moj motër, por ama mua më kanë prerë paratë, shpërblimin.
- Unë ia njoh dhe gjuhën, dhe dëshirat Andresë, — tha Nesti. — Andrea nuk e ka të qartë se kujt i shërben heqja e këtij lloj shpërblimi. Nuk e kuption se klasa punëtore mbi interesin vetiak vë interesin e përgjithshëm. Po avash-avash edhe ky do ta kuptojë.
- Dhe ti, Nesti, flet kështu se nuk është prekur interesi yt, se do të flisje ndryshe. — Andrea nuk tërhiqej kollaj.
- Besoj se tani e keni të qartë, Andrea, iniciativën e organizatës së rinisë, — tha Marika.
- Unë nuk jam dakord!
- Kur i gjithë kolektivi është në një mendje me organizatën e rinisë, ti, Andrea, kot ngul këmbë. — Marika filloi të humbiste durimin.
- Ju, Andrea, me këmbënguljen tuaj po bëheni një shembull negativ. Nuk e kuptioni këtë? Sekretarja e organizatës i foli me dashamirësi.
- Shoqja sekretare, ti e di që kam derdhur gjak për këtë pushtet dhe s'kam nevojë të më bësh agjitation mua!
- Nëse ke derdhur dje gjak, sot duhet të derdhësh djersë. Po ti gjithnjë mburresh me xhaxhanë tënd dëshmor, me meritat e të tjerëve!
- Unë kërkoj hakun tim.
- Luaj nga vendi, o derëzi! Pse hakun të kemi ngrënë? Arben Korça me shokë ka plot një vit që po i thartojnë trutë duke vrarë mendjen se si të çajnë bllokadën me linjën e gjilpërës e ne të bëjmë sehir?
- Ra qetësia. Andrea ishte zymtuar në fytyrë dhe s'kishte guxim të vështronë të tjerët në sy. Marika Milka

thithi ajrin që iu duk i ngarkuar nga era e vajit të turbinës dhe nga pambuku.

— Duhet ta pastrosh kokën nga konceptet mikroborgjeze, Andrea, — i tha Marika.

— Borgjezët i kemi shtypur!

— Borgjezët i kemi shtypur, por nga mikroborgjezët lindin borgjezët e rinj!

— Nuk jam dakord! — Andrea e vështroi njëherë me vëmendje Marikën që pati shprehur atë mendim. — Ja, vështro vështro se si na qëndroka puna!

— Ke mendime të nxituara, Andrea, — i tha qetë-qetë Nesti.

— Mirë atëherë më mbushni mendjen pse ka firo të madhe në fije? Përse ndodh kjo rënie?

— Për këtë jemi mbledhur këtu. Ju mjeshtrit e vjetër sigurisht që duhet të keni zbuluar shkakun.

— Shkaku është heqja e shpërblimit.

— Jo, Andrea, shkaku është gjetkë.

— Ku?

— Te vënia e interesit vetiak mbi interesin e përgjithshëm!...

— Pse Arben Korça nuk do të marrë ndonjë shpërblim të majmë, po i doli më anë linjës së gjilpërës?

— Ai nuk e bën atë pér shpërblim. Natyrisht shoqëria do ta shpërblejë atë me stimuj moralë, kurse ti, në vend që ta vrasësh mendjen pér ta çarë bllokadën, të ha meraku vetëm pér shpërblim material, — i tërhoqi vëmendjen Marika.

Andrea uli kokën dhe fshani thellë.

## KAPITULLI I NJËZETË

### 1

Nga pija e shumtë Stefan Grabovës iu varën si qeska rrathët e qepallave të poshtme të syve të nxirë e të zverdhur nga një jetë e alkoolizuar.

Vasfi Dishnicën ai e priste në shtëpinë e vet. Midis tyre shpërthente një bisedë e vrazhdë që shpeshherë përshkohej nga fjalë plot palavi, sepse ata nuk po ia gjenin anën arritjes së qëllimit të tyre. Në orët e vona të natës Vasfi Dishnica si një hije ikte duke u përpjekur të mos binte në sy të kalimtarëve, sidomos nga dilte e ku kishte genë.

Atë natë, posa doli në bulevardin kryesor plot drita, Vasfi Dishnicës i ra në sy parulla e shkruar me shkronja kapitale me bojë të kuqe në ballin e ndërtesës pesëkatëshe përkarshi: «Punë, vigjilencë, mësim!».

Iu kujtua biseda që kishte zhvilluar para ca kohësh me Stefan Grabovën për atë parullë.

— Kjo do të thotë që ne të kemi mendjen, inxhinier, — i pat thënë Vasfiu.

— Mirë thua, po mua më shqetëson largimi nga ne i Qendro Kolonjës.

— Vërtet ka një muaj e ca që Qendroja s'po na afrohet fare. Si shpjegohet, inxhinier?

— Kërmilli thuaj më mirë, sepse Qendro Kolonja

paska qenë një kërmill i ndyrë, por ne nuk e kemi pikasur me kohë.

- E keqja është se ai di shumë gjëra prej nesh.
- E pastaj?
- Po ja, mos i llapë goja gjékundi.
- Kërmilli di ta ruajë kokën e tij.
- Këtë mund ta bëjë pikërisht për të shpëtuar kokën e tij.

— Ai di vetëm për bilën tënde të manganit, që s'arrite ta vësh. U harrua ai marifet. Tani jemi përpara provave të reja. Duhet të mendojmë seriozisht se si t'u hedhim në erë makinën e gjuhëzës, që është kryesorja e të gjithë linjës së gjilpërës. Po s'ia arritëm kësaj, jemi të dështuar e të turpëruar për tërë jetën! Për këtë asgjë s'duhet të dijë Qendroja, as ndonjë tjetër, se na fluturon koka.

- Këtë radhë e kemi më vështirë se kurrë!...
- Deri tani një vrimë në ujë kemi bërë! Vetëm kemi dërdëllisur!

— Ju e dini, inxhinier, që makinën e gjuhëzës e ruajnë natë-ditë. Për këtë interesohen personalisht Miha dhe Kopi Nanushi.

- Ti, Vasfi Dishnica, je zemërlepur, prandaj si me zjarrin, si me bilën e manganit një vrimë në ujë bëre.

— Veprimet tona, inxhinier, qenë të pastudiuara.  
— Jo të pastudiuara, por të mungonte guximi, se je zemërlepur dhe, në vend që t'a arrinim qëllimit, zgjuam vigjilencën e tyre dhe dështuam. Dhe për këtë ti do të përgjigjesh me kokë!

Vasfi u bë dyllë në fytyrë. Nuk dinte si t'i shpëton-te atij kërcënimi. Coi gotën me fund dhe uli kokën mendumeshëm.

- Mos pi kaq shumë, Vasfi, — e zbuti tonin Stefani.
- E ç'të bëj?
- Të vrasësh rradaken se si t'i dalim më anë.
- Murit me kokë nuk i bihet.
- Domethënë të ka hyrë lepuri në bark, ë?
- E ç'të bëj, inxhinier?

— Të hedhësh bilën e manganit në makinën e gjuhë-zës!

— E nga ta hedh?

— Si nga ta hedh? Ti punon në atë repart. E kush të ndalon ty të shkosh pranë makinës së prodhuar, ta shohësh, ta përkëdhelësh, të shfaqësh «gëzimin» tënd përndërtimin e saj dhe t'i hedhësh në gushë bilën e manganim.

— Dhe, kur të bëhet hataja, mua të më vënë kokën në satër, ë?

— Të thashë se je zemërlepur, por, po s'e bëre këtë, atëherë koka jote do të fluturojë se s'bën. Këtë mendoje mirë, Vasfi Dishnica!

— Do të përpinqem, inxhinier! — Vasfiu foli me zë të dridhur.

— Ta rrëkellejmë edhe nga një për suksesin, Vasfi, — tha Stefani dhe i mbushi gôtat, të cilat i çuan me fund. U ndanë.

## 2.

— Ti nuk dëgjon nga veshët, Arben.

— Hë? — Vështroi orën e madhe që ishte në ballin e oficinës. Ajo tregonte mesnatën.

Jashtë nuk dallohej asgjë. Nata ishte e errët pus, kurse në oficinë llamburisnin dritat. Kështu ndoshte zakonisht kur drita e fortë e neoneve ngrihej më shumë nga tensioni i tepërt që vinte i liruar nga pushimi i elektromotorëve që në atë kohë nuk punonin. Vallë sa elektromotorë flinin në atë çast? Sigurisht që shumë duhej të ishin ata gjumashë, po Arbeni nuk po i ndiente gjymtyrët nëse ishin të tijat.

— E di se çfarë po mendoja, Arben?

— Hë?

— Qytetarët janë në gjumë.

— Jo të gjithë.

— E di sa më flihet?

— E shoh se të janë skuqur sytë.

— Ç'farë të të bëj ty që s'më dëgjon? Ti duhet të flesh e të çlodhesh ca orë, Arben!

Arbeni nuk foli, por ndjeu kapakët e syve të rënduar plumb, që ai mezi i përbante, dhe mendoi se vajza kishte të drejtë kur e këshillonte që të flinte. Por të flinte tanë kur dhe për gjashtë orë gjithçka do të bëhej gati, i dukej e pakptueshme, bile e pamundur, sepse ai e dinte që, edhe po të shtrihej në krevat, kurrsesi nuk do ta zinte gjumi.

— As që më shkon mendja për të fjetur. Por po mendoja diçka tjetër, Margarita. Po të jesh e zgjuar, duhet ta gjesh vetë se çfarë mendoja! Nuk e ke të vështirë përtatë gjetur se për çfarë mendoja.

— Për gazetarët.

— Jo.

— Për televizorin

— Nuk ke gjetur gjë.

— Për kinostudion?

— Ehu, sa larg të shkon mendja!

Arbeni me sytë të fryrë nga pagjumësia pati të drejtë që i kujtoi vajzës se zemra e tij nuk përvëlohej përlavdi, përdukje e përmbarje. Ai ishte gatuar nga një brumë tjetër. Nga ai brumi që nuk e hapte dot petësi i lavdisë e ta bënte të hollë të tejdukshëm si një petë të holdlë pa vlerë.

— Atëherë më trego, Arben, përsë po mendoje?

— Duhet ta gjesh vetë.

— Ja që nuk po i bie më të.

— Vallë a do të mundja unë i vetëm të ndërtoja këtë makinë kaq të komplikuar? Pikërisht përkëtë po mendoja.

— Përderisa u zotove përpëra këshillit teknik, përpëra organizatës së Partisë, përpëra kolektivit, ti i kshe matur forcat e tua!

— E ja ku po ta them se pa kujdesin e organizatës së Partisë dhe pa ndihmën e shokëve dhe të kolektivit, unë do të isha turpëruar përpëra të gjithëve.

— Këtë e thua për modesti, Arben, dhe mirë bën.

— Margarita, kjo është e vërteta. Këtë do t'uva them

të gjithëve. Le ta marrin vesh të gjithë se vetëm iniciativa është imja, kurse makina e gjuhzës, linja e gjilpërës është vepër kolektive, fryt i mendimit dhe i punës krijuese kolektive. Së bashtu me mua shkrinë aftësitë e tyre mendore e fizike gjithë ata njesëz të aftë, shumë të pastër nga karakteri, njerëz të palodhur, si usta Naumi, inxhinier Alqi Katro, mjeshtri i rrallë Koço Opingari, tani së fundit inxhinier Adriani. Më fal që s'po të zë në gojë ty, Margarita, Mihën, Kopi Nanoshin, Tori Pinin. Po ata të ndërmarrjeve të tjera që u treguan aq të gatshëm dhe na ndihmuani me mish e me shpirt?

- Arben, meqë ra fjala, atë Alqi Katron sikur e ka zënë qymyri me Marika Milkën.
- Në qoftë kështu, ta dish se Marika Milka ka marrë një djalë të shkëlqyer.
- Por dhe vajza nuk ka të sharë.
- Më gëzove.
- Ti e ke shok të ngushtë, nuk të paska thënë asgjë?
- Nuk ma ka zënë në gojë.
- Këtë lidhje më duket se e organizoi Tori.
- Për të tillë punëra, ai ka aftësi të rralla.
- Ai di t'i bashkojë mirë copat pér kursim.
- Ai di t'i bashkojë edhe zemrat.

Qeshën. Ishte një dialog i shtruar, i mbushur me fjalë të ëmbla, pastaj fjalët u ngjeshën dhe vazhduan rreshtin e tyre ashtu siç e vazhdojnë rreshtin e tyre duke shtyrë shoqja-shoqen shishet në makinën e mbushjes me birrë, që shkumëzon e dallgëzohet gjithë rrapëllimë në shishet.

— Të vjen gjumë? — Ajo e pyeti duke e hapur gojën e saj si një troftë që porsa e kanë nxjerrë nga uji i ligenit.

- Gjumë kam, po gjumi s'më merr.
- Këndojmë një këngë?, — tha ajo.
- Tani asnje s'më kujtohet.
- Diçka nga muzika e lehtë?
- Jo, më mirë nga kupletet e Anastas Kitarës.

— Oh, jo, ato nuk më pëlqejnë, Arben. Se pse nuk më pëlqejnë, dhe unë nuk e di, por më duket sikur mes vargjeve të tyre varet i qepur interesit.

— Ndoshta, por mua nuk më kanë pëlqyer, mbasi janë të gjata têrkuzë e të zë gjumi kur i këndon, — tha Arbeni dhe hodhi cigaren në tokë dhe e shtypi me këmbë sikur të shtypte kokën e një gjarpri

— Sa frikë e ke zjarrin, ë?, — tha Margarita dhe qeshi me të madhe. Arbeni doli në anën tjetër të makinës dhe tha:

— Më duket se kjo susta e lëvizjes së ushqimit është pakëz e fortë e shumë e sertë!

— Ku?

Arbeni pat dalë në anën tjetër të makinës së gjuhëzës. Margarita u afrua të vështronte, por s'po diktonte asgjë në mes të atyre veglave aq të imëta sa edhe të orës së dorës. Vetëm kur preku atë sustën e fortë e shumë të sertë që të mpinte dorën nga fuqia e saj, duart e të dyve u pleksën.

— Si djallin e kemi lënë kaq të fortë këtë sustë?, — tha Arbeni me njëfarë nervozizmi.

— Harrove që vetë kërkove që kjo sustë të bëhej e fortë?

— Ashtu?

— Ashtu.

E hoqën me forcë. Koka e sustës ishte e përdredhur. Ajo ngjante me kokën e nepërkës. Hynte në gjuhëzën e metalit që do të rinte e mbërthyer. Gjithçà ishte llogaritur me precisionin më të madh. Susta kryente funksionin e një dore të vërtetë që lëviz. Një mrekulli të tillë Margarita nuk pati ndeshur as jashtë shtetit. E gjithë makina e lyer me bojë i ngjasonte asaj sikur të ishte një shpikje e re e vendosur në një nga sallat e ekspozitave të shteteve të industrializuara. Por ja që ajo makinë e bukur me një ndriçim të veshur gjithë vezullime, me bardhësinë e detaleve të lyera me një shtresë nikeli e me damkë të shkruar në një pllakë prej tunxhi që reflektonte të gjithë atë verdhësi të artë që e ka shkëlqimin e një monedhe

ari, shkruhej me shkronja kapitale: «Oficina e ... prodhuar me forcat e veta 197...»

Margarita e lexoi dhe një herë me pasion atë mbishkrim dhe iu drodhën faqet nga emociioni. Prodhimi i parë i një makine shumë të vështirë, e ja pasaporta e saj. Makinë e markës shqiptare!

Vajza mendoi për një çast sikur të vinte ai i nxitnieri gjerman Endrih Shtojfi. Ai do të zverdhej më shumë kur të ndalonte përparrë asaj makine të çuditshme e hunda me majë do t'i djersinte, ashtu siç i djersinte sa herë që nuk ishte i zoti të zbulonte një sekret, gjë që e bënte atë të tërbohej e të grindej me veten e tij me atë gjuhë të vrazhdë, si gërvishtja e llamarinave.

Çfarë do të thoshte ai? Si do të reagonte për atë makinë shqiptare? Në fillim ai do të skuqeje e pastaj pikëlat e djersës do të mbulonin majën e hundës së tij të habitshme. Do të dridhej e do të përplaste këmbët në dysheme-në e oficinës. Pas pak i nxehur ai do të kthehej nga Margarita me vrull e do të hapte atë gojën e bardhë sikur ta kishte të lyer me shkumë paste:

— Amerikajn?

Hajvani! Mendja tek Amerika i pat mbetur dhe vëtëm tek ajo ai shpresonte e besonte se do të ishte e aftë për të krijuar një makinë të tillë.

— Albanien!, — do t'i thoshte me të fortë Margarita.

Gjermani do të ngrinte supet e pastaj do të skuqeje përsëri e, si ta kishte zënë njeri nga gryka, do të nxirrte zërin e çjerrë:

— Nahn!

— Punë e madhe që nuk beson ti, o gjerman!

Margaritës se pse iu mbush zemra me një dashuri më të madhe për të gjithë punëtorët që me ato duart e tyre të vajisura, por të arta, kishin krijuar atë mrekulli.

— Na lodhi kjo sustë, por duhet ta dish se një sustë e fortë është më e ndershme se një sustë e butë.

— Ju keni të drejtë, Arben, — tha Margarita që e kuptoi se ku e hodhi fjalën ai.

— Njeriu i vendosur nuk têrhiqet pêrpara çdo pen-  
gese e vështirësie.

— Ashtu është, por «qengji» i sertë nuk pi as nënën  
e tij.

— Logjikë intelektualiste!

— Pse?

— Sepse ata që udhëhiqen nga ato konceptet intelek-  
tualiste, nuk kanë besim në aftësitë krijuese të klasës pu-  
nëtore. Apo s'kemi nga ata?

— Kemi, por ja që ju me iniciativën tuaj thyet kon-  
ceptet frenuese dhe jam e bindur se inxhinierët e nder-  
shëm jua dinë për nder për këtë shkundje që u dhe. Ishte  
një punë e guximshme, por shumë e domosdoshme.

— Ja edhe tani shprehesh gabim, Margarita!

— Përse?

— Këtë shkundje nuk ua bëra unë, ua bëri klasa pu-  
nëtore e udhëhequr nga organizata — bazë e Partisë, se  
unë vetëm, bile edhe pa ndihmën e specialistëve dhe të  
inxhinierëve të ndërgjegjshëm, një vrimë në ujë do të  
bëja.

### 3.

Koço Opingari u ngrit në orën gjashtë të mëngjesit,  
porsa pushoi kënga e këndesit të tij, një kaposh i sjellë  
nga Berati me pupla të kuqe e një bisht si hark që ngja-  
sonte me dëgët e shelgjeve lotuese që lëshohej për sherr  
poshtë oborrit të mbuluar me kalldrëm.

Lorika e tij, një grua e shkurtër, që dikur me buku-  
rinë e saj u sillte dëshirën fotografëve për ta fotografuar  
e për të vënë portretin e saj nëpër vitrinat e dyqaneve të  
tyre, tani mezi i zvarriste këmbët e sëmura nga reuma-  
tizmi.

— Paskan ardhur gamilet e ngarkuara me shakujt e  
ujit.

Lorika e kuptoi që Koçoja pat vështruar qìellin dhe  
se ai sigurisht duhej të ishte i mbushur me re, sepse gjithë

natën asaj i kishin dhëmbur këmbët e eshtrat e mesit. Ndoshëta atë ditë ai nuk do të shkonte në shëtitjen e tij të zakonshme e do të vazhdonte atë magje që e pat filluar prej një viti dhe ende nuk po e përfundonte. Lorika e dinte se një punë e rëndësishme nuk e linte të shoqin ta përfundonte atë magje të motrës së saj, por fundja ai duhej të kujtohej se ajo në fshatin e saj të largët me gjithë ato pritje të ngrohta e me sofrat e mbushura ding me mish Koços, e pat justifikuar një magje të thjeshtë,

— Do të dal në mal, kam pér të marrë dhe Liskën. — Më vonë Lorika ndjeu kuisjen e Liskës, kërcitjen e portës së madhe dhe hapat e rëndë të të shoqit.

Koçon e zuri mëngjesi majë kodrës prej nga dukej qyteti i shtrirë në fushën e ngushtë. Ai vështroi fushën që shtrihej përposh qytetit dhe ngopi mushkëritë me ajrin e freskët që përzihej me vesën. Vesa që pati njomur majat e bisqeve të barit, nga thyerja e rrezeve të diellit ngjasonte si një kokërr margaritari.

Sa herë që mjeshtri i vjetër e i fortë vështronët një kokrrizë të tillë që të habiste me atë vezullim, ai kujtonë se nga kjo kokrrizë e kishte fillimin e saj emri «Margarita». Prandaj, pér të merituar atë emër, sigurisht, që duhej të zotëroje bukurinë. Por vallë a nuk ishte e bukur Margarita? Sigurisht që kryeinxhinierja ishte një vajzë e bukur dhe ai e kuptonte dhe e ndiente thellë në shpirt se Arbeni e Margarita duheshin e së dashuria e tyre ishte një ngjarje e bukur, shumë e bukur në të gjitha ngjarjet e tjera që kajeta...

Koço Opingarit iu bë qejfi dhe iu kujtua Lorika e tij, e cila, kur qe e re, pér nga bukuria nuk binte më poshtë se Margarita. Por ata vitet e para të rinisë së tyre në kohën e satrapit dhe pastaj të pushtimit fashist e patën kaluar duke bredhur poshtë e lart pér të gjetur punë. Prandaj ai Koço Opingari kishte rrokur pushkën. E djeshmja me të sotmen ndryshonin si dita e pranverës me natën e dimrit. Koço Opingari ofshani pér ato vite të rinisë që i kishin kaluar me aq mundime e varfëri. Ai vështroi pishat e mbjella në kohën e aksioneve të rinisë, lastarët e

shëndetshëm që gjelbëronin ato kodra që Çlirimi i gjeti lakuriq ashtu siç gjeti të gjithë vendin. Ai ndjeu kënaqësi për ato pisha dhe iu kujtuan ato vite kur shkonte së bashku me të rintjtë për gjelbërimin e atyre kodrave, që tani ia kishte ëndë t'i sodiste çdo ditë. Koço Opingarit iu kujtuan fjalët e një mjeku që i kishte treguar për dobinë e pishave për të ngopur mushkëritë me azot, për të gloadhur trurin me gjelbërimin e tyre të përhershëm. Kjo e bënte Koçon që të dielave të ngrihej herët në mëngjes dhe të ngjitej shtegut të shpatit të malit.

Ngjitja ditët e diela në kodrat e pyllëzuara me pisha, jo vetëm për Koço Opingarin, por edhe për punëtorët e tjerë, kohët e fundit po bëhej sa më masive. Dhe kjo e gëzonte Koçon, sepse e shihte se lidhja e njerëzve me kodrat e pyllëzuara i bënte ata më të gëzuar e optimistë.

Liska, një qen nga më të vegjlit që ka rraca e qenve, me një feçkë të mprehtë si të dhelprës, vraponte përparrë tij dhe herë pas here ndalej e kthente kokën nga i zoti. Tringëllima e ziles që varej në rripin e qafës mbushte atë boshllëk të pasur me ajër, por të pakët me zhurma me një melodi të këndshme që të fuste në èndërrime. Qeni besnik kridhej në një lodrim të zhdërvjellët. Koço Opingari vështronte kafshën e vogël që buiste nga avulli i djersëve dhe me atë zërin e tij të trashë e nxiste për të vrapuar më shumë: «Jepi, Liska! Çapkëni i Koços! He! He! Hidhu, hidhu dhe mos ki frikë. Ja dhe pishat tonë!».

Qeni i ngazëllyer férkohej mbas këmbëve të trasha të të zotit, pastaj kthehej nga një shkurre, e kapërcente atë me vrull, shtrihej në kurriz duke përpjekur të kafshonte me dhëmbët e mprehtë të bardhë si fildish barin e lagur nga vesa, e pastaj hovte e hidhej në të katra këmbët si një tigër i vogël që ngordh pas lodrave.

Sa vinte e shtuna, Koçoja përgatitej për të dielen që të ngjitej kodrave të pyllëzuara, që të mblidhët kërpudha, të cilat i pëlgente shumë. Lorika, që ia njihte mirë dëshirat burrit të saj, shkonte e blinte sallam e mish viçi që t'ia jepet të shoqit me vete.

Koço Opingari kishte dëshirë të pikte në natyrë një

shishqebap të ngulur në degë të thatë që vihej në gurët e nxehur rreth zjarrit për t'u pjekur. Por atë ditë ai nuk qëndroi gjatë në mal. Ja, kur dielli e arriti majën e oxhakut të uzinës, e kuptoi se erdhi koha për të zbritur poshtë në ofiqinë, sepse fjala e dhënë duhej mbajtur e ai nuk e hante dot premtimin.

Puna ishte përfundimin e pllakës që duhej të vendosej në fundin e makinës së gjuhëzës, mbasi, megjithëse gjithçka u bë e re, ai mendoi se nuk do të bënte fiturë të mirë një bazament me pllakë të vjetër!

— Koço, e kur e mbaron atë pllakë bazamenti?, — e pyeti Miha Voskopoja duke fërkuar syrin e majtë që po i lotonte ngase diçka i kishte rënë në të.

— Të dielën, — tha ai, por menjëherë iu kujtua se kishte vendosur që të dielën ta kalontë në mal.

— Mirë atëherë, por mos harro se të dielën ajo duhet të jetë e përfunduar, mbasi makina është gati. — Miha sa herë që shprehej përpara kohës që makina ishte gati, se pse ndiente një ftohtësi të brendshme, që edhe ai nuk e kuptonte se nga i vinte.

— Mirë, mirë, të dielën do të jetë gati.

Koço Opingari qeshte nën buzë duke zbritur shtegun e ngushtë me një ngadalësi breshke duke bërë frena me gojë si një fëmijë që me zhurmat e ndryshme zëvendëson motorin e makinës së improvizuar. Liskën e la në shtëpi. U la, u vesh dhe, kur zbriti poshtë rrugëve të drejta gjithë kalldrëm, u kënaq nga pastërtia e tyre që sapo ua lau kurrizin ajo fshesa e butë e amvisave të heshtura.

Koçoja hyri në ofiqinë tërë shend e verë. Ai mendjen e kishte ende te kodrat e pyllëzuar dhe te lodrat e Liskës së tij. Në vend që të merrte kominoshet e veta, mori të tjera. Ai u përmend vetëm atëherë kur dora nuk i hynte në mëngën e ngushtë të kominosheve të tjetrit. Koço Opingari i vështroi ato me habi dhe lexoi qartë inicialet: «V. D.». Koçoja atëherë e kuptoi se ato kominoshe ishin të Vasfi Dishnicës. I mbështolli e u mat t'i hidhte në dillap, kur ja, tingulli i një metali që trigëlliu dhe u rrokullis nëpër dysheme. Vallë çfarë ishte ajo që ra nga xhe-

pi i kominosheve? Ndonjë vegël e vlefshme? Vështroi me kujdes, po syri s'po i kapte gjë. U shtri barkazi në dyshemë.

Kërkoi me pëllëmbë i vrarë shumë në ndërgjegjen e tij dhe ja, mollëzat e gishtërinjve të tij ndeshën në një send të rrumbullakët. U ngrit dhe e vështroi me habi atë bilë të vogël dhe e afroi në sytë e tij të hapur nga çudia.

«Bilë mangani!» Po, ajo ishte një bilë e vogël që reflektopte herë ngjyrë vjollcë, herë ngjyrë të verdhë, si një çelik që sapo ka dalë nga ftohja e furrës dhe ai Koço Opingari e njihet mirë atë ngjyrë të verdhë si lëkura e luanit, që fsheh në vetvete një forcë shumë herë më të madhe dhe një rezistencë më të thellë se gjithë metalet e tjera.

«Po kjo?». Koço Opingari nuk u zinte besë syve të tij. I hapi edhe një herë kominoshet nga kishte rënë bila. Koços i ranë në sy përsëri inicialet «V.D.».

Koço Opingarit i tërhoqı vëmendjen një trak-trak që i erdhi nga çatia e ofiçinës. Vështroi me kujdes andej nga i erdhi krisma. Për çudinë e tij pa Vasfi Dishnicën tek po zbriste nga çatia. Aty për aty Koços i vajti mendja se Vasfiu po hynte nga çatia për të përvetësuar ndonjë material, sepse i kishte rënë në vesh se Vasfiu bënte edhe ndonjë punë private. Koçaja shpejt e shpejt u fsheh prapa tornos që ndodhej përkarshi makinës së gjuhëzës, e cila ishte e mbuluar me një mushama dhe priste t'i bëhej prova përfundimtare, që ishte caktuar ditën e hënë (të nesërmën).

Vasfi Dishnica, pasi i hodhi një vështrim prej ujku andej-këndeje repartit të tornerisë, përgjoi një copë herë dhe pa se në ofiçinë mbretëronte një heshtje memece, eci me hapa prej dhelpre dhe shkoi pranë makinës së gjuhëzës. U ndal. Vështroi përsëri andej-këndeje. Syri as veshi nuk i kapi asgjë që atë mund ta shqetësonte. «Hë, të erdhi vdekja! Të erdhi vdekja edhe ty, edhe Arben Korçës me shokë. Të jap unë një «karamale» që nesër ty dhe mendimet e Arben Korçës me shokë do t'i bëjnë copë e grimmë! . . . — tha Vasfiu dhe me dorën e mëngjér ngriti pakëz cepin e mushamasë që mbulonte makinën, kurse me do-

rën e djathtë, që po i dridhej, hodhi diçka në «gurmazin» e makinës dhe uli me kujdes cepin e mushamasë.

Koço Opingarit i rrahu zemra me forcë, me një forcë që kurrë në jetën e vet nuk e kishte provuar. Nuk iu durua më gjatë. Doli nga vendi ku po qëndronte galic dhe me sa fuqi kishte, si një luan me fuqi të shumëfishuara, iu hodh në kurriz dhe e përplasi përtokë.

— Hë, i poshtër! Ç'hodhe aty?

— Asgjë, more Koço. Ç'ke që je tërbuar, po lëshomë, se më mbyte!

— Më thuaj, më thuaj për ç'djallëzi erdhe, o të mora shpirtin, qen!

— Unë erdha të punoja, por gjeta portën të myllur dhe s'mu durua pa vështruar atë mrekulli që krijoj Arbeni me ju, — tha Vasfiu duke dihatur që po përpiquej ta mashtronnte sa t'i dilte nga duart.

#### 4.

Kopi Nanushi pati vendosur që atë të diel të pushonte. Meqë edhe të shtunën në darkë pati qëndruar deri vonë, mendoi që të nesërmen të mos ngrihej nga krevati derisa të ngopej me gjumë. Kafen e mëngjesit e piu i shtrirë në kanape. Pasi shoi cigaren, mbuloi kokën me batanije dhe filloi të gërhiste sa të tundej dhoma. Atë gjumë të ëmbël ia prishi trokitja e potershme e portës që s'po dinte të pushonte.

«Kush vjen tani në mes të ditës e më prish gjumin?» — mendoi Kopi Nanushi dhe u ngrit nga kanapeja i nevrikosur. Ai me atë paraqitje me velenxë në supe dukej si një aktor komedie.

— Kush është?

— Jam unë!, — u përgjigj Koço Opingari.

Kopi Nanushi hapi portën dhe nuk i erdhë mirë që shoku i vjetër e gjeti ashtu të shkujdesur me një velenxë të hedhur në supe.

— Isha në një gjumë të thellë. Ëndrra më kishte çuar në kohën e vegjëlisë kur ruaja dhentë në mal. A e di ti,

Koço, ku ndodhet mali ynë? Sigurisht që nuk e di, se, po ta dije, do të kërkoje dhe vetë të shkoje dhe të flije një natë në mes të barit të gjatë, aroma e të cilit të mbush mushkëritë me ajrin e malit. Çfarë ka ndodhur, Koço?

Koçoja me atë fytyrë të çakérdisur dhe me zërin e tij kumbues zuri t'i tregonte Kopit të gjithë ngjarjen dhe, për të vërtetuar atë, nxori nga xhepi bilën e vogël të mangani.

— Çfarë është kjo, Koço? — Kopi u hodh nga kana-peja.

— Bilë!

— Bilë! E pastaj çfarë?!

— Është bilë mangani?

— Që Vasfi Dishnica ka hyrë për të vjedhur ndonjë material, këtë ta besoj, o Koço, por, që ai të ketë hyrë për çfarë të rreh ty mendja, nuk besoj. Po ti, në vend që të prisje ta zije me presh në duar iu hodhe në grykë. Ah, more Koço, sa i rrëmbyer që je, sa i rrëmbyer që je! Me këtë e humbe veten dhe na vure edhe ne në telashë!

— Për telashet e mia përgjigjëm vetë e mos u shqetëso, o Kopi Nanushi! Unë jam i bindur që ai i poshtër diçka të tillë hodhi në makinën e gjuhëzës. Do të çmontojmë makinën dhe doemos do ta gjejmë se s'bënn, — tha Koçoja i pezmatuar sa s'bëhet.

— Po s'doli kështu si thua, ku do të futemi ti dhe unë, mor Koço?

— Po s'doli kështu, preje kokën time!

— Po ai hajduti nga vajti?

— Ja dorëzova policisë.

— Ashtu?

— Po, po.

— Ah, Vasfi Dishnica! Po doli kështu, kokën do t'ia shtyp si gjarprit. — Kopi shtrëngoi dhëmbët. — Prit një minutë sa të vishem!

Koço Opingarit s'po i rrihej në vend. U ngrit më këmbë dhe po vështronte Kopin që po vishej me nxitim. Nxitimi i tij tregonte se tanë mendja e tij u qartësua dhe po i jepte rëndësinë e duhur ngjarjes që i tregoi Koçoja. Po

të kronometrohej koha e veshjes së tij, Kopi arrinte shpejtësinë e ushtarakut më të shkathët e më të shpejtë në një rast alarmi.

— Shkojmë, Koço?

— Shkojmë.

Koçoja e ndoqi pas duke mos parë asgjë, bile as pikturen e madhe që e zonja e shtëpisë e paskësh varur jashtë në korridor. Nxitonin si t'i ndiqte njeri. Në shtëpinë e Mihës hynë me nxitim. Miha Voskopoja u trondit kur ndeshi vështrimin e Kopit të djersitur e frysma Marrjen e nxituar të Koço Opingarit.

Miha Voskopoja po lante enët. Kopit nuk i shkonte fare në mendje se Miha e ndihmonte gruan deri në atë shkallë. Por jeta është një shkollë e madhe. Ajo të shkul nga koka konceptet e gabuara dhe të ngul ato të barazisë së gruas me burrin në familje.

— Ç'ka ndodhur?, — pyeti Miha duke fshirë duart me mësallën që kishte lidhur përpara. Ata u ulën.

Kopi Nanushi po tregonte ç'kishte ndodhur. Fjalët po i shoqëronte me lëvizjen e shpejtë të duarve, kurse Koça Opingari flakë në fytyrë po qëndronte si në gjemba. Ai, për ta bindur Mihën pér ato që po i thoshte Kopi, nxori nga xhepi i vogël i pantallonave dhe ia lëshoi Mihës në pëllëmbë të dorës atë që kishte gjetur në kominoshet e Vasfi Dishnicës.

— Ç'është kjo??

— Bilë mangani!

— Vallë të ketë hedhur një të këtillë në makinën e gjuhëzës?

— Me siguri, përndryshe pérse ai të zbriste nga çatia dhe të shkonte drejt e te makina e gjuhëzës?, — foli tërë pasion Koço Opingari.

— Qeni!, — shfryu Kopi.

— Domethiënë sytë e tij prej dhelpre fshihnin tërë këtë armiqësi, ë? Ai kohët e fundit fliste me admirim pér Arbenin dhe pér linjën e gjilpërës!

— Kjo i duhej si perde pér të hedhur gurin e pér të fshehur dorën gjakatare.

— Kuptohet. Armiku éshtë dredharak, por, në qoftë se një bilë e tillë nuk gjendet në makinë, atëherë si t'ia vëmë emrin kësaj? — pyeti Miha duke fërkuar me bulat e gishtërinje bilën e manganit.

— Edhe po nuk u gjend një e tillë, hedhja nga çatia a nuk vërteton armiqësinë e tij? — Koçoja dukej tepër i shqetësuar.

— Tregon diçka, po nuk vërteton këtë, për të cilën po llafosemi, Koço!

— Edhe në qoftë se nuk arriti ta hidhte, si një e një që bëjnë dy, ai për këtë u fut nga çatia.

— Kjo çështje duhet biseduar me shokët e Degës, — tha Koçoja.

— Jo, më parë ne duhet të sigurohemi mirë nëse ka hedhur apo jo në makinë një bilë të tillë, pastaj të informojmë Komitetin e Partisë për gjendjen reale, se me hamendje nuk ecet, — tha Miha.

— Për të verifikuar këtë çështje, duhet hapur makina. Kjo do kohë dhe s'mund të bëhet pa Arbenin. E atë ku ta gjejmë tani? Prandaj për kaq të vihet në dijeni Komiteti i Partisë edhe operativi, pastaj të tjerat bëhen nesër,

— u shpreh Kopi Nanushi më i përbajtjut.

— Këtë çështje do ta ndjek vetë, shoku Kopi, po që tanë të marrim masa, të sigurojmë më rojë oficinën. Të tjerat i zgjidhim nesër, — tha Miha.

## 5.

— Ju jeni Vasfi Dishnica?

— Unë jam, — iu përgjigj ai.

— Në emër të popullit jeni i arrestuar!, — tingëlloi zëri i një djaloshi.

— Vasfi Dishnica u bë grusht, fytyra iu shtrembërua dhe mori ngjyrën e limonit të kalbur. Ai kundërshtoi lidhjen e duarve, por ndeshi në një forcë prej Herkuli e u nënshtrua duke kafshuar buzët. Nuk shihte asnë rrugë shpëtimi, se ishte zënë me presh në duar. Koka po i ush-tonte. «Hë, unë ta paguaj me kokë e Stefan Grabova, që

më detyroi ta bëja këtë, të shpëtojë pa i hyrë ferra në këmbë, ë? Kurrë, kurrë!», — përsëriti ai me vete tërë natën e natës e nuk mbylli sy. Po lodhte mendjen se si t'ia linte dobiçin te porta Stefan Grabovës, por si t'ia bënte që ai ishte zënë me presh në dorë? I dukej se e kishte para-sysh fytyrën e Stefan Grabovës. Iu kujtuan fjalët e tij, porositë e tij, premtimet dhe kërcënimet e tij, fytyra e ngrysur qymyr, tèrbimi i të dyve nga rezultatet e Arben Korçës me shokë. Sa më shumë përparonin punimet për ndërtimin e linjës së gjilpërës, si Stefanit edhe Vasfiut u dukej se diçka si një litar po i shtrëngonte në grykë dhe një ditë do t'u merrte frymën. Prandaj vendosën që atë ta hidhnin në erë me një bilë mangani. E shau vetveten me fjalët më fyese që mud të ndeshen vetëm në leksikun e ndonjë vagabondi. Vetveten nuk po e shante për krimin që kishte kryer, por për mendjetrashësinë që kishte tre-guar duke mos e menduar thellë si të fshihte dorën, pastaj të hidhte gurin, e jo si guak, që ra si miu në kurth. Tek po bluante këto e të tjera në kokë, trupin e tij e kishin pushtuar shtatë palë ethe. Ai e ndiente se ato po i lëviz-nin valë-valë nga koka gjer te këmbët herë të ftohta akull, pastaj të nxehtha dhe koka sikur i nxirrte tym dhe veshët i ushtonin. Iu kujtua ekskursioni i fundit që kishte bërë ditët e fundit në pikën turistike buzë liqenit të kal-tër. Kishte provuar të voziste në drejtim të kundërt të rrymës dhe kishte vështruar anën tjetër të liqenit.

Zhurma e lopatave që rrihnin ujin ia pati çlodhur trurin dhe i pati ngjallur dëshirën që në atë barkë të ishte së bashku me Stefan Grabovën dhe të merrnin me vete Mihën e Arbenin, që, kur të shkonin ku rrymat përplase-shin e dallgët ngriheshin lart, t'i qëllonin me lopata në kokë dhe me not të përbironin nëpër liqen në shtetin tjetër, që do t'i priste me duar hapët.

«Po s'hodhëm në erë linjën e gjilpërës, edhe atje bur-gu do të na presë», — pat paralajmëruar veten Vasfiu dhe pat shtrënguar nofullat.

E ktheu barkën drejt bregut. E lidhi atë që të mos ia merrte rryma, nxori një shishe të gjysmuar me raki dhe

e futi atë në ujin e kristaltë që ishte brisk i ftohtë. Provoi ta mbante dorën atje në atë akull të lëngëuar e filloj të numëronte, por nuk duroi dot dhe, kur arriti shifrën katter, e tërroqi dorën me të shpejt. Hipi në kodër lart dhe vështroi tutje luhatjen e kontureve të një qyteti të huaj. Duke vështruar horizontin e mjegullt përtet kufirit, Vasfi Dishnica kujtonte kohën e pushtimit, kur i ati kishte vajtur për tregti dhe e kishte marrë me vete për ta stërvitur. Mori shishen dhe nxori pakon e ushqimit, një pakon mbushur me bukë të bardhë e sallame të ndryshme. Kaçkavalli i Gjirokastërës me erën e tij të këndshme i nxiti oreksin për të ngrënë. Po sa do të ngrinte gllënkën e dytë, aty ia behu me automatik në sup e bomba në mes e me dylbi një djalë i ri, i veshur me çizme.

Vasfi Dishnica e vështroi ushtarini si me habi, si të ishte ai që ia prishte qetësinë e jo Vasfi Dishnica që pat hedhur hapat më shumë se ç'e lejonin rregullat.

Thumbat e çizmeve që ndeshën në strall nxorënixa, të cilat e trembën Vasfi Dishnicën.

— Mirë se rrini! — i foli ushtari që ngriti automatikun mbi sup e, duke u ulur në gjunjë, mori ujin e burimit dhe e lagu kokën e djersit.

— Mirë se vini!

— Nga jeni? — Ushtarit i kullonte uji i freskët që ndaloj mbi ballin si kokrriza margitarësh.

— Nga..., po kemi ardhur ekskursion. Duam të njohim çdo pëllëmbë të vendit tonë.

— Që ta duash e të dish ta mbrosh Atdheun, duhet ta njoësh pëllëmbë për pëllëmbë, — tha ushtari, — po këtu është brez kufitar e duhet të shtyhemë më tutje.

— Më falni, se nuk e dija. Na çoje njëherë!, — dhe i afroi shishen e rakisë.

— Unë nuk pi, po, edhe sikur të pija, tani jam në krye të detyrës.

— Më falni, se gabova, por pa dashje.

— S'ka gjë.

— Po me ç'punë merreni?

— Jam mekanik i kategorisë së shtatë.

- E njihni Arben Korçën?
- Posi, e kam koleg pune.
- Radio Tirana dje foli pér ndërtimin e linjës së gjil-përës pér të çarë bllokadën. Ju sigurisht do të jeni njëri nga bashkëpunëtorët e kësaj iniciative. Mund të më tregoni ndonjë hollësi, se jam kurioz.
- Natë-ditë pér atë linjë po punojmë, por këto punë janë plot me sëkëlldi. Derisa ta bëjmë provën përfundimtare, asgjë s'mund të themi, — tha Vasfiu dhe i dha dorën.
- Po shkon?
- Më presin shokët. — U largua i ngrysur me hap të lëshuar. Ca gurë shkanë pas tij. Ata ranë plluq-plluq në faqen e ujit që formuan rrathë. Vasfi Dishnica ktheu kokën prapa, pështyu me inat dhe vazhdoi të pinte me një frysme të gjithë rezervën që kishte në shishen gjysmë-litërshe. «Hë, edhe kufitari e lodhka mendjen pér linjën e gjilpërës! Pastaj do t'ia dëgjoni krismën, po mos u lodhni të qeshni para kohe, se...», — shfryu Vasfiu tërë duf. I zhytur në ato mendime të zymta, u mat të hipte në barkë, por i shkanë këmbët nga balta e kuqe e ai si një deng u rrëzua poshtë në ujë.

Klithi. Një klithmë çjerrëse që u shua në ujin e ftohtë. Atij iu mblodhën buzët e nxira ca nga ujet e ftohet, ca nga frika e vdekjes.

Ishte trembur kot. Nuk ishte thellë. Uji i vinte deri në majë të hundës prehuce. Mornicat e mbuluan e dhëmbët kërkëlinin si sharrë.

Si të hipte në barkë? Përballë tij po vinte një çift që voziste mengadalë. U mat të shtrihej që të humbiste qenien e tij nga sytë e tyre, por qe krejt e pamundur. Çifti i ri nuk e vuri re. Ata u mëshonin fort lopatave dhe as që u kujtuan pér atë faqezë të qullur si një nepërkë uji.

Vasfi Dishnica e la barkën «Korabi» dhe doli në breg që të thahej në diell. Iu duk se një erë e furishme e rrihte pa pushim. Nuk po i komandonte dot nofullat që i dridheshin.

Vasfi Dishnica erdhi në vete. U trondit. E mallkoi veten një mijë herë që kishte vepruar aq trashë. «Ditën pér

diell si u hidhka në erë linja e gjilpërës! Ja, tani, unë i myllur si ariu në kafaz, kurse Stefan Grabova rrezik se ua ka mbathur këmbëve dhe koka ime fluturon, kurse ai të bëjë qejf, ë? Pika atyre të jashtëmve që nuk janë në gjendje të mposhtin një vend të vogël sa pëllëmba e një fëmije dhjetëvjeçar!...».

I dukej se po i silleshin dhjetë palë gurë mulliri në kokë. Iu morën mendtë. U platiit në dysheme si një plendës lope i mbushur plot und.

## KAPITULLI I NJËZETENJËTË

### 1.

Fundi i prillit. Kënga e bilbilit u kujton njerëzve se pranvera ka ardhur. Avujt e ngrohet mbushur gjithë erë jargavani të kënaqin shpirtin. Lulet e qeshura e të harlisura me gjithë atë mori ngjyrash të kuqe e lila të kujtojnë se erdhi festa e punëtorëve dhe se pesë ditë pas saj lulet duhet të bëhen kurora për dëshmorët e Luftës, që dhanë jetën e tyre të re që Shqipëria të bëhet e kuqe flamur.

Arben Korça si gjithnjë edhe atë ditë ishte ngrysur në oficinë, e cila kishte marrë një pamje festive. Ai ndezi cigaren dhe po vështronte përkundruall siluetën e makinës së gjuhëzës që tanë ishte gati. Po atë akoma nuk e kanë vënë në provë, ndonëse pilulen e hedhur nga Vasfi Dishnica ia kishin nxjerrë nga barku. «Po si mund ta quajmë të përfunduar e në gatishmëri një makinë, kur ende nuk e kemi vënë në provë, nuk ka dhënë prodhimin, nuk ka nxjerrë gjuhëzën?», — mendoi Arbeni dhe ndjeu dridhjen e dorës dhe thartimin e qiellzës. Me një kujdes të tepruar sikur të kishte përpara një epruvetë me një lëndë të djegshme e shkatërruese si nitroglycerina, ai mori shufrën e telit që duhej të kthehej në fluturzë.

Vendosi tа provonte atë pjellë të punës së vështirë,

vallë a do të justifikonte ajo makinë të gjithë mundin e tij, të shokëve, të inxhinerëve, të Naumit, Margaritës e dhjetëra e dhjetëra të tjera, duke mos harruar mes këtyre dhe inxhinerin nga Skrapari e punonjësit e uzinës së autotraktorëve «Enver Hoxha» në Tiranë.

E futi telin në vrimën e hyrjes.

Ai e dinte se makina nuk kishte lidhje elektrike se ajo lidhje do të bëhej vetëm në mëngjes nga vetë Margarita, por shtytja ishte më e fortë se ngurrimi dhe ai vendosi që ta provonte njëherë me dorë makinën, sepse ai kishte aq forca që ta vërtiste atë kompleks detalesh të komplikuara që formonin një trup solid të bukur e të fortë, si trupi i një atleti të lidhur gjithë muskuj.

Kështu i ngjasonte makina e gjuhëzës e për këtë Arbeni ishte shumë krenar. Vendosi ta lëvizte një herë pa ngarkesë makinën dhe pastaj ta lëvizte atë me ngarkesë dhe të shihte rezultatin që do të jepte. Ashtu bëri. U ndje kërkëllitja e ingranazheve dhe ngritja e vajit nga depozita që u dha menjëherë nga poshtë-lart e pastaj pikat e tij si një pikë loti.

«Po qan, po qan!». Por kush po qante, ai apo makinan?

Arben Korça me një lëvizje instinktive e shpuri pëllëmbën e dorës në mollëzat e faqeve të tij, por atje ishte një thatësirë Sahare e nxehëtë si një saç i mbuluar me prush. Atëhere ai e kuptoi se ishte pika e vajit të makinës, një punë e përkryer, e përsosur, që do të çapëllente çdo fytyrë akademiku sado me maska që të ishte ajo fytyrë. Ai vështroi lëvizjet e akseve që ngriheshin e zhyteshin në bokullat e presuara të mbajtëseve të tyre e nga bardhësia e shkëlqimit të trupit të tyre të tornuar e të rrahuar e zbukuruar nga duart e arta të punëtorëve e teknikëve, sepse dukeshin si nuse me tela. Nga lëvizja e detaleve ai ndjeu sikur i thirrën shokët e shkollës: «Ej ti, kapedan i linjës së gjilpërës, jemi ne treshja: Ylli, Ylviu e Skënderi! Si nuk je i kënaqur, o derdimen. Por ne për këto akse kemi gdhirë kaq net të ftohta. Ja, Ylviu nuk shkoi në opera, dhe a e di ti, kapedan, se ai u habit

që nuk iu mërit as e fejuara, por e përgëzoi që për këtë makinë ai bëri një punë të mirë. Hë? Nuk beson?? Mirë, ta dish se ne kemi besim, kemi besim, sepse jemi punëtorë, me shpirt të madh, me ndjenja të ciltra, me shpirtin e sakrificës. Përse dyshon? Gjithçka ka për të kaluar mirë, mos ki frikë. Ec, e nuk e ndien forcën që po të jepim ne, dorën që po të jep Partia?».

Arben Korça u ngrit e vështroi me habi me shpresë se mos në mes të sallës së madhe do të ndeshte në fytyrat e dashura të Ylviut, Yllit e Skënderit. Ai nuk ndeshi asnjërin prej tyre dhe nuk dyshoi se ata do të ishin fshehur si çapkënë pas tornove e frezave në oficinë. Jo! Ai thirri me të madhe: «Po të jeni këtu, dilni!». Por nuk u ndie asgjë tjetër, vetëm zëri i tij që u vërtit si një jehonë në repartin e oficinës duke kaluar mbi muret, mbi shpinat e tornove dhe të makinave të tjera.

*Teli ishte* në vendin e tij. Arbeni e lëvizi me forcë kokën e makinës. Ai e ndjeu ngarkesën e saj që po përtyponte në nofullat e hekurta telin, lëndën e parë, e me një dridhje që mposhtte çdo nerv qetësie ai po priste me pëllëmbën e shtrirë poshtë vrimës së daljes atë fluturzën e vockël, që nuk e kapje dot me gishtat e dorës.

Ajo ra si një zog i porsadalë nga veza, me pendë të butë, pa u ndier, si një insekt që ulet vetë si një qenie e urtë, dhe ai nuk e ndjeu, nuk e ndjeu, sepse duart e trasha mbushur gjithë kallo nuk ndienin gjë ashtu siç nuk ndihet lodhja, ashtu siç nuk ndiheshin mundimet e kaluara, ashtu siç nuk ndihet lodhja në shpirtin e komunitit, mundi, sakrificaat, mjafton që ideali i tij, porosia e Partisë të jetë realizuar.

Arben Korça vështroi gjuhëzën në pëllëmbën e tij të madhe. Gjuhëza si një krah i vogël insekti po puthte pëllëmbën e ndërtuesit të saj, atë që triumfoi mbi shtetet monopoliste që ruanin monopolin e saj. «Mos vallë jam në èndërr!». Arbeni fërkoi sytë. Gjithçka ishte në rregull e kot që shqetësohej. Me një shumëfishim energjish ai vërtiste e vërtiste kokën e makinës e ja, poshtë vrimës së saj filloi qimëzimi i gjuhëzës. Ato po binin

poshtë me radhë, si fjollat e dëborës, të qeta e të bardha, më të bukura e më të forta se gjuhëzat e shteteve monopoliste. «Do të krijoj një pirg me fluturza, një pirg, e, kur të vijnë shokët, të gëzohen për fitoren tonë mbi bllokadën, mbi përbindëshit imperialistë e revisionistë, që përpinqen të na mbysin në vratat tona.

Arben Korça e vështroi pирgun me atë detal të imët, pastaj, duke ndier një gëzim të paprovuar, mbushi pëllëmbën dhe me bulat e gishtave po i përkëdhelte me dashuri. Në atë çast donte të kishte pranë Margaritën. Ajo hyri me vrull. E pa Arbenin të dalldisur nga gëzimi i fitores.

—Ja fluturza! Fluturza! Edhe në këtë fushë bllokadën e bëmë hi e pluhur, Margarita!, — tha Arbeni dhe e mbështeti në gjoksin e vet i pushtuar nga lumturia.

Margarita vështroi pирgun e detalit, i përkëdheli me bulat e gishtave të gjatë e delikatë.

— Po... Ju e mposhtët dyshimin tonë, Arben!

— Kurajën e guximin na e dha Partia, Margarita!

Margarita miratoi me kokë. Arbeni po e ndiente se gjithçka rrëth tij ishte e pastër, e bukur. Iu kujtuan Vasfi Dishnica e Stefan Grabova që përpinqeshin t'i bënин varrin mendimit krijues të klasës punëtore, mundit e djersës së tyre dhe të groposnin makinën e gjuhëzës, linjën e gjil-përës.

— Qelbësirat! Të poshtrit!, — klithi Arbeni.

— Hë? Për cilët e ke llafin?, — pyeti Margarita, që nuk u përqëndrua.

— Për krimbat që deshën të na hidhnin në erë mundin e djersën tonë, mendimin krijues.

— Ata janë si hijet e vdekjes!

— Nuk ua kemi pasur kurrën e kurrës frikën.

— Edhe Stefanin e arrestuan!

— Dihet që Vasfiu nuk ka vepruar në kokën e tij.

— Ti i flake në kosh të plehrave, Arben!

— Jo vetëm unë, por ne, Margarita vetëjeta jonë!

— Çfarë ndien në këto çaste, Arben?

— Jam shumë i lumtur. Do të desha që tanë të njoftonim shokun Enver. T'i raportonim se fluturza është gati.

E prodhuam me forcat tona, ashtu siç na mësoi Partia dhe udhëheqësi ynë i dashur.

— Ai do të lumturohej si ne! Mua më duket se ai na ka zgjatur duart e përkëdhel supet tona, Arben!

— Sigurisht që na përkëdhel. Ai është gjithmonë midis nesh. Unë e ndiej, ne mësojmë e kalitemi prej qenies së tij midis nesh.

— Ti ke të drejtë, i dashur!

— Margarita, tani ndërtimi i linjës së gjilpërës u vu në rrugë të mbarë.

— Patjetër, i dashur.

— Më në fund!

Dialogun e tyre të gëzuar e optimist e ndërpren ardhja e punëtorëve, që, së bashku me rrezet e shkëlqyera të diellit, hynë në oficinë tërë vrull. Ata u drejtuat në gardërobë pér të veshur rrobat e punës dhe pér të filluar punën më me vrull, pér të fituar garën e shpallur reparateve të tjera. Ata ishin zotuar të prodhonin sa më shumë pjesë ndërrimi pér të çarë bllokadën e egër imperialisto-rezisioniste, e cila si një gjarpër i stërmadh përpiquej të mbyste Shqipërinë socialiste.

## 2.

Lajmi i fitores së Arben Korçës me shokë u dha me radion lokale. Të gjitha ndërmarrjet simotra që kishin ndihmuar e përshëndetën këtë fitore me sirenat e tyre. Qyteti i ngjante një porti të madh detar ku përshëndetej me sirena hedhja në det e një anijeje të re!

Kopi Nanushi e Miha Voskopoja nxitonin si era pér të parë atë detal kaq të imët që ua kishte shtuar më shumë thnjat dhe andrallat, por i kishte bërë më të rinj.

Mes grupit të vajzave që ecnin me vrap Kopi Nanushit i dukej sikur po fluturonte. Kur hynë në sallë, panë Arbenin që kishte kapur pér qafe Dhosi Qafëzezi, që nuk dinte ta lëshonte. Pastaj sipër tavolinës Anastas Kitara po ia thoshte këngës si një këndes majë gardhit që laj-

mëron lindjen e një dite të bukur, shumë të bukur e të hareshme.

Oficina që gumëzhinte nga këngët e vallet, gjëzimi e hareja nuk kishin të sosur. Të gjithë nuk përbaheshin nga gjëzimi. Secili shpejtonte t'i shtrëngonte dorën dhe të rrokte Arbenin për qafe.

Tani nuk merrej vesh se kush ishte në oficinë. Aty ishin derdhur aë nga Nesti, inxhinier Sotiri e Adriani, Toçi e Skënderi. Ylviu e Ylli, sekretari i Partisë i uzinës mekanike, e deri te Dhimitrulla e të tjerë të ndërmarrjeve si motra.

Nga vërvshimi i njerëzve Arben Korça ishte bërë si i hutuar. Ai mendoi se tani në atë vend pati hyrë dhe vetë reparti i fonderisë.

Margarita po rrinte në krah të Arbenit. Aty për aty ajo mendoi se ata të dy shumë mirë mund t'i pozonin një skulptori për të bërë si model një kompozim në skulpturë me diciturën «Lumturia».

— Ngadalë, shokë, ngadaë, se po i shtypim heronitë!

— Më mirë të shpallin sot martesën. Ku do të gjeinë ditë më të lumtur. — Anastas Kitara do të lëshonte edhe ndonjë gafë tjetër, por Koco Opingari e zbriti fare pa vështirësi nga vendi ku kakariste si këndes.

— Flakë, flake jashtë atë shakaxhi!, — thirrën vajzat si në kor.

— Arben. Arben, falmë jetën!, — lutej ai që nuk pushonte së bëri shakara.

— Mos ia fal gafën. Arben!

— Jashtë jashtë atë shakaxhi!

— Si katandisi Anastas Kifara, si një kapan i varur.

— Ah, të kishim një fotograf ta nxirrnim në fotografi këtë shakaxhi të «varur»!

— Lëshomë, o div, o ari i murmë, o gjirafë!

— Jep fjalën se nuk do të turbullosh ujët!

— Mirë!

Kocoia e lëshoi, por ai nuk ndahej nga kitara dhe sigurisht që nuk do të ndahet dot dhe nga shqimet e vickëlat humoristike, do të lëshonte ndonjë torpillë që bënte të gajaste e gjithë oficina.

— Po mua më gënjet kështu!, — tha Marika Milka.

Ajo me një purpur të kuq hodhi njëherë vështrimin nëpër sallë se mos vallë ishte dhe ai atje, por nuk e pa gjëkundi, sepse njerëzit ishin mizëri.

— Erdhi fotografi, fotografi!

Kopi Nanushi u gëzua pa masë që ndeshi fotografin atje në atë çast aq solemn e të rrallë, por ai duhej të zbulonte se kush ishte autor i pat sjellë atë fotograf në oficinë.

— Kush ju ftoi të vini kaq shpejt në këtë gëzim, shoku fotograf?

Një djalosh me kitarë? Unë thashë se mos tallej me mua, por paska pasur të drejtë.

— Anastas Kitara!

— Një urra të fortë për ndërtuesit e makinës së gjuhëzës!

— Një urra për iniciatorin kryesor, për Arben Korgçën!

— Prisni, shokë, na lini të qetë, mblidhuni, mblidhuni pranë makinës!

— Mos flisni, lëreni në duart e fotografit.

— Si të rrimë; usta?

— Uluni!

— Ngrihuni!

— Nuk ju nxe vendi!

— Pushoni!

— Do të na nxjerrë me zë!

— Mos lëvizni!

— Ik që andezaj, buzëqeshni, buzëqeshni!

— Gati!

— Me shëndet!

— Arbeni e zgjati kokën me shpresë se mos vallë ndeshste mjeshtër Naumin, por, nuk pa asgjë.

— Në punë në punë, të gjithë në punë!, — tha Kopi Nanushi.

— Sot e kemi festë!, — thirri Anastas Kitara.

Kopi Nanushi vrenjti vetullat dhe vështroi vëngër Anastasin që nuk e zgjati. Vërvshimi i pandalshëm e kurreshtar i të gjithë atyre që patën ndihmuar për ndërtimin

e makinës së gjuhëzës i zhvendosi mendimin Kopi Nanushit. Ai e kuptonte se puna e mbarimit të linjës së gjil-përës nuk pati përfunduar dhe se vështirësitë e reja që u dilnin përpëra për mbarimin e të gjithë zotimit do të ishin përsëri të mëdha, por ishte i vendosur që zotimin para Partisë ta çonin doemos deri në fund.

— Nuk e di shoku drejtore, por unë sot jam aq i lumenj sa nuk bëhet hesap! — Dhosi Qafëzezi nxori dhe shaminë e pastër nga xhepi e fshiu një pikë lot në mollëzën e rruar të faqes.

Kopi Nanushi e mori vesh se magazinieri i magazinës së veglave lumturinë e paskësh të shoqruar me lot, ashtu siç e kanë pijen e rakisë të tjerët që bëjnë zullume.

— Ashtu, Dhosi! Por nuk kuptoj se ku qëndron lumturia jote, apo mos vallë për ato kushinetat e kursyera prej teje?

— Jo!, — kundërshtoi Dhosi dhe si me habi e vështroi Kopi Nanushin në fytyrë dhe, si të shprehët një sekret të madh, iu afrua në vesh dhe i foli: «Pse vallë a nuk të bën jetë lumtur kur jeton me njerëz të fortë, heronj të vërtetë, siç, i ka epoka e Partisë?»,

Dhosi Qafëzezi u largua. Ai ishte i bindur se nuk kishte pse ta zgjaste bisedën më tej, meqë gëzimin e tij e kishte shprehur me dy-tri fjalë që i kishin buruar nga zemra:

— Dhosi, o Dhosi vëlla! Arbeni e bëri fora, fora që e pastë motra sa malet, që i marrsha të gjitha të ligat! E bëri fora, xhani i motrës, — tha Dhimitrulla që po mbante fshesën në dorë për të pastruar oficinën, po s'po dinte nga t'ia fillonte nga hyrjet e njerëzve, që s'kishin të sosur.

— Sigurisht që e bëri fora, po këta lot q'i ke!

— O Dhosi vëllai, unë e di se sa ka vuajtur xhani i motrës, por Arbeni është djale për kokën e djalit, xhevahir e ja, më duket sikur ka fituar djali im.

Dhosi Qafëzezi e ndinte thellë në zemër se ndërtimi i makinës së gjuhëzës gëzonte dhe frymëzonë të gjithë njerëzit që luftonin për të bërë realitet porositë e Partisë. Dhosi eci më tutje duke menduar për detyrat e tij dhe iu bë qejfi për kujdesin e madh që tregonte Dhimitrulla për

mbajtjen aq pastër të zyrate, të korridoreve dhe të të gjithë ambientit të ndërmarrjes. Duke punuar me një ndërgjegje të lartë, ajo nuk e ndiente lodhjen dhe e kishte për turp të dukej ndokund **ndonjë pëlburë merimage** në-  
**për mure apo ndonjë letër e bisht** cigareje përtokë.

Duke vështruar të gjithë njerëzit që shkonin grupe-grupe duke nxituar hapat për të shkuar në oficinë, Dhimitrulla kujtonte kohën e vegjëlisë së saj kur u lutej me dorën e zgjatur për t'i falur diçka që të hante, sepse uria dhe vdekja ishin ulur këmbëkryq në baltën e shtëpisë së saj përdhese. Mirëpo lufta çlirimtare e rilindi edhe Dhimitrullën me një tufë kalamajsh të ngjallur si toptha dhe të qeshur si drita e diellit. E, duke krahasuar të gjithë këtë ndryshim në jetën e saj, ajo ndiente një gëzim të papërmabjatur për fitoren e Arbenit me shokë. Dhimitrulla, e pushtuar nga gëzimi, filloi të pastronte me atë fshesën që po mbante nën sjetull. Në hyrjen e derës së madhe atë e ndeshi një djalosh i gjatë që nga trupi e nga fytyra tregonte fisnikëri e dëlirësi, virtytë këto që e bënin njeriun nga tiparet të dashur e të mirë.

— More çapkën, mos je ai shoku i Arben Korçës?

— Unë jam, moj nène, unë jam. Por ja që roja nuk më njeh, të lutem i thuaj të më lejojë vetëm sa ta vështroj pakëz makinën që kemi bërë.

Dhimitrulla vendosi ta shoqëronte vetë atë djalosh që ajo shpeshherë e kishte parë së bashku me Arbenin.

— Po si quhesh ti që t'i them Arbenit?

— Alqi Katroja.

— U! Po ti je ai inxhinieri i ri?! — Ajo e la fshesën dhe iu afrua rojës, një plaku të imët e të thatë që po ngrohej në diell.

— Kaso lëre këtë inxhinierin! lëre!

— Ik o gjexh belanë; o Dhimitrullë! Ka fletëhyrje, le të hyjë. Kasoja nuk është librelal (ai nuk e shqiponte dot fjalën e huaj)!

— E de, e, e njoh unë. Ai është djali ynë!

— E po nuk po vështron se çfarë po bëhet? Ka fletëhy-

rje, Kasoja e lejon. Nuk ka fletëhydrje, Kasoja nuk e ha atë koqe ulliri

Meqë Kasoja nuk tundej nga e tija, Dhimitrulla shkoi me hapa të ngadaltë, u kthye nga mesi i rrugës, ia mori emrin në shënim Alqi Katros në një copë letër dhe shkoi me të katra. Në zyrë nuk gjeti njeri dhe ajo e mallkoi veten që nuk po tregohej e mençur dhe kërkonte njerëz në zyrë atë ditë kur të gjithë ishin shkulur për nga oficina. Por Dhimitrulla e kuportonte se mes rrëmujës së oficinës drejtor Kopi nuk do t'ia firmonte fletëhydrjen, prandaj më mirë për të do të qe sikur ta takonte Marika Milkën. Dhe fytyra e saj ndriti kur ndeshi vajzën mes grupit të inxhinierëve që po vështronin nga të gjitha anët makinën, e cila bënte një zhurmë ritmike dhe xirrte pa pushim flutura si një qimëzim pa mbarim dëbore.

— Drejtoreshë, Kasoja nuk e lë të hyjë një inxhinier, se nuk ka fletëhydrje (ajo enkas ia shtoi shkallën e përgjegjësisë).

— Cili është ai?

Dhimitrulla kaq kërkonte dhe ia zgjati fletën e vogël ku shënohej emri i atij që e bëri Marika Milkën të lëvizte cepat e buzëve me një gëzim që nuk e fshihte dot, gjë që i ra në sy edhe Dhimitrullës, e cila kafshoi lehtë buzën e poshtme, por nuk foli.

— Po vij vetë!

Ato ecën krah për krah pa folur dhe Dhimitrulla gjatë gjithë kohës po hetonte fytyrën e vajzës, e cila papritur mori një ngjyrë të tillë, sekretin e së cilës vetëm gratë e kuptojnë.

— Eh!, — ia bëri Dhimitrulla duke u ulur për të marrë fshesën.

— Ç'keni kështu, shoqja Dhimitra?

— U plaka, moj bijë, u plaka!

Dhimitrulla i vështroi të dy të rinjtë që shtrënguan duart tërë buzagaz, pozicionin gatitë të Kasos që nderoi çiftin që hyri në oborr, pa u ndalur dhe psherëtiu:

— Pika Kasos, plaku i djallit, vetëm të më mundonte mua e bëri të gjithë këtë punë! — Pastaj tundi kokën duke

e kritikuar veten e saj, mbasi u bind që Kasoja pat vepruar drejt, se ashtu ia kërkonte detyra. Edhe ai duhej t'i bënte sytë katër.

— Nuk ju prisja sot, Alqi!

— Më thanë që makina e gjuhëzës punon me sukses, e dini që kam ardhur me një frysme nga shkolla?

— Pse kështu?, — e pyeti vajza, e cila kërkonte të zbulonte qëllimin e vërtetë.

— Nga padurimi!, — iu përgjigj ai.

— Vetëm kaq?

— Oh, jo, doja t'ju takoja dhe ju!

— Në vjeshtë do të kemi dasma. Shumë dasma do të kemi. Alqi nuk përmbahej nga gëzimi.

### 3.

Naum Shanoja e mori vesh ndoshta i fundit nga të gjithë shokët e Arbenit lajmin që prova e makinës së gjuhëzës doli me sukses. I shtrirë në kanape ai u hodh përpjetë nga gëzimi, aq sa e shoqja, që nuk mori vesh se ç'ndodhi në atë çast, disi u hutua.

— Shpejt pantallonat, këpucët e jekun!

— Je në vete, ti ke të nxeh të, digjesh si një furrë e kërkon të dalësh jashtë??

— Grua! Mos më bëj nevrik, kupton apo jo?

— Nuk të lë dhe pikë!

— Pse, moj, xhandar je ti përmua?

— Pika ty! Si nuk fole një herë si duhet.

— Mirë, mirë, po më sill pantalonat e këpucët, se nuk pret puna.

— Pse, luajte nga mendtë të dalësh me temperaturë?

— Mos e zgjat.

— Unë e shkreta po të rri qiri mbi kokë e ti...

— Unë nuk jam në atë gjendje sa të qëndroj i shtrire në një rast si ky i sotmi.

— Kokës sate do t'i bësh keq, o Naum! Më plaçin sy-

të e ballit po s'vajta atje dhe t'u them atyre të Partisë që ti nuk e dëgjon fare fjalën e sat shoqeje.

— Hyner të madh ke për të bërë!, — ia priti ai duke veshur këpucët.

— Ku do të shkosh kështu, xhanëm?

— Atje ku kanë vajtur të gjithë shokët.

— Po ti je i sëmurë, o lumëmadh!

Naum Shanoja e vështroi vëngër, po s'foli. Ajo i hoddhi një sy të shoqit me atë kujdes që ka një amvisë e kujdesshme dhe, si i hoqi një fije peri të bardhë nga supet e kostumiit të zi, ia vuri pëllëmbën e dorës në ballë dhe e mërzitur tha përsëri:

— Mos shko, o Naum, se ke të nxehjtë!

— Mirupafshim!

Ajo e ndoqi trupin e të shoqit që luhatej në shkallët, ndoqi me kujdes hapat e tij që u ndien në trotuarin e rrugës dhe pastaj u afrua në dritaren që vështronë nga rruaga dhe ia cepi sytë trupit të tij që lëkundej derisa ai humbi në kthesën e rrugës përballë. Kalimtarët po e përshëndesnin me aq respekt, saqë atij i ngrohnin zemrën. E kush nuk e njihet Naum Shanon? Atë derdhës të fonderisë që u pati zbukuruar shtëpitë me ato lulet e derdhura në gizë në stufat e ngrohta që i kishin si ornamente në kapakët e mëdhenj tek mbulohej goja e madhe e stufave.

Kasoja që e njihet shumë mirë e përshëndeti me grusht, një privilegji që ai ia bënte rrallëkujt.

Në oficinë e pritën si me habi Miha Voskopoja, Kopi Nanushi, Arbeni e Koço Opingari. Margarita diç po vështronët në makinën e gjuhëzës, që punonte e shtruar, si një sahat i kolauduar që e hedh hapin e tij me hapin e zemrës.

— Naumi, paska ardhur Naum Shanoja!

Arbeni e rroku plakun dhe e puthi me dashuri. E pikasi se Naumi ishte me temperaturë.

— Po nga na vjen kështu, o Naum?, — i tha Kopi.

— Nuk e kuptoj pyetjen tuaj, o drejtor Kopi, — ia ktheu si i zemëruar. Kopi Nanushi, që nuk e dinte se Naumi ishte shakaxhi i dorës së parë, nuk dinte si t'i zbuste

zemërimin Heroit të Punës Socialiste, prandaj e vriste mendjen të zbulonte se ku e kishte ngacmuar usta Nau-min.

— Ti digjesh si zjarr, o mjeshtër Naumi!, — tha Arbeni.

Naumi e vështroi Arbenin me një dashuri me sytë e tij të futur thellë, që shkriheshin nga temperatura e lartë, e vezullimi i tyre dridhej si ajri që dridhet në ditët e nxehtha të korrikut,

— Digjem, se kam gjak!

— Jo, vërtet që ke temperaturë të lartë! — Margarita iu afrua me një vështrim gjithë këshilla.

— Pa më lini një herë të vështroj se si punon kjo «qerratucja» jonë! — Naum Shanoja iu afrua makinës dhe po e vështronte me kujdes e me një dashuri prej ati atë qenie që punonte ritmikisht. Atij iu duk se ajo punonte me ritmin e zemrës së një foshnjeje të porsalindur.

— Vështro, Marga, ti s'duhet të më flasësh fare, se nuk është koha për ato fjalë këtu, — i tha plaku kur u ndodhën përpara makinës së gjuhëzës.

— Ti ke bërë gabim të madh, xhaxha.

— Nuk më rrihej, moj bija ime, në shtrat. Më dukej sikur po më merrte vdekja pa parë këtë makinë.

— Po të jetë kështu, atëherë po e lëmë këtë bisedë. — Vajza, e cila në fillim deshi të shpërthente në qortime të rënda ndaj xhaxhait të saj që s'pyeste fare për sëmundjen, kur ndeshi në singjeritetin e tij, hoqi dorë.

— Më mbeti peng në zemër, shoku Naum, përse jua kemi prishur qejfin në të drejtorisë? — Kopi Nanushi ishte vrarë shumë dhe mendja i mbeti atje.

— Bëra shaka, o Kopi, — ia priti Naumi çiltër.

— Po të jetë puna kështu, dhe unë po tërhiqem, na e hoqe atë barrë të rëndë, shoku Naum.

— Makina punon shumë mirë, shoku Kopi.

— Po! Ju lumshin duart.

— Nuk ke fat, o Naum! Ja, ti vjen atëherë kur ka mbaruar e gjithë dasma... Mbete pa dalë në fotografi me kolektivin.

— Jo, o Miha Voskopoja, dasma tani sa ka filluar. Çdo ditë do të kemi dasmë më të madhe se Arbeni, Miha, Margarita, Koço Opingari, Alqi Katroja, ju vetë, o Kopi, nuk do të kënaqeni me kaq. Për fotografi, ta dish që më ka mbetur peng.

— Fjalë me vend na the, po ç'e do që ti nuk u ndodhë midis nesh.

— Të dërgoje një kaçator e të më thërrisje. Nuk isha larg. Pse më harruat?

— Kjo ndodhi pa pritur, o Naum! Tani sapo e bëmë provë.

— Dhe të justifikoheni, nuk dini. — Naum Shanos nuk ia hidhte njeri. Kopi nanushi u skuq në fytyrë, por nuk e zgjati.

Në sallën e madhe hyri me vrull Tori Pini, që udhëzonte dy punëtorë për të futur një arkë të madhe që ata vështirësi e mbanin nga pesha e rëndë.

— Kujdes, më nga e djathhta, pakëz nga e majta, mos e lëshoni, ngadalë, ashtu!

Veprimet e tij tërhoqën vëmendjen e të gjithëve. Tori Pini, kur vështroi se prapa tij fshihej një turmë e madhe njerëzish, u thirri:

— Ejani dhe na ndihmoni! Nuk po e vështroni se po na del shpirti nga pesha e madhe? Ç'bëni sehir?

Ai po e tepronte shumë, e sidomos kur shprehej se atij po i dilte shpirti nga pesha, të cilën nuk e pat prouvuar. U sulën që të gjithë dhe ja, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, arka u vendos në sallë.

— Ishte plumb e rëndë, — Tori Pini dalloj mes grupit dhe vështrimin e ngrohtë të Naumit, dhe interesin e syve të Kopi Nanushit.

— Fshini djersët, Taqkë, Dhimitraqkë e Petraqkë. — Tori Pini po shoqëronte fjalët me lëvizje të shpejta të duarve.

— E ku është Taqka që duhet të fshijë djersët, o Tori?

— Ai jam unë, — iu përgjigj Arbenit Tori Pini.

— Je lodhur shumë, i shkreti ti, — ia priti Anastas Kitara, që në çdo rast nuk e linte pa lëshuar ndonjë nga ato shakarat e tij të piperosura.

Aty shpërtheu një e qeshur e hareshme.

— Pse pak të duket ty të drejtosh? — Tori Pini u bë flakë në fytyrë dhe vështroi Kopin për të parë reagimin e tij. Tori u pendua pér atë pyetje pa takt që ndoshta do të keqkuptohej nga Kopi Nanushi. Por Kopi Nanushi nuk ka pi gjë nga shqetësimi i Tori Pinit dhe ai mbeti i kënaqur.

— Çfarë ke në këtë arkë, o Tori?

— Ja, edhe unë jam përpjekur të bëj diçka.

— Je vënë në garë me Arbenin, ë?

— E pse jo, me Arbenin dhe me të gjithë, — tha Tori Pini.

— Si nuk të rrinë duart rehat një herë, o leckaxhi?

Në oficinë u dhanë dhe inxhinierët Sotir Fillo dhe Adrian Bunça. Ata qeshnin dhe nuk dinin se kë të zinin më parë pér duarsh pér ta uruar pér fitoren. Arben Korçën, Miha Voskopojën, Koço Opingarin, apo Kopi Nanushin. Ndoshta kjo vështirësi e paparashikuar prej tyre i bëri ata të dukeshin pakëz të hutuar, megjithëse buzë-qeshja u lodronte në buzë.

— Sazam, hapu!, — thirri Tori Pini.

Të gjithë heshtën nga fjalët magjike. Ata po vështronin se çdo të dilte nga ajo arkë pas atyre fjalëve magjike, por u habitën.

Petraqi dhe Dhimitraqi në pëllëmbët e tyre kishin nga një liitar dhe u tërroqën duke shtyrë kureshtarët që ishin mbledhur përpara duke hapur të gjithë arkën që u zbulua në çast e përpara tyre doli një makinë krejt e re, e bardhë si ta kishin lyer me varak.

Kureshtja e njerëzve po shtohej. Ata po shtyheshin pér të parë se ç'kishte sjellë Tori Pini në atë arkë. Mos vallë ai, duke qenë i dehur nga suksesi që u arrit me makinën e gjuhëzës, kishte kurdisur ndonjë lodër?

— Uaa!, — u dëgjuan ca zëra vajzash.

— Po kjo?

- Vështro, vështro se sa mirë na e punoi Tori!
- Dunet te jetë makina e leckave.
- Nuk gjete gjë.
- Atenere do të jetë lavatrice.
- Jo, centrifuge gjalpi.
- Ai qe e gjen, ka një kate prej meje. — Tori Pini ishte ngritur ne majë të kembëve.
- Unë e di!
- Ti, Margarita, mos fol dhe ti, Arben, mos fol, ti e di.
- Eshtë makina e vatës, — thirri nga grumbulli Alqi Kastroja dhe e bëri Marika Milkën të skuqej nga faqet.
- Tori Pini u dha te makina si një akrobat me një kërcim prej maceje.
  - E pse tregove? Mos vallë bëre ndonjë punë të mirë?
  - Tori, për këtë makinë do të të urojnë kalamajtë e çerdheve, se vata do t'i mbajë ngrohtë e të pastër, — tha Anastas Kitaraja. Piasi një e qesnur e madhe.
- Talluni me makinën time, talluni, por ajo e ka vendin ja këtu përkarshi makinës së gjilpërës.
- Nuk i lejohet maces të qëndrojë përbri elefantit.
- Mjaft, shokë, mjaft. Ai nuk e mban shakanë e rrezik që në vend të penjëve e leckave të hidhet ai në makinë.
- Tori nuk del vatë!
- Por çfarë del?
- Shtëllungë vate.
- Qeshni, qeshni, por ta dini se kjo makinë e vogël na kursen një milion në muaj!
- Një milion lekë në muaj?
- Luaj nga vendi, Tori!
- Vështro, vështro «çifutin», po na tall ai ne tani.
- Po, shokë, kurzen një milion. — Kopi Namushi e pa të udhës që t'u vinte në ndihmë autorëve.
- Një milion. Ishte një shumë e madhe. Anastas Kitara iu afrua asaj makine që vezullonte nga bardhësia. Ai e goditi një herë me çok. Tingulli i saj i ngjante mjaullitjes së maces.
- Kjo makinë që duket sikur do të pjekë kafe, të kursejë një milion?

— Vështron që ka gjëra më të thjeshta që sjellin më shumë shërbime se ajo goja jote që pjell vend e pa vend shakara?

— Anastas Kitara, ta hodhi Tori.

— Pse ma hodhi? Ashtu është, — tha Anastasi dhe heshti. Sigurisht po sajonte ndonjë shaka tjetër, po s'po e gjente.

— Pse heshte, Anastas?

— Dale ta shohim pak këtë makinën e Torit.

Naum Shanoja eci me një hap xhambazi që i afrohet një kali të mirë dhe, sa dalloj se ajo ishte prej llamarine, qeshi me të madhe.

— Nga llamarina të bësh një makinë që të sjellë kaq fitim?! Të lumtë, të lumtë, o Tori!

— Jo! Ndal! Nuk jam unë autori. Janë këta shokët! — Ai e drejtoi dorën nga Petraqi e Dhimitraqi që s'po flisin, vetëm po dëgjonin shakarat e pa kursim që nuk kishin të sosur.

Një urra të fortë për të tre Taqkat!, — thirri Anastas Kitara.

— Urra!, — jehoi zëri i ngazëllyer i të pranishmëve. Tori Pini fshiu ballin me pëllëmbën e dorës së djathhtë dhe përshëndeti me kokë të pranishmit si një dirigjent që mbulohet me duartrokositje nga spektatorët.

#### 4.

Të pushtuar nga atmosfera e gjëzueshme, asnë nuk pyeti përfat e inxhinier Stefan Grabovës. Lajmi për arrestimin e tij nuk habitit njeri, e përmë shumë kur të gjithë morën vesh bashkëpunimin e tij me agjentin tjetër Vasfi Dishnica.

Vetëm Hamid Dëllinjës gjëzimin që ndjeu përfzilimin e atyre armiqve të tërbuar ia shushati një dëshpërim i thellë. Dhe kjo rriddhë, ngaqë ai i pat dhënë Stefanit një shumë të hollash borxh. Ajo shumë nuk ishte pak.

— Qelbanik që paska qenë ai Stefan Grabova. Unë as që dyshoja, por më vonë diçka zura të dyshoja e kjo vinte

ngaqë borxhet e mia, sa herë e takoja, bënte sikur i harronte. Maskarai!

- E sa lekë i ke dhën, o Hamid?
- Një mijë lekë të rinj.
- Një mijë lekë të rinj?, — u habit Arbeni.
- Një mijë!
- Qaji ato para, o Hamid, —e shpoi Anastas Kitara.
- Pse në rrugë i kam gjetur?
- Ik kërkoja në «kuvli»!
- Ku ta dish, gjykata mund ta detyrojë t'i paguajë.
- Në dreq le të venë ato të holla. Ai me kokë do t'i paguajë të gjitha fajet që ka bërë, se s'bën.
- Ti, Hamid, do të kesh shumë para, përderisa e paske darovitur edhe Stefanin...
- Anastas, të lutem më lër në hallin që më ka zënë.
- Të tjerët heshtën, sepse Hamidi ishte ndezur e mund të shpërthente vend e pa vend.
  - Ti e pe i pari kur ia hodhën hekurat? — Anastasi tani u bë serioz.
  - Unë!, — u përgjigj Hamidi.
  - Kushedi se si të erdhi, ë?
  - Për atë, pér atë qelbësirë?
  - Jo pér atë, po pér të hollat që t'i kullufiti.
  - Ti nuk di se çfarë flet, Anastas! — Anastasi nuk e zgjati më tej.

Hamid Dëllinja nuk kuptonte përsë njerëzit nganjëherë u japid kaq rëndësi të hollave. Por ai nuk nxitohej. Nuk fuste në kallëpin e njerëzve të ligj, siç ishin Stefan Grabova e Vasfi Dishnica, njerëzit e tjerë. Ai ishte i bindur se ai kallëpi ishte vetëm pér tipat e tyre e, nga sa kuptonte e vështronë Hamidi, ata krimba shkonin me dashje kundër rrjedhës së jetës së vrullshme, jetë e cila pér të gjithë njerëzit e mirë, të fortë, punëtorë e të ndershëm, nuk këmbehej me asgjë tjetër dhe ata të pakët që do të dilnin kundër kësaj rrjedhe të fuqishme sigurisht që do të shtypeshin nga vrulli i pandalshëm i kësaj jete të re e të begatshme.

— Mos u mërzit, i dashuri Hamid, — i foli inxhimier

Sotir Filloja. Ai për mjeshtrin e urtë e pa fjalë ruante në zemrën e tij një ngrohtësi që çel petalet e lules së respektit në të gjitha stinët e viti.

— Jo, inxhinier, nuk më vjen keq për të hollat e mia, por më vjen të çahem nga inati, sepse më duket sikur unë kam ndihmuar një të poshtër, një krimb që duhej t'i shtypnim kokën me kohë.

— Zemërimi yt është i drejtë, por ec e hapja zemrën njeriut të atillë, o Hamid. Që të kuptionim dhe të zbulonim çfarë po gatuante me kohë Stefan Grabova së bashku me Vasfi Dishnicën, si ti edhe ne duhet t'i bënim sytë katur.

— Hë, pra, përsë nuk i bëmë, o inxhinier Sotiri?

— Po të kishte hapur sytë, nuk do ta daroviste me një-mijë lekë, — tha Anastas Kitara përsëri.

— Të hollat e mia janë e keqja më e vogël, por me ato që ka bërë ai hëngri kokën e tij.

— Kokën e tij, po edhe paratë e tua.

— Punë e madhe, do t'i vjellë që të gjitha, inxhinier.

— Ajo është e qartë, xhanëm, po përsë të përfitonë nga ti? Edhe mua më kërkoi borxh ai rufjan, por unë ia prisja drutë shkurt. «Përsë, nuk të mjaftoka rroga ty?», — i thashë dhe nuk u ndie më, kurse ti u tregove dorëlëshuar. Këtu ta kam llafin unë, o Hamid.

— Mua as që më shkonte ndër mend se Stefan Grabova ishte i krimbur. Besoj se edhe juve, inxhinier, nuk ju kâ vajtur.

— Që është armik, nuk na ka vajtur, por që ishte batakçi, po. Prandaj edhe i kam têrhequr vërejtjen përsë nuk i mjaftonte rroga.

— Që nga fillimi i makinës së gjuhëzës shumë çështje kanë dalë më në pah. Kjo i ka vënë njerëzit në peshore si për mendimet edhe për veprimet e tyre, — tha Koço Opengari që deri atëherë kishte dëgjuar se ç'po thoshin të tjerët.

Të tjerët miratuan me kokë, Sotir Filloja e vështroi

Hainidin që rrinte i menduar dhe i hequr në fytyrë dhe tha:

- Vërtet që je hequr pak!
- Nuk jam peshuar, por ndihem mirë nga shëndeti!
- Hamidi ia hodhi bukur.

— Ke të drejtë, i dashuri Hamid, — ia priti Sotiri. — Jeta shkon përpëra e ata që ndjekin hapat e shpejtë të saj, sigurisht kanë respektin e brezave që do të vijnë. E një nga këta je edhe ti, Hamid.

— Në këtë ushtri që e hedh hapin me kohën radhitesh edhe ti, inxhinier. Bile Arbeni na ka thënë shpeshherë se ju keni kontribuar shumë për makinën e gjilpërës.

— Veç kjo është makina e parë që mua me disa të tjerë na zgjoi nga gjumi, Hamid, bile na shkundi nga mendimet e konceptet frenuese.

— A e dini se ku e keni të keqen, inxhinier?

— Ku?

— Pikërisht se nuk ju hyn në sy mendimi i klasës dhe veten, diplomën e mbivlerësoni.

Sotir Filloja tundi kokën e po mendohej t'i jepte apo të mos i jepte të drejtë mendimit të Hamidit që kishte thënë një të vërtetë. Iu kujtuan profkat e Stefan Grabovës që, kur pat mbaruar shkollën e lartë, e vështronte veten sikur të ishte mbi një jastëk ajri dhe qëndronte disa pashë mbi të gjithë njerëzit e punës fizike dhe se ai kishte lindur vetëm e vetëm për të urdhëruar, kurse njerëzit e punës fizike vetëm për të zbatuar mendimet e tij.

— Ju keni të drejtë, Hamid. Ata që derdhin çelikun, nxjerrin flori nga barku i tokës, ngrenë oxhaqet drejt qieillit, janë më të fortë, kanë guxim e besim në forcat e veta, kurse ata që mburren vetëm me diplomën, janë të qullët e kanë frikë debatet e telashet.

Sotir Filloja u bind se duhej ta thellonte më tej gjykimin e vetvetes se ku ndodhej dhe q'vënd zinte ai në rrugën e revolucionit. Ai vendosi që të fillonte një remont kapital të shëndetshëm në vetvete dhe në familje dhe do ta bënte.

— Këtu qenke?, — i tha Adrian Bunça disi i ngrysur.  
— Çfarë ke kështu, Adrian? — Sotir Filloja dëshiron te të mos ndahej nga mjeshtri, megjithëse sytë e Adrianit ia bënë shumë herë me shenjë që të shkonte pas tij, sepse ai kishte diçka për t'i thënë.

— Fol hapur, Hamidi është shoku ynë, Adrian, — e qetësoi Sotiri.

Adrian Bunça e vështroi një herë me ata sytë e mprehtë që fshihnin një shqetësim dhe një pyetje të hafshime. «Mos vallë ke luajtur nga mendja?!».

— Nuk kam asgjë, dola ashtu kot këndezaj, — Nuk deshi të hapej në sytë e Hamidit.

— Hape të shkretën e thuaj se të kanë hyrë në trup mornica, sepse kanë arrestuar ata qelbësirat, Vasfi Dishnicën e Stefan Grabovën, apo jo?

— Të duket vetja sikur bën shakara, por mos harro se ata të poshtë mund të hedhin baltë mbi ne!

— E përsë? Ç'kemi pasur ne me ata maskarenj, me ata armiq të tërbuar, — foli Sotiri i ndezur në fytyrë.

— Mirë thotë Sotiri, se, po s'hëngre hudhër, nuk ka përsë të të vijë era, o Adrian!

— Mirë thua, o Hamid, por faqeziu bën çmos të njosë, të paktën të pluhurojë sadopak të tjerët që ka pasur përreth.

— Për këtë fli i qetë, inxhinier, se secili me aktivitetin e tij ose e turpëron veten, ose e vendos personin e tij në vend nderi. Të thuash se nuk i kuptuan më parë, po, por për tjetër të mos të hajë fare meraku.

— Bukur, shumë bukur e përcaktuat, shoku Hamid. Keni goditur tamam në shenjë dhe s'ka përsë të shqetësohet askush, — tha Sotiri.

— Partia në çdo çast e ka ndarë mirë shapin nga shëqueri, inxhinier. Por si mua edhe ju duhet të na shqetësojë fakti që nuk i kemi diktuar më parë këmbët e gjarprit. Kjo më vret në shpirt.

Adrian Bunça po e përtyponte atë mendim të shprehur aq thjeshtë, por që filloi t'i qetësonte shpirtin. Edhe ai qortonte veten që nuk kishte mundur të diktonte asgjë të

Stefan Grabova. Dhe kjo vinte ngase asnjéherë nuk pat vlerësuar politikisht shprehjet e qéndrimet e tij.

— Dua t'ju pyes, vallë, a nuk ka mundësi të shpifë e të trillojë Stefan Grabova ndaj meje.

— E çfarë të shpifë pér ju, inxhinier?

— Por ja! Të thotë që në fillim edhe unë nuk kam qenë i bindur që linja e gjilpërës mund të ndërtohet me forcat tona.

— Pér atë ka pasur edhe komunistë që kanë dyshuar. Ky është mendim frenues, po jo veprimitari armiqësore, inxhinier!

Adrian Bunça tani u qetesua disi. Ai po bluante në kokë fjalët e Hamidit. Vallë si inxhinier i revolucionit ai në cilat pozita ishte? Ai vërtet në fillim nuk pati besim në ndërtimin e linjës së gjilpërës, por pastaj jeta e kishte bindur dhe pak a shumë kishte kontribuar diçka. Po ajo tani i dukej aq pak, saqë po i vinte turp dhe nga vetvetja.

U skuq nga gjyqi i heshtur i ndërgjegjes e, duke mos ditur se ku ta fshihte ashpërsinë e këtij gjyqi, tha:

— Partia, populli na i hapën sytë, na bënë inxhinierë. Ne u kemi borxh mundin, djersën, bile edhe gjakun tonë.

— Dukej se Adrian Bunça ato po i thoshte me zemër të lehtësuar e të ngrohtë. Tani nuk kishte asnje turbullim në shpirt. E ndiente se në të ardhmen ai duhej të mprehte mendimin, të thellohej në gjykimin e mendimeve dhe të veprimeve të tjerëve, që të mos e hante sapunin pér djathë.

## 5.

### Një Maji.

Atë ditë të bukur e të gëzuar, të mbushur me aq rezultate e fitore të arritura nga klasa punëtore me organizatën bazë të Partisë në ballë, Arben Korça e ndiente vreten më të gëzuar se asnjéherë. U ngrit herët si zakonisht, se nuk i rrihej në shtrat. Po dëgjonte radion. Ajo po jepte marshe e muzikë. Nga ana tjetër e rrugës u ndie banda e

qytetit dhe kënga e trumpetave. Zërat e gjëzueshëm të pionierëve jehonin kudo. Rrugët e sheshet ndrisnin nga pastërtia. Flamurët kombëtarë dhe ata të kuq, që valëviteshin në hapësirë si shqiponjat në fluturim krijorin një kontrast të madh me fasadat e bardha të ndërtesave shumëkatëshe të stolisura me parulla e banderola.

Sofie Korça që po merrej me punët e kuzhinës u dha në dhomë me hapa të ngadaltë. Ajo si një hije u vërtit rrëth dhomës e zuri të këndonte një këngë të lashtë populllore, që shquante për tonin epik. Toni epik e triumfues i kësaj kënge Arbenin e futi në mendime. «Po, kush lufton, doemos fiton», — pohoi ai me vete.

— Mbrëmë dhe sot në mëngjes radioja për ty dhe sho-kët e tu ka folur.

— Ashtu?

— Posi! Mua m'u ngroh zemra aq shumë, sa tërë natën nuk kam fjetur nga gjëzimi, mor bir!

— Vështro se mos lëvdohesh në shoqet kur mban radhë në dyqanet.

— Unë të mburrem? Pse çfarë jam unë, ndonjë bur-gjeze që të rrah gjoksin përpara të tjerëve? Por mua në dyqane më lënë radhën përpara të gjithëve. «Kalo, — më thonë me buzë në gaz të gjithë burrat e gratë që më njohin. — Kalo përpara nesh, moj nëna e Arbenit»!

— Dhe ti kalon?

— Unë në fillim bëj naze, sikur nuk dua, por ata, more bir, ngulin këmbë dhe flasin «Shko, nëna e Arbenit, shko, sepse ai na ka nderuar!».

— E ti shkon, ë?

— E po si të mos shkoj, jam aq me mendje sa të mos i zemëroj njerëzit.

— Ta dish që bën gabim!

— Pse bëj gabim? Unë nuk u kam kërkuar që të më lejojnë jashtë radhës, por ja që ata vetë më lënë, mor bir!

— Kur të thonë ashtu, ti rri e heshtur në radhë e mos fol.

— Ti e di se unë nuk rri dot pa folur, sidomos tanë që zemrën e kam plot. Por më mirë të shkoj e të vështroj

se mos më digjet gjella në zjarr, sesa të rri e të grindem me ty.

Sofie Korça vajti deri në mesin e dhomës e pastaj seç iu kujtua dhe u kthye e vazhdoi bisedën e lënë në mes.

— Pa le se çfarë thonë njerëzia, mor bir!

— Çfarë thonë, nënë?, — tha Arbeni me vështrimin të përqëndruar përjashta, diku larg.

— «Lum Sofia pér atë djalë që ka. Djalë që ta pish në kupë, éshtë si flori në mushama».

— «Lum ajo që do ta marrë».

— «Djalë aq të mirë si vështirë éshtë të gjesh sot», — thonë.

— Pse s'del atje ku e ke qëllimin, nënë? — Ai e dinte se ku i rrihte asaj.

— Si je bërë, o bir? Ta rrëmben fjalën nga mendja e jo nga goja! Se ç'bluan ajo koka jote? Mos vallë të ka hipur përsëri ndonjë gjë në kokë dhe merresh me ndonjë punë tjetër e mbetesh pa martuar?

— Vendosa të marto hem, nënë! — Arbeni buzëqeshi dhe e vështroi të ëmën në sy.

Sofie Korça shtangu në vend. Nuk po u besonte vësheve. I vërtitej dhoma, muret dhe pastaj iu duk se po vështronte Arbenin hipur në rodhanin e fëmijëve. Prapa e ndiqnin të gjithë, dhe ata hipur nëpër kuaj, luanë, makinë, aeroplanë, në varka e automobilë, bërtisnin me hare. Ishte shporeja e dasmorëve të gëzuar. Pastaj Sofia e vëshur me një xibun leshi të zi të rrahu fort në vegël, me një xhamadan të endur e të zbukuruar me lila në kokë, një shami të madhe ngjyrë vishnjë në të errët si fletë çeliku.

Oborri i mbushur plot e përplot me fëmijë. Orkestra ka zënë vend në mes të oborrit dhe nuk kursethet e nuk pushon asnë minutë. Tingujt e gënernetës jehojnë me të madhe aq sa shtëpia dridhej e burrat e shëndoshë ia hedhin valles që tund dyshemenë.

Sofie Korça kishte myllur sytë përgjysmë dhe poënërronte si të bënte një dasmë të madhe që të habiste të gjithë qytetin. Por ajo me kohë kishte menduar pér këtë

dhe kishte vënë mënjanë aq të holla sa i nevojiteshin pér t i dalë më anë asaj dasme me shpenzime të mëdha. Vetem ajo e dinte se çfarë kishte vënë në atë sëndukun e madh, qe i kishte mbështjellë fort në shaminë e nusërisë dhe i numëronte herë pas here.

— Do ta djegim, o bir, se të kam si një luan. Do të bëjmë një dasmë të madhe, sa të habitet i gjithë qyteti.

— Seç mban erë, nënë?

— U, korba unë, u dogj gjella në zjarr!

Sofia vrapoi me të katrat pér një kuzhinë. — Përpjekja pér të shpëtar gjellën kishte qënë e kotë. U kthyte në dhomë tek Arbeni.

— Na e mori të keqen gjella, kurban të na bëhet!

— E po dasmë pa mish nuk bëhet, nënë!, — ironizoi Arbeni dhe qeshi me të madhe.

— Mos ma thyej zemrën, Arben! Në dasmën tënde do ta djeg se s'bën. Mos më thënë Sofie Korça po nuk nuk e nxora rakinë me gjyma!

— Me gjyma, me gjyma, po nuk të lë njeri!

— U! Si nuk më lë! Fundja unë prish paranë time dhe pér këtë punë që bëj, nuk ka të drejtë asnjeri të më kërkojë llogari. Ja, që thua ti, Arben, se çfarë mendoj të bëj. Nuses do t'i bëj një peshqesh të mirë se s'bën. I kam tak-sur t'i blej një sahat dore prej atyre më të mirëve, pastaj do t'i bëj edhe ca peshqeshe të tjera, se ashtu e do zakoni. Le të vejë sa të vejë, do të përgatis një kostum dhëndërie që të mos e ketë bërë kush në qytetin tonë. Edhe pér shpenzimet e dasmës kam menduar me vakt e me kohë.

— E unë mendoja se kisha një nënë revolucionare, kurse ti, shtrembëroi buzët Arbeni dhe tundi kokën.

— Pse nuk jam revolucionare?

— Një revolucionare nuk mendon kështu.

— E si mendon një revolucionare?

— Të bëjë një dasmë të thjeshtë, pa shumë shpenzime dhe pa shumë bujë e krekosje siç kërkon ta bësh ti!

— Po unë një djalë kam.

- E pastaj? Dhe këtë djalë që ke, kërkon ta turpë-rosh?
- Ta martosh thuaj, o qafir!
- Po të bëhet kështu siç mendon ti, ta dish që unë nuk do të martohem fare.
- E ku e ke hallin ti, xhanëm?
- Te shpenzimet e kota e buja, nënë!
- Pika mua. Pika mua që kam menduar gjatë përgëzimin tënd!
- Kot rënkon e mallkon veten, nënë!
- Se mos ke menduar ti, bandill, të më gëzosh një herë si nënë që më ke! Pas gjithë këtyre telasheve që na nxore me gjilpërën, unë dua të gëzoj se s'bën!
- Ke të drejtë të gëzosh, po jo me bujë e potere! — Arbeni i foli me të butë, por i vendosur në të tijën. Ai përpinqej ta bindte, po Sofia, s'luante nga e saja.
- Po ç'ke ti, o malukat? Fundja, në qoftë se turpërohem, unë do të turpërohem!
- Sa ngushtë që mendon ti, nënë!
- Posi, ngushtë! Fundja cilët do të ftojmë? Ja t'i numëroj unë: drejtor Kopi një, Miha dy, Alai tre, Koço Opingari katër, shokët pesë, miqtë gjashtë, disa nga fisi im shtatë, nga fisi i babait tënd tetë. Për shtatë-tetë të ftuar na prish dasmën e na thyen zemrën, ë?
- Pak për besë, një batalion!
- Një batalion. Po si kujton ti, të bëj unë një dasmë partizanë sikur e kemi nusen të vjedhur!
- Ashtu dua unë!
- Do ti, po nuk dua unë. More, kush është këtu kryefamiljari, unë apo ti?
- Ti, nënë!
- Dëgjomë mua atëherë!
- Shpenzimet e tepërtë kritikohen me të drejtë, nënë!
- Ç'ke ti, o lumëmadh? Unë ha mollë të tharta, ty t'u mpikan dhëmbët! Po e di ti, o pëllumb, sa borxhe më ka-

në njerëzia e fisi mua? Unë kam çuar peshqeshe. Ata duhet të m'i kthejnë, se u kam vajtur me kulaç e mish...

— Jua kam falur që të gjithëve.

— Pika! Po ku ka lezet një dasmë e thjeshtë si gjella pa kripë? Ashtu do të tallat bota me mua.

— S'kanë përsë të tallen me ty.

— Do të thonë se Sofie Korçës i ka hyrë kopraclëku në shpirt. Një djalë ka dhe s'ftoi as rrëthin familjar në dasmë!

— Ne do të bëjmë ashtu siç na mëson Partia, nënë. Përse të dëgjojmë se ç'thonë llupësit?

— Partia nuk ka thënë që t'u vëmë kazmën dasmave. Mos pandeh ti se jam ndonjë grua leshko! Unë i di mirë gjërat në themel. Apo pandeh se ti i di më mirë nga unë ato që thotë Partia? Andaj dëgjo mirë fjalën time!

— Ti e di, nënë, aë të dëgjoj për çdo gjë dhe kurrë s'ta kam prishur, por shpenzime të kota e bujë nuk dua. Apo do të më kritikojnë edhe me gazetë?

— Le të të kritikojnë një herë, se nuk bëhet qameti. Mjaft të lëvduan me radio e gazeta. Unë nusen, që do të ma mbushë shtëpinë, pëqirin me nipka e mbeska, nuk do ta marr fshehtas. Ei, vëri gishtin kokës! Ku të çon mu-shka, se më çmende!

Arben Korça u shkul së qeshuri e zëri i tij i mbushur me gjithë ata tingui të gëzueshëm dëgjohej në rrugë. Vajti dhe e përqafoi për t'i zbutur zemërimin.

— Qesh ti. aesh, por mos më thënshin Sofie Korça po nuk vaita te Miha, te Kovi dhe më lart, për t'u treguar se kjo koka jote do gdhendur, se s'bën!

— E ke të humbur davanë, pra!

— Pse e kam të humbur? Ata janënierëz me mend në kokë e do të më marrin vesh, se nuk janë kungui si ti. aë i merr gjërat toptan. Unë i kam svtë në ballë dhe kam parë me këta sy se çfarë dasmash kanë bërë dhe nierëz të tierë aë nuk janë komunistë më të vegjël se ti.

— Ata gabim kanë bërë dhe janë kritikuar.

- Posi! Gabim për ty! Por ja ku po ta them. Unë gjallë pa dëgjuar tingujt e orkestrës, erën e mishrave të pjejkura e të rakisë nuk e fus nusen në këtë shtëpi.
- «Gjella me kripë e kripa me karar», thotë populli.
- Atë e di unë. Ti vështro e çoje deri në fund punën e gjilpërës dhe kujdes se po të rritet mendja.
- Ashtu?
- Po, po. Për makinat di ti, për në shtëpi di unë...
- Arbeni buzëqeshi dhe ia hodhi duart në qafë.

Armëpushimi midis tyre pat mbaruar. Sofia nuk përmabahej nga gjëzimi se kishte dy dasma të mëdha që ajo nuk mund t'i ndante nga njëra-tjetra, ndërtimin e makinenës së gjilpërës dhe martesën e Arbenit tanë i quante një të vetme. Ajo e ndiente dhe e kuptonte mirë se kudo, në çdo skaj të jetës së përditshme, parrulla «të mbështetemi fuqimisht në forcat tonë» kishte depërtuar deri te vocërrakët e kopshteve. Ajo ishte bërë kushtrim.

## 5.

Këshilli teknik u mblodh mbas festës së Një Majit. Zyra e madhe e Kopi Nanushit dhe korridoret shndritin nga pastërtia. Një javë para festës Dhimitrulla i pat bërë dritë xhamat e zyrave, perdet e dritareve i pat larë e hekurosur, bile pat vajtur te magazinier Dhosi Qafëzezi e pat kërkuar perde tyli për zyrën e byrosë teknike, kortinat e së cilës qenë bërë të verdha nga tymi i cigares.

— Të shkëlqen ftyra, moj Dhimitrulla, si ta kesh lyer me xhela këpucësh!, — e kishte ngacmuar pastruesen Dhosi.

— Kemi festë, o Dhosi, e njeriu, kur ka festë dhe gjëzon gjithë të mirat, mëkat të mos shkëlqejë nga ftyra. Ndrysuan kohët, ndrysuan njerëzit, ndrysuan dhe mendimet!

Dhosì Qafëzezi tundi kokën me leshra të bardha dhe po habitej për fjalët e mençura të pastrueses. «Vërtet ndryshuan mendimet e njerëzve. Në fillim iniciativën e Arbenit për gjilpërën disa e quajtën endërr me sy hapët, kurse tani ajo u përqafua të thuash nga i gjithë kolektivi. Bile u bë nxitje edhe për ndërmarrjet e tjera», — pohoi me vete Dhosi.

— Mirë thua, Dhimitrulla, po, që thua ti, unë perde tili nuk të jap, po laj ato kortinkat që kanë, se duhet të kursejmë kudo e në çdo gjë, na mëson kjo parulla që kemi vënë këtu. Apo nuk të ra në sy? — Xha Dhosi i tregoi parullën e shkruar me shkronja kapitale.

Dhimitrulla lexoi parullën dhe u skuq në fytyrë.

— Mirë thua, o Dhosi, po ata të zyrës teknike më posositën kështu.

— Perdet e tylit, thuaju, më tha Dhosi, janë luks i tepruar.

Ora dhjetë e paraditës. Dhimitrulla e mbështetur në parmakët e shkallëve vështronte anëtarët e këshillit teknik që po futeshin në mbledhjen që bëhej në zyrën e drejtësor Kopit. Ajo i njihte mirë anëtarët e këshillit teknik, por dy prej atyre që vajtën në atë mbledhje, Dhimitraqin e Petraqin, një çift shokësh si Çuku e Geku që nuk ndaheshin gjökundi, që skuqnin nga faqet, dhe iu dukën disi si të hutuar, ajo për herë të parë i kishte lajmëruar për mbledhjen e këshillit teknik.

Inxhinier Sotiri dhe inxhinier Adriani ngjitën shkallët së bashku. Dhimitrullës iu bë qeifi se si njëri dhe tjetri e përshëndetën me kokë, gjë që nuk e kishte vërejtur asnjëherë tek inxhinier Stefan Grabova. «Hë, qeni! Të

tjerët i dukeshin miza. Askush nuk i hynte në sy maskarait!», — mendoi ajo ëdhe u ngrys në fytyrë.

Miha Voskopoja, Arbeni dhe Margarita nuk ndareshin. Ata u ngjitën së bashku në shkallët e ngushta e Dhimitrulla u ngjit lart për t'u hapur rrugën.

Më dhjetë filloj mbledhja. Korridori i ngushtë ra në qetësi. Dëgjohej vetëm tiktaku i sahatit të murit. Dhimitrulla e qetë mori karrigen e saj të zakonshme e vendosi në hyrjen e korridorit dhe hodhi fillin e çorapes që pat lënë përgjysmë dhe mori shtizat. Një grup vajzash ndaluani përposh shkallëve dhe zunë të tregonin ngjarje të gëzueshme. E qeshura e tyre e hareshme bëri që Dhimitrulla të sulej si një skifter poshtë shkallëve atje tek porrinin ato.

— Të keqen Dhimitrulla, uleni zërin, se po prishni qetësinë, — u tha ajo vajzave.

— Pse ç'ka ndodhur, teze?, — u habit njëra prej tyre

— Lart në drejtori bëhet mbledhje me rëndësi.

— Përse është mbledhja, teze?

— Ku di tezja, po mendja më thotë se për gjilpërën.

— A?

— Mbledhja e këshillit teknik!

— Na fal, teze!

— Nuk e dinim!

— Ikëm!

Dhimitrulla e mori karrigen dhe e zbriti poshtë, atje tek ishte grupei i vajzave. Mendoi se do të ishte më mirë dhe për të, dhe për qetësinë e mbledhies. Por ja që Anastas Kitara e solli kokën andezaj dhe filloj nga romuzet e tij të zakonshme:

— A. Dhimitrulla, na qenke bërë tepër serioze sot?

— Pika ty, o Tasi (ajo u përgjigj romuzeve të tij me shkurtim emri).

— C'e do aë s'kam nië aparat të të marr ca poza tak-fak, që ta shihje seriozitetin tënd në resme.

— Pusho i veremosur, ka mbledhje lart!

— E pastaj?

— Si pastaj! Duhet qetësi. Ata po vrasin mendjen për

punëra të rëndësishme e jo si ti që di vetëm të hargalishesh.

— Bota pa ne do të ishte e mërzitshme, — tha ai serioz. Dhimitrulla buzëqeshi lehtë, vështroi një herë nga syzet e saj dhe me vete i dha të drejtë mendimit të tij, sepse Dhimitrulla si edhe të tjerët ngazëllehej nga shakatë e Anastas Kitarës. Tjetër se ai herë-herë edhe e tepronter.

— Mirë thua, o Tasi, ti je djali ynë, por unë e kam fjalën që të bëhesh shakaxhi serioz, si ajo gazeta që i kritikonte ata shakaxhinjtë që nuk janë seriozë.

— Je për humorin pozitiv, ë?

— Ik shporrmu sysht, se e teprove!

— Mos m'u hakërrë kështu, se po më pushon zemra, Dhimitrulla.

— Ku ke zemër ti, o këndes, që këndon vakt e pa vakt.

— Këndésët e kanë për detyrë të këndoijnë, ndërsa pulat vetëm të kakarisin.

— Ik, o i paudhë, ik, — i foli Dhimitrulla dhe mori karrigen e u ngjit përsëri lart në korridor vetëm për ta hequr qafe, se Anastasi nuk po shqitej.

Në korridor miza të fluturonte ndihej.

Në orën dympëdhjetë u hap dera e drejtorisë. Dolën njëri pas tjetrit. Dhimitrulla mendoi se ata dolën sa përt'u çlodhur. Vajti me të shpejtë për të mbushur me ujë të freskët kanën e madhe, që kishte vënë në zyrën e Kopit që në mëngjes. Në zyrë ndeshi me drejtorin që po bisedonte me telefon me Tiranën. Kopi e vështroi, por nuk i bëri shenjë Dhimitrullës të largohej siç ndodhët herët e tjera. Drejtor Kopi dhe të tjerët duke sheshin të entuziazmuar. «Keni të drejtë, shoku...! Arbeni? Mirë! Do të vij. Patjetër do jem dhe unë. Ju falemnderit!», — tha Kopi. Miha e Margarita po prisnin në këmbë. Dolën së bashku për kafe.

Në orën dympëdhjetë e tridhjetë filloj mbledhja përsëri. Dhimitrulla rrinte e mendohej sa ishte urtësuar ai Kopi Nanushi që kishte ndryshuar si dita me natën me atë

Kopin e parë që, kur nevrikosej kot së koti, i ngriheshin qimet si kreshta e luanit!

«Vërtet kanë ndryshuar shumë njerëzit këto vitet e fundit. Kjo gjilpëra e Arbenit i shkundi, po, po, i shkundi», — mendoi Dhimitrulla.

Në orën katërbëdhjetë e pesëdhjetë minuta mbaroi mbledhja. Dhimitrulla nuk pati rast ndonjëherë tjetër të vështronte një mbledhje të madhe që të mbaronte me aq urtësi sikur të gjitha fjalët e tyre të kalonin në vatën e Tori Pinit.

Ajo pa Tori Pinin që po puthte Arbenin në faqe, duart e mëdha të Miha Voskopojës në supet e gjera të Arbenit, i cili nuk fshihte dot gëzimin që e kishte pushtuar; Margaritën që u buzëqeshte të gjithëve me lumturi; inxhinier Sotir Fillon që i dha dorën Arbenit dhe e rroku për qafe; inxhinier Adrianin që Arbenit i shtrëngoi dorën me të dyja duart dhe pastaj rroku për qafe Koço Opigarin.

«Çfarë po ndodhët kështu me ta? Përse kaq shpejt e mbaruan mbledhjen? Herët e tjera debatonin me fjalë shumë të ashpra e ajo kishte dëgjuar zëra të ngritur: «Bëhet». «S'bëhet». «Endërr në diell!». «Bëhet që ç'ke me të, po s'doni të prishni rehatin, qetësinë mikroborgjeze! . . .». «Ti po na fyeni!» «Unë po them të vërtetën!» . . . e dilnin të zemëruar e të skuqur në fytyrë duke mbajtur kokën mënjanë. Kurse sot kaq të qetë e të urtë si shqerrat! Siç duket të gjitha grindjet këtu i kishte futur ai faqeziu, ai i mallkuari Stefan Grabova, po e gjeti vendin maskarai!», — poħoi me vete Dhimitrulla.

— Mbaroi mbledhja?, — pyeti Marika Milkën Alqi Katroja që u dha në fund të shkallëve.

— Mbaroi!, — iu përgjigj ajo shënd e verë.

— E si u **vendos**?

— Që të ndërtohen me forcat tona tri linja për prodhimin në vend të të gjitha llojeve të gjilpërave.

— Domethënë iniciativa e Arbenit u miratua?

— Njëzëri, — tha Marika. — Të gjitha makineritë për të tri linjat do të prodhohen në vend në kooperim me ndër-

marrjet e tjera. Çdo linjë do të prodhojë një grup gjilpërash. Çdo grup ka njëzet lloje. Sipas grupeve e llojeve gjilpërat kalojnë nëpër shtatëmbëdhjetë, pesëdhjetë e gjashtë deri në nëntëdhjetë e gjashtë procese pune. Domethënë do të ngrihet një oficinë e tërë për prodhimin e të gjitha llojeve të gjilpërave.

— Afati?

— Brenda vitit 1978.

U shkrua në Korçë

1977

F u n d